

# RESUL BEDO

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

85H-31

B 36



## GJURME TE NDEZURA

ROMAN


RESUL  
BEDO

854-31

B 36

GJURMË  
TË NDEZURA

ROMAN



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

*Në çdo hap që hedhim shkelim në gjurmët tona, na del përpara një gérxh, lugine apo pllajë; vështrimi ynë ndesh në vende të njo-hura. Përmendim emra të shokëve që ranë në luftime, mbledhim krisma të armëve dhe këngët e tyre. Na qëndrojnë këto ditë më pranë shokët e rënë, sofra kosovare... votra kosovare dhe jehona e ditëve me luftime.*

*Kujtojmë... Gjithnjë kujtojmë... Ato që jetuan dje, në luftë, pleksen në një të vetme me mbresat e këtyre ditëve.*

*Ecim mbas krismave të pushkëve tona, në gjurmët e gjakut tonë.*

Lugina midis vargëzimeve të maleve, përmes së cilës brigada jonë duhet të kalojë në veri të lumenit Drin, ishte e zënë. Armiq të shumtë e të egër qëndrojnë nëpër

shtigje. Me këto radhë nisin shënimet e mia ngajeta në luftë. Në faqet e para të ditarit shkruaj:

«... Diçka që pritej. Afrimi i brigadës partizane u prit në luginën e Drinit të Zi me rropama të çjerra daullesh dhe klithma zérash të ngjirur, plot frikë e panik, që shpërndahen nga kulla e bajraktarit:

«Bjeruni daulleve!»

«T'u pritet turri komunistave!»

«Merrni në shenjë komunistat!»

Populli vërtet u ra daulleve, por jo sepse cirret bajraktari. Ai lajmëron: «Çohuni, burra! Erdhën brigadat partizane!»

Ditë me kisma... Ditë me alarme! Jehojnë shpateve krismat e pushkëve, të bombave e të mitralozave.

Hap e kismë.

Në luginën e Drinit të Zi duel thirrjesh, duel kris-mash, duel gjëmimesh! Ato s'pushojnë, ditë e natë. Duke çarë përmes vijave të luftës, luftëtarët e brigadës shkojnë nga kulla në kullë, çojnë në to zërin e Partisë, i bëhet thirrje popullit të ngrihet në këmbë për t'i bërë varrin armikut.

Malësorët në frëngjité e kullave nxjerrin në përgjim grykëhollén.<sup>1)</sup> Armiku e ka keq.

Një top goditi shtigjet e maleve... Telefoni rrahu nga Prizreni, kërkonin kolonelin e divisionit të esesëve. Një radio kërkon të hyjë në lidhje me shtabin e Bazit të Canit. Topi heshti. Kapiteni hitlerian u largua nga pozicionet. Një kapiten anglez që kishte ardhur ato ditë në kullat e bajraktarit iku me ngut, u zhduk si hije për të mos rënë në duart e partizanëve. Edhe Cen Gozhita që ishte thirrur në takim me kapitenin anglez nuk arriti dot në kullat e bajraktarit. Sulmi partizan e ktheu pas.

I mbytur në dëshpërim majori Cen Gozhita bëri një ikje të shpejtë. Ajo që ndodhi për Cenin ishte e papritur. Ai erdhi nga Prizreni me shpresën e madhe se në kohën e duhur, kur po mbytej varka, i qe dhënë mundësia të kapte vegëzën ku duhej të mbahej për të mos u mbytur.

1) pushkën

Aty në kullën e bajraktarit ishte thirrur në takim me kapitenin anglez. Nuk e takoi. Endrra iu ndërprenë mes. «Më mirë të kthehem në vendin ku isha», — tha me vete. Dhe vrapi i në drejtim të Prizrenit, aty ku ishin struktur në pozicionë esesët e divisionit «Brandenburg». Ekte me vështrimin mbrapa, te kulla mbi shkëmb. Aty bëhej një luftim i ashpër. «Me siguri që ka ikur inglizi», — tha Ceni. «Ku dreqin e thyen qafën?» Gjahu i kishte shpëtuar nga duart, qortoi veten që nuk u nis nga Prizreni natën, u ishte trembur pritave. Dhe tani s'mund të bënte asgjë, veç të rrudhët ballin dhe të pinte duhan duke menduar si të fshihtë më mirë gjurmët e lëvizjes së tij nga Prizreni në Kukës. Nuk do ta kishte të lehtë në qoftë se kolonel Vilenbergu do ta mësonte të vërtetën. Iu duk se kishte hedhur një hap të pamatur. Sa mori lajmin që e kërkonte një kapiten i misioneve angleze, vrap në takim. Do të mundohej ta fshihtë çdo gjurmë dyshimi. Herë mbas here hidhët vështrimin prapa, aty te shkëmbi ku mendoi se gjeti shpresën e shpëtimit. Një zjarr përvëlues afrohej asaj ane. «Ec më shpejt», — i tha shoferit sapo zbriti në xhade. Atëkohë, mbrapa te «kulla e Shpresës», në themelin e sarajit të bajraktarit, ndihej lëkundja e tërmëtit. Marshimi i partizanëve dhe urrejtja e popullit bajraktarit i ngajnjë si një litar i hedhur në fyt, që nga çasti në çast i shtrëngonte. Nga kulla e tij e zymtë gjithë zemërim ai cirret:

«Kjo s'ka me ndodhë! Kjo s'ka me ndodhë! Bjeruni daulleve!»

Po sulmi i brigadës partizane s'po ndalej.



Dy ditë më vonë, mbas luftimeve që zhvilluan në afërsi të Kukësit me një repart të esesëve të divisionit «Brandenburg», batalioni ynë u grumbullua në shpatin e lartë të malit.

— Këtu do të pushojmë, — na tha Dardani, komandan-  
ti i kompanisë. Nga luginat vijnë kompani të tjera. Ato  
vijnë nga pritat në xhade. Buzë Drinit u bë një përlesh-  
je e ashpër.

Komandanti i kompanisë, Dardan Velishta, me një zë  
basi, që e veçon atë në gjithë brigadën, përgëzoi skuad-  
rën tonë, se në pritën që zumë hyri si e verbër një ve-  
turë me oficerë nazistë, dhe asnjëri prej tyre nuk na  
shpëtoi.

— Merre, — e ke kujtim nga shokët e skuadrës, — i  
tha Lulo Driza dhe i dhuroi Dardanit një «Valter» frin-  
go të ri.

Dardan Velishta ka qenë komandant i skuadrës sonë,  
shpesh ai qëndron me ne, i pëlqen të jetë në sulm me  
skuadrën tonë. Edhe neve na vjen mirë ta kemi në skua-  
dër. Në vend të Dardanit komandante e skuadrës u vu  
Bukuria. Në fillim u pëshpërit: «Për guxim e trimëri  
vështirë se mund t'i afrohet kush Dardanit...» Bukuria i  
miratonte me kokë. Breshëritë e automatikut të saj në vi-  
jën e parë të sulmit shuan çdo pëshpëritje.

Dardani, i ngazëller për «Valterin» e ri që i dhuru-  
an, ende deshi të qëndronte, por e thirri në mbledhje ko-  
mandanti i brigadës, Sopot Golemi. Iku duke na përshën-  
detur. U mblodhëm të gjithë. Secili tregoi diçka nga për-  
leshjet e fundit me armikun. Uria po na gërryente stoma-  
kun. Është dita e dytë që nuk e kemi parë Vaso Lundrën,  
intendentin e kompanisë, dhe s'guxojmë t'u afrohemë bu-  
rimeve të ftohta të bjeshkës. Lulo Driza drodhë një ciga-  
re dhe ua kaloi kutinë e duhanit të tjerëve. Xha Goxhoja  
i ra masatit — eshka mori që me shkëndijën e parë — ty-  
mosi cigaren dhe filloi bisedën. Skuadra jonë, ose siç i  
thonë skuadra e Bukurie Çabirit, formon një rrëth. Jemi  
të veshur me uniforma nga më të ndryshmet, gjë që tre-  
gon mundin që kërkohet për t'u veshur e mbathur një  
brigadë partizane. Dino Çinoja mban një kostum në ngjy-  
rë të barit, pak të vjetër. Një vit më parë ua ka rrëmbyer  
ushtarëve italianë në Drashovicë. Bukurie Çabiri ka kë-  
pucë me qafa të ushtarëve, çorape prej leshi që i shkojnë  
gjer te gjunjët, pantallona killota dhe bluzë të shkurtër të

mbërthyer te mesi. Goxho Bërdëllima ende mbante kostumin karakteristik të fshatit prej shajaku të zi, me kallca të bardha, opinga llastiku dhe vetëm kapelën e ka me strehë të shtrirë përpara ballit. Lulo Drizën, mitralierin e skuadrës, në luftimin e fundit në breg të Drinit pér pak e vranë shokët, sepse është veshur me uniformë ushtari eses. Mero Buresi mban veshjen e një ushtari tej deteve që ra në duart tonë kur u përplas në shkëmb një aeroplani. Kurse Vaso Lundra i ka mbështjellë këmbët me do-lakë ushtari e i duken si këmbë lejleku. Ai u duk në pllajën përballë. E njohëm në të ecur. Kalin e bardhë e ka vënë përpara. Ai ecën ngadalë, si duket është ngarkuar rëndë. Çfarë ka në shpinë! Bukë apo predha! Të dyja na duhen.

Intendent i kompanisë erdhi drejt nesh i gjëzuar, duke recitar vargjet e një kënge të njohur pér kompaninë.

*Asgjë nuk duam, nukë,  
veç plumbë dhe pak bukë!*

— Ku je, o Vaso Lundra, — i thirrëm ne, — se gjerdanët na kanë mbetur bosh dhe stomaku po na gërryen!

— Hajde, djem, shpejtoni! Skuadra e parë tri bukë të verdha dhe katër të bardha, mjafit i keni... Ej, ku jeni ju të skuadrës së dytë? — U afrova unë. — Jeni dy më pak ju nga e para, — më tha. — Kështu, shoku gazetar!? Hë de, rrëmbei, ç'pret? — Vasos i pëlqejnë shkrimet e mia që botoj në revistën e brigadës dhe i lexon me dëshirë.

— E treta një si e para... Në rregull!!! Ç'm'i peshoni ashtu në duar?

Mbasi mbaroi ashtu i kënaqur siç kënaqej ai në raste të tilla, nuk harroi të na thotë: «Ju bëftë mirë e gjemb në këmbë të mos ju hyjë! Hani, vëllezër....» Dhe porositi: «Kurseni fishekët, se bukë, kripë e zemër gjejmë kudo...»

Në shpatin e malit të lartë u ndez kënga e vallja. I pari ia nisi Goxho Bërdëllima. Ne të tjerët u mblohdhëm rrëth tij, mbajmë iso. Xha Goxhoja, si e pa që na rrëmbeu mirë kënga, e ngriti më lart zërin. Kënga vuri në një rrëth gjithë shokët e skuadrës. U gru-

mbulluan edhe partizanë të tjerë. Goxho Bërdëllima u gjallërua dhe më tepër.

— Iso, djem, iso për këngën dhe plumbë për armikun, — tha ai. U ngrit në këmbë sikur të ishte djalë, lartoi supet, lartoi zérin dhe këngën e ktheu në valle.

Mbas këngës erdhi te ne Dardan Velishta. Erdhi rrëmbyeshëm.

— Shotë! — i foli Bukuries dhe iu ndezën bebëzat e syve. Bukuria u bë gjak e kuqe në fytyrë. Ishte një mungesë takti, i kryer më tepër nga dehja e urdhrit që u dha për të vepruar brigada në Kosovë.

— Ej, Agim, ku je bre?! — U lëshua drejt meje. E bëri këtë edhe ngaqë jemi shokë të vjetër, por edhe për të larguar përshtypjen që la ndër të tjerët ai veprimi i pamatur me Bukurien. Më rrëmbeu midis krahëve.

— Ngadalë, se më shtrydhe, — i thashë. Mjerë kush bie në duart e tua si darë çeliku.

Jemi shokë të vjetër. Bashkë kemi punuar një kohë të gjatë, në një barkë peshkimi, bashkë dolëm partizanë në çetë dhe në brigadë. Nga gëzimi s'më lëshon. Endrra për ta parë Kosovën të lirë e ka rrëmbyer.

— Erdhi dita që ëndërronit, — i thashë. Ai shpesh më thoshte: «Kam déshirë ta djeg barutin në vendlindjen time». Pastaj e pyeta:

— Ku është Batini yt?

— Batini? — murmuriti, ndërsa sytë i lodruan nga gëzimi, balli iu çel. Nuk e priste pyetjen që i bëra. — Batini... Batini..., — belbëzoi si një fëmijë në fillim, kur mëson fjalën së pari herë. E hodhi vështrimin te mal i lartë përtëj Drinit të Bardhë. Mundohet të më shpjegojë: «E shëh atë pyllin e zi, ato rüdinat që duken, i sheh?... Po ato... Mbas malit janë fshatrat. Aty është fshati im, Batini. Aty Agim, aty...

— Je malluar?

— S'di si të të them, kam vite që jam larguar, s'më zë vendi vend. Më në fund erdhi dita që prisja.

Vështrimi i luftëtarëve hidhet andej, përpara.

Përpara shtrihet Kosova. Kosova pret agimin...

Kosova! Një ndjenjë krenarie ka rrëmbyer secilin

prej nesh. E gjithë brigada ecën në kolona. Një ndjenjë e fuqishme na shtyn përpara, ndjenja e fitores mbi armiqtë, ndjenja e lirisë.

Kosova! Historia duke filluar nga lashtësia dëshmon për heroizmat e panumiërt të saj për t'u mbrojtur nga armiqtë e huaj, ashtu siç dëshmon historia e gjithë kombit tonë.

A mund t'ia nis revistës së brigadës kështu një shkrim të gjatë për kosovarin Dardan Velishta dhe shokët e tij?

II

Grupi ynë me ish-luftëtarë të brigadës partizane erdhë në fshatin Bjeshkëz të Prizrenit në ditën e katërt të tetorit, gjë që na kujtoi atë ditë që brigada jonë kapërciu malin e lartë dhe sulmoi në drejtim të qytetit.

Ngjarjet e asaj kohe kthehen në kujtesën tonë mbas shumë vjetësh. Ato vijnë të forta, plot emocione, me mbinarkesë. Skifter Velçës, burrit me thinja, sapo arritëm në malin mbi Prizren, iu rrudh balli, iu gjallëruan sytë, si atëherë në ditët me sulme e krisma. Dukej më i ri në vështrim dhe në lëvizje. Më vuri dorën e tij të rëndë mbi supe e më tha:

— Dëgjo, Agim! Ky shtegu i Gurit të Çarë është i rrezikshëm. Të kujtohet Perikliu? Këtu u vra.

— Lufta ka plot të papritura, — thashë unë. — Njëri nga shoqëruesit nuk e di shqipen mirë, prandaj fjalën «të papritura» ai nuk e shqiptoi dot.

— Ai u varros këtu dhe këtu do të kërkojmë, — ngu-

li këmbë Skifter Velça dhe eci ngadalë. Duket se e ka rrëmbyer shqetësimi i së papriturës.

Kazma çukiti në disa vende ku u mendua se mund të ishte varrosur partizan Perikliu.

Nuk e gjetëm.

— Kot u munduam, këtu s'ka partizan, druzhe moj, — tha shoqëruesi.

Skifteri u end andej-këtej nëpër shkëmbinjtë.

— Unë thashë, druzhe moj, s'ka këtu gjurmë varri, — tha shoqëruesi që mezi komunikon me ne. Skifteri nuk flet. Flet fytyra e tij, rrudhat që thellohen në ballin e tij. Në luftë s'e kisha parë asnijëherë kështu, edhe kur plagosej.

— Dhimbja e shokut është më e idhët se dhimbja e plumbit, — tha Skifteri. — Motra e tij në Tiranë e di që unë e kam varrosur me duart e mia vëllanë e saj. Ç'ti them kur të kthehem! Nuk e gjeta! Më vjen... Si të mos e gjej vendin?! — Dhe u largua. I pëlqen të rrijë në vetmi. Mundohet të rikujojë ngjarjen duke hedhur vështrimin rrëth gurëve dhe te disa lëndina.

— Ndoshta fshatarët e Bjeshkëzës e dinë ku është varri, ata duhet t'i pyesim, — i thamë shoqëruesit.

— Në këtë shteg guri s'kalon njeri, — shpejtoi të jep-te shpjegim shoqëruesi, që s'e di mirë shqipen. — Kemi pyetur edhe më parë. Aty s'ka... aty...

— E gjeta, Agim! E gjeta! — tha Skifter Velça dhe me padurim më zuri nga krahu. — Aty shiko, në faqen e shkëmbit.

Një fshatar që kaloi rrujës ndaloi.

— Kérko me kujdes, ka zënë myshk guri, ka zënë myshk edhe ylli. E shikon? — tha fshatari dhe fërkoi gurin me pëllëmbën e tij të ashpër. Mbas pak dolën gërmat. Ishte gdhendur në shkëmb emri i partizanit dhe ylli...

— Dorë mjeshtëri e ka gdhendur, — pohova i gjëzuar.

— Ka mjeshtëri të mbaruar fshati ynë, e gdhendin mirë gurin, — tha fshatari. Shoqëruesi iu vodh vështrimit tonë dhe të fshatarit.

Vendosëm te shtegu në Gurin e Çarë piketën e parë.

Lexoj gërmat e emrit që kanë gdhendur me aq kujdes duart e mjeshtrit vendës. Shënova në fletore:

«Sa e madhe është zemra e popullit!»

Dhe në kujtesën time u rikthye gjithçka ndodhi atëherë kur komandanti i postës, Rexhep Shtanga fliste në telefon:

— Alo! Alo! Ma jep në telefon major Cen Gozhitën! — kërkonte me ngut kapteri i postëkomandës së Gurit të Çarë. Telefoni ishte bërë i shurdhër. Gjatë i kishte rënë ziles, shumë herë ua përmendi centralistëve në qytet emrin e Cen Gozhitës dhe më në fund i thanë:

— Major Ceni nuk është në zyrë.

— Heu breeee! — shkoi nëpër fillin e telit gjer në Prizren shqetësimi i kapterit të postës së Gurit të Çarë.

— Çfarë ka ndodhë, zoti kapter? — e pyeti centralisti kureshtar.

— Po bjen rrufeja e kuqe, gjarpnon këndeja, heu breeee!

— Ahaaa, po tutesh a? Mos u tut, he burrë! Ai ke me veti trimat e tu?

— Oj, oj, — e zuri lemza kapterin e postës së Gurit të Çarë. — Oj, oj! Më flet si me kenë komunist, breeee! — iu hakërrye. — Or te, njeriu i telit, major Cen Gozhitën ban mirë të ma nxjerrësh në tel sa më parë, dëgjon? Po vijnë brigadat komuniste, or te. Ma gjej bajraktarin. — I pëshpëriti fjalët disa herë.

— Teli heshtte...

— Bafti i zotit, po u dal në pritë, — murmuriti. Me një pushkë Italie të gjatë doli nga godina e postës. Mbas i vinte nënoficeri eses me uniformë të murme e një pushkë të rëndë në dorë. Ai ia ndiente çapin gjermanit që i vinte prapa. Dëgjonte prokat e këpucëve të esesit, që e ndiqte në gjurmë si një hije e frikshme. Zuri pozicion në krah të esesit. Iu dukën sytë e kapterit eses më të bardhë. Nuk mundi të dinte e mbante zemra gjermanin apo edhe atij si kapter Rexhepit i përpëlitez në gjoks... Dy mitralozat i vuri në dy anët e shtegut të shkëmbit të çarë, xhandaarët i ndau: një dhjetëshe nga shkëmbi i majtë dhe një nga shkëmbi i djathë. — Veç syrin e pushkës ma nxirri në përgjim. Mos u tutni. Prisni të afrohen dhe mbërrthenia secilit plumbin pullë në shtat. Dëgjuet? — i porositi xhandarët.

— Shumë janë, si me ba, zoti kapter? — pyeti një xhandar.

Në kolonën e brigadës sonë vargoheshin njëzet e pesë kompani, toga mortajash e topash.

— Fola në telufon me major Cen Gozhitën.

— Aa, — bëri prita.

— Besa po, Major Ceni i dha alarm Prizrenit. «Për dy sahat më keni aty, mos ua lironi shtegun!» Kështu më porositi, — gënjeu kapteri.

— Aaa, — ia bëri ai që pyeti për të liruar gogësimën e frikës.

— Besa po, për dy sahat e kemi këtu!

Kjo ndodhë kur kompania jonë hyri në të çarën e frikshme të këtij shkëmbi.



Te ky shteg i ngushtë ecën nëpër dredhat e rrugës dhe anash shohim gur e shkëmb, përpëra, në horizontin e largët shtrihet fusha e pafund.

— Kosova! — tha Dardani i malluar si njeriu i larguar me vite e sapo kthehet në vatër mërmërit me vete: «Shtëpia!»

Ecnim mbas njëri-tjetrit e gjithë skuadra. Bukuria si një thëllëzë mal i hidhej nga guri në gur e mbas saj, në varg të gjithë; në fund ishte mitraljeri i skuadrës, Lulo Driza. Erdhi gjer te Bukuria urdhri i Dardanit: «Skuadra të ndalojë!» Mbas pak arritën Dardani dhe Perikliu.

— Ata na kanë zënë pritë, të hapemi në formacion luftimi, — i tha Dardanit njëri nga mitraljerët, Mero Buresi.

— Jo, — i tha Dardani, — ndryshe duhet të veprojmë.

— Si ndryshe? — tha Mero Buresi me mitraloz në dorë dhe zuri pozicion.

— Duhet ta kapërcejmë pritën pa luftë, — na tha komandanti i kompanisë. Më bëri përshtypje urdhri që dha, duke ecur, iu afrova Dardanit dhe e pyeta:

— Ç'më do? — e pyeti i shqetësuar komandantin e kompanisë. Dardani mblodhi supet, s'deshi t'ia thoshte. Atë që s'guxoi t'i thoshte Goxho Bërdëllimës komandanti i kompanisë, ia tha komandanti i brigadës.

— Mjaft na ndoqe, o xha Goxho, tanë dhe vetë e shikon që do kemi marshime të gjata, vështirësi ndoshta dhe më të mëdha, ndaj mendojmë që... — Sopot Golemit diçka iu mblodh në grykë, si një lëmsh, e s'tha dot që Goxhoja do të kthehet në shtëpi. Goxhoja e pikasi se ku do të viste fjala dhe i preu rrugën. Tha:

— Shoku komandant! Me gjithë mend m'i thua këto fjalë? Besoni ju që Goxhoja malisherin e Halimit, djalit tim që m'u vra, ta ngulë në vend të shkopit? Hiqe nga koka atë mendim. Të kthehet Goxhoja në shtëpi kur brigada shkon për të çliruar Kosovën? Jo, shoku Sopot, jo! Dëgjon? Kthehem atëherë kur t'i kem bërë të dyja këmbët çift... Ndryshe jo... Dua që të jem në vijën e luftës gjer në ditën e fitores, të jem me ata që do të shkrehin pushkën e fundit mbi shkelësit e trojeve tona. Në këtë pikë nuk ta dëgjon fjalën Goxhoja. Arrin Goxhoja me këto opinga gjer në Berlin, — tha ai dhe zuri me dorë llastikat e qepura me tel. — Nuk kthehet Goxhoja në mes të rrugës, jo!... Mirë mbetsh, shoku komandant! — tha Goxhoja dhe iku flakë i kuq në fytyrë. Me hap të nxituar po ngjitej përpjetës së malit. Me atë veshjen e tij, me jekun e bardhë karakteristik të labit dhe me kollanin dyradhësh të fishekëve shtrënguar për mesi, nuk e dalloje dot nga Goxho Bërdëllima i vitit njëzet kur ishte djalë dhe luftonte në Vlorë. Mbahet, po dhe koha ka bërë punën e saj, dele eshtë bërë nga flokët, rrudhat i kanë mbuluar ballin, një gropë e çarë dikur nga një plumb në faqen e majtë shkon duke u thelluar gjithnjë e më shumë. Shpejtonte të na arrinte. Afër i vinte jehona e këngëve të kolonës partizane.

Dëgjohen më shumë këngët në male, kështu i dukej apo ishte e vërtetë? Jehona e këngët arriti te veshët e tij, ndaj mbajti këmbët.

— Ata janë, ata, — tha ai dhe vuri veshin për të dëgjuar edhe më mirë këngën. Goxhoja kujtoi fjalët e fi-

llimit të këngës. I shqiptoi ashtu, nëpër dhëmbë, një përnjë fjalët. U mundua t'u gjente edhe avazin, ndonëse nuk i këndonte dot ngaqë, siç thoshte vetë, e pengonin esht-rat e gojës; Murmuriti:

— Kosovë! Kosovë!

Tyat e sarta të armëve të brigadës vështronin shtigjet... Vështronin përpëra, nga Kosova.

Goxho Bërdëllima nxitoi që të arrinte batalionin, skuadrën e tij që ishte në krye dhe dredhonte nga shtegu i Gurit të Çarë.

Arrihet era?

Erdhi i mbytur në djersë.

— Dre, dre, ku ishte futur zuzari?! — tha Goxhoja dhe fshiu ballin me pëllëmbën e tij të madhe.

— Kush, o xha Goxho? — pyeti njëri nga shokët.

— Ai pizevengu që na e vrau shokun de! Eh, Perikli!

— pshëriti.

— Po ku ishte futur?

— Në oxhakun e mullirit. Na tregoi një fshatar, — tha Goxhoja.

— Rexhep Shtanga ishte? — pyeti Dardani me padurim.

— E de. Ai i téri: «Ju e qëlluat partizanin?» — e pyetëm. Ai nuk pohoi.

— Do ta pohojë se s'bën. Ai e qëlloi, unë e pashë kur...

— E liruat? — pyeti i trembur Dardani.

— Jo, jo, — tha Goxho Bërdëllima, — i hodhëm hekurat në duar. — Pastaj vuri dorën te brezi, përkëdheli biçakun dhe një darë dhëmbësh. — I thashë: «Më vjen keq që darën e vogël që u heq shokëve të mi dhëmballët e sëmura ta ndyjë në gojën tënde. Fol, mor zuzar, se t'i hoqa një e nga një ato kucka, dëgjon? Edhe biçakun të trohisur e kam, mos fol, po deshe». Do që u bë bilbil gjyzar! Të gjitha i tregoi. Edhe atë ngjarjen tek Ura mbi Drin e tregoi.



\* \* \*

«Miro Térbaçes i ngjan kjo vajzë, — thoshte Goxho Bërdëllima pér komandanten e skuadrës, Bukurie Çabin. — Oj, ku gjeti ai dhëmbëkrimburi të marrë nuse këtë thëllëzë mal. Mirë bëri vajza! Bukuria ditën që shkuan krushqit pér ta marrë u doli në rrugë me pushkë në sup e u tha: «Thuajini plakut murg s'kam kohë pér marte-së, po dal njéherë maleve, pastaj dasmat!..., — dhe vajti në çetën partizane të Gurshpatit».

Thashethemet që u ndezën si déllinjat e thata, u shuan apo njerëzit mësuan që dhëndri ishte në prag të shtatëdhjetave. Xha Goxhoja, duke tërselluar, e vuri plakushin lakmiqar në shënjestër të fjalës: «Le t'i vëré kurrizin zjarrit, të ngrohet dhe pak ditë që i kanë mbetur», — thoshte pér dhëndrin plak.

E kishte mbrojtur Bukurien, ndërsa tanë i rrudhi buzët dhe, sa herë gjente rastin, lëshonte fjalë thumbuese që e bënин komandanten e skuadrës t'i skuqeshin veshët. «Që femra të kapë dyfekun kundër shkelësit të vatanit, po, por të kumandojë burrat në luftë...» — kishte thënë i pakënaqur xha Goxhoja.

\* \* \*

Dardan Velishta është njëzet e dy vjeç, me një shtat të gjatë. Ai është luftëtar i gjatë i brigadës. Fytyrën e ka ezmëre, të hequr e me shumë kockë, është gjoksjerë e me pamje më burrërore se mosha që ka. Edhe në vitet e luftës s'iu ndalua rritja Dardan Velishtës, ndaj Goxho Bërdëllima, luftëtar më i moçëm i kompanisë, si përherë kur kalon afér tij, thotë:

— Gjer ku do të shkosh, o tu mbylltë, në qill?

— Deri në qill është jona, o xha Goxho. Me këto

armë do të mbrojmë edhe trojet tona edhe hapësirën e këtyre trojeve. Si thua, xha Goxho? — iu përgjigjet Dardan Velishta dhe përqëndron vështrimin në malin e Sharrit.

— Halli hallit nuk i ngjan, — murmuriti Goxho Bërdëllima kur e pa Dardan Velishtën të pikëlluar dhe kujtesa e tij gërmoi te një ngjarje, që s'lidhej me brengën që e mundonte Dardanin.

C'ngjarje ishte ajo?

Në malin sipër fshatit Bjeshkëz kompania u ndal të pushonte. Goxho Bërdëllima u hoq mënjanë dhe u ul mbi një dëllinjë degështruar. E bluante në mendje atë ngjarje. Ishte janar, muaj me dimër të fortë. Atëherë sipas xha Goxhos zinte fillin ai pikëllim që shihte në sytë dhe në ballin e Dardanit. E donte shumë Dardanin dhe i vinte keq që ishte ngatërruar me një vajzë që ia arrinte në trimëri e në shtat, se femër me zë e pamje burri ishte Bukuria. Pikërisht se Dardan Velishta e admironte Bukurie Çabirin, i thërriste asaj Shotë. Me këtë emër quajnë në Kosovë rosat e egra e të bukura. Goxho Bërdëllima u mblodh në vetvete dhe bluante ngjarjen. Atëherë ai kishte vënë re një shoqëri të ngushtë, asgjë tjetër. Mbas plagosjes së Dardanit xha Goxhos i dukej se puna kishte ndryshuar. Ajo që shkaktonte gjësim te Dardani ngjallte shqetësim te Goxho Bërdëllima.

— Ende pa e mbaruar luftën filloj me gilivili, nuk i ka lezet Dardanit, e kemi komandant, — më tha xha Goxhoja.

Mendimi i Goxho Bërdëllimës zuri të ecte në gjurmët tona, në ditët me dëborë të janarit kur kolona partizane me të plagosur ngjiste malet e Gurshpatit. I kujtohet dita kur në fytyrat e të plagosurve binin flokët e borës, u mpiheshin duart, këmbët, trupi... Dardanin e mbartnin në shpinë katër shokë të skuadrës.

— Kujdes! — foli një nga ata që mbartnin të plagosurin. Dardani e njohu, ishte Bukuria. Ai si nëpër mjegull kishte përfytyruar Bukurien, ngaqë nuk mund t'i ngrinte qepallat. Ajo për atë qe një vajzë e çiltër, e pastër, në shpirt, e bukur, e guximshme e trime. Të gjithë

shokët e skuadrës atë e thërrisinin «motër». kurse Dardani e thërriste «Shotë».

Zemra nuk u bënte udhë fjalëve...

Në shpellë, ku u vendosën të plagosurit, nuk dëgjohej asnje krismë arme, asnje zhurmë. Heshtje e plotë. Një masiv gjigant i ngjeshur qëndronte mbi shpellën e gurtë e të errët. Shokët e ulën Dardanin me kujdes. Dardani e ndiente kokën të rëndë, aq sa e kishte vështirë t'i ngrinte qepallat.

Asnjëherë nuk i qe dukur trupi aq i huaj, aq i rëndë, aq i tepërt. Dëgjoi zërin e Bukuries dhe lëvizi buzët, po s'mundi të thoshte asnje fjalë, ngaqë zëri, pa arritur te qiellza, iu shua.

— Eh!

Rënkim i erdhi në veshin e Bukuries si nga fundi i dheut. Ajo nuk mundi të dallonte i kujt ishte ai rënkim, i Dardanit apo i ndonjë shoku tjetër të plagosur, ndaj u ul pranë tij.

— Eh... ëöh...

Ajo i vuri dorën mbi ballë. Digje balli i Dardanit, që vazhdonte të rënkonte.

— Shotë, — i foli ai.

— Durim, Dardan!

I plagosuri shtrëngoinofullat dhe çakërriti sytë në errësirë, u mundua të lëvizte trupin, po s'mundi.

Dikush ndezi zjarrin. Gjuha e kuqe e flakës ndriçoi guvat e shpellës dhe fytyrat e mpira të njerëzve. Dardani u përmend. Dëgjoi zëra.

— Ku jam? — Kaq mundi të thoshte dhe sërish nofullat e tij u shtrënguan.

Bukuria atë kohë ishte ulur mbi një gur dhe po pastronte automatikun, dëgjoi zërin dhe i shkoi pranë. Dardani mbylli sytë e ra si në kllapi.

— Ikim, — tha xha Goxhoja, — shokët na presin.

Bukuria shkonte përpëra në vijën e luftës, po vështrimin e hidhje prapa te shpella ku dergjej Dardani.

— Dashuricëkat këtë bulmet nxjerrin, — tha Goxho Bërdëllima dhe shkundi çibukun në llastikun e opingës. — Vë tjetri në ballë rrudhë derti e përsë? Për higjë. Hajde,

Dardan, hajde, s'më besohej të arrije në këtë gradë. Humber Stambolli për gjilpëra! Jo, lumëzi, jo! Guguçe e kulumbri e ke, t'i mori mendtë, s'thuhet kot sytë e dashuruar shohin ndryshe nga sytë e tjerë. Foli, Agim, shok e ke, foli sa s'është vonë, dëgjo Goxhon, foli të them! — m'u ngërmua ai.

Filluam përsëri marshimin. Kur u ngjitëm përpjetë shpatit të malit të Bjeshkëzës na ra në sy se Dardani ecte përpara e po çapitej si kali kur e zë gozhda. «Do të jetë i sëmurë Dardani, — mendova, — apo mos është gozhdë dashurie, si e ka hallin?» I shpejtova hapat ta arrij. Më pëlqen të ecë në krah të Dardanit. Njihet në brigadë si njeriu më i shpejtë në ecje. «Erë në të ecur komandanti, erë edhe kompania», — pëshpërita me vete.

— Erdhët! — më tha Dardani sa më dëgjoi hapin. Nuk e ktheu vështrimin nga unë, ma njohu hapin ashtu si ia njoh edhe unë atij. S'm'u durua dhe e pyeta:

— I sëmurë?

— Jo. Kisha dëshirë të ecim në drejtim të Batinit, kurse po ecim në drejtim tjetër, — më tha pasi u mendua pak dhe ndaloi një hop e vështroi i malluar andej, në anën tjetër të Drinit. Jeton me brengën. I dridhet diçka midis ballit. Nga vështrimi andej larg iu drodhën qerpikët e gjatë, që nuk i ishin dridhur nga plumbi as nga flaka e pushkës. — S'kuuptoj, — më tha. — Komandanti i brigadës njoftoi se do të sulmojmë për të dalë në anën tjetër të Drinit, kurse sulmet bëhen në drejtim të Prizrenit. Mos ka ardhur urdhër tjetër?

— ...?

\* \* \*

— Xha Goxhoja ç'u bë? — pyeti komandantja e skuadës, Bukuria, mbas çlodhjes nga rruga. Asnjeri s'dinte ku shkoi Goxho Bërdëllima. Shok e miq i ka të gjithë, nga batalioni gjer te komandanti i brigadës. Po xha Go-

xhoja ulur, me maliherin në prehër, ende jeton me ngjarjen e hershme ku zuri fill dashuria e Dardanit me Bukri.

— E po nga humbe, mor xha Goxho? — tha një nga partizanët, Ago Ymeri, dhe e vështroi me buzë në gaz.

— Isha atje tej, te kroi e, si rufita dy-tri grushte ujë, u shtrova të haja byrek, — tha Goxho Bërdëllima.

Xha Goxhoja aty për aty i ujdisi aq mirë fjalët, sa-që na bëri të gjithë të qeshnim me të madhe. Zyntësinë e Dardanit kësaj here ai gabimisht e lidhi me brengat e dashurisë.

— Gabon, xha Goxho, gabon, — i thashë kur ma tregoi. — Dardani është i malluar për vendlindjen. Ai mendoi se do të kapërcenim Drinin dhe do të shihte njerëzit e tij dhe Batinin. Ka ikur i vogël nga fshati. — I tregova historinë e dhimbshme të Dardanit.

— Ashtu qoftë, Agim, por gilivilet s'kanë lezet, dëgjon! — pëshpëriti dhe thithi çibukun e më mbuloi me vështrimin e tij të vrenjtur.

### III

Dita e katërt e vjeshtës së dytë na gjeti të grumbulluar në fshatin Bjeshkëz. Batalionet e tjera janë hapur në formacion luftimi, kurse batalioni ynë dhe shtabi i brigadës qëndrojnë në Bjeshkëz, një fshat i bukur i mbështetur në gjoksin gjysmë të zhveshur të malit. Mbasdite horizonti u bë ngjyrë gri, era erdhë e furishme, mali u ftoh dhe vargmalet e larta, në të djathtë të rrjedhjes së Drinit, mbas shiut që ra, vunë qeleshen e bardhë. Të ftohtët që erdhë papritmas paralajmëron trokitjen e dimrit, krismat e armëve, ashpërsinë e luftës.

Shiu me rrëmbim erdhë dhe me rrëmbim iku. Dolëm nga kulla ku pushonim. E gjithë skuadra u grumbullua në një lëndinë afër çezmës me lugje druri.

— Gati jemi? — pyeti Bukuria dhe na hodhi një vështrim hetues. Asgjë nuk i shpëton syrit të saj. Qëndrojmë grumbull gjer të vijnë skuadrat e tjera, bisedojmë për

ngjarje nga më të ndryshmet, siç mund të bisedojnë shokët e një moshe dhe të një ideali. Kolektivi ynë ka shkri-re në një të vetme, zemrat, grushtet, plumbat...

Veç Goxho Bërdëllimës, të gjithë jemi në lulen e rinasë. Me lloj-lloj punëra jemi marrë: Luloja punëtor në minierën e Selenicës, Vasoja fshatar, Bukuria rritur ugarreve, xha Goxhoja bari, Ago Ymeri marangoz, Meroja gurthyes. Është nga më të fuqishmit në skuadër dhe në batalion askush s'ia vë kurrizin përtokë. Shumë i dashur me shokët, shpesh e ndez sherrin për hiçgjë. Luloja emrin e vërtetë e ka Andon. E mori këtë emër pasi luajti një pjesë teatrale në rolin e një luftëtarë partizan me emrin Lulo dhe emri i vërtetë i tij u harrua. Dino Çinoja me flokë të dredhur e të verdhë është i shkurtër në trup, por i gjerë në gjoks. Vaso Lundra është i gjatë si plepi që rritet në tokë të shëndoshë, tanë sapo i ka djersitur qimja në faqe. Sytë i ka shkëndijë. Bukuria ka flokë të bukur dhe sy të zez si kokrra e ullirit, ashtu si të gjitha vajzat që rriten në jug të Vjosës. Është një nga vajzat më të shkathëta të brigadës dhe trime si ajo, por me tipare mashkulli në vështrim e në zë. Kjo i është bërë vesveze xha Goxhos, ai shpesh më thotë:

— S'dua të ngatërrohet Dardani me atë, s'bën ajo, as te këmba nuk i arrin Dardanit. Dardanin shok e ke. Mbushja kaplloqen që të heqë dorë. Ty, Agim, ta dëgjon llafin ai. Dëgjo mua, se Goxho Bërdëllimën nuk e gënjen syri, — më thotë xha Goxhoja dhe ndez eshkën me masatin e tij të madh.

Secili nga pjesëtarët e skuadrës ka historinë e tij në luftë. Të gjithë jemi afruar e miqësuar ngushtë me njëri-tjetrin sikur të ishim lindur dhe jetuar nën një strehë. Nuk ndahemi dot nga njëri-tjetri, as nga brigada. Edhe Luloja që u plagos rëndë kur brigada bënte rojë në mbrojtje të Kongresit të Përmetit e u dergj dy muaj në spitalin partizan të Gurshpatit, udhëtoi ditë e natë nëpër shtigjet e maleve gjersa na gjeti. Në brigadën tonë ne rresh-tuam ndjenjat tona, këngët tona. Historia e brigadës është tërësimi i historisë së secilit e gatuar në zjarrin e luf-tës.

Dardani posa u kthye u përgatit pér të kryer detyrën, që i ngarkoi komandanti i brigadës Sopoti. Zgjodhi katër partizanë të tjerë, ndërsa mua nuk deshi të më merrte me vete. Më tha:

— Është punë me rrezik, Agim.

— Rrezikut nuk i jemi shmangur asnjëherë, përsë ma thua këtë? — Dobësinë e Dardanit ndaj meje e kam vënë re edhe herë të tjera. Nuk jemi duke gjuajtur peshk në det, mendo q'po bën, — i thashë i fyter. Foli murit, aq më dëgjoi. I fola rëndë.

— Është punë me rrezik, s'do të vish, — nguli këmbë si mushka dhe i solli ndër mend gjithë shokët e kompanisë. Pastaj, kundër dëshirës së vet, vetëm kur iu kujtua se isha njëri nga ata të pakët luftëtarët që dinin ndonjë fjalë gjermanisht, më thirri dhe mua. Na tha të visheshim me rroba xhandarësh. Nga çasti që kapërcyem vijën e rojave u bëmë «xhandarë» të postës së Gurit të Çarë.

Kaluam vijën e luftimeve dhe të gjashtë ecërn në drejtim të Prizrenit. Ecëm pyjeve pa fund të bjeshkës.

— Tash e mbas jemi «xhandarë» të postës së Gurit të Çarë gjer të zgresim në Prizren, aty do të strehohemi në një bazë, do të mbledhim informata mbi armikun dhe kërkohet të kapim një rob nga repartet e garnizonit të Prizrenit, — na tha Dardani. Tek po ecnim, qytetin e lashtë të Prizrenit po e përfytyroja si një qytet me sheshe e rrugica të shtruara me kalldrëm, me shtëpi shumëkattëshe, me rrugica të mbushura me dyqane, qytet me bukurinë të veçantë. Dhe ky përfytyrim më ishte ngulitur nga një dokumentar që kishin xhiruar për ushtarët e një divizioni alpinësh italianë që ishte ngulur në këtë qytet. Edhe lavdia e këtij divizioni ishte tretur siç janë tretur në fushat e Kosovës gjithë divizionet që e shkelën. E tanisë të huaj ishin ngulur në këtë qytet? Që të mësonim këtë të fshehtë, ne duhej të kapnim një gjuhë të të huajt.

Robi do të flasë. A është mjaft një rob? A është aq e leh-të të kapet një rob? Edhe pér shtabin e brigadës sonë ësh-të enigmë, s'dihet sa është numri i forcave të armikut në Prizren, ku e ka vendosur shtabin e tij koloneli i esesëve, Vilenbergu.

Ndërruam rrugë dhe, si dredhuam një pylli anash, iu afroam kullës. Nga kjo anë është shkëmb e buzë. Është mbërthyer kulla mbi shkëmb.

— I zotë i kësaj kulle është yni, — tha Dardani. Ukë Rustemi e mbante çdo mbrëmje të lidhur qenin, se priste e përcillte njerëz me yje që hynin e dilnin nga qyteti.

Dardani më tregoi se te fshati në luginë do të tako-nim probatinin e babait të tij, Ukë Rustemin. Kështu do të kalojmë, mik mbas miku, në besë të njerëzve pér të plotësuar misionin. Na kërkohet të kapim rob një ushtarak gjerman. Rrugë pa rrugë ecën gjersa dolëm në anë të pyllit.

Ndeshëm në rrugë disa xhandarë, as u folëm, as na folën. U ndalëm buzë arave të Ukë Rustemit. Errësira kishte mbuluar gjithë fshatin. U afroam te shtëpia e Ukës. Dëgjuam një zë burri.

— Rexhë, qit rojën, a po dëgjon?

— Brenda ka njerëz të tjerë, — i thashë Dardanit dhe e zura pér krahu.

— Gjallë, vdekë, duhet ta takojmë, — tha Dardani prerazi.

Përgjuam përjashta që të takonim njerëz të shtëpi-së. Njeriu i parë që doli nga shtëpia ishte i huaj. Një burrë i gjatë ndaloj afér nesh dhe i foli tjetrit që ishte rojë:

— Jo aq larg, lum Rexha, jo aq larg prej kulle?

Burri i gjatë me pushkë iu afroa shtëpisë. Pastaj sërisht ra heshtja.

— Si t'ia bëjmë, Dardan? Brenda ka xhandarë.

— Ani, këtu se këtu do të qëndroj më. Ndoshata... — Zumë qoshet e kullës dhe po përgjonim.

Fjalët brenda u ndezën më shumë. Një grua doli nga ana e pasme e kullës. Iu afroa Dardanit dhe diç bisedoi me zë të ulët.

— Baca Ukë ku është? — pyeti Dardani.

— Brenda në odë, — iu gjegj gruaja me një kusi në dorë. — Është edhe një oficer me ca xhandarë të Cen Gozhitës. Me ta është edhe një gjerman, he u daltë fara!

— Po munde, i thuaj bacës Ukë të dalë, se kemi një amanet, — i tha Dardani gruas. Ajo miratoi me kokë dhe u fut brenda. Dardani erdhi pranë nesh.

Po qëndronim si mbi gjemba. Minuta na bëhej orë. Një hije na u afroa avash-avash. E kuptuam se ishte i zoti i shtëpisë. Na dha dorën.

— Ejani pas meje, — na tha ai me zë të ulët. Nga ana e pasme e kullës na futi brenda. Ngjitëm shkallët e drunjta nga brenda. Në katin e dytë në lojën e dritës së një kandili lëvizëm nëpër korridor. Në dhomën tjetër që e ndante një stenë e çatmuar, në odën e burrave, janë xhendarët dhe esesi, kurse në dhomën tjetër ne. Ata bisedojnë për t'u ndalë hovin brigadave partizane, kurse te ne bëhen plane për t'i zhbirë një orë e më parë nga trojet tonë pushtuesit e tradhtarët. Ata ia kishin shtruar me rakin, ne armët i kishim plot.

— Rexhë, këqyr njëherë rojën, — u dëgjua përsëri zëri i togerit.

Dardan Velishta vuri buzën në gaz. Bisedonte me të zotin e shtëpisë sikur bisedonte me të atin. Uka bisedon me Dardanin e vështrimin e ka te ne, do të na qetësojë.

— Rrini lirshëm, burra, si në shtëpinë tuej, — na thotë Uka. — U ka hyrë tuta në shtat qenave...

— I huaji s'ka vend këtu, — tha Dardani.

— Kushdo që ka lakinue këtë tokë, ka ardhë me brina, po është kthye pa krye, — tha Uka dhe rrudhi vetullat.

— Rexhep Shtanga ra në kurth, — tha Dardani.

— Pse s'ma the në fillim, bre burrë? Konopin hak e ka qeni i tërbuem, — tha Uka dhe u ngrit e shkoi në odën ku ishin ata. Donte të hetonte planet e tyre.

Uka, me një pishë në dorë, kaloi korridorin dhe hyri në dhomë. Foli me ta, ndreqi zjarrin, ngriti fitilin e llambës.

— Rexhë, kontrollo rojat! — urdhëroi togeri.

Uka doli në oborr me një sëpatë në dorë dhe filloj të shkurtonte dru. Vodhi me bisht të syrit rojat.

\* \* \*

Ndërsa po çante dru dhe po vidhte me bisht të syrit Rexhën që po kontrollonte rojat, Ukë Rustemit iu kujtua një ngjarje që kishte ndodhur vite më parë.

Cen Gozhita, i biri i bajraktarit, probatini i pukovnik Stepanit, në kohën e kralit me një tapi false bëri të tijën bjeshkën e Batinit. Për fshatarët e Batinit vunë shtrëngim. Nuk lejoheshin të kullosnin bagëtitë në malin e vet, që e kishin trashëgim. Revolta e fshatit u shtyp nga hija e rëndë e kralit. Batini u mbush me xhandarë. Veli Velishta, babai i Dardanit, guxoi t'i qëndronte Cen Gozhitës. Kishte filluar të pritej pylli i Batinit. Shoqëria «Stre-na Mitrovica» e rrëmbeu drurin. Xhepat e kolonel Stepanit dhe të Cen Gozhitës u mbushën me dinarë. Cen Gozhitës s'guxonte kush t'i dilte përpara, sepse atë e mbron-te kolonel Stepani.

Fshati Batin po ziente nga revolta. Një turmë fshatarësh zbritën në Prizren, ndër ta edhe Veli Velishta.

— Ku shkoni, bre burra? — i pyeti një plak kur i pa aq të ndezur.

— Në Sheher, të gjykohemi, — tha Veli Velishta.

— Ruhuni se po thyeni kryet tuaj, bre burra, — u tha plaku.

Ata ecën flakë të kuq në fytyrë. Posa arritën buzë lumit, kur kalonin urën, ecjen e tyre e ndërprenë dy krisma pushkësh. Veli Velishta ra përdhë. Nga prita përballë u ngritën dhe u larguan dy burra me qeleshe të bardha në kokë. Ata u larguan me ngut. Qeleshet e bardha të tyre i shikuan njerëzit disa herë nëpër pyllin me gështenja. Veli Velishta me trupin e skuqur kishte rënë mbi kaldrëmin e urës. Dy plumba e kishin përshkuar tejpërtej në gjoks.

— Mozomakeq, gjakësit, — thanë ata që mundohe-shin t'i ndalonin gjakun nga plaga.

— Jo, jo, nuk i kam borxh askujt, por..., — tha Veli Velishta dhe shtrëngoi nofullat.

Vrasësit me qeleshe të bardha u zhdukën. Mbas pak ia behën në rrugë dy xhandarë.

— Hajli kjoftë, — foli i pari. Ishte xhandar Rexhep Shtanga.

— Gjakësi, — tha xhandar Stojkoja.

— Mozomakeq, — u shpreh i pikëlluar xhandar Rexhepi. — Rëndë e ka marrë plumbi.

— Sa e ke sahatin, o Rexhep Shtanga? — pyeti Veliu.

Xhandar Rexhep Shtanga, i mbërthyer nga hutimi, hodhi dorën në xhep, atëherë pa se nuk e kishte zinxhirin e sermtë.

— Qe ku e ke zinxhirin, të ka mbetur në vendin ku le gëzhojën e pushkës, — i tha Veliu. Fytyra e vrasësit u bë meit.

— Po u ngrita, vrasësit do t'ia shtyj plumbin pak më majtas nga lugu i gjoksit, — i tha Veli Velishta, — po s'u ngrita, amanet djalit...

Xhandar Rexhep Shtangës i ngriu vështrimi. Mallkoi veten. E si do t'u thoshte bajraktar Cen Gozhitës dhe pukovnik Stepanit? Surrati iu çakërdis, iu shtrembërua. I vinte ta shqyente veten që nuk kishte qëlluar më mirë që Veliu të mbetej pa gojë.

Veliu rënkonte. Ai, pasi u la të afërmve dhe të birit amanetin e fundit, mbylli sytë.

Fjalët rrjedhin. Amaneti i Veli Velishtës u vajti në vesh si xhandar Rexhepit edhe Cen Gozhitës e puknovik Stepanit. Ata e urdhëruan xhandar Rexhepin që t'i jep-te një plumb qorr edhe të birit të Velikut, Dardanit. Fshatarët e kuptuan rrezikun. Dardani u detyrua të emigronte që i vogël për t'i shpëtuar syrit të vrasësit.

\* \* \*

«Eshtë pak me ia qitë kryet në konop», — tha me vete Ukë Rustemi dhe me një krah dru lisi në duar ngjiti shkallët me rrëmbim.

Njëqind hapa larg kullës endej një hije. Ishte roja....

— Zoti toger, — iu drejtua Uka posa lëshoi krahun e druve në vatër, — disa xhandarë të postës së Gurit të Çarë kërkojnë të takohen me ju.

— Silli, silli këtu! — urdhëroi togeri me njëfarë shqetësimi për ndonjë lajm ogurzi.

Iu paraqitëm togerit. Ai na vështroi vëngër, na bombardoi me ca pyetje rrufe, pastaj na lejoi të uleshim.

Në çastin e parë të takimit ndjeva që më humbën mendimi dhe fjala. Pyetjeve të togerit u përgjigjesha në mënyrë të përgjithshme, mandej unë e mora veten.

Përgjigjet e mia togeri ia thoshte rreshterit gjerman me një italishtë shatra-patrat. Rreshteri gjerman na vështronte me sytë e tij të pangjyrë dhe u egërsua, kur mësoi q'kishte ndodhur në postën e Gurit të Çarë.

— Ai që lë pozicionin, duhet të vihet në plumb, — tha rreshteri gjerman. Këto fjalë togeri nuk na i përktheu, por unë e kuptoja mirë italishten.

— U luftua shumë te Guri i Çarë? — pyeti togeri.

— Për një qime kemi shpëtar, zoti toger, sulmi i atyre ishte si një ortek që zbret nga malet, — tha Dardan Velishta.

— Nesër do t'uа bëjmë gjëmën në Bjeshkëz, — tha togeri dhe picërroi sytë.

— Për të zmbropsur sulmin e tyre, duhen forca të shumta, — tha Dardani.

— Jena mbi dyqind veta. Ka ardhë edhe major Ceni. Do t'i sulmojmë njëherë e mirë komunistat. Qebesa kanë me ikë e s'ka me e pa i pari të dytin, — u mburr togeri. — Kolonel Vilenbergu ka nisë një batalion granatierësh.

Gjermani, mbështetur pranë zjarrit, shtrëngoinofullat.

— Bukën, i zoti i shtëpisë, — tha togeri dhe shikoi orën. — Jena vonë, bukën.

Pas darkës togerit e gjermanit Uka u shtroi në dhomën tjetër. Ata ranë të flenë.

— Kujdes rojën, Rexhë, — porositi togeri kur vajti për të fjetur.

Në odën e Ukë Rustemit midis nesh dhe rreshter Rexhës po shkëmbeshin mendime.

— Është mbushur bjeshtë e Sharit me partizanë, besa kota kemi shpëtuar, — tha Dardani. — Major Ceni duhej të dilte përpëra se ata t'i zinin shtigjet. Apo s'kanë ardhur me yrysh të madh! Kanë edhe topa...

— Topin ma të madh në botë e ka Gjermania, — tha rreshter Rexha që kujdesej për rojat. — A ke ndie që nemja ia dërgon predhën si ballonë Inglizit? Ka vu një top tek Ura në breg të Drinit të Bardhë që bën hatanë!

— Brigadës komuniste që mësyn kësaj ane s'ka dalë kush t'ia ndalë duhinë. Ajo përlan si orteku, — tha Dardani dhe më shkeli syrin.

— Besoj se do t'i hasë sharra në gozhdë, — tha rreshter Rexha, — se me esesët e kolonel Vilenbergut deri tash nuk ka mundë kush me i shti brinat.

— Esesët e kolonel Vilenbergut nuk i kanë shti brinat me komunistat e Shqipnisë, o Rexhë! — tha xhandar Delia, që deri atëherë po dëgjonte.

— E pra dije se Hitleri nuk ia ka vënë kot në gjoks dekoratën më të lartë me kryqin e thyer Vilenbergut, — tha rreshter Rexha.

— Në një gazetë të gjermanëve që del në Tiranë shkruhej se brigada komuniste që komandohet nga Sopot Golemi, që mësyni këndej, është brigadë tepër e rrezikshme, — thashë unë.

— A? — bëri rreshter Rexha, i alarmuar.

— Mozomakeq, bre burra, — u ankua Mero Buresi dhe i shtyu kutinë e duhanit rreshter Rexhës.

— Mos u tut, bre burrë! — tha rreshter Rexha që po dridhët cigaren.

— Kjo është një fjalë goje, zoti rreshter, — tha Ago Ymeri, — po ne kemi shpëtue për një qime. Ata na u holdhen në pozicione, desh na zunë të gjallë.

— Di me na thanë, a kanë shumë topa, lum miku? — pyeti rreshter Rexha.

— E kush e merr vesh sa topa kanë? — tha Ago Ymeri. — Di vetëm nji gja, se ata na gjuejtën me topa të mëdhenj, që ia kanë marrë gjermanit.

— Heu, — klithi rreshter Rexha.

Ra heshtja. Koha nuk priste. Ne duhej të vepronim sa më parë. Informata që morëm se në mëngjes banda e Cen Gozhitës dhe disa kompani hitlerianësh do të sulmonin në drejtësim të fshatit Bjeshkëz, ku doli brigada jonë, duhej t'i jepej shtabit të brigadës sa më parë. Po si, në ç'mënyrë?

Togeri me nënoficerin hitlerian bënин gjumë, rreshter Rexha me të vetët ishin pushtuar nga ethet e frikës.

— Le burrat, po edhe çikat hidheshin në sulm si zanat! — tha Dardani

— Kanë çika me veti? — pyeti Rexha.

— Besa me qindra, — tha Dardan Velishta.

— Allah, allah, ç'u prish dynjaja! Gratë me kapë pushkën! — shtrembëroi fytyrën rreshter Rexha.

— Mos u habit, zoti rreshter, — ndërhyri Uka. — A nuk ke ndie ti se si Shotë Galica shtinte me pushkë mbi naçallnikët e kralit, a?

Dardanit iu përfytyrua në sulm Bukurie Çabiri. Në luftimet e fundit ajo kishte treguar një trimëri të rrallë, kishte hedhur një granatë mbi një autoblindë. Ishte një episod i bukur. Dardan Velishta kishte dëshirë të tregonë ngjarjen, por nuk mund të tregonë. Ai e përmendi mbyturazi emrin «Shotë». I hodhi vështrimin flakës së zjarrit në vatér dhe i ndriçuan bebëzat e syve. Shikonte me sytë e mendjes Bukurie Çabirin. Heshti.

— Tash po më vjen në hatër, — tha rreshter Rexha. — Për trimëritë e Azemit e të Shotës na tregonë baba dhe u këndonte edhe këngë.

— Shota e Azemi luftuan kundër kralëve të serbit, — tha Uka, — tash po luftojnë djemtë e çikat kundër gjermanit, zoti rreshter. Prandaj Vilenbergu vari në litar edhe trimen gjakovare Ganimete Tërbeshi. Ku ka poshtënim ma të madh sesa me të shkelë i hueji votrën dhe me të varë në litar edhe çikat e gratë? Edhe i thotë vetit burrë Cen Gozhita! Që atë sahat kur gjermani vari në litar gratë e çikat tonë, kush është shqiptar e me pushkë në dorë atë duhet t'ia vinte gjermanit në shpinë, se shqiptari për nder e vatan bën hije mbi dhé!...

— Të lumtë ajo gojë, — tha Rexha me mustaqe të dredhur. — Pas sodit ma mirë ha mushkënité e mia se lekun e Cen Gozhitës. Hëm, — psherëtiu, — gjuhë helmi e dhëmbë gjarpni ka. Medet për ne! Na rrejti qeni.

- Ka shumë njerëz? — pyeti Dardani.
- Ka nja dyqind si veten.
- Togeri tha katërqind.

— Rrejti besa, se edhe atij i ka hy lepuri në bark, — tha rreshter Rexha. — Ushtri gjermane e pafarë ka ardhë në Prizren nga jugu. Me ta kanë ardhë plot makina edhe me xhandarë e ballistë.

— Medet për ne, bre burra, — tha xhandar Dini. — Gjermani më një anë, Cen Gozhita në anën tjetër, thonë se, kush nuk lufton kundër komunistëve, do të pushkatohet në vend, nulla do t'i bahet rrafsh me tokën, gratë e fëmija do t'i degdisen në kampin e Prishtinës.

— Po pse nuk rri si unë në shtëpinë tande, o Din, — iu drejtua Ukë Rustemi, — po vritesh me vëllaznit e tu e bahesh stërvinë për korba?

— Pasha besën, vetëm tutem se më shfaros me gra e fëmijë Cen Gozhita me anën e kolonel Velinbergut, — u përgjigj Dini dhe vështroi rreshter Rexhën.

Reshter Rexha tundi kokën dhe vështroi kapotën e trashë të rreshterit gjerman dhe me zë të ulët tha:

— Ja, major Ceni s'ka besim te ne e na ka qepë mbra- pa gjermanin. Në çdo togë tonën ruan nga një si ky. Ai të shqyen si ujku i tërbuar!

— Cen Gozhitës gjermani ia ka mbushur xhepat me pare, po neve pse na i mori dreqi mendtë? — foli Dardan Velishta. — Ja çfarë shkruajnë partizanët! — dhe nxori nga çanta një komunikatë.

Sytë e xhandarëve shprehën shqetësim dhe padurim për të parë komunikatën. Dardan Velishta ia dha Dinit, ai ia dha rreshter Rexhës. Gjithë sa ishin rreth vatrës shihnin me habi komunikatën.

— Lexoje, Rexhë, — i tha xhandar Dini, — se ti di shkrim e këndim.

Rexhës iu hapën bebëzat e syve. Vështroi portën. Pasi u sigurua se togeri e gjermani po gérhinin në odën tjetër, filloi të lexonte me zë të ulët:

«Ushtria e popullit shqiptar po vjen. Brigadat partizane do të çlrojnë Kosovën...»

Cen Gozhita, ky këlysh i Pashiçit, i italianëve e gjermanëve, kërkon t'ju zhysë në llumin e tradhtisë, duke u hedhur në luftë kundër vëllezërve tuaj. Ne ecim përpara në sulm me besim se pushkët tuaja do t'ia ktheni armikut, sepse vëllai nuk vret vëllanë, nuk qet pushkë në motrën....»

Rreshter Rexha i zgurdulloi sytë, iu drodh buza e sipërme, e mbuluar me mustaqen e gjatë.

— Pasha besën ashtu ashtu, — tha rreshter Rexha. — Cen Gozhita ka ba kërdinë në kohën e kralëve të serbit.

— Atë po ban edhe tash me gjermanin, — tha Dini. — E na s'mujmë me ba kurrgja!

U dëgjua gérhima e rreshterit eses në dhomën tjetër dhe zëri i toger Delisë.

— Rexhë, roja? Roja, Rexhë, roja!

— Si urdhnon, zotni toger! — tha rreshter Rexha dhe bëri shuk komunikatën dhe e futi në xhep. Doli e kontrolloi rojën. Fjalët e komunikatës partizane po i shponin trurin si turjelë. E si t'ia bënte? Edhe ndaj toger Delisë ushqente një urrejtje që i ziente nga brenda. Dikur kishin qenë shokë, po tani ku toger Delia e ku rreshter Rexha.

Në odë ra një heshtje varri. Si rreshter Rexha dhe xhandarët e tjerë diçka të mundimshme po bluanin në kokë. Ndërsa toger Delia dhe gjermani po gérhinin në odën tjetër, dhe ne me armët nën kokë bëmë sikur po flinim. Nga mesnata, rreshter Rexha me xhandarët ngjeshën armët dhe dolën nga oda njëri pas tjetrit. Dardan

Velishta vështroi në dritare. Dalloj hijet e tyre që po largoheshin.

— Ikën, — na tha Dardani. Ukë Rustemi me ca dru të shkurtuara në duar u fut në odën ku ishim ne.

— Ku janë? — pyeti Uka me habi.

— Ikën, e thyen qafën, — u përgjigj Dardani.

— Ma hante mendja, — tha Uka. — Cen Gozhita disa i ka gënjer, shumë të tjerë i ka mobilizue me bajonetët e gjermanit. Prandaj po i lënë në dorë ferkemin e lepurit. Po largohen duke i marrë edhe pushkën e fishekët.

— Ata duhet t'uvin pushkën në shpinë Cenit e gjermanit, — tha Dardani, — por...

— Edhe asaj do t'ia dëgjosh krismën, — tha Uka, — se kanë shumë haqe për të marrë, e dije që nuk i harrojnë...

— Tashti duhet të bëjmë atë që biseduam..., — tha Dardani. Uka miratoi me kokë.

Dolëm në korridor. I vumë veshin portës. Dëgjohej gérhima e togerit dhe e gjermanit. Me gishtin në këmbëz të armëve u futën pa u ndier. Dardani dhe Meroja i vunë armën në gojë gjermanit, ndërsa unë e Uka ia vumë togerit.

— Mos luani! — thirri me zërin e tij të rreptë Dardani.

Togeri dhe gjermani hapën sytë të daldisur. U hoqëm armët dhe i lidhëm. Gojën ua mbyllëm me nga një shami. I nxorëm nga shtëpia dhe ikëm në drejtim të fshatit Bjeshkëz ku qëndronte shtabi i brigadës. Ukë Rustemi deshi të na përcillte deri në Bjeshkëz, po i thamë që të ruante shtëpinë e tij, se kushedi çmund të ndodhte.

Ndërko'hë kur ne po udhëtonim me makinë xhadesë mbi Prizren, në kërkim të vendeve ku kanë rënë

partizanët tanë, në kujtesën e secilit prej nesh vazhdojnë të vijnë copëza subjektesh nga veprimet e kompanisë, të batalionit e të brigadës. Posa makina doli nga gryka e thellë, shpatet e së cilës ishin të veshura me dushk e ah dhe eci anash fshatit, nulla dykatëshe e Ukë Rustemit majë bregut më rikujoj ngjarjen e asaj nate, rrështerin hitlerian në çastin që dalldisi me hovin e bishës që goditet në pritë. Më mbiu në sy pamja e tij, sytë e zgurdulluar, shkuma që nxirrte nga goja dhe Ukë Rustemi i heshtur me ata sy zbirues e fjalëpak.

— Ndalo, ndalo! — i thirra shoferit.

Makina bëri stop në vend. Sytë e Skifter Velçës pyetën: Përse? Tufa e deleve në pllajë vrapi e trembur, bariu u turr t'i priste hovin qenit ujk që me vërtik u përplas në xhamat e makinës si mbi egërsirën, por fjala e të zotit e zmbrapsi...

— Kulla e Ukë Rustemit është kjo? — pyeta unë.

— Po, — tha bariu.

— Në këtë kullë kemi ngrënë bukë atë natë me Dardanin, — thashë unë. Shokëve ua kisha treguar ngjarjen e asaj nate.

— Kërkojmë varrin e një partizani, — i tha bariut Skifteri.

— Qe ku e keni. Ukë Rustemi ia mbolli këtë qershë te kryet. Qershia është rritur ashtu si trimëria e partizanëve...

Në një rrasë guri, të vendosur te koka e varrit, ishte gdhendur ylli partizan dhe emri i dëshmorit. Në majë të tij ishte një varr tjetër me një rrasë guri të bardhë te kryet.

— Po Ukë Rustemi ku ndodhet? — e pyetëm bariun.

— Bri partizanit varri i tij është. Fill pas tij u vra. Një këngë u këndojnë.

M'u kujtuan fjalët që na pati thënë atë kohë Ukë Rustemi: «I hueji na ka vu zjarrin e na ka hapë shumë varre. Gjamë ka lëshue mbi këtë tokë, po na ja ku jena.

Zani ynë ndihet nëpër tytën e pushkës dhe nëpër telat e çiftelisë».

Në majat e hirta, në shkrepat e malit retë e den-dura i rrihte era. Era e ftohtë mundohej të tkurrte tokën e njerëzit. Ishte erë me thëllim.

— Më dhembin plagët, — u ankua Skifteri. Ai ka disa plagë në trup.

Një piketë tjetër vendosëm te varri afër kullës.

## IV

Një natë më vonë, njëri nga ne të gjashtë që bujtëm atë natë në shtëpinë e Ukë Rustemit, Mero Buresi, u vra. I kërkuam eshtrat e Meros e s'po biem në gjurmë. Disa javë para se të vinim në Kosovë kërkuam një portret të Meros dhe nuk e gjetëm, kërkuam certifikatën e lindjes. Nuk e gjetëm! Ishin djegur. «Katrëmbëdhjetë operacione bëri armiku në krahanë tënënde, djalo, dhe përherë i dogji shtëpitë tona, edhe qentë në zinxhirë na i vrau...» Dhe s'kishim vec emrin e Mero Buresit dhe kujtimet tona. Një javë më vonë gazeta lokale botoi një shkrim për Meron. Me kureshtje fillova të lexoj.

— E njohët? Është Meroja, — i thashë Skifterit.

Dhe i tregova skicën e botuar në gazetë. Ai papritur tha:

— Jo, ky nuk është Meroja. Është e vërtetë që Me-

roja kishte fytyrë të mbushur, vetulla korb të zeza, sy të bukur, por... Ky ballë me rrudha s'është i tij, balli dhe fytyra e Meros ishin të ciltra. Të kujtohet? E njoh mirë Meron. Ky nuk është Meroja. Mund të jetë kushdo, por Meroja nuk është. Ky ishte vështrimi i syve të Meros? Jo, ai kishte vështrim zhbirues, e njoha në ditët e vështira të luftës.

U detyruam të shkonim në fshatin e Meros, një fshat majë maleve të Gurshpatit, me themele të shtë-pive të mbërthyera në shkëmb. Gjetëm në shtëpi nën-nën e tij, Azikon. Nëna na dha një fotografi. E kishte mbështjellë me kujdes dhe e ruante. Fotografia më pruri më afër në kujtesë shokun e skuadrës, Meron, më bëri të mendohem përpëra portretit të tij, më duket sikur merr pjesë edhe ai në bisedën tonë rreth vatrës ku u përkund në djep dhe nëna Aziko i mërmëriti këngë trimërie. Në kujtesë më ishin fiksuar ngjarjet, shokët, udhët... Gjithë koha që jetova me Meron në malet e Gurshpatit dhe në brigadë, nata që kaluam në shtëpinë e Ukë Rustemit. Era e malit e rriti Meron shtatëgjatë e faqekuq. Ai, kur shtati i arriti gjatësinë e llabanes mori prapa manarët. Djali, si puna e mushkës së stanit, rritej gjithë huqe. «Djalë me xanxë», — thoshin në fshat. I ati si gurgdhendësi që pret e skalit gurin, ashtu dhe ai priste e gdhendte në karakterin e djalit të vetëm ato gjëra që ia kërkontejeta, se jeta në këto male ishte e sertë. I ati nguliste në shpirt të të birit ato që do ti kërkontejeta me dallgë.

Nëna Aziko na tregoi për ditën që Meroja doli partizan. «Ishte viti dyzet e dy, — tha. Atë vit erdhi në fshat komandanti i çetës partizane të Gurshpatit, gojëbilbili, Sopot Golemi. Na mblodhi dhe foli për luftën, foli fjalët e Partisë. Sopoti u tha të rinjve:

— Djemptë e vajzat e Shqipërisë kanë vendin në mal me çetat partizane». Shtatë-tetë djem nga fshati thanë: «Do të shkojmë!» Unë u dëgjova fjalën dhe më erdhi mirë, por, kur mësova që edhe Meroja im 16-vjeçar do të dilte partizan, s'di pse m'u drodh zemra, punë me rrezik m'u duk, por edhe ferrë në rrugë nuk iu bëra

djalit. «Ik, — i thashë, — ik aty ku të kërkon vatani». Dhe ai u përgatit. I bëra të hante dhe i dhashë me vete në trastë bukë me djathë. I vura edhe një palë çorape t'i ketë, thashë. Tjetër gjë s'kisha!

Sopoti ma pa hallin si e kisha. Më hodhi dorën në sup, e ndjeva dorën e tij si dorën e tim biri, më tha: «E ke dërguar zhveshur djalin, nënë, është hollë në veshje». E vështrova dhe një herë djalin, me shëndet div qe djali i nënës, më i madh nga çishte tregonote. Ka shëndet vendi ynë, vjen buzës së Vjosës era e detit dhe kemi klimë me shëndet. Nuk duhej vetëm shëndeti, kërkohej të qe i veshur djali tani që hidhte hapin tej pragut të shtëpisë. Dhe shoku i Partisë e kishte mi-rë. Veshja e djalit s'bënte, llastikat bërë me tela anash, rrobat napë e djegur, i njomte shiu që kur ishte reja larg në det. Ç'të bëja? «Edhe unë s'dua ta nis kështu, o bir, mos kam më tepër dhe s'i dhashë». U afrova unë tek ai, sa i afërt m'u duk. I jepja me vete djalin, i jepja shpirtin. Dhe kësaj here ia vura unë dorën në sup atij. «Eh, bir, po dhe ju vetë kështu jeni, copë e cikë. Parti e fukarait është kjo jona!» Ai qeshi, vuri rrudhë në ballin e gjerë. Gjatë natës punova dhe e bëra fannellën time bluzë për djalin dhe vrapova me një frymë tek ata.

«Urdhëro, nënë», — më tha komandanti i çetës, Sopoti. Ai priste t'i thoshja ndonjë fjalë. Iu bë qejfi mal kur i tregova bluzën e leshtë. Meroja e veshi shpejt e shpejt. Sikur m'u ngroh një cikë zemra kur e pashë djalin ashtu, të veshur. Para se të largohej çeta nga fshati, erdhi djali në shtëpi dhe më tha:

«Nënë, do të të kërkoj një gjë, s'besoj të ma prishësh, si thua?» Unë t'ia prishja qejfin djalit? E dërgoja në luftë, e dërgoja aty ku gumëzhinin plumba... aty ku vdekja orë e çast u qëndronte më pranë njerëzve.

«Do të ma prishësh?» — më pyeti Meroja, xhan i nënës! Edhe shpirtin të më kërkonte, s'do t'ia prishja. I thashë: «Fol, bir, fol!» Ai s'po ma thoshte. U bëra merak, ç'do të më kërkonte im bir? Pastaj ai hodhi vështrimin përballë te muri i plevicës. «Mos, atë jo», —

murmurita me vete që të mos më dëgjonte. Ajo ishte një diçka e pamundur për mua. Sytë e tim biri aty shikonin.

Ishte një amanet i plakut. Kur erdhën njëherë në fillim ushtarët e Italisë, ia mori nga dora atë armë një ushtari dhe e mbylli aty në mur. I bëri një vend të mirë me kashtë dhe e mbylli murin me baltë. Unë e dija, asnjëri tjetër s'dinte për armën që pruri burri në shtëpi, por Meros nuk i shpëtonte gjë pa e parë. Mu lut: «Na duhet, nënë, na duhet shumë mitralozi në çetë».

«Korba!» — thashë. «Mos t'ia thyej zemrën djalit, do të më zemërohet plaku, por...» «E bërë qoftë», — i thashë. Ai më shtrëngoi fort dhe djali e mori dyfekun me ç'kishte.

— Mitraloz, nënë Aziko, — i tha i nipi, — ashtu quhet ajo armë.

— E de, nga ato të Duçes ishte, m'u bëftë kurban. I la ferrave e gërxheve të Gurshpatit me ç'pati, bah ç'ushtri pa kripë paskësh qenë ajo e Duçes. Këta të allamanit, jo, s'qenë si ata.

Meroja u gëzua. Dorën e majtë e vuri mbi flokët e tij të zez, kishte flokë bandilli, ja fotografia! Dorën e djathtë e kishte të zënë, mbante dyfekun, apo si i thonë ndryshe...

— Mitraloz, — thamë ne të tjerët. Ajo vazhdoi:

— Unë, të them të drejtën, desha t'i flisja djalit, t'i thosha shumë gjëra, t'i thosha që të mos ligështohej në luftë, se nëna që nuk ia thotë djalit të saj këtë fjalë, bëhet pishman që e ka bërë. Djali rritet për vendin, për pushkën, për krismën... Më vjen turp nga vetja që s'mund ta bëja atë që duhet të bëja si dhe nënët e tjera. Të bëja atë që bën çdo nënë kur e përcjell djalin në luftë, kur ia jep atë Shqipërisë. S'gënjen dot nëna, nuk e di pse atë ditë më mbetën fjalët në grykë dhe s'ia thashë dot. Ama e dija ç'djalë kisha rritur, s'ia hante qeni shkopin. Ç'të them për atë ditë, sikur e kam përpara syve në kohën që e përcolla, më duket si të ketë ndodhur dje.

Kur u nisëm në drejtim të malit, im bir erdhë

tek unë dhe ma vuri kokën në gjoks, e përkëdhela dhe e shtrëngova fort. S'di përse, por atë kohë m'u duk se Meroja ishte ende i vogël pér t'u bërë luftëtar. I ndrisnin sytë. M'u shkëput papritur nga duart dhe iku biri i nënës, iku vrap që të arrinte shokët. Ai mbante në dorë atë dyfekun që s'e kishte tjetër.

«Nënë, mos u mërzit. Do të kthehem në vatër bashkë me lirinë», — më tha dhe iku.

Unë mbeta atje, vështroja nga mali tim bir dhe Sopot Golemin me çetën partizane. Kur u ktheva në shtëpi, ndreqa vendin në plevicë, e bëra murin përséri me baltë, njëlloj sic ishte, dhe heshta. S'bën ta them, po e kisha të sertë plakun.

Ishte e para herë në jetë që plakut nuk i tregova të vërtetën. I trembesha sherrit.

\* \* \*

Bjeshkëza, fshati ku u përqëndrua batalioni ynë një ditë më parë se të sulmonim në drejtim të Prizrenit, nxirrte avuj të tejdukshëm, degët e mollëve dhe të kumbullave ishin rënduar nga kokrrat dhe vështronin tokën. Në pranverë e në vjeshtë, këtu në fshatin Bjeshkëz bleron bari, blerojnë lule.. buis bollëku, bie lodra dhe bëhen dasma. Mbi gjelbërimin e barit, afër çesmës atë ditë bëmë mbledhjen e celulës së Partisë. Në këtë mbledhje erdhi edhe zëvendëskomisari i brigadës, Ar gjir Progri. Ai lavdëroi Dardan Velishtën pér aksionin e guximshëm që kreu me njësitin e tij në kapjen e roberve.

— Informatat që nxorëm nga robërit, — tha zëvendëskomisari, — bënë që armikun ta godasim në kohën që ai u nis pér të sulmuar. Goditja jonë e befasishme i coroditi veprimet e armikut. Shoku Dardan edhe këtë rradhë u tregua i devotshëm në plotësimin e detyrës.

— Unë? — tha Dardani i habitur dhe u skuq në fy-

tyrë. Kur e lavdëronin, e kishte më të vështirë se çdo herë tjetër. Iu mbush balli me djersë dhe s'diti të lidhë fjalën, donte të fliste dhe s'mundte.

Tregoi një episod të Mero Buresit. Atë natë Meroja nuk e kishte me vete mitralozin.

Ishte një ndodhi e bukur e Meros, që ishte veshur me uniformë xhandari.

— Kjo është meritë e të gjithë njësitet, shoku Argjir, — tha Dardani. — Unë nuk bëra asgjë më tepër nga Agoja, Agimi e Meroja, as nga fshatari patriot e trim, Ukë Rustemi, që vuri në grykë të topit armik familjen, shtëpinë!...

Zëvendëskomisarit i qeshën sytë, balli, fityra e tij e hijshme. «Ç'njerëz të mrekullueshëm po mbrujt luftha jonë, dashurinë për shokun, lavdinë për kolektivin, për popullin, atdheun, Partinë...» — mendoi ai me vete. Më vështroi në sy, më thanë sytë e tij: «Ja, për këto duhet të shkruani, shoku Agim».

Mbas mbledhjes së celulës fillova të zhvilloja me kompaninë një orë kulturore, Goxho Bërdëllima m'i nguli sytë therës. Përse më shikoi ashtu, vëngër? Ç'ish-te ai pungj me bërryl që i dha Meros, mandej përsë e vunë buzën në gaz? Shpjegova diçka për tokën, për ndarjen e saj në kontinente. Fola për detet e oqeanet, për shtetet e mëdha dhe për shtetet e vogla...

— Ç'flet ky Agim Noka, përralla me mbret na tre-gon? — i tha xha Goxhoja me zë të ulët Meros që e kishte në krah. Fjalën ma kapi veshi dhe më rrëmbeu zemërimi. E vështrova drejt në sy dhe zura të flisja, por nga zemërimi e humba fillin e bisedës.

Xha Goxhoja e kuptoi shqetësimin tim. Megjithatë pungjet i vazhdoi, i dha një bërryl tjetër Meros. Po prisja që Meroja të shpërthente në zemërim. «Një shkre-

pëse është Meroja, fup ndizet, aty ndizet e aty shuhet, rrëmbehet e në çast bie, hesht si memec e s'do t'ia kujtosh atë që ndodhi. «Ç'të bësh, — thotë, — shpirto misri është, ja kështu unë i ziu në çdo mbledhje të kompanisë të bëj autokritikë. Ama dhe shokët ma dinë huqin, s'më hapin rrugë kur më bie xhindi», — mendova aty për aty dhe u përpoqa të gjeja fillin e bisedës. Kur e goditi me pungj në ije xha Goxhoja, thashë: «U bë sherri sherr. Nuk ndodhi asgjë, sot Meroja u bë qengj. Nuk foli. Xha Goxhoja i murmuriti: «Kodra mbas bre-gut thotë.» U mundova t'i largohem shigjetës që ai hodhi në adresë time, por shigjeta më goditi dhe belbëzova, m'u mekën fjalët në gojë, më pushtoi turpi e m'u bë balli me djersë. Atëherë xha Goxhoja pushoi dhe fjalët e mia rrodhën më lirshém. Ai e hoqi vështrimin nga unë, u mbështet pas lisit dhe sodiste malin e Koritnikut, kurse unë po flisja për kontinente e oqeanë, po shpjegoja si rrrotullohet toka dhe bestytnitë mbi rrrotullimin e tokës. Thashë që dikur thuhej që tokën e mbante peshë me brirë një dem i zi. Të gjithë më dëgjonin me interesim veç Goxho Bërdëllimës. Ai, i mbështetur në trungun e lisit, zuri të gérhinte. Gérhima e tij më cingërisi nervat, jo vetëm se po térhqte vëmendjen e të tjerrëve, por më tepër se aty ndodhej zëvendëskomisari i brigadës dhe i ra në sy se një partizan flinte e gérhinte në orën e mësimit.

— Xha Goxho, — i thirra. Ai lëvizi buzët. I lëvizi mustaqja e zbardhur. Të tjerët buzëqeshën. — Ç'bën kështu, xha Goxho? — i fola së dyti.

— U mbështeta pak te brirët e demit të zi si toka dhe dremita. Më humbtë vendi i varrit, një sy gjumë mora, de! Dëgjon? — u përgjigj ai qetë-qetë dhe me pëllëmbën e djathtë lëmoi mustaqen xhufrrake.

Thumbi që lëshoi Goxho Bërdëllima drejt meje më hutoi. E gjithë kompania shpërtheu në gaz.

— Më thjesht, shoku Agim, shpjego më thjesht, — qortoi zëvendëskomisari i brigadës. — Nisu tek e afërtë e shko tek e largëta, nga e thjeshta tek e ngatërruara...

U hutova. Nuk dija nga t'ia filloja. Përsëri emi-

grova nëpër kontinente, fola me fjalë të përgjithshme. Zëvendëskomisari i brigadës filloi të shpjegonte. Ai e fillooi bisedën me këto pyetje: «I njihni këto fusha të gjera që shtrihen përpara? Si quhet ky vargëzim kreshtash të hirta që shohim në verilindje? Ku buron e ku derdhet Drini i Bardhë? Cilat janë qytetet që shohim? Dini ku ndodhet Peja... Gjakova, Prishtina. E dini ku...»

Ai foli thjesht e kuptueshëm për krahinën ku do të vepronim, për malet, fushat, rrugët ku do ta godisnim armikun. Ai na shpjegoi disa nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare të zhvilluara në Kosovë. Partizanët ishin bërë sy e veshë.

— Hë, mo, këto desha unë të dëgjoja! — tha xha Goxhoja. Të tjerët miratuan me kokë. Unë fshiva ballin.



Bisha, edhe kur lind, edhe kur ngordh, ulerin. Me zhurmë e gjëmime erdhën në Kosovë ushtarët esesë, me zhurmë e gjëmime do të largohen. Ujku i murmë (kësh-tu e quajnë divisionin «Brandenburg» të esesëve) është shtrirë gjatë e gjerë në Kosovë. Gjer ku shtrihen repartet e këtij divizioni?

Nga burimi mëmë, aty ku del i bardhë dhe i kristaltë Drini, andej nga malet e Pejës gjer në Kukës ku takohet me Drinin e Zi, gjithë rrugës, kishte ngulur kthethrat divizioni «Brandenburg». Ishte zënë si gerthi mbas rrënjes, thithë gjak si këpusha, bëhej gjithnjë e më gërryes divizioni i egër i esesëve.

Në fillim, kur erdhën për t'u ngulur në këtë vend, esesët përhapën fjalën se ata ishin njerëz të timoksillës<sup>1)</sup>. Mirëpo ky mit që u krijua, vetëm ditët e para shkrua nga pushkët partizane. Atëherë esesët me qëllim që të

1) Kështu quheshin ata njerëz që gjoja nuk i kapte plumbi.

nguleshin në këto troje, rrëmihën tokën, ngulën repar-tet në qdo nyje rruge, zunë anët e Drinit, i rënduan lartë-sitë me pozicione, bënë fortifikime në qytete. Kështu mbanin nën grykat e topave qytetet, fshatrat, fushat, rrugët.

Forcat e brigadës sonë ranë me vërtik nga mali në drejtim të xhadesë me vështrim nga qyteti. Në planin operativ të brigadës Sopot Golemi kishte shënuar me laps të kuq në hartë dy vija të kuqe, aë shkonin në të dy anët e kalasë që ngrihej sipër qytetit.



Bukuritë e malit të Sharit vërtet janë fantastike. Të duket se ky vargmal gunga-gunga, me sheshe, lugina e pllaja, éshtë i pambarim. Aty humbet delja në bar, de-hen tufat e kuajve nga njomishtja, zukasin bletët nëpër lloj-lloj lulesh. Në njérën nga shpatinat, në njérën nga këmbët që lëshon Shari në drejtim të fushës éshtë fshati mikpritës, Bjeshkëza.

Mbas dite kaluam vargëzimin e kodrave dhe e lامë mbas fshatin e bukur me kulla të bardha. Nga mali po frynte një erë e freskët, kurse në qiell retë u tra-zuan.

— Më ngjet reumatizmi në kyçë, do të prishet moti,  
— tha xha Goxhoja.

Dardani që nga fundi i rreshtit nxitoi të dilte në krye të kompanisë. Pas tij po ecte Ukë Rustemi. U për-shëndetëm me përzemërsi. «Sa burrë i pashëm éshtë!» — thashë me vete dhe m'u kujtua nata që kaluam në ku-llën e tij. Ukë Rustemi kishte sjellë në brigadë disa djem të armatosur, nga të cilët dymbëdhjetë erdhën në kompaninë tonë. Ata ishin nga fshati Bjeshkëz.

— Sa larg éshtë Prizreni? — e pyeti Ukën Lulo Dri-za, mitralieri i skuadrës. Batalioni eci në drejtim të qy-tetit.

— Një vrap pele, — tha Uka duke buzëqeshur.

Dardan Velishta po shpejtonte. Vështrimi i Dardanit u ndesh me atë të Bukuries. Ajo uli vështrimin përdhë, u bë lulëkuqe në fytyrë, eci disa hapa me vështrimin në tokë, enkas eci ashtu, iu vodh vështrimit zhbirues të Dardanit. Kishte ende edhe dy orë ditë. Nga kreu i kolonës erdhë urdhri i Skifter Velçës.

— Më shpejt! Ecni, mos e ndërprisni rreshtin!

Nga kreu i majtë batalionet e tjera të brigadës goditën në drejtim të Zburit dhe luftimet u shtrinë gjer në afërsi të Bistricës së Prizrenit. Oshëtimën e luftës po e thithë dhe po e shpërndante në gjirin e vet pylli pa anë.

Zbritëm me nxitim shpatit të malit në drejtim të Prizrenit.

— Kujdes, nuk jemi larg nga kalaja, — i tha Ukë Rustemi Dardanit.

Mjegulla mbuloi lartësitë mbi qytet dhe zbriti në fushë. Nuk dallonim çfarë kishim përpara.

— Eh, kjo mjegulla, — u ankua Dardan Velishta. Ndërsa ai po kërkonte komisarin e batalionit, Skifter Velçën, si nëpër tym, përballë pa ushtarë me helmeta, të cilët iu zhdukën nga sytë. — Ah! — psherëtiu. — Mjegulla është më e keqe se nata. Mjegulla...

Qëndruam një çast në heshtje me supet pranë e pranë dhe me vështrim përpara, ku e dinim se ndodheshin esesët me helmeta hekuri.

Luftimet në ditët me mjegull janë të rrezikshme, është më e mirë nata se dita me mjegull, vjen një çast që ajo largohet dhe atëherë mbetesh nën breshërinë e mitralozave e të topave të armikut. Ende jetoja me këtë mendim kur mjegulla e liroi vargun e kodrave dhe vezulluan në llogore helmetat e hekurta.

— Armikun e kemi afër, kujdes! — dëgjova zërin e Dardanit.

Plumbat që erdhën nga lartësia rrähën tokën, na bënë të gjithë të ulemi rrafsh. Zumë të matim vendin me sy. Pushkët tonë kérkuau shenjet... Helmetat e hekurta i kishim afër.

— Zjarr! — thirri Dardani.

Armët e kompanisë që u zbrazen njëherësh e kthyen zerin e Dardan Velishtës në bubullimë.

\* \* \*

— Ah, bre vëlla, lumenj gjaku kanë derdhur bijtë e këtyre trojeve për liri, por..., — më tha Ukë Rustemi. Kishte zënë pozicion pranë meje, mbante në brez një gjashtëshe Italie me nulli, për qafe gjermankën e gjatë e syrin në shënjestër. Uka ishte i veshur me tirq e mesin ia shtrëngonte brezi i leshit. Të gjithë burrat e kësaj krahine e mbështjellin fort belin me brezin e leshit, që e bën burrin të qëndrojë si borigë mali. Në shpatin e malit dhe në fushë vështronim qytetin, rrugët e kalldërëmta, ndërtesat e bukura, minaret e shumta, Bistricën që zbriste nga mali dhe ndante qytetin mes për mes.

Dalngadalë qytetin e mbuloi muzgu. Posa errësira u bë më e dendur, ne rrëshqitëm këmbadorazi në drejtim të kështjellës.

Errësira na shndërrroi në silueta, por nuk ishim të padukshëm. Esesët, të gurosur edhe ata vetë në murin e ftohtë të kështjellës, përgjonin që të na vinin në shënjestër. Poshtë, nën kështjellë, qyteti ndezi dritat. Flakët e pushkëve nga mali, dritat e shumta të qytetit të madh e mbyllën nga cdo anë kështjellën, i nxorën më në pah konturet e saj. Mbi kështjellën ku ishin futur dhe përgjonin gjarpërinxhë vdekjebrurës, ishim ngulitur vështrimet tonë me svrin në shënjestër. Një llogore e hapur në shpatinë përpëra mureve të kështjellës na goditi në befasi me granata dore. Do të ishte vetëvrasje të qëndronim në vend ose të tërhiqeshim.

— Përpara, — thirri Dardan Velishta. Me granata në duar u hodhëm në drejtim të llogores. Esesët në kështjellë ende nuk po merrnin vesh kush e mbante llogoren, ne apo ata, që të bënин zjarr. Po llogoren nuk

e mbajti asnijëra anë. Ata ikën në drejtim të kështjellës, ne shkuam mbas tyre.

Një bateri mortajash bëri zjarr të përqendruar mbi llogore.

Me granata dore detyruam të heshtnin dy-tri pozicione të tjera. Përballe kështjellës na ndeshi sharra në gozhdë. Një mitraloz «Shars» u gjallérua. Ai zuri të villte plumba me zjarr.

Dardani dhe Vaso Lundra përparuan me zjarr përtë arritur gjer te çerdhja e mitralozit «Shars» që mbannte në shënjestër vargun e kompanisë sonë. Granatën në frëngji të mitralozit e hodhi intendent i kompanisë, Vasoja, ndërsa Dardan Velishta iu qep pas esesit, që ta zinte të gjallë. Vasoja nuk hodhi asnje çap më tej, e hoqi vështrimin nga esesi që iku në drejtim të kështjellës. Sytë e tij panë tytën e mitralozit të braktisur nga ushtari. Vrapoi nëpër hendeklidhje dhe hyri në pozicion. Mitralozi kishte në gojë zinxhirin e gjatë me plumba. Ishte i padëmtuar. Kështu bënte gjithnjë në sulm Vasoja. Thesi i bukës i intendentit mbushej me fishekë e granata, supet rëndoheshin nga armët trofe. Ai iu gëzua kapjes së armëve më tepër nga Dardani që e kapi rob esesin. Edhe diçka tjetër e gëzoi Vason. Esesët, armët që u mbeteshin, në çastet e fundit i bënin të papërdorshme. Mitraljeri nazist nuk arriti ta bënte këtë, se shpejtoi të mos binte rob. Vasoja iu afrua armës që pak më parë i kërkonte kokën dhe e përkëdheli. Qëndroi një kohë me armën në duar, u ul në llogore, e mbajti afër, i kaloi dorën sipër, e vëzhgoi me kujdes dhe bëri disa shkrepje bosh. Kur u bind që arma ishte në rregull, desh fluturoi nga gëzimi. E gjeta duke ledhatuar armën e zënë. Përpiquej të dëgjonte krismat e mitralozit të Mero Buresit.

— Gjysmak edhe ky, — i thashë.

— Jo, jo! — tha Vasoja. Zéri i derdhte gëzimin. — Iu shtua kompanisë sonë edhe një mitraloz tjetër.

— Shpejt u bëtë miq! — i thashë.

— Mjaft u shërbeve atyre që mbjellin vdekjen në troje të të tjerëve, sot e tutje do të bësh ashtu si të

themi ne. Kemi shumë borxhe pér tē marrë! — i foli Vasoja armës si tē ishte njeri dhe ta dëgjonte.

Muzgu fshehu pamjen e largët, po kështjella dukej. Në afërsi tē pozicionit ku ishte Luloja me mitraloz u afrua një njeri. Ai u ndal te cepi në anë tē llogores. Ishte Vasoja. Në mbledhjen e fundit që pati bërë kompania në fshatin Bjeshkëz, Agoja e pati shembur në kritikë Meron. «Kam tre muaj mbas tij dhe s'ma dha një herë tē qëlloj me mitraloz. Si kështu? U dashka që t'i çoj kasën me fishekë prapa, vetëm kaq duhet tē bëj unë?....» Meroja shurdh që shurdh mbeti edhe kësaj here. Agos s'iuh dha rasti tē luftojë me mitraloz.

— Usta jo i mirë je, — i kishte thënë ai Meros. Meroja s'ia kishte marrë fjalën pér tē keq. Ai e ndiente veten si pa duar po tē mos luftonte me mitraloz në vijën e luftës.

— Eja, këtu, Ago, afrohu, — dëgjoi një zë nga afër, te cepi i llogores. Agoja lëvizi nëpër hendeklidhje. Dalloj trupin e atij që i foli, e njohu. Ishte Vasoja.

— Të solla një turtull, bëje tē këndoje dhe tē qoftë! — i tha Vasoja. — Ama, tani e dua t'ia dëgjoj zérin, sa më parë, dëgjon?

Agos i flakëruan sytë. Mitralozi ishte i ri, fringo.

— Provoje, ndoshta...

Agoja e vuri në pozicion, e mbështeti qytën e mitralozit te supi dhe sytë e tij vështruan myret e përhimta tē kështjellës. Aty ia drejtoi tytën mitralozit. E shtrëngoi armën fort dhe ia tërroqi këmbëzën. Qyta e armës rrahu supin e Agos, zinxhiri i plumbave dum-dum rrahu murin e kështjellës.

— Xixë genka. Ja ku e ke edhe arkën me fishekë. Faqe bardhë, Ago! Ika, ika! — i foli Vasoja buzagaz dhe u largua.



Dardan Velishta, me pushkën dhjetëshe në dorë, vrapiqë ballë dhe u dha zemër shokëve.

— Dardan! Shoku Dardan! Shoku komandant! — u dëgjuan zëra. Errësira s'na linte të vështronim asgjë. Me sytë e mendjes po shikoja duke u endur nëpër llogore shokun tim, Dardanin shtatgjatë, flokëzi e syzhibirues, me vetull të bukur, shikoj buzëqeshjen e tij, gjiltërsinë e komunistit. Ai zbrazi gjer në fishekun e fundit një karikator me fishekë në drejtim të kështjellës dhe thirri:

— Përpara!

Humbi edhe ai vetë nëpër flakët.

\* \* \*

Plumbat me zjarr të mitralozave vollën plumba, që shuheshin sipër kokave të të dy palëve kundërshtare. Gumezhinë automatikët e, në të rrallë, befas zjarri u ndëpre. U duk sikur përlleshja mori fund, por papritur feksi flaka e një belgjiku e kjo ishte e mjaftë që të dy palët të shtinin në përdorim armët që zotëronin. Pas krismave rrodhën piika gjaku... Me gjak u hapën shtigjet e myllura. Midis krismave dëgjohej një zë. Këndonte një partizane:

*Dhe mos ktheftsha unë, moj nënë,  
ti mos bëj merak,  
se liria s'jepet, nënë, fitohet me gjak,  
hej, moj nënë, hej...*

U mundova t'ia mësoja emrin partizanes që këndonte, por s'munda dhe eca në atë drejtim. Ajo vrapi më përpara. Më rrëmbeu dëshira që pikërisht atë partizane që këndonte ta njihja, t'ia mësoja emrin, t'i qëndroja afër gjatë atij luftimi. Ishte një rast i mirë, doja t'i shkruaja revistës së brigadës. Shkova në atë drejtim.

Mbas krismave të armëve dëgjova përsëri zërin e partizanes. M'u bë si zëri i Bukuries. Aty ku thirri par-

tizania, disa hapa afër saj u dëgjuan krisma. Nuk dallohej asgjë, ishte errësirë, po një gjë ishte e qartë: mitralozi ishte prishur e esesi mundohej ta rregullonte me gurë. Partizania që ishte afër rrëshqiti, iu afrua në terr kundërshtarit, dhe, në çast, ia lëshoi granatën mu në prehër dhe eci përpara.

Dritat e shenjave ndriçuese që hodhën në kështjellë u hapi sytë mitraljerëve armiq dhe ata filluan të shtinin si në ethe.

U dëgjua edhe një herë zëri i partizanes. Ajo shtinte me automatik dhe këndonte:

*Liria s'fitohet, nëno, pa derdhur gjak,  
hej, moj nënë, hej!*

Rrëshqita kämbadoras në drejtim të asaj. Doja medoemos t'ia mësoja emrin.

## V

Në çdo hap që hedhim nëpër Kosovë ndeshim gjurmët e gjalla të qëndresës dhe të heroizmit. Ndalemi te rrapi me emër. Aty nën muret e kështjellës, ku luftetari i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Ramadan Zaskoci, ia zbrazi telegrafistik të Mehmet Ali pashës koburen në gjoks. I huaji u shafit përdhë, i deleguari i sulltanit, mashali i Perandorisë Osmane, pohoi: «Më mirë të isha vrarë unë...» Sa frikë ndien i huaji në hapin që hedh në këto troje...

Tradita është vazhdë, gjak mbi gjak...

Në këtë grykë, te ky vend kërkojmë eshtrat e Meros, partizanit të kompanisë sonë që mbuloi tërheqjen tonë duke sakrifikuar vetveten. Mundohemi të përcaktojmë vendin ku qëndroi e luftoi Meroja. E prumë gjurmën e tij te kryqëzimi i dy rrugicave prej nga vështrohen nga lart-poshtë si në pëllëmbë të dorës shtëpitë e qyte-

tit. Këtu është vrarë dhe këtu është varrosur shoku ynë.

— Erdhët, djemtë e nanës? — na tha e zonja e shtëpisë. — Ajo është e etur. — Kam pritur me vite, — tha nënë Gjyla, — e dija që dikush do të trokiste, do ta kërkonte birin e nanës. Dhe erdhët, që ku e keni trimin!

— Është nëna Shqipëri që e nderon, — tha Skiftri, — një Shqipëri e kuqe si e ëndërronin ata që ranë.

Hymë në oborr, u përshëndoshëm me të gjithë njerëzit e shtëpisë dhe u ulëm të bisedonim. Në odën kosovare si askund gjejnë shtrat të ngrohët, fjalët për trimërinë dhe për trimat. Trim i nderohet dhe respektohet. Trimëria lartësohet nga burimi i pashtershëm i patriotizmit të vatrës. Ky burim, sado kërcëllima të bëjnë, s'shterr kurrë. Rrjedh i bardhë me ngjyrën e kuqe të lules bozhur siç rrjedh i bardhë Drini.

Nënë Gjyla është e moshuar, me thinja, por me vështrim shqiponje. Si çdo nënë shqiptare ajo është burim i trimërisë dhe qëndresës. Ajo lartësohet në sytë tanë.

— Këtu e kemi trupin e trimit, — tha nëna. Shikuam midis bahçes varrin e shokut tonë të rrethuar me lule e trëndafila të kuq. — Emrin nuk ia dimë, i dimë vetëm trimërinë, — tha nënë Gjyla. — E dimë që është i brigadave të Shqipërisë, e dimë që... Lum nana për trim që kishte rritur. Ja vendi ku luftoi, aty ishte. Luftoi e luftoi dhe hop, u hodh në mur. Kërkonte të ndihmonte shokët që të tërhiqeshin mbi kala, por, duke qëlluar, u plagos. Im bir vrapoi dhe e futi brenda që të mos binte në duart e nemcelinjve e të tradhtarit Cen Gozhita.

Balli i nënë Gjylës posa zuri në gojë emrin e pushtuesve e të tradhtarit u mbush me rrudha të thella, brazda-brazda. Shënova në fletore: «Nënët, si askush tjetër, e urrejnë pushtuesin e tradhtinë».

— E morëm para duarsh dhe e shtrime në votër trimin e nanës. U munduem ta shpëtonim, por nuk mundëm. S'priti puna për ilaçe e për doktor. Ishte goditur randë. Ishte në agim të ditës kur ia shtrëngojë duert e

ai më tha dy herë: «Nënë! Nënë!» Dhe më mbaroi në duer.

Një çast heshti. Në përfytyrimin e nënë Gjylës, në sytë e saj, mbiu shoku Mero Buresi, djaloshi me yll të kuq i goditur nga plumbat. Qëndrimi i tij i pamposhtur në çastet e fundit të jetës i dha zemër dhe nënës. Ajo i fshiu lotët. E rrëmbyer nga zemërimi, tha:

— Erdhën nemcelinjtë bashkë me ata qenat e Cen Gozhitës dhe s'lanë vend pa kërkue, por nuk e gjetën. Një partizan tjetër që u vra atje sipër, qentë e Cen Gozhitës e luajtën nga vendi dhe e zbritën në qytet. Tri ditë e lanë trupin e tij të varur. I marroftë zoti, i banin qejfin dushmanit dhe linin vëllanë në litar. E hoqëm natën dhe natën e varrosëm. Si ta linim djalin tonë në konopin e të huajit?

— Ia dini varrin?

— Si jo? Ju çon nana, — tha ajo. — Mozomakeq, mozomakeq, për atë që dëgjon të huajin. Eh, i hueji të nxjerr kafshatën nga goja, fëmijén nga barku i nanës. Të huejt u përpoqën të na fusnin të gjallë në dhé, po ne nuk u tutëm, se dy duer janë për një krye!.... I varrosëm djemtë, ju pritëm të vinit t'i merrnit dhe s'po vinit, ndoqët hasmin. As emnin nuk mundëm t'ia mësonim djalit. I shkruem në gurin e vorrit «Partizan i brigadave të Shqipnisë.»

Hapa listën dhe vura një shenjë bri emrit të partizanit. Ua tregova dhe emrin.

— Emër të bukur na paska pasë, nuk e gjëzoi lum nana, u vra. Ishte i ri kur u vra. E mbaj mend kurmin e tij të njomë, fjalët e tij: «Nënë! Nënë!» Zérin e tij këtu e kam, — tha nënë Gjyla dhe vuri dorën e vyshkur në zemër.

— E kishte nëna djalë të vetëm.

— Heu, i paska tharë zemrën plumbi i dushmanit, — tha nënë Gjyla e kësaj here i rrëshqiti një pikë tjetër loti. Në çastin kur arkivoli i kuq doli nga porta, nënë Gjyla u zbeh në fytyrë e tha:

— Më ike, bir i nanës. Ani s'ka gja, ti je djalë me dy nana, ajo që të lindi e të rriti pret t'i shkojnë

kockat në Tiranë... Ani, selam m'i bani. — Iu drejtua arkivolit: — Vënu në radhë me trimat e tjerë, këtu në këto troje le gjakun, toka do ta ruajë gjithmonë gjakun... — Me pëllëmbën e dorës ledhatoi arkivolin. Lotoi... Dhe prapë murmuriti me zë të mekur dëshpërimi: — Toka do të ta ruajë gjakun... po, bir.... Toka jonë gjithmonë e ka ruajtur gjakun e trimave, ndaj asht e butë, jetëdhënëse e pjellore, e sertë, sepse pika gjaku kallon.

Arkivoli i kuq, si një flakadan i ndezur, doli nga porta....

\* \* \*

Atë natë që batalioni sulmoi në drejtim të qytetit kompania jonë me një vrapim të shpejtë rrëshqiti anash kështjellës. U munduam t'i shpëtonim vëzhgimit të armikut që ishte në kështjellë. Ajo që arritëm ta bënim në kërcimin e parë u bë e pamundur në të dytin. Hodhën nga kështjella në drejtimin tonë një shenjë ndriçuese. U shtrimë rrafsh me tokën dhe u humbëm nga vështrimi shënjestrave të armëve të armikut. Pritëm gjersa të shuhej drita, që të hidheshim përpara. Drita nuk u shua, por qëndroi e varur mbi një parashutë të vogël, ndriçonte vendin. Goxho Bërdëllima e gjuajti me maliher dritën.

— Mos i harxho fishekët, xha Goxho, — i tha Dardani.

Mitralozat nga kështjella zbrazën shiritat, një zinxhir i zjarrtë, një ndërprerje vijash xixëlluese dhanë flakërimë. Mbas pak drita në qìll papritmas u fik. Goxho Bërdëllima përkëdheli maliherin: «S'ma ke turpëruar syrin, as gishtin.»

— Përpara, — thirri Dardani. Vrapuam, u humbëm nga vëzhgimi armëve të kështjellës.

Në krahun e majtë të lumit të rrëmbyer Bistricë

kompania zbriti shpatit. Disa herë Dardani zgjati koken për të parë shtratin e lumi. Dëgjonim zhurmën e lumi, po shtratin e tij nuk e vështronim dot.

— Grykë tepër e ngushtë, — tha Dardani. Zjarri u dendësua.

— Më shpejt, më shpejt! — Dardani nxit shokët me zë të ulët. Rrëshqitëm nëpër bokërima, zbresim në fund të grykës.

— Ndal, kush shkon aty, — thirri një xhandar nga të Cen Gozhitës. Xhandarët kanë mbyllur shtegun që zurret anash Bistricës, në qendër të Prizrenit. Krismat dhe flakët u kryqëzuan rreptë.

\* \* \*

Mercenarët e Cen Gozhitës nuk i rezistuan dot sulmit tonë. U vunë në ikje... Anash lumi u afroa ballas tyre një përbindësh i hekurt.

— Cen Gozhita, — thanë mercenarët, me frikën e fëmijës së vogël kur i thonë: «Gjarpri!»

— Ku shkoni, he ju marroftë zoti? — hungëroi Ceni nga kulla e hekurt. Ata nuk u ndalën. Cen Gozhita nga autoblinda hapi zjarr më mitraloz mbi njerëzit e tij. Ata mbetën si pika të zeza anash rrugës.

Dardan Velishta, sapo e dëgjoi emrin e Cen Gozhitës, rrëshqiti në drejtëm të autoblindës t'i priste rrugën.

Ndjenja e shokut për shokun na ngriti nga pozicioni dhe nëpër plumba ecën edhe një shënjestër pushke më përpara. Aty u ndalëm. Syri i Bukuries u mek mbas Dardanit që vraponte në drejtëm të autoblindës. Ajo nuk fliste, as nuk shtinte; donte të thoshte diçka, po nuk e tha. Çfarë donte të thoshte Bukuria? Dardani u nguros në vend kur dëgjoi emrin e Cenit. Ishin ballë për ballë ata të dy, kryqëzonin vështrimin dhe armët mbi njërit-tjetrin. Dukej që mbrapa s'kthehej asnjëri nga të dy.

Dardani fill i vetëm shkoi në drejtim të makinës së hekurt. Edhe autoblinda në drejtim të Dardanit.

— Dardan, — i thirrëm. Ai s'foli as nuk ndaloi. Në këto raste Dardani bëhej shurdh. Do t'ia kishte arritur më mirë qëllimit, po ngutja i prishi punë Dardanit. Hodhi para kohe granatën e yetme që kishte. Autoblinda eci në drejtim të tij, Dardani i drejtoi grykën e pushikës.

— Ndalu, he bastard, ndalu aty! — thirri Dardani dhe mbi kullën e autoblindës rrähën plumbat e dhjetëshes gjermane. Dardani dëgjoi fjalë. Njëri nga të vrarët, i mbytur në gjak, tha: «Cen, o farë e keqë». Autoblinda kaloi, Dardani iu afrua të vrarit, donte të dinte nëse ishte ai vërtet Cen Gozhita i Batinit apo ndonjë tjetër? Kufoma nuk jepte më shenjë jete.



Urdhri që mori nga Skifter Velça Dardanit ia mpiu këmbët. Murmuriti:

— Në këtë çast nuk duhet të tërhiqemi. Ata na kanë nën vëzhgim dhe do të na sulen si ujq të tërbuar.

Në lartësinë mbi kështjellë shenjëdhënset përsëritën edhe një herë urdrin e tërheqjes. Në vështrim, në të ecur dhe në fjalë Dardani u bë tjetër. Dukej që jetonte çastin e njeriut që zgjohet nga gjumi, i zhgënjiyer nga një èndërr e bukur.

— Mendova se po sulmonim në qendër të qytetit, aty të jehonin armët tonë, kurse tanë duhet... — Nuk tha q'duhet të bëjmë. — Hë! — ia bëri me një mëri të rëndë dhe pastaj me pëllëmbën e tij shtrëngoi tytën e pushkës dhjetëshe. Dënesë zemërimi si asaj here nuk kisha vënë re te Dardani.

- Ndezin drita, — thashë unë për ta qetësuar.
- Populli na pret me padurim, — tha Dardani.
- Po, Dardan, ai na pret krahëhapur.

Dritat në qytet dendësohen më shumë.

— Të huajt u përpoqën të shuajnë çdo shkëndijë drite në këto troje, — tha Dardani. — Ah, liria! Një ëndërr e përjetshme e kosovarit. Kralët e mëdhenj e të vegjël dogjën me zjarr e hekur këto troje, vetëm se bijtë e tyre luftuan pér liri, pér dritë!...

Pak më tutje Goxho Bërdëllima ishte ulur e po dridhët një cigare. «Eh, kokë më vete dhe ky xha Goxhoja! Kur të tjerët luftojnë, i shkrep të luftojë, lufton; i shkrep të rrijë, rri. Ja tani pi duhan, dhe vështron qytetin, dritat që ndizen, shuhën, ndizen, shuhën...» — mendova me vete.

— Bah, c'qytet i madh qenka? — tha Goxhoja dhe nisi një këngë që ka lidhje me historinë e qytetit, me historinë e gjithë kombit:

*Ky Abdyl bez Frashëri  
C'u përhoq i varfëri..*

Burrat e Bjeshkëzës me xhamadana të shkopshitur zunë vend krah nesh, në një llogore të përbashkët. Disa çaste më parë, në atë pozicion qenë esesët. Tre mitraljerët tanë: Luloja, Meroja dhe Agoja lëshuan në drejtim të esesëve breshëri të paprerë plumbash.

— T'i ndjekim, bre, — tha Ukë Rustemi që e kisha në krah.

— Prit, kujdes! — tha Bukuria. Unë miratova me kokë.

— Kush është kjo? — më pyeti Uka.  
— Komandantja e skuadrës, — i thashë.

— A, — bëri Uka dhe balli i tij i gjerë, vetullat e mbledhura, fytyra simpatike shprehnin habinë e tij që na komandonte një vajzë. Një ushtë e zjarrtë shkoi në drejtim të qiellit, ajo mbeti një kohë mbi pozicionin tonë e vendi llapsi si të ishte ditë. — Këtu ka me gjuetë mortaja, duhet të largohem nga ky vend, — tha ai. Në çast një mortajë gjashtëgrykëshe hapi zjarr në shpatin e malit. Predhat goditën në afërsi të pozacioneve tona. Ballas lëvizën përsëri ushtarë. Burrat e Bjeshkëzës sokëllinë më të madhë dhe shtinë në drejtim të esesëve. Gjokset e tyre të shkopsitura dhe syri në shënjestër as që donte t'ia dinte. Mendova: «Gurë stralli janë këta! Vëç shkëndija nxjerrin!...»

Sokëllinin thekshëm, shtinin rrallë, plumbat e tyre kafshonin idhët, nuk tundeshin nga pozicioni.

\* \* \*

Dardanit iu duk vetja si njeriut në ëndërr që dëshiron të arrijë në një pikë, ecën, afrohet me mundim, por nuk arrin dot në pikën që dëshiron. I mbyllur në vetvete, shtrëngoi nofullat dhe filloi të ecte nëpër llogore.

— Duhet të térhiqemi, — tha. Dha shenjën e térheqjes...

Vaso Lundra, sa ra në gjurmë të arkave me fishekë e granata, iu afrua Dardanit me një frysë dhe i tha:

— Aman, t'u bëftë Vasoja, më ndihmo! Një morime fishekë e bomba!...

— Kjo është punë me trezik, na është dhënë urdhri të térhiqemi, — tha Dardani.

— E këto? — zgjati duart nga arkat me fishekë dhe me bomba.

— T'i djegim, — tha Goxho Bërdëllima. U kallim eshkën dhe në të s'ëmës të venë bashkë me jermanin.

— E si t'i djegim?! — kundërshtoi Vasoja, ashtu si kundërshton njeriu pér një tjetër që s'e sheh të udhës të pushkatohet.

— Nuk ngarkohet mali në shpinë, Vaso, eshkën de, ç'presim, Dardan, jep urdhër. — foli xha Goxhoja.

— Jo, jo! — kundërshtoi Vasoja përsëri. — Duhet t'i marrim, se këto i duhen batalionit, brigadës si buka që hamë!...

\* \* \*

Disa minuta më parë Dardani thërriste:

— Qëlloni mbi egësirën, sulmoni përpara! Përpara!  
— Këmbëngulja e tij pér të hyrë medoemos brenda në qytet e veçoi kompaninë nga forcat e tjera të batalionit. Tani ai e ndiente që ishte futur në gojën e egësirës, midis dhëmbëve të saj. Shtrohej çështja: «Do të mundim të dallim nga ajo grykë e thellë, apo...?» Dardani e ndjeu se shkaktar pér këtë ishte ai vetë.

Aty, një shënjestër pushke larg llogoreve, Dardani vazhdoi të grindet me Vason. Mali i arkave me fishekë, granata e predha qëndronte ballas tyre.

— Janë pak njëzet arka. Edhe dyzet janë pak, — thotë Vasoja. Ngopet i urituri me bukë, aq ngopej edhe Vasoja me fishekë. Afër xha Goxhos shpërtheu predha, plumbat e armikut kafshuan dheun. U dëgjua edhe një rënkim që arriti mbyturazi në veshët tanë. Xha Goxhoja rrëshqiti andej. Ai që rënkonte ishte Ago Ymeri. Ndaj s'dëgiohej më «turtulli» i Agos?

— Ç'ke? — i tha xha Goxhoja. Agoja u përgjigj duke rënkuar.

— Plaga nuk është e rëndë, — tha sanitaria e kompanisë me zë të dhembshur. Adilja nuk i alarmonte gjérat, prandaj i kishte hyrë në shpirt Goxho Bërdëllimës.

— Ik, ore, thashë se të dhimbte dhëmballa, pér atë erdha, — tha xha Goxhoja dhe iku. Adilja e vuri buzën në gaz, Agoja heshti, nuk rënkoi më.

Secili nga ne hodhëm në sup nga një arkë me fishekë dhe filluam të tërhiqeshim, kurse xha Goxhoja hoqi një kasetë me zinxhira me plumbë mitralozi, e afroi afër trupit pér ta marrë me vete dhe goditi strallin me masatin që ndizte eshkën. Ai, pasi ndjeu erën e eshkës, e tundi dorën dy-tri herë që eshka të merrte mirë.

Ndërkaq kompania u largua dhe ai kuptoi që u nda nga shokët, hodhi eshkën midis arkave të predhave dhe nxitoi. Dëgjoi afër zëra. «Erdhën syfandaksurit», — tha dhe e la rrugën, eci bregut të lumit. Esesët u derdhën pas nesh, po vrapi e rrëmbyeshëm të tyre e topitën breshëritë e paprera të një mitralozi që ishte vendosur sipër, në afërsi të disa shtëpive. «Mitralozi i Lulos nuk është», — murmuriti me vete xha Goxhoja. E njihte «Bredën» e Lulo Drizës. Iu kujtua Meroja. U bind se ishte mitralozi i tij. U topit anës së Bistricës me veshin në përgjim te mitralozi i Meros dhe tek eshka që digjej në malin me predha.



— Duhet të shpejtojmë. Q'të bëjmë me municionin? — pyeti Dardani me zë të lodhur. Fjala e goditi Vason si shufër teli në ballë.

Afër tyre ndodhej Ukë Rustemi dhe burrat e Bjeshkëzës, që erdhën në luftim. Uka dëgjonte bisedën që bënnte Dardani me intendentin e kompanisë.

— Ne po vijmë me ju, — tha njëri nga territorialët, — do t'ju ndihmojmë pér tërheqjen e arkave, fishekët i duhen brigadës...

Ecëm. Dardani vështroi të kapte Yllin e Mëngjesit. Qielli u rëndua përsëri nga retë. Mbas pak një shi i rrëmbyer vjeshte shkarkoi me shtrëngatë.

\* \* \*

Një predhë murtaje shpërtheu në buzë të llogores ku zuri vend Meroja për të mbrojtur tërheqjen e kompanisë. Ai mbylli sytë, qëndroi një kohë ashtu.

— Mé verboi drita e predhës, s'po shoh, — tha ai dhe fshiu sytë me pëllëmbën tërë dhé. Vazhdoi të kollitej. Ty-mi i tritolit ishte farmak. Ushtarët e huaj i krahasoi me dimrin e gjatë me acar. Atë dimër vriste mitralozi i Meros që, aty për aty, kishte heshtur. Esesët menduan se zjarri i mitralozit qe shuar. Meros një mendje i thoshte të tërhiqej, tjetra jo. Vendosi të qëndronte. E hodhi dorën te krahu i mitralozit. Mbi esesët që vraponin grykës për të arritur kompaninë u derdhën breshër plumbat e «Sharshit» të Meros. E kuptoi se shtigjet ishin të zëna. Mendja e Mëros përsëri u hallakat, kërkoi një rrugëzgjidhje, një shteg nga do të tërhiqej. Gjallërimi i zjarrit të mitralozit i shtoi edhe më tepër qitjet e mortajës. Meroja ndjeu që diçka i gufoi në gjoks, vuri dorën, shkumë e valë në gjoks. U mundua ta mbyllte plagën dhe rrëshqiti disa hapë më tej nga vendi ku u godit. Eci anës murit të kësh-tjellës në drejtim të shtëpive. Ndjeu hungërimën e bashi-bozukëve të Cen Gozhitës.

— Në je burrë, dil në log, — i tha një nga të Cenit.

Meroja mundi të rrëshqiste më tej, aty e lanë forcat. Ata po i afroheshin. Ai u hodhi një granatë. Ndodhej përballë një shtëpie me avlli. Vështroi murin, po s'kishte fuqi ta kapërcente. Iu afrua portës, s'mundi të trokiste. «Eh», — rënroi. Kanati i portës u hap. Ndjeu që dikush e rrëmbeu në duar. Korbat e Cen Gozhitës po e kërkonin... Në çast ndodhi e papritura që u duk sikur e fundosi në dhë qytetin. Eshka e Goxho Bërdëllimës i dha zjarrin malit me predha.

\* \* \*

Ankthi i pritjes nuk e mban kohën në vend. Brigada e kapërceu Drinin. Edhe batalioni ynë ishte vënë në kolonë. Skifter Velça me disa partizanë qëndronte në bregun e lumit. Kompania s'dukej. «Ku është kompania? E mori lajmin e tërheqjes? A e gjetën kompaninë korrierët? Një breshëri automatiku në pritë dhe urdhri u shua!» Këto pyetje po i bënte vetes ai dhe përpiquej të largonte mendimin e keq. Skifteri e dinte që Nasi shalëgjati kishte këmbë, zemër e zgjuarsi ta çonte në kohë urdhrin. «Atëherë përsë u vonua kompania? Mos Dardani bëri ndonjë proçkë». Në sulm rrëmbehej Dardan Velishta, sado që Skifteri e kishte porositur që të ecet përpëra në sulm aq sa të kishte mundësinë të dilte nga luftimi. «A e kishte këputur kontaktin kompania me armikun? Ndoshfa! E ato gjëmime të vazhdueshme në qytet c'ishin, ajo flakërimë që shihej nga larg nga se ishte shkaktuar?» U lodhën duke vështruar me dylbi malin nga zbrisnin rrugët në drejtim të luginës. U çuditën kur na shikuan afér duke kaptëcyer xhadënë.

— Erdhën? — i thanë të gëzuar dy korrierët.

Kompania kaloi në anën tjetër të lumit. Burrat e Bjeshkëzës në luftimet e natës bashkë me partizanët ia bënë fora. Na ndihmuani në tërheqje, mbushëni rrathët me fishekë dhe vajtën në drejtim të malit. Edhe Ukë Rustemi, pasi takoi duart me shokët e skuadrës sonë, u largua për në fshat. Atje kishte detyra të tjera. Me Dardanin u qafua. E ndoqëm me sy tek ecet ashtu lehtë siç ecin njerëzit e malit. Uka, burri me xhamadan të zbërthyer, s'më largohej nga sytë.

## VI

Sopot Golemi dhe Argjir Progri urdhëruan forcat të kalonin në anën tjetër të Drinit pér ta mashtruar armikun. Këtë ai e quajti si zmbrapsjen e një njeriu që do të marrë hov pér të kapërxyer hendekun e thellë.

Malet Koritnik dhe Pashtrik te vau nën shkëmb ulin supet, afrohen gjithnjë e më shumë; gjersa syri i bashkon ato me njëri-tjetrin në një pikë. Gënjehet syri, sepse malet i kanë çarë si me shpatë dallgët e furishme të Drinit dhe përmes shkëmbinjsh kalon me gjëmim të pandërrerë lumi. Aty sipër grykës së ngushtë, te shkëmbi, kaluan partizanët në anën tjetër të Drinit. Gjithë natën komandant Sopoti qëndroi në breg duke vështruar nga afër kalimin e lumbit.

Brigada goditi si rrufe, e çoroditi kundërshtarin dhe u zhduk si era, kaloi në veri të Drinit, aty ku kishte marrë detyrën.

\*

\* \* \*

Komandanti i divizionit «Brandenburg», kolonel Vilnbergu, i ra në gjurmë pikës së kalimit të brigadës në Drin, po atëherë ishte tepër vonë. Nga të dy krahët vërsuan autoblindat nëpër xhadën që gjarpëronte buzës së Drinit. Nga partizanët e praparojës skuadra jonë mbeti e fundit në buzë të lumbit. Goxho Bërdëllima zuri vend dhe bëri zjarr.

— Térhiqu, xha Goxho, térhiqu! — i thirrën nga bregu tjetër i Drinit. — E njojin Goxho Bërdëllimën, kur zë vend, nuk shkulet.

— Vraponi, djem, vraponi! — na foli xha Goxhoja me zë të lartë. Partizanët e skuadrës sonë hynë në valët e Drinit. Nuk e lëshonte zemra Goxhon, por ia kishin mera-kun, ndaj, sa po dolën shokët në bregun tjetër të Drinit, zunë vend dhe bënë zjarr. Ai i dëgjoi afër krismat dhe zërat e shokëve.

— Térhiqu, xha Goxho, térhiqu! — i thirrëm. U bë xhind Goxho Bërdëllima. Ne shtimë me automatik. Ese-sët shtinë në drejtimin tonë. Një fishkëllimë afër... Një ushtar mori në shenjë xha Goxhon.

— I shkoi bosh plumbi, huq i shkoi, — thirrëm të gëzuar me vështrimin të mbërthyer te Goxho Bërdëllima. Ai na vështroi vëngër dhe nuk foli.

Veprimet e Goxho Bërdëllimës, në mjaft raste, ngjallin më tepër ankth se admirim. Ai ngulej në pozicion dhe duhej ta nduknin nga palltoja se nuk shkulej, ose i dilte ballë për ballë kundërshtarit, thua kishte vendosur të vritej. Për këto këshillohej nga shokët e skuadrës, po ai zemërohej. Xha Goxhon e donin dhe e respektonin të gjithë, po Dardani s'ia prishte kurrë. Edhe xha Goxhoja me Dardanin s'vinte asnje tjetër. «Në vend të Halimit që m'u vra të ka Goxhoja, por...» — i thoshte ai dhe nuk

e çonte mendimin deri në fund. Nuk donte ta zemëron-te, kurse njëfarë dufi që kishte ndaj Bukuries e zbrazte. Ajo s'ia merrte për keq, i buzëqeshte.

— Duhet t'i ruhesh plumbit, o xha Goxho, — e këshilllonim ne për ta shkulur nga pozicioni.

— Goxhon ta rrëzojë plumbi? Mos u bëni merak, e ka vënë në shënjestër të pushkës Goxhon dreqi dhe i biri, ua kam pirë lëngun të gjithëve.

Mbi xhade një patikë shtinte rrallë. Një esesi iu rrokullis helmeta, tjetri u përplas përdhë para syve tanë. Ish-te Ukë Rustemi që kishte vënë në shënjestër ushtarët e kolonel Vilenbergut. Uka fishekët i shpenzonte me kimet. Plumb e shenjë.

Uka, burri babaxhan me xhamadanin e bardhë të zbërthyer, në sytë e mi lartësohej si një lis i lartë në kreshtë.

— Hë de, ç'pret, Agim? — më qortoi xha Goxhoja.

— Hidhu në bregun tjetër të Drinit, e shikon që po vijnë?

Fjala e tij ishte e sertë dhe e prerë. Lashë pozicionin dhe vravopa.

Vala e Drinit më rrëmbeu, por herë mbas hëre ktheja vështrimin nga ai. Për ne ai ishte në vend të babait, ne ishim bijtë e tij. Sa herë gjendej mes shokëve të skuadrës bënte shaka, tregonte ngjarje. I pëlqente të na kallëzonte trimëri të lashta, por ndonjë çikë edhe lavdërohej, ndaj e çonte nga e çonte fjalën dhe dilte te lufta që kishte bërë brigada buzë Drinit të Bardhë. Në atë lutfim xha Goxhoja kishte shpëtuar për qime nga plumbi i esesëve. Ishte ca fanatic xha Goxhoja. I ruante ca mendime të babaqemos. «E di që ju djelmëria nuk i doni këto gjëra, po, nëse vdes, dëgjoni, amanet ju lë të më hidhi ni në trup nja dy sapllakë ujë, të varrosem i larë de!» — na thoshte ngahera.

Ai fliste; ne gajaseshim me të madhe. Atëherë edhe xha Goxhoja ia plaste gazit tok me të tjerët. Nuk e dinim nëse i thoshte ato fjalë me gjithë mend apo bënte shaka. Nuk ishte lehtë të zbërtheje tërësisht Goxho Bërdëllimën. Ai u mbështet mbas një guri në anën e Drinit dhe vështronë kolonën që largohej malit e murmuriste: «Ashtu, djem, lart të ma mbani ballin, ashtu duhet! Erë

të bëheni kur tërhiqemi, vetëtimë kur godasim!» Fliste, qëllonte e pak nga pak tërhiqeji. Plumbat i shkonin pranë e më pranë. Pyeste Goxho Bërdëllima se çfarë nxirrin prej gryke armët e armikut? Shtinte. Maliherin edhe në gjumë nuk e lëshonte nga dora. Me atë armë kishte luftuar i biri, tanë luftonte ai vetë. Pas çdo luftimi ai fshinte, pastronte e vajiste maliherin. E përkëdhelte si nëna të birin. Shkrim nuk dinte, po mësoi të lexojë emrin e të birit që Halimi vetë e kishte shkruar me kapsolla fishekësh të ngulura në drurin e qytës së pushkës. Sa herë e shikonte, murmuriste me vete, sikur fliste me të birin.

«Do ta ndjek këmba-këmbës hasmin, bir!» — thoshte xha Goxhoja dhe shtrëngonte me pëllëmbën e madhe qytën e maliherit.


Drini ishte i rrëmbyeshëm dhe i ftohët. Nuk mund të largoheshim nga bregu i Drinit, në anën tjetër të lumit kishte mbetur xha Goxhoja. Me vështrimin tek ai, Dardani thërriste:

— Zjarr! Zjarr!

Luloja dhe Agoja në bregun tjetër të Drinit i zbrazën gjer në fund shiritat me fishekë. Kjo i dha mundësi xha Goxhos të ndalej një çast, vetëm një çast, aq sa mundi të nxirrte nga gjerdani ballin e fundit të fishekëve për të mbushur pushkën. Qëndroi më këmbë, maliherin e vuri mbi dorën e majtë dhe nuk mundi ta shkrepte. Atë kohë disa plumba vërvhellyen në drejtim të tij. Atë e rrëmbeu vala.

— Xha Goxho! Xha Goxho! — i thirrëm me të madhe. Gryka e thellë e Drinit e përçolli gjer në shkëmbin përballë thirrjen tonë të dhimbshme që jehoi disa herë:

— Xha Goxho!... Xha Goxhoooo!



Goxho Bërdëllima humbi pa asnjë gjurmë. Ngjarja na pikëlloi shumë. Secili tregonte diçka për xha Goxhon. Skifter Velça, komisari i batalionit foli për sakrificat e

mëdha që po bënte populli ynë për fitoren, për hakmarrjen që na mbetej për të bërë ndaj shkelësve të huaj dhe Cen Gozhitëve...

— U bëra shkak të vritet xha Goxhoja, — më tha Vaso Lundra i pikëlluar thellë. — Po ta kishim kaluar Drinin natën, xha Goxhoja s'do të ishte vrarë. S'më dalin nga mendja shakat e tij, përbetimi që bënte: «Më humbtë varri.»

Bukurie Çabiri, apo i përmendim emrin e Goxho Bërdëllimës, shkrehej në vaj. Nga këto vegime më largoi zëri i korrierit të kompanisë që thirri:

— Agim Nokén e kërkojnë. — Dëgjova dhe zëra të tjërë:

— Agim, Agim!

Shkova dhe u paraqita te komandanti i kompanisë. Aty ishte dhe Dino Çinoja.

— E mban mend vendin ku e pe së fundi herë xha Goxhon? — më tha Dardani.

— Si jo,— i thashë. — Unë isha i fundit që u ndava prej tij.

— Nuk mund të largohemi pa bërë edhe një kontroll anës së Drinit, — tha Dardani. — Duhet të fillojmë aty ku u ndatë prej tij dhe gjer ku mund të shkojmë. Kjo punë është me rrezik. Brenda dy orësh duhet të ktheheni, se do të largohemi! Shoku Skifter më porositi që të kthehem patjetër me ditë. — Dardani na i dinte huqet, prandaj i trembej së papriturës.

Dino Çinoja dhe unë u nisëm bregut të Drinit.

«E, Agim,» — më dukej sikur më pyeste vështrimi i syve zhivë të Dinos. Ai priste nga unë. Qëndrova disa minuta me vështrim të mbërthyer tek ai guri në breg të limit ku xha Goxhoja në pozicione shtinte me malipherin e tij.

Sytë e mendjes më sollën afér Goxho Bërdëllimën, burrin babaxhan me flokë e zemër të bardhë. Dinoja shprehu mendimin se Goxho Bërdëllima s'kishte mundur t'i bënte ballë furisë së valëve të Drinit. Drini në atë vend rridhëte rrëmbyeshëm, por, që ta rrëmbente Goxhon si të ishte kleçkë, këtë s'mund ta besoja.

— Goxhoja ishte ai që në vitin njëzet u iku nga ishu-

lli i Sazanit italianëve dhe e kaloi ngushticën e Karabu-runit me not. Ai që i bëri ballë dallgës së detit që fundoste vaporët mund t'i qëndronte edhe rrymës së Drinit, — thashë unë.

— Mos harro vitet që i rëndoijnë në supe, jetën me halle, kot nuk është bërë i bardhë nga flokët. — tha Dinoja.

M'u kujtua çasti kur xha Goxhoja ra në ujë. Ata nga bregu ia bënë dumani me plumbat. Të gjithë e qëlluan me pushkë e mitraloza, edhe autoblinda që doli te kthesa e vuri në shënjestër të mitralozave.

Kërkua dhe asnjë gjurmë nuk ndeshëm anës së Drinit. Aty ku Drini i Bardhë bënte një va të gjerë, gjetëm një kapele ushtari eses të mbuluar nga rëra. Nga ylli e njohëm që ishte e Goxho Bërdëllimës. Kapelja ishte shpuar në shumë vende nga plumbat. U bindëm se Goxho Bërdëllima ishte vrarë dhe trupin e tij e kishte rrëmbyer Drini.

— Mbeti Goxho Bërdëllima pa vend varri. Sa keq, — mërmëriti Dino Çinoja.

U kthyem në kompani. I gjetëm të ndezura këngët. Hija e dëshpërimit ishte larguar. E njohëm nga zëri, ia kishte marrë këngës Bukuria. «Ndoshta ajo ka ngritur ndonjë këngë për Goxho Bërdëllimën. I duhet nxjerrë patjetër një këngë xha Goxhos», — mendova kur m'u shfaq papritmas burri që s'më largohej dot nga përfytyrimi. Në fillim s'po u besoja syve. Xha Goxhoja ishte ulur në një gur, maliharin e kishte mbështetur në gjoks dhe thithje cibukun. Vrapova drejt tij dhe e përqafova.

— Mjaft, Agim, plak njéri jam, mjaft de, dëgjon? — Më buzëqeshi. Unë s'ngopesha, nuk më bëhej ta lëshoja.

— Mos më gudulis de.

- Thashë se të vranë, — murmurita.  
— Kush, more?  
— Esesët!  
— Aq lehtë vritet Goxho Bërdëllima, or t'u mbylltë, si mendon ti? Jo, Agim Noka, jo! — U mendua ca dhe vazhdoi: — Më gjuajtën esesët me ç'u erdhi për dore dhe ja ku jam, gjallë sot e mot. Nuk vdes Goxho Bërdëllima pa i parë dhe potkonjtë e Hitlerit nga dielli, dëgjon?  
— Menduan se..., — tha Dino Çinoja që iu hodh në qafë.

— E di si keni menduar, e di. Më pisk se kësaj here nuk e kam pasur tjetër herë, jo nga Drini, jo, po ata nga bregu më mbuluan me plumbë. E pashë pisk, s'dilja dot në anën tjetër të Drinit i gjallë, ndaj i rashë me not. Kur u ndezën mirë pushkët e esesëve, thashë m'i hëng-rën dreket, por m'u dha e fët u zhyta thellë e më thellë në ujë dhe mbajta frymën. Sipër mbeti vetëm kapelja ime. Ishte e mirë dreqi, më ruante kokën nga të ftohtët. E lashë të shkretën të notonte. I ranë e i ranë esesët me plumbë kapeles gjersa u lodhën. U mbërtheva pas një guri gjersa kapelja u largua. Ajo më hapi rrugën për të ecur qetë. Eh, ç'kapelë që ishte, mbeta kokëjashtë për të më marrë në shenjë esesët që larg, ishte e mirë dreqi, më fshihë bardhësinë e flokëve.

— Ja ku e ke, e gjetëm, — i thashë. Ai e mori kape-lën. I numëroi plumbat që kishte marrë...

— Vjen i vërtet që kishte marrë, — i thashë. Ai e mori kape-lën. I numëroi plumbat që kishte marrë...

— Vjen i vërtet që kishte marrë, — i thashë. Ai e mori kape-lën. I numëroi plumbat që kishte marrë...

## VII

Ishët natë. Komandanti i divizionit «Brandenburg», kolonel Vilenbergu, kishte vajtur me ngut në kështjellën e qytetit dhe bënte analizën e asaj që ndodhi. Garnizoni i esesëve në kështjellë ende ishte në alarm. Esesët e plagosur rëndë i larguan nga kështjella. Partizanët ishin tërhequr, depoja digjej, shpërthimet ndiheshin me një gjëmim të rëndë që jepte përshtypjen se luftimet vazhdonin. Në qytet mercenarët e Cen Gozhites zbraznin armë. Ata s'mund të bënin ndryshe. U kishte hyrë lepuri në bark.

— Të ndalohet në çast shtënia me armë, — urdhëroi koloneli i egersuar. Shtënia me armë u ndërpri, por shpërthimet gjëmonin njëra pas tjetrës.

— Qyteti ka ndezur drita, — tha koloneli.  
— Këtu ka diçka, — tha oficeri i esesëve të kështjellës.

— Të hidhet në erë centrali elektrik, — urdhëroi koloneli pa ditur që qytetarët kishin ndezur llambat me vajguri.

Gjëmimi i shpërthimeve dhe ndezja e dritave nga prizrenianët kolonel Vilenbergun e bënë bishë.

— Këta që ndezin dritat me ata që zbresin nga malet janë njëloj, — tha koloneli duke goditur me kamxhikun që mbante në dorë qafën lustrafine të çizmes. Dërgoi autoblinda që të mitralonin pullazet e shtëpive. Çuditëj kur shihte që dritat e qytetit ndizeshin përherë e më shumë.

— Të gdihen edhe të tjerë të varur në trekëmbësh, — urdhëroi kolonel Vilenbergu. Ai në mëngjes, kur zbriti në qytet, u end në sheshin te çezmat e qytetit dhe në pazarin mbas qafës së vogël.

Urdhri ishte zbatuar...

Në mëngjes, posa doli dielli mbi kreshtën e malit të Sharit, në kryqëzimin e rrugëve, tek Ura mbi Drin, në rrugën Prizren-Gjakovë, zbriti nga vetura një oficer madhor.

Kolonel Vilenbergu dhe divizioni «Brandenburg» quhen në hekurt. Komandanti i gruparmatës hitleriane «E» e kishte nxjerrë njeriun e hekurt në këto pozicione kyçë për t'i prerë hovin vërshimit të forcave partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë e brigadave të Kosovës. Kolonel Vilenbergu e nuhati rrezikun që i kërcënohej divisionit të tij, prandaj ai vuri në veprim tërë aftësitë e tij. Aty, buzë Drinit, kolonelin e prisnin officerë të tjerë që i përkisnin repartit që ishte vendosur në lartësitë tek Ura mbi Drin. Veshja e tyre e rregullt, gatishmëria që treguan sa po eprori doli nga vetura tregonte se ata kishin dijeni dhe ishin përgatitur për ta pritur.

Koloneli, pasi vështroi me dylbi vargmalet që ngrihen në të majtë, hipi përsëri në veturë. Ata e ndoqën

prapa. Ndaluani buzë lumi. Drini buciste nëpër shtratin e ngushtë të hapur në shkëmb gjatë shekuje. Ishte i vetmi vend nga burimi mëmë në malet e Pejës e gjer në mbarim të fushës së Prizrenit, që Drini kishte një shtrat aq të ngushtë me buzë të thepisura anash. Koloneli sotiste. Dita ishte e bukur dhe era e freskët që vinte nga larg lozta me bimët e fushës së gjerë e pa mbarim, fërgëllinte gjethet e dégët e pemëve. Koloneli ndjeu freski-në e erës në fytyrën e tij të gjatë e thatime.

— Ditë e bukur, — tha koloneli duke sositur. Vësh-troi lartësitë në dy anët, pastaj thellësinë, vërshimin e lumi. Vërshimi i ujërave të Drinit me vërshimin e pa-ndalshëm të brigadave partizane iu bë një. Iu cingërisën nervat, fytyra iu shtrembërua. Oficerët u munduan që në sytë e kolonelit të hetonin diçka. Ai, me sytë e tij si të gjarprit, përqendroi vëmendjen e tij te një ushtar xhenier që hapte në këmbët e urës vendin ku do të vendosej eksplozivi për të hedhur, në erë urën e madhe. Ushtari i ngjante me varrmihësin që çel varrin para se të vihet në plumb i dënuari. Filloi t'i ndreqeje fytyra e shtrembëruar. Pyeti oficerin e xhenios:

— Vazhdon minimi i urave të tjera?

— Nuk ka mbetur asnjë urë pa u minuar, — tha oficeri i xhenios me qëndrim gatitù.

U ngjitëm te bunkeri mbi xhade. Bunkeri ishte aq i maskuár, saqë të dukej si një copë shkëmb kompakt. Kolonel Vilenbergu, i ndjekur nga të tjetrët, hyri i pari në bunkerin e madh. Dera u mbylli lehta me një tingëllimë si të vinte nga një pus i thellë që shënoi fillimin e një bisëde që do të mbaronte me gjëmimë artilerie.

Kolonel Vilenbergu mori në dorë një laps me ngjyrë blu të errët dhe prerazi shpjëgoi. Ndryshe i mendonte ngjarjet e pritshme dhe ndryshe ua shpjegonte vartësve. Në divisionin e tij ai ishte njeriu më i fortë, me fjalë të pakta, por të hekurta. Vartësit e kishin mësuar se nga mosbatimi në kohë e me përpikmëri i urdhavrave që jep-te koloneli, secilit mund t'i ikte koka. Sytë e ftohtë të kolonelit egërsoheshin, bëheshin sy ujku dhe nxirrte

«Parabelin» nga brezi dhe ia vinte vartësit tytën midis vetullave.

Planin «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe» ua shpjegoi vartësve sipas drejtimeve të mundshme ku mund të sulmonin brigadat e Shqipërisë dhe të Kosovës. Lapsi i tij u end sipër hartës.

Kolonel Vilenbergu dha udhëzime të hollësishme e pruri vështrimin e të gjithëve mbi hartën dhe mbi shigjetat blu. Në skemat e hartuara me kujdes ishin shënuar me shigjeta blu pikat e kundërgoditjeve ballas, anash dhe daljet në shpinëmarrje. Hartat dukeshin të ndezura, kokat e nepërkave dallohen në larg, lapsi dhe vështrimi i syve të bardhë të kolonelit dukeshin sikur përkëdhelnin nepërkat dhe ato nxirrin në përgjim në errësirën e natës kokén e zezë e të frikshme. Sytë e nepërkave hidhnin përgjimin nga rrugët e shtigjet që zbrisnin nga malet në drejtim të fushës e qyteteve. Në fshikëzat e tyre me nga një qeskë të madhe helmi kolonel Vilenbergu shikonte armët e njerëzit që kishte vënë në fortifikata pritjeje, ndaj duart e tij kalonin mbi shigjetat, i përkëdhelnin kokat blu të nepërkave dhe ato lëvrinin e shtriheshin përpara, pickonin e mbyllnin çarqet.

Furinë e sulmëve të të kuqve doemos duhet ta thyej më me qëndrësë këmbëngulëse, me zjarr të fortë të armëve, me goditje të paprrera artillerie, me lëvizje të papritura të autoblindave e tankeve; më goditje nga krahët dhë me shpinëmarrje duke e mbyllur rrethin tonë të hekkurt, kështu sulmi i të kuqve duhet të përfundojë me dështim të plotë. — urdhëroi koloneli dhe mbuloi me vështrimin e tij të egër e të ftohtë vartësit e tij, për t'u blerë mendimin. Ata morën qëndrim gatitu dhe miratuan më kokë.

## VIII

Ritmi i një daulleje që nisi të binte në lëndinë, afër ndërtuesës së madhe, në anë të fshatit ku ishte grumbulluar brigada, zgjoi kureshtjen e luftëtarëve dhe të fshatarëve. Binte një daulle, binte fort: Bam — barabam! Në lagjen tjetër dëgjohet tupani. Shpërthyen këngë në dialekte nga më të ndryshmet. Këngë të Labërisë... Këngë të shtruara nga Dangëllia, këngë nga Mallakastra, këngë nga Përmeti, këngë nga Tirana, Kruja, Mati Luma, këngë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Valle të forta e të shkathëta vlonjate, ja dhe vallja jonë burrërishte, vallja e gurshpatarëve, valle e rëndë që rreh me këmbë tokën e rrit qëndresën e forcën.

Në lëndinë me ritme të shpejta binin daullet. Këndohej dhe vallet s'kishin të sosur. Në formë rrethi një grup tropojasish ishin lidhur sup më sup, krahët e tyre hapeshin e mbylleshin si krahët e shqiponjës në kreshtat e bjeshkëve të larta. Kënga më rrëmbeu dhe afrohem aty. Këndojnë partizanët e një brigade të Kosovës:

*Oj Kosovë, oj nana jonë,  
T'mirat fusha i kanë zaptue ushtritë fashiste.*

Kosova, si të jetë diçka e gjallë, dëgjon dhe u përgjigjet luftëtarëve:

*Partizanë, o heronjt' e mi!  
Vraponi në luftë, jepni jetën për liri,  
Përsëri, përsëri kënga ka me u këndue!*

Në lëndinë binte daullja me ritme më të shpejta, me goditje më të forta. I ka rrëmbyer vendasit gëzimi i ardhjes së brigadave partizane. Fjalët e këngës në një kohë japin edhe dhimbje, edhe krenari. E njëjtë këngë:

*Oj Kosovë, oj nana jonë...*

Pastaj të gjithë së bashku, partizanë e popull këndonin:

*Malet me blerim mbuluar  
Plot me bukuri, bum!  
Dhe shqiptarët të bashkuar*

Na rrëmbeu afshi i këngës, të gjithë këndojojnë. Edhe xha Goxhoja me shenjat e plumbit në kapele, edhe ai, i rrëmbyer nga atmosfera e gëzimit, hyri midis të tjerëve, ngriti malipherin lart, sipër kokës, e kënga u ndez edhe më shumë.

*Luftha jonë drejt po shkon,  
Para, partizan!*

\* \* \*

Krismat e armëve tona shkonin më larg nga sa dëgjohej oshëtima e luftës. Rrënjet tona shtriheshin pa fund, thellë në drejtim të maleve e fushave, kudo ku ki-

shte fshatra e qytete... kudo ku kishte njerëz liridashës. Kjo i tmerronte kolonelët dhe gjeneralët hitlerianë, ndaj përpinqeshin që të këpusnin rrënjet tonë, të na prisnin rrugën me topat e autoblindat e tyre. Ata gjithë shpresat e tyre i mbështesnin tek armët e tyre vdekjeprurëse, prandaj përpinqeshin që të gjithë popullin ta fusnin në zjarr, po s'e fusnin dot.

Ecnim nëpër shpatin e malit. Ai mal dukej si një piramidë armësh. Vendësit e quajnë «Kulmi i armëve».

Brigada kaloi në të djathë të rrjedhjes së Drinit të Bardhë. Komandanti i brigadës, Sopot Golemi, u ngjit në majë të «Kulmit të armëve». Hodhi vështrimin përpara në drejtim të Gjakovës dhe fushës pa fund. Komandantët e komisarët e batalioneve formuan një rreth të ngushtë afér tij. Nga çanta prej lëkure dreri, e zënë edhe kjo në fushën e luftës, Sopot Golemi nxori një skemë në gjuhë të huaj me shigjeta me koka nepërkash.

— Kjo që shikoni është tepër sekrete. Duhet ta dini vetëm ju, — tha Sopoti. Planin e komandës gjermane të koduar «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe» që kishte hartuar kolonel Vilenbergu ia dërgoi shtabit të brigadës sonë një zbulues yni. Këmisari i batalionit tonë, Skifter Velça, kishte milituar në një celulë partie me të. Ishin ndarë në vitet e para të luftës. Skifteri kishte dalë ilegal në mal, kurse ai ishte dërguar nga Partia bashkë me komunistë të tjerë në Kosovë.

Skema u hap mbi një pllakë guri. Në ato vende që shënoheshin në skemë Sopoti me sytë e mendjes shikon-te telat me gjemba, fortifikatat e minuara, postblloqet e rojave, armët me tytat në përgjim... Atë çka mendonte, e shihte të hedhur me hollësi në skemën që mbante në duar. E kishte lexuar e rilexuar atë skemë natën. Kishte biseduar dhe me Skifter Velçën për njeriun që e dërgonte skemën. Ai në letër i bënte të fala me emër Skifter Velçës.

— Ju njiheni me atë? — e pyeti Sopoti.

— Kemi qenë shokë të ngushtë. Detyrat luftarake na larguan nga njëri-tjetri, — tha Skifteri i përmalluar. S'i pritej gjersa ta takonte.

Duke i shikuar shigjetat me kokë nepërke të drejturna nga brigadat tonë partizane, Sopot Golemi deshifronte mendimet e kolonel Vilenbergut.

— Kolonel Vilenbergu nuk ka vetëm uniformën të murme, në ngjyrën e lëkurës së ujkut, — tha Sopoti. — Ai është në çdo veprim ujk i tèrbuar.

Në fytyrën e komandantit të brigadës të tjerët shihnin përleshjet e ashpra që na prisnin, guximin dhe mprehtësinë e tij, besimin në fitore. Ata hodhën vështrimin e tyre në fushat pa fund. Andej fshihej e panjohura... Ajo duhej të njihet. Sopot Golemi tha:

— Duhen katër palë sy në vëzhgimin e terrenit dhe të pozitave ku është vendosur armiku.

U këmbyen fjalë dhe vështrime...

— Ky është plani i tyre, — tha Sopoti dhe e uli skemën nga guri në tokë. Të gjithë mbërthyen vështrimin tek ajo letër e shkruar në gjuhë të huaj. Komandanti i brigadës iu drejtua shtabit të batalionit që do të sulmonte në qendër, në drejtim të Gjakovës. — Vështroni me kujdes, ja kurthi i armikut, e shikoni atë vargëzim kodrash me dushk, aty është struktur bisha... Shikoni, gjykon dhe mendoni si do ta asgjësoni...

— Doemos do ta shkulim dhe do ta asgjësojmë, shoku komendant, — tha komisari i batalionit tonë, Skifter Velça.

— Skifter, mos harro që batalioni juaj është në një drejtim të rëndësishëm, veprimet tuaja duhet të janë të matura. Do të ecni gjer përtje lumit në vargëzimin e kodrave, më në thellësi nuk lejohet. Mos harro që kolonel Vilenbergu fshatin Batin kërkon ta mbajë me çdo kusht. Ky pozicion përparrë qytetit të Gjakovës i duhet. Ai ka vendosur në dy lartësitë e fshatit ushtarë, aty, në Batin, ka prurë edhe bandën e Cen Gozhitës dhe ka drejtuar nga aty disa shigjeta. E shikon?

Skifter Velça vështroi në skemë shigjetat e tundi kokën.

Komandanti i brigadës, mbasi u la kohë të njiheshin me planin e kolonel Vilenbergut «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe», tha:

— Marrja e kodrave përballë Gjakovës dhe asgjësimi i garnizonit të armikut në Batin e gremis buzë fushës gjermanin; përkundrazi mbajtja e këtyre kodrave prej tyre na detyron të tërhiqemi nga ky vend. Peshojeni mire dhe secili le të na thotë mendimin e vet.

\* \* \*

Cen Gozhita po ecte në vitin e pesëdhjetë. Ai shpeshherë kishte marrë pjesë në luftime, po si këtë radhë kurrë nuk e kishte ndier peshën e luftës.

Frika e luftës partizane prej kohësh po e brente përbrenda, po vëershimi i brigadave në Kosovë i kishte kallur datën. Truri i tij shtypej nga një peshë gjëmimesh të rënda që po merrnin përmasa të pallogaritshme. Megjithatë, përpara gjermanëve dhe të vetëve Cen Gozhita përpigjet të tregohej si një burrë që s'ia lëvizte qerpikun as flaka e pushkës, as fishkëllima e plumbit.

Sulmet e furishme, krismat e armëve partizane i kishin shkaktuar një tronditje dhe një dhimbje koke, që nuk e kishte provuar në jetë. Gjëmimet e armëve ia shto nën dhimbjen, ajo i bëhej si një shtrëngim në gjoks dhe e ndukte me një pickim vdekjeprurës. Nuk guxoi të bisedonte me njeri, aq më pak të hapej në bisedë me kolonel Vilenbergun. Jeta e tij e kishte mësuar Cen Gozhitën ta njihët mirë proverbin e vendit : «Rrushin, kur e shtrydh dhe i merr lëngun, hidhe, ai s'vlen as për pleh». Cen Gozhita nuk kishte bërë ndonjë shkollë të lartë, por në vitet e kralëve serbë dhe pastaj kishte jetuar e mësuar aq shumë gjëra, saqë vetëm gjysma e lekut mund ta shmangete nga kahja nëpër të cilën kishte ecur gjithnjë. Dikur kishte thënë se forca e kral Aleksandrit ishte e pa-thyeshme, por erdhi një ditë kur dinastia e kralëve të

Serbisë u shemb si një karakatinë e ndërtuar mbi rërën e shkretëtirës. Cen Gozhita ishte i shkathët e dhëparak. Ai menjëherë kaloi në varkën e Duçes. Kishte besim se tetë milionë bajonetat e Duçes do ta ruanin përjetë ngjyrrën e këmishës së tij të zezë në ato troje. Po erdhi një ditë që Duçja u rrrokullis. Ceni ndjeu tronditjen e dytë, po eci pa u ndalur. Ndërrroi vetëm uniformën. Ngjyra e uniformës së ushtrisë së Hitlerit i dukej më e përshtatshme, sepse ajo ishte ngjyra që kishin plumbat, predhat, topat, tanket në tokë, aeroplani në qzell dhe kufomat. «Qe, ky është kral me b... ky është kral për shtatë kralica», — kishte thënë Cen Gozhita ditën që divizioni i kolonel Vilenbergut u vendos në qytetet e Rrafshit të Dukagjinit dhe menjëherë në vend të xhaketës me shenja të zeza veshi uniformën e esesëve.

Cenin me bandën e tij prej dyqind vetash e sollën në fshatin Batin. Ai u ngul në kullat e fshatit; fjeti një natë dhe ditën e nesërme u ngrit herët nga gjumi. Sapo çeli dita, doli në dritaren e kullës dhe hodhi sytë në vargmalet mbi fshatin ku ishte grumbulluar njegulla. Si edhe mëngjeset e tjera dhe atë ditë u ngrit me ngut nga bubullimat. Tani po e shifte se uniformës së murme po i vinte vdekja, një vdekje e turpshme si ajo e Duçes. Ngjyra e kuqe po vinte si uragan. Kishte ditë që Cen Gozhita dridhej nga mendime të zymta. E kuptonte se kahja e ndjekur prej tij po e çonte drejt greminës. Shpresat e tij të fundit i kishte përtëj detit. «Po ata ende s'po duken...», — tha ai me vete.

Gjëmimet e afërtë ishin vërvshime të papërmabjutura. Cdo gjë po vidhisej dhe Cen Gozhita kërkonte si i mbyturi të hidhte dorën ku të mbahej. Ngado që shikonte, shtigjet i dilnin të zëna. Iu kujtua probatini, kolonel Stepani, njeriu që s'kishte lënë shteg pa hapur e kurth pa shkrehur. Pukovnik Stepani ishte në Mitrovicë, në shtabin e një korparmate çetnike. Endi një ngjarje dhe desh u nis t'i bënte një vizitë probatin Stepanit, por nuk guxoi të kërkonte leje. Iu tremb vëzhgimit të kolonel Vilenbergut. Mbeti aty i mbërrthyer në fshatin Batin.

— Vellezërit i bashkon vatra. Përpara! — tha komandanti i brigadës, Sopot Golemi. Nën flakërimën e armëve tonë drita filloj të hedhë hapin përpara. Ecim mbas flakëve të armëve... Pushka e parë zuri fill në një shteg mali, pastaj kudo krismat u dendësuan në shtigjet e maleve. Në drejtim të fshatit Batin batalioni ynë e vuri në ndjekjel një nënrepart të esesëve. Disa mitraloza gjermanë u mbliduan të na e ndalonin hovin e sulmit.

— Dridhu, armik, dridhu! Përpara! — thirri Dardan Velishta dhe eci në ballë me pushkën dhjetëshe në dorë.

— O ku je, Dardan Velishta! — sokëllinë me zë të lartë partizanët e kompanisë.

Milefin e dhimbjen Dardani i zbras nëpërmjet krisave të dhjetëshes e granatave që hedh në pozicionet e armikut.

— Mirë se të gjetëm konakun, o Dardan Velishta, — i thainë shokët e luftës. Dardanit i ndritën sytë, fytyra, balli i gjérë.

Aty ku mbaron vargëzimi i kodrave, shtrihet fshati Batin, me kullat e bardha dy-trekatëshe. Ato mbushin lugun dhë në fushë, lënë pas dy lartësitë, që hapen anash e bëjhë ballë përpara në drejtim të lumit. Më e largëta kullë arrin gjer buzë lumit. Në anën tjeter të lumit mbaron fusha e fillojnë vargëzimin e tyre kodrat e buta që mbarojnë me lartësinë e Cobratit sipër Gjakovës.

Ende pa hyrë në fshat rrebeshi i plumbave theri tokën. Sulmi ynë në hapin e parë u ndal. Na qëlluan prej kullave. Aty ishin struktur ushtarë të tjerë nazistë.

Kullat nuk ishin larg. Nga kullat villnin plumba

dum-dum mitralozat e armikut. Frëngjité e kullave nga vinin plumbat u bënë objekti i qitjes së armëve tona.

Ishim afér. Shumë afér. Po ec e shkuli nga kullat ku ishin futur. Sulmet tona ishin të vrullshme, po gjarpri nuk nxirrej lehtë nga strofka.

— Përpara! — thirri Dardani.

Njëri nga partizanët e skuadrës sonë, Dinoja, me vrull të papërmabjatur si e kishte zakon, arriti deri në muret e një kulle trekatëshe. Shtyu derën dhe me armët ngritur thirri:

— Dorëzohuni!

Kush të dorëzohej? Esesët ishin mbytur në gjak. U kthyte, doli jashtë dhe hodhi vështrimin në një objekt tjetër.

Armiku ishte i mbyllur midis katër mureve, ne sulmonim e vraponim rrugëve të ngushta. Hapa të papritur. Njëri nga tanët, me mitraloz në dorë, vuri në shënjestër frëngjinë e një kulle. Ai, bashkë me ndihmësin e tij, u hodh përpëra, mori për të hyrë në kullën ku ushtarët armiq kishin pushuar së jetuari nga mitralozi i tij, por s'mundi, s'arriti dot, sepse u godit nga një kullë tjetër. Ra me s'ytë drejtuar nga kulla në krah, andej nga e qëlluan esesët gjermanë. Lulo Driza kaloi përmës plumbave, kërkoi të shkonte pranë shokut të qëlluar. Mori guxmin për ta tërhequr shokun, pa ditur nëse ishte i plagosur apo i vrarë.

Dino Çinotja e mposhti zemërimin, u çuá nga pozicioni dhe rrëshqiti drejt një mitralozi, vërviti dy granatë për t'i mbuluar pamjen mitraljerit nazist. E pamë kur çoi lart dorën, i pamë automatikun, i dëgjuam zérin.

Kompania vâzhdoi sulmin.

Dardani, kûr mësoi se Cen Gozhita ishte afér, harroi se ishte larguar nga kompania, u vërsul përpëra e i thirri me sa zëkishte Cen Gozhitës:

— Dil në log të burravë, o këlysh i kralëvë!

Ndërsa Dardani me dhjetëshen në dorë po i afrohej kulle, Cen Gozhita me trupin e gjatë stërhell çau si derr i egër përmes misërishtes. Dardani e ndoqi pas, po nuk e futi dot në shënjestër.

— C'ishte ajo që bëri? Kù duhej të ndodhej dhe ku kishte shkuar? Cfarë bënte kompania, ku ishte ajo? E kuptoi që ai padashur kishte hedhur përpara këmbëve të shokëve të tij një ferrë ku mund të pengoheshin të gjithë. «Kokëshkretë, ku shkon?» — qortoi vetveten. U kthye te kompania që të ndreqte gabimin, po ishte vonë.

Mbas luftimit Skifter Velça qëndronte në këmbë me vështrim nga batalioni dhe batalioni me vështrim tek ai. Foli me mllif. Kurrë s'kishte folur me aq zemërim.

— Kështu nuk duhet! Kështu nuk duhet! — bubulloi zëri i tij. Mandej belbëzoi diçka tjetër, g'tha, nuk e mora vesh.

Ishte e papritur përmua kur dëgjova emrin e Dardanit. Ai përsëri u kritikua, se rrëmbehej në luftim. Dardani uli kokën i heshtur. Skifter Velça i lidhi dëmet që pësoi batalioni ynë me veprimet e nxituara dhe të pamatura të Dardanit. Përgjithësisht batalioni i kritikoi veprimet e tij. Dardani as që u përpooq përt'u mbrojtur. U zbeh në fytyrë dhe uli kokën. Në fund, kur ne menduam se gjykimi i Dardanit përfundoi, u çua një partizan.

— Dardani nuk ka asnje faj, komisar, fajin e kemi ne! — tha Lulo Driza. — Dardani na foli me sa zë kishte: «Ndaloni, ndalon!», po oshëtima e predhave e mbyti zërin e tij. — Fajin e kemi ne. — Luloja ishte i bindur në ato që thoshte.

— Nuk është ashtu! Nuk është ashtu! — kundërshtoi Dardani. E kishte zakon të fliste me zemër në dorë para shokëve. Tha të vërtetë. — Fajin e kam unë që harrova shokët... Vrapova pas një krimineli. Atë doja ta vrisja me dorën time... Ani pse të vritesha...

— Cen Gozhitën? — pyeti njëri nga tanët.

— Ashtu kujtova, po nuk ishte ai, — tha Dardani me zë të lodhur. — Veprova gabim...

Luloja shtangu. I erdhi shumë keq që foli, iu duk sikur nga fjala e tij mori prapsht diskutimi.

— Nuk mund të ecet përpara si i vembri, — tha komisari i batalionit. — Nuk ishte e papritur, përkundrazi ajo që ndodhi dihej nga shoku Dardan. — Skifterit iu kujtua skema e kolonel Vilenbergut, shigjetat me koka nepërkash. — Një shigjetë e blinduar lëvizi xhadesë. Asaj nuk duhej t'i vihej gjoksi përballë, ishte një sakrificë e panevojshme, mbi këtë duhet të flasim, të gjykojmë veprimin e gabuar, ta dënojmë atë, që pësimi të na bëhet mësim.

Dardani jetonte me një peshë të rëndë në shpirt. Kurre nuk i fshihej kritikës, por...

«S'po përzihem në këtë punë», — tha me vete Goxho Bërdëllima dhe heshti, por, kur pa komandantin e kompanisë me ballin të djersitur, nuk e mbajti vendi. Mendja e tij bluante... U ngrit në këmbë, mbështeti të dy duart mbi grykën e malitherit, përkuli trupin e pesha e gjoksit ra mbi tytën e pushkës. Tha:

— Me ngadalë t'i marrim punët, komisar. Kështu thotë Goxhoja. Kjo që ndodhi s'duhet të kishte ndodhur, po për Dardanin s'më bën zemra të flas. I doli para grykës së armës dreqi. Si të bënte? Ai s'mund të ndahej prej tij, e ndoqi pas, mirë bëri. Nder të veçantë ka pushka që vret ujkun e terbuar. Ndryshe do të flisnim po të kishte vrarë Cen Gozhiten, apo jo? Më humbtë vendi i varrit, kështu është!

— Anarkia është e dëmshme në çdo rast, — tha komisari i batalionit.

— Nga vret kjo fjale? Tirrja më hollë Goxhos fjallen, shoku Skifter?

— Anarkia s'u shkon revolucionarëve, — tha komisari, — anarkisti...

— Unë s'di me q'pupla vishet anarkisti, shoku Skifter, s'di Goxhoja nga këto, ama atë punën e Cenit ma ka treguar fill e për pe Dardani. E di që duhet të qërohet ndyrësira. Këtë di të thotë Goxhoja.

— Nuk luftohet pa mend, mendimi dhe gjykimi i du-

het qđo partizani, kurse për atë që komandon kjo është domosdoshmëri... Është kështu, xha Goxho?

— E de, po, ta kishte qëruar qenin, tjetërsoj do të flisnit edhe ju, o komisar. Fituesi nuk gjykohet. Më humbtë, vendi i varrit, kështu është!

Skifteri u prek nga autokritika e Dardanit, nga fjalë e të tjerëve. «Flasin me zemër në dorë», — tha me vete. Ata vërtet flisnin me zemër në dorë, por ai nuk mund të lejonte veprime të nxituara. Përsëri foli. Kësaj here Goxho Bërdëllima vuri re se fjalët e komisarit ishin pa ato dallgë zemërimi, E kishte languar vështrimin nga balli i Dardanit. Vështrimi i tij ishte përqendruar në majë të malit përballe.

— Dardani eci një sheshin afër gështenjës së madhe. Aty ishte një grup partizanësh, këndonin gjer t'u vinte radha të ndaheshin njëpër baza. Sëcili nga fshatarët kërkonte që të merrte partizanë në vatrën e tij. Dardani si edhe shumë të tjerë priste radhën të ndahej në baza... Bukuria e njobu, atë një ecje, çapitej ngadalë, me hapa të rëndë, me një lëvizje trupi jo si Dardani i vërtetë. Në mbledhjen e battalionit u paralajmërua që, në rast përsëritjeje të gabimit, do të gjykohej më rëndë. Kritikën e quante të drejtë. Ectë njëpër errësirën e natës dhe gjykonë vetveten. E përfytyronte luftimin nga çastet e para gjer në mbarim. Në qđo hap që kishte hedhur kishte vepruar gabim, kishte ecur si plumbi, drejt përpara. Plumbin diçkush e komandon, nuk e quajti të kotë lëvizjen e plumbave. Ai s'kishte ecur si plumbi... Jo, vrapimi i tij ishte një rrëmbim, donte të kafshonte, kërkonte që dhëmbi i tij të ngulej në gurmazin e Cen Gozhitës, donte...

— Dardan, — i foli Bukuria.

Ai as foli dhe aq lëvizë. Qëndroi në vend me vështrim larg, te maja e malit përkarshi. Çudi, ajo majë e

lartë atij i përmigjante me shqiponjën... Murmuriti me vete: «Te kjo gështenjë janë mbledhur burra me zë: Isa Boletini, Bajram Curri, Hasan Prishtina, Azem Galica...» Sa e sa luftëtarë të lirisë ishin mbledhur në kuvend në atë log burrash dhe ishin lidhur me besa-besë për luftë kundër të huajit. «Ja, edhe brigadat tona kanë ardhur për të shkulur të huajin nga vatrat tona kaq të bukura e kaq pjellore...» — mendonte Dardani me vete.

Dëgjoi në krah hapin e Bukuries. Ai e njihte mirë hapin e saj. E thërriste Shotë. Dëgjoi këngë. Pak më përtej një grup partizanësh po këndonte. Dardani priste sa të shpërndahej nëpër baza edhe grupi i fundit. Atëherë do të shkonte edhe ai në një bazë. Partizanët e kompanisë së tij u shpérndanë në disa kulla. Gati në çdo kullë i takoi të shkonin edhe partizane. «Të gjitha janë trime, po çdo mal ka një majë. Kosova ka pasur e ka gra trimëresha, po Shota qe maja më e lartë. Edhe Bukuria është një Shotë e vërtetë. Bukuria ka lindur për pushkë...» Këto mendime ia ndërpren hapi i Bukuries. Ai e donte atë me gjithë shpirt. Kur i tregoi Bukurias për bëmat e Shotës, ajo iu lut të mos i thërriste me emrin Shotë. «Jemi larg», — i thoshte Bukuria. Po Dardani Shotë se Shotë i fliste.

Dardani hodhi vështrimin te Bukuria, ajo i qëndronte pranë. Tak, trokiti diçka në gjoksin e tij.

— Shotë, — murmuriti.

— Çohu të shkojmë në bazë. Shokët të presin në bazën tonë, — i tha Bukuria.

Dardani u ngrit si me pishmanllék. Ecën me hap të ngadalshëm. Kur zbritën në fund të livadhit, dëgjuan llokoçitjet e ujit të lumit që zbret në drejtim të Gjakovës. Ai ecte i heshtur. Heshtja e tij e shqetësoi Bukurien. Ajo jetonte brengën e Dardanit, kurse ai në të vërtetë ndihej i qetë. Nuk fliste. Fantazia e tij derdhej nëpër thellësinë e shekullit. Dëgjoi tingujt e një çiftelie, lodronin gishtat e një partizani mbi telat e çiftelisë. Dëgjoi zërat e dy këngëtarëve. Iu dukën si zëra të njojur. Cilët ishin ata? Mjaft partizanë i binin çiftelisë dhe këndonin. Nuk ishte zëri i tyre. Ishin zëra të tjerë.

— Më duket si zëri i Korabit dhe i Kolës, — tha Bukuria.

— Këngë derti, — murmuriti Dardani me sytë hedhur tutje.

— Kësaj here derteve u vjen fundi, — i tha Bukuria.

— Për ta zhbirë të huajin po derdhim gjak, moj Shotë! — i tha Dardani. Bukuria miratoi me kokë, leshrat e saj të shkrifëta i mbulonin supet e drejta.

“*Shqipëria e lirë*”

## IX

Kur kárvari i krushqve kthehej nga larg, në çastin që ata kalonin xhadënë, dégjuan uturimën e një autoblinde që ecte ngadalë. Kuajt u trembën nga zhurma dhe vargu i krushqve u ndërpri.

— Qoftë larg e keqja! Ç'është kjo hata e zezë? — murmuriti kryekrushku.

Përbindëshi i hekurt ndali midis xhadesë. Krushqit u shtangën. Shikuani nusen. Kali i nuses ende nuk e kishte kapërcyer xhadënë. I pari i krushqve i dha prapsht kalit si të donte të merrte forcë e të godiste përbindëshin e hekurt që i preu rrugën kárvanit. Në çastin kur i pari i krushqve iu turr përbindëshit të hekurt, u hap kapaku i kullës dhe doli një burrë ftyregjatë i veshur me uniformën e esesëve.

— Ah, Cen Gozhita, — murmuriti kryekrushku.

— Si je, mulla Vesel? — iu drejtua Cen Gozhita dhe qëshi me të madhe: — Ha-ha-ha-ha!

Mulla Veseli theri kalin dhe iu afroa njeriut që nxori kokën nga makina e hekurt. Ata biseduan kokë më kokë me njëri-tjetrin. Mullai dëgjonte me vëmendje dhe miratonte mendimet e Cen Gozhitës.

— Komunistat, bre! — lëshoi Ceni një dorë miza në drejtëm të kryekrushkut. — Ata të pafetë i keni përpara! Mjerë batinasit që ranë në duart e tyre...

— Nuk është e para herë që Batini sheh partizanë, o Cen Gozhita, — i tha kryekrushku. Ceni u nxi në fytyrë.

Kapaku i hekurt u mbyll, hekuri e fshehu fytyrën e gjerë me mustaqe vesh më vesh të Cen Gozhitës. Makina e hekurt gumëzhiu dhe u largua në drejtëm të Gjakovës.

Mizat i ngacmonte mulla Veseli.

— Kjo nuk durohet, bre! Erdhën nga ana e anës e u ngulën në Batin... Ec e bjer në pritën e tyre. Prit plumbat e duro maren. A ka bërë vaki në Kosovë t'i ndalë kush në rrugë krushqit me nuse? Ata s'ta lëshojnë shtegun. Mozomakeq pér ne! — klithi mulla Veseli.

— Po dëgjojmë ato që nuk i mban toka, — tha një tjetër që rrinte afër mulla Veselit. — Më mirë të përmbyset bjeshka dhe të na zërë, sesa të shohim ato që nuk i duron zoti.

— I duron robi, — tha kryekrushku i pikëlluar.

— Ato që nuk i duron zoti, nuk i duron as robi, o Halil, — iu përgjigj mulla Veseli. — Mos i shtjer njerëzit si të verbër në shtegun e djallit.

— Krushqve nuk u pritet rruga, — tha Halili - dhe ngacmoi kalin të ekte përpara.

— Të pafetë kanë mbyllur rrugët, bre vëllazën, — tha mulla Veseli, — e do të bahet kiameti...

— Komunistët s'kanë punë me ne, po me gjermanët e me horrat e Cen Gozhitës, — tha një krushk që nuk i kishte kaluar të tridhjetat.

— Ata janë të pafe.. Ata... Mozomakeq, do të bahet kiameti! — hodhi përsëri benzinë mulla Veseli.

— A me ndërrue rrugë a? Me dekë të gjithë po, me ndërrue rrugë, kurrë! — thanë disa zëra njëherësh. Ndodën rrugën e nisur. Ata hynë në pyllin e madh me gësh-

tenja. Ecën një orë rrugë. Asgjë s'panë, asgjë nuk dëgjuan.

— E sheh, është rrenë, — qetësoi mullanë kryekrushku.

— Estakfulla, Cen Gozhita nuk rren. Ai e di mirë që të zezën e kemi përpara. Bani burrni që na kallëzoi. Folu krushqve të shtrëngojnë vetin, ky ishte fati ynë, një fat i zi, i kobshëm, si ai i Lëndinës së Nuseve.

Një hije frike lodronte në fytyrën e secilit. Ecën edhe një orë tjetër e njeri nuk u pa. Sipas zakonit krushqit s'mund të ndryshonin rrugën edhe sikur të shuheshin nga i pari tek i fundit.

Ruga për të arritur në Batin dredhonte nëpër pyllin e madh me gështenja. Të dukej se ai nuk kishte të sosur. Në ballë ecte kryekrushku. Përpara tij një djalë i ri i veshur me tirq e jelek me ar mbante në duar shtizën e gjatë me flamurin kombëtar kuq e zi. Mulla Veseli vazhdonte t'i bënte erë së keqes. U lutej të kthenin rrugë. Ata ecnin përpara. Dolën në një lëndinë. Ajo u kujtoi Lëdinën e Nuseve.



Në anën tjetër të lëndinës, te shkëmbi, qëndronte roja jonë partizane. Nga shkëmbi që del thep përpjetë roja shikonte pyllin e madh me gështenja dhe fushën e rrafshët që shtrihej në drejtim të Pejës. Fusha të dukej pa mbarim. Ajo nuk kishte të sosur. Fshatrat e mëdha me kullat e gurta të bardha, të rrethuara me bâhçe frutore, shtriheshin rrëzë pyllit me gështenja dhe nëpër fushën e gjerë.

Roja jonë lajmëroi komandanten e skuadrës. Bukuria i vështroi krushqit me dylbi. Ata viniin kaluar. Në barillë printe flamuri kombëtar.

Bukuria vështroi me kureshtje. Dylbia iu mbush me krushq.

— Mbrëmë në odën kù fjeta mësova një nina-nina të bukur, — më tha Bukuria dhe nuk e hoqi dylbinë nga sy-

të. Kudo që shkonim, shoqet partizane të batalionit hynin në sobat e grave. Fjala e tyre ndizte shkëndija në qdo vatrë. Goditej pesha e kanunit. Goditej pesha e rëndë e fesë. Goditej errësira. Gratë e vajzat dëgjonin. Në zemrën e tyre ndizeshin shkëndijat e ëndrrave të bucura, shkëndijat e zgjimit të madh.

Bukuria nxjerr bllokun nga çanta. Më flet për një nënë në kullén ku bujtëm.

— E kishte fëmijën e parë, ishte një fëmijë i bukur, vajzë ishte... — Nga biseda kuptova që Bukuria ëndërronte jetën e saj mbas luftës.

— Kur të martoheni ju, do të vijmë krushq të gjithë shokët e shoqet e kompanisë, — i thashë unë. Ajo u bë gjak e kuqe në fytyrë. Mendoi se Dardani më kishte treuar gjithçka. U hutua. E nxori bllokun dhe tha:

— Në djep ishte gdhendur shqiponja. Në atë djep ishte përkundur edhe i ungji, që u vra në çetën e Azem Galicës. — Pastaj hapi fletët, lexoi fjalët e nuses së re që i këndonte fëmijës së parë:

*Nina-nina djepin me dushk,  
u bafsh nuse me njëqind krushq,  
njëqind krushq më duken pak,  
dy tupana e një bajrak.*



Në vendrojën tonë erdhi me furinë e erës Dardani. Ishte i shqetësuar.

- Kaluan disa kalorës? — na pyeti.
- Kaluan, — i thashë. Bukuria nuk foli.
- Mos! — klithi ai me zërin e tij kumbues.
- Ata ishin dasmorë me nuse.
- Ka kohë që kaluan?
- Gjysmë ore.
- Ashtu? Mbas meje! — thirri dhe vrapi me në drejtim të luginës. Diçka e keqë fshihej. Çfarë mund të ishte ajo, s'dinim, atë e dimte vetëm Dardani. Ecën mbas tij. Kur dolëm në rrugë, u vumë në gjurmët e tyre,

— Ku shkojmë? — e pyeta.

Dardani nderi dorën, më dha një letër. E dërgonte komisari i batalionit. Ai shkruante se Cen Gozhita me anë të mulla Veselit ka organizuar të kryejë një vrasje.

— Kjo bëhet me qëllim që të na armiqësojë me pullin, — më tha Dardani. — Sa keq që letra erdhi me vonesë.

— Do t'i arrijmë, — i tha shq. —

— Është larg shtegu i keq, Agim. Ata vetëm aty do të kenë zënë pritën.

Në krye të luginës, sipër fshatit të madh, humbëm në pyllin e dendur. Asgjë nuk dëgjohej. Ecëm mbas gjurmëve.

— Ai është gjarpër, pështyma e gjarprit helmon krejt qumështin e enës. Njerëzit e tij në pritë do të paraqiten si njerëzit tanë dhe sherri do të shpërthejë, — tha Dardani.

— Të huajt këtë kanë bërë në shekuj. Ata me spiunë e tradhtarë na kanë përçarë, por populli ka mësuar ç'është bishti i dhelprës e dhëmbët e ujkut.

Dardani eote në ballë. Na dukej se s'po ecte për tokë.

Pyjet me gështenja shtriheshin nga kullat e bardha prej guri gjer lart te brezi me ahe. Sipër brezit të ahut fillonte brezi me pisha. Ecëm nëpër pyllin e dendur. Atykëtu mëpër pyll, anash nesh, dëgjoheshin ca kërcitje trak-trak. Vështronim anash, para, prana nga na vinin kërcitjet. Ishte vjeshta e begatë që na gjuante me kokrra gështenjash të shëndetshme, që ishin pjekur e binin në tokë si pika shiu.

\*

\* \*

— Mos harro që Pérroin e Keq e kemi përpara, — i tha mulla Veseli kryekrushkut. — Kush zë pritë aty, ta puq në gjoks tytën e pushkës. Komunistat aty i ke?

— Nuk ma ha mendja, — iu përgjigj kryekrushku me një ndjenjë frike.

— Kot së koti po merr më qafë gjithë këta burra!

— Kush të tutet, le të kthehet, — ia priti Halili.

— Kori më të madhe s'kanë njojur malet, — i bëri erë së keqes mulla Veseli.

— Nuk ma ha mendja, — i tha Halili pa kthyer fare kokën. Ai po vështronë përpara, anash.

— E shoh se t'u ka ba exheli ftujak, mozomakeq!

Kali i hoxhës ecte mbas kalit të kryekrushkut. Mulla Veseli e therte kalin që të mos largohej nga kryekrushku, që po përgjonte sa djathtas-majtas.

— Gjallë e me marre s'ka ç'na duhetjeta.

— Duhet t'u grahim kuajve.

Kryekrushku nuk iu përgjigj fjalës, e theri më rëndë në bark kalin. Fjala dhe ata hynë në grykën e thellë.

Kryekrushkut iu duk më e gjatë rruga që bënte. Iu kujtua Lëndina e Nuseve, gurët e bardhë... Eci nëpër shtegun e ngushtë, i bëhej se errësira bëhej përherë e më e dendur.

Kryekrushku tha diçka me zë të vogël, ndjeu një shtrëngim në gjoks. Kali ecte me hap të rëndë. Ekte vërtet kali me hap të rëndë apo i bëhej atij? U mundua të dëgjonte hápat e kalit, nuk i dëgjoi.

Mbës pak ata afritën te Lëndina e Nuseve. Në trupin e secilit vërshoi gjaku. Legjenda e Lëndinës së Nuseve, që vintë nga lashtësia, tanj ishë futur në kokën e secilit batinias. Aty ishin takuar dy palë kruhq. Ata s'ia kishin hapur rrugën njëri-tjetrit, ishin ndeshur si dy vëtëtima dhe ishin vrarë një e nga një, flakë më flakë. Dy të fundit i kishin rënë njëri-tjetrit në një kohë, ishin shuar nga i pari, tek i fundit dhe atëherë të dyja nuset kishin vdekur nga vaji. Aty ishin vendosur gjithë ata gu-rë të bardhë. Kështu thoshte legjenda.

— S'ta lëshon shtegun komunisti, jo! — tha mulla Vseli.

— Ma mirë me dekë se me rrnue me marre, — u përgjigj kryekrushku me vetulla të tkurrura.

Gjithsecilit zemra i rrihte hovshëm. Ata vështronin

anash, përpëlisnin qerpikët. Sherri hidhte dorën te pu-shka.

— Qysh jeni, burra? — i përshëndeti Dardani që ku-llopte djersë nga vrapimi që kishte bërë për të arritur krushqit:

— Të paçim me nder! — iu përgjigj kryekrushku dhe e mbuloi me vështrimin e tij të vëngërt.

— Prisni, prisni e mos u ngusni, sa të sqarojmë një punë, — tha Dardani.

— Krushqit me nuse nuk ndalohen në rrugë. Ku ka ba vaki kjo? — pyeti kryekrushku. — Pse na keni dalë pritë? Nji marre ksisoji shqiptari për të gjallë kurrë nuk e duron!

— Në pritë nuk ju kanë dalë partizanët, — tha Dardani, — ata janë zagarët e Cen Gozhitës, që është shitur tek i huaji. Prandaj erdhëm që t'ua tregojmë qenave, sa u vlen lëkura. — Dardani kishte çuar skuadrën që mërcenarëve të Cenit t'ua merrte krahët dhe ti asgjësonë. — Prisni edhe pak, bre burra!

— Krushqit me nuse nuk mund të presin ma gjatë, o trim! — i tha kryekrushku, që nuk po besonte fjalët e Dardanit. I grahu kalit. Të tjerët ecën pas tij. Me ta eci edhe Dardani. Ai e kuptionte mirë rrezikun, po s'kishte ç'të bënte. Pëllëmba e tij e madhe, ajo pëllëmbë mekaniku që ishte regjur e plasaritur si një lëvore lisi shumëvjeçar në barkën e peshkimit, kishte shtrënguar fort automatikun.

Krushqit ecën drejt shtegut. Posa u afruan, nga shkëmbi u dëgjua një zë si zë korbi.

Krushqit e ndien rrezikun. Krau, u dëgjua krisma e një pushke.

— Heu, na vranë qenat, bre! — tha kryekrushku. Kthëu sytë mbrëpa dhe pa kalin e një tjetri duke u rrokullisur në shkëmb.

— Krauuu! Krau! — Jehuan krismat e pëshkëve.

— Na vranë komunistat, — klithi mulla Vëseli. — Gju-eni mbi ta, bré! Ç'm'i mbani ata mauzerë si hunj gar-dhi? Fryjani barkun me barut!

Lugina shungulloi nga krismat.

Mulla Veseli i dha mbrapsht kalit... Krushqit zunë vende mbas trupave të aheve, nxorën në vërgjim tytat e pushkëve dhe gjuajtën në drejtim të pritës. Mbas therte në vrapin e erës një kalë i zi.

— Na preve në besë, he t'u thafshin krahët! — i tha kryekrushku Dardanit.

— Mos u ngut të flasësh keq, o bacë. Partizanët nuk vrasin popullin. Këtë pabesi e ka bërë këlyshi i gjermanëve, Cen Gozhita. Po s'doli kështu, më vrisni për pabesi, — tha Dardani.

Krismat kishin pushuar. Të gjithë ishin tepër të egërsuar.

— Plumbi është pak, — tha kryekrushku, — po ç'ka me i ba babës tand që vdiq për Batinin. Falju shpirtit të babës.

Krushqit qëndruan të shtangur nga e papritura. Dino Çinoja e Lulo Driza sollën tre nga «trimat» e Cenit të lidhur...

Bukuria u shfaq afër papritur. Ata e panë vajzën me shtatin e gjatë. Doli befas si del zana në bjeshkë. Thirri:

— Për hair dasma, o burra të Batinit! Për hair nusja! — dhe zbrazi automatikun.

Kryekrushku e vërtiti rrëth kalin. Atij iu pështje llua vështrimi. Murmuriti:

— Rrenë! Rrenë!

Shihet që larg dikça e bardhë, në madhësinë e gurit të varrit.

Ishte koka e mulla Veselit...

— Ku asht ka shkon ai? Ku asht ka shkon? — pyeti kryekrushku kur dalloj në largësi të madhe çallmën e bardhë të mulla Veselit.

— Korbi kërkon korbin, — i tha Dardani.

Ujkan Batinit o lidhurit e mbrojtës së përgjithshme. është  
në qytetin e tij që i ka varet këtij qyteti. Në këtij qyteti është  
një qytet i madh i cili ka qenë përmendur e njëqind  
vjetësh. Në këtij qyteti është një qytet i madh i cili ka  
qenë përmendur e njëqind vjetësh. Në këtij qyteti është  
një qytet i madh i cili ka qenë përmendur e njëqind vjetësh.  
Në këtij qyteti është një qytet i madh i cili ka qenë përmendur e njëqind vjetësh.  
Në këtij qyteti është një qytet i madh i cili ka qenë përmendur e njëqind vjetësh.



E vështrojmë nga larg Batinin dhe syri na mbetet te  
vargmali që fillon të lartësohet aty ku mbaron fusha dhe  
shkon përpjetë nga qelli i kaltër me dy maja në formën  
e kokës së shqiponjës, që shikojnë njëra në drejtim të  
Gjakovës dhe tjetra nga Peja.

— Qe, aty është varri i Ujkan Batinit, — na thotë kosovari që na shoqëron.

— Ujkan Batinit? — pyetëm ne.

— Nuk është legjendë. Në majë të malit është një  
varr mbi dy metra i gjatë, — tha shoqëruesi. — Në gojë-  
dhënët e popullit thuhet se treqind vjet më parë Ujkan  
i ka prirë Batinit në luftë kundër osmanlinjve. U plagos  
rëndë, para se të vdiste, tha: «Ma bëni vorrin majë  
shkrepit, ku të mos mujnë me ma shkelë as potkoi i su-  
varisë, as këmba e osmanllisë!»

Gjurmët e qëndresës kundër pushtuesve i ndesh kudo  
nëpër fushat e gjera deri në majat e larta të maleve

që rrrethojnë Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit. Shqiptari s'ka pranuar të bjerë kurrë as i gjallë, as i vdekur në dorë të pushtuesit. Tradita është ruajtur nga një brez te tjetri. Çeta e luftëtarëve të Drenicës kur u vra prijësi i tyre, Azem Galica, e futi trupin e tij në thellësi të dheut, se në zemër të tokës ruhet gjaku, besa e trimëria. Ngjarjet i ruajnë zemrat e brezave pasardhës dhe dheu, ato shndërrohen në legjendë. Varri i Ujkan Batinit i rrrethuar me gurë të mëdhenj të bardhë ruhet sot e asaj dite. Më kot u munduan osmanllintjtë të shkelnin shkrepat e malit me kokë si shqiponjë. Tek koka e varrit të të rënitet është ngulur një gur i bardhë. Ai u kujton brezave gjakun që derdhën të parët tanë për të qenë zot në trojet e veta stërgjyshore.

Pushtuesit e nëmën bjeshkën, por për vendësit ajo mbeti fole, strehë, kështjellë qëndrese... Këtu fushat, gérxhet, shkëmbinjtë, secili ka historinë e vetë që lidhet me topat që i goditën këto vise. Topat mbajnë emërtimet e shteteve grabitqare:

Topi i turkut  
Topi i serbit  
Topi i karadakut  
Topi i austriakut  
Topi i italianit  
Topi i gjermanit  
Topi i ...

Pëllëmbë e ngjarje historike. Vendësit përmendin emra shtetesh agresive, emra sulltanësh, kralësh, gjeneralesh, oficerësh të ushtrive pushtuese, po nuk harrojnë edhe emrat e Cen Gozhitëve që lëpinin çanakun e të huajit, por që vendësit edhe këtyre nuk ua kanë kursyer kurrë gjysmën e lekut...

Këto na i tregonin batinasit në odat e tyre, ku na shtronin «bukë e kripë e zemër». Këngët e trimërisë i shoqeronin me tingujt epikë të lahatës, çiftelisë dhe të sharkisë. Në ato këngë ne partizanët mësonim historinë e shkruar me gjak.

Mbasdite, posa u ndërprenë luftimet, burrat e Batinit u mblohdën te gështenja e moçme. S'mbeti burrë në nulla, të gjithë u ulën në lëndinën barbutë. Aty erdhë edhe më i moçmi burrë i Batinit. Në dorë mbante një mauzer turku. Ishte shtatgjatë, mustaqet i arrinin vesh më vesh. Njerëzit u ngriten, i hapën rrugë.

— Si jeni, burra? — përshëndeti ai dhe eci përmes tyre. — Kaq trima ka ditë nuk kam pa të tubohen nga katundi ynë në këtë log kuvendi.

— Vetë e ke thanë, baca Shpend, se trimat në Batin dalin si nga dheu kur qitet kushtrimi!

— Po besa, mirë e kie, lum baca. Burrat e Batinit kurër nuk iu kanë tutë hasmit të vatanit, as zagarëve që lëpijnë çanakët e dushmanit.

— Cen Gozhita hapi zë se shtigjet për partizanët janë myllur, — tha një mesoburrë.

— Qeni duhet ta dijë se, sado i gjatë të jetë dimni, prandëverën nuk mund ta ndali pa ardhë, — tha baca Shpend, — epo ajo e bekueme nuk vjen vetë. Atë e bjen kjo, — tha plaku dhe me pëllëmbën e tij të ashpër rrahu tytën e mauzerit. Të tjerët miratuan me kokë.

— Qebesa, po të ishte gjallë Shotë Galica, me pushkë e yll të kuq në ballë do të kishte ra sot këtu, në fshatin tonë, si atëherë kur Batini s'ishte as i kralit dhe as i mbretit, — tha një burrë i moshuar.

Në mbledhje erdhë zëvendëskomisari i brigadës. Ai foli për luftën. Pesëdhjetë djem të armatosur erdhën vullnetarisht partizanë. Ata u rreshtuan nëpër kompanitë e batalionit tonë. Batini zgjodhi Këshillin Nacionalçlirimtar të fshatit. Ish-kryeplaku u bë dhë në fytyrë.

— Burra, sot fitoi vegjëlia, — foli një mesoburrë, i cili brofi në këmbë dhe zbrazi pesë herë pushkën e gjatë.

— A thue bash fituem? — tha burri i moçëm. Shpendi. Ai imblodhi vetullat dhe u vrenjt në fytyrë. Balli i

tij kishte shumë rrudha të thella si brazda. Tundi kokën dhe heshti.

Në sytë dhe në ballin e bacës Shpend, në shprehjen e tij «A thue bash fituem?» Argjir Progri kapi shqetësimin e brendshëm të plakut. Foli përsëri mbi qëllimet e luftës.

— Goja të lumtë, o shoku komisar! — uroi plaku me vështrim të ndezur. — Fjalë ari, pasha besën, po na thua, po këto troje vetëm në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kanë pa pak ditë me diell, pastaj vërvshuen se cilë dimën më i randë se tjetri!...

Zëvendëskomisari i brigadës i kuptoi mirë shqetësimet e bacës Shpend dhe sytë i mbetën te balli i tij i gjerrë plot rrudha, iu duk sikur foli vetë bjeshka, fusha e gjerë, Drini ujëshumë.

— Popujt nuk luftojnë që të heqin një zgjedhë përtë vënë mbi qafë një tjetër, mixhë..., — tha Argjir Progri. — Popujt do derdhin gjak që të jenë zot në trojet e veta...

— E di, e di, po, pasha besën, ujku ndërron vetëm qimen, po kurrë lëkurën, o komisar..., — tha përsëri baca Shpend dhe rrahu tokën me qytën e pushkës.

Dardani e Bukuria ecën nëpër lëndina.

— Qe, kjo është nulla ime, — i tha Dardani. — Bukuria u drodh nga e papritura. Ajo e dinte me hollësi dramën e familjes së Dardanit. Ndaloj me vështrimin te murat e kullës.

— S'ka pér t'u shembur, — tha Bukuria, ndërsa iu ndezën sytë dhe i vërshoi të kuqtë në fytyrë si të kishte thënë një fjalë që s'duhej.

Te kjo kullë ai mori fluturimin, eci në jetë, kaloi fëmijerinë. Kujtonte vitet e fëmijërisë në vatrën e tij. Dymbëdhjetë vjet kishte kaluar ai nëpër lëndinat e bukurë,

në krojet ujë akull, nëpër pyje pa anë e fund. Pastaj, ai vite të tëra u end nëpër porte detare, por pesha e punës nuk ia ndaloj dot hovin e rritjes që i kishte dhënë era e Bjeshkëve të Nemuna dhe qumështi i deles. Rikujtoi një pér një vendet ku kishte lodruar me shokët e fëmijërisë, njerëzit...

Ata u sollën rrëth mureve të kullës dhe ndalën te molla përballë dritareve. Kokrrat në degët e saj sikur prisnin t'i këpuste ai.

— Është mollë sherbetë, — tha Dardani, dhe këputi disa kokrra faqekupe dhe ia dha Bukuries. Ishin të mëdha me lëkurë të ndezur. Mollezat e faqeve të Bukuries iu dukën Dardanit tamam si faqet e mollëve sherbete në degë.

— Sa-të ëmbla, — tha Bukuria. Dardani u gjëzua që i dha diçka nga trualli i tij. Kishte muaj që e dashuronte dhe s'kishte mundur t'i jepte asgjë.

Dielli prekte muret e kullës dhe në livadh shtrihet gjatë hija e kullës trekatëshe. Bukuria kaloi skaj mureve të shtëpisë dhe ndali përsëri nën degët e mollës shtatlar-të. Aty erdhi edhe Dardani. U ndie flladi i erës së malit. Dardani nderi dorën nga supi i Bukuries. U bashkua vërshimi i dashurisë me shushurimën e fletëve në degën e mollës. Duart e të dyve u bashkuante dega e renduar nga kokrrat. Ata vështruan njëri-tjetrin drejt në bebeza të syrit dhe buzëqeshën ëmbël.

Goxho Bërdellima nuk u besoi sëvë kur pa Dardanin e Bükurien të largoheshin në drejtëm të kullës të bregut. Ajo kullë ishte paq e veçuar nga shtëpitë e tjera të Batinit. «Është Dardani ai apo mos më bëjnë sytë?» — pyeti veten xha Goxhoja dhe u ngrys në fytyrë.

Dardani ecotë përpara, Bükuria një hap mbas tij. Dardani shikelte në livadh rëndë, ajo lehte. Ai këputi një lule të kuqe dhe ia dha Bukuries. Ajo tundi kokën dhe i mori erë. Xha Goxhos iu ndez shqetësimi. U përpoq ta largonte, po aq më thellë i çukiste në kokë. U la rrugë mendimeve që s'duhej t'u linje. Murmuriti.

— C'mendohesh, o xha Goxho? Gjysma e mijës pe-

šeinqind... — e ngacmova. Ai tundi kokën me leshra të bardha dhe më hapi barkun.

Xha Goxhos i shpjegova disa hollësi për jetën e Dardanit. Ai më dëgjoi me vëmendje e tha:

— Bëre mirë që më tregove këtë histori të Dardanit e të prindërve të tij. M'u bë edhe një herë më i dashur komandant Dardani dhe më e urryer fytyra e atij djallit dhe e ortakut të tij, pukovnik Stepanit. — E kishte fjalën për Cen Gozhitën. Më afroi gojën te veshi dhe më tha: — Pa dëgjo këtu, Agim, dëgjomë mirë. E ke shok me kokë Dardanin, por një ngatërrsesë mund të ndodhë. Dardanin e këmë komandant e trim me fletë. Xhinglaminglat s'i lejohen partizanit, jo më komandanit, jo se jo. Fundja le të fejohen, të rinj janë de!

Dardani e Bukuria po ecnin dhe po bisedonin afër e afër. Supet u takoheshin.

— Khë, — bëri Goxho Bërdëllima, sikur e zuri kolla... Ata-nuk e pikasën kollitjen e tjetrit.

Qe kulla e bacës Shpend, — tha një fshatar dhe thirri: — O Shpend Përdrini!

— O hajde bujrumb! — u dëgjua në katin e tretë të kullës një zë burri. Mbas pak, në vend të hapeshin dy kanatet e rrënda të portës së oborrit, krëk, bëri dicka, u hap avash një deriqkë e vogël dhe doli andej një burrë shtatgjatë me qeleshe të bardhë në kokë. Shpend Përdrini, që foli në mbledhjen e fshatit, ngjiti shkallët dhe na çoi në odën e madhe të shtruar me qilima e sixhade dhe të rrethuar me jastëkë të zbukuruar me motive popullore.

— Bujrum, bujrum-e mirë se na erdhët! — foli i zoti i shtëpisë.

— Ndize zjarrin, se vëllazënит janë të lagun, — i tha të nipi, ndërsa ai vetë na i vari armët e gjata në çivillëk, në fund të odës.

— Njitash, bacë, — foli i nipi shtatëmbëdhjetëvjeçar dhe mbushi oxhakun me dru.

— Shtro postiqe e shilte, o bir, — foli përsëri plaku.

— Njitash, — gjegji Haziri dhe erdhë fluturim me tri-katër postiqe e shilte në duar.

— Rrini lirshëm, si në shtëpinë tuej, bre vëllazën, se pasha besën edhe trenët e shpisë sonte janë gëzue! — tha baca Shpend dhe, vetëm pasi u rehatuem, atëherë u ul përballë nesh. I erdhi mirë që asnjeri nga ne nuk e pinim cigaren. Vetë ndezi cibukun.

Në qilimat, sixhadet dhe jastëkët e odës së miqve sundonte ngjyra kuqezi. Në fund të odës qëndronin varur armët e trimave të shtëpisë, lahuta, çiftelia dhe sharkia. Anash, dritaret dy e nga dy. Muret e kullës së gurtë ishin plotë frëngji që përgjonin nga cdo-anë, ku në rast rreziku dilnin tytat e pushkëve.

I zoti i shtëpisë e hapi bisedën. Kur mësoi që Di-noja ishte nga Vlora, tha:

— Kam qenë në Vlorë.

— Në Vlorë? — shpreha unë habinë.

— Pasha besën, dy herë. Kur u ngrit flamuri, që shkuem katërqind e sa burra me Isa Boletinin dhe kur e qitëm Italinë në det, — tha baca Shpend. — E bukur Vlora, — tha ai dhe filloj të tregonte për ngjarjet e viti dy-mbëdhjetë. — Shqipnia tanë jetën ka qitë burra, të gojës e gishtit që s'janë tutë as nga kralat e mëdhaj. Po arma ushtri kaq të madhe e kaq të fortë si ushtrinë e Enver Hoxhës kurrë nuk ka pasë Shqipnia. Italianin e varrosi, edhe gjermanin pasha besën.

Bukurie Çabirit që ishte ulur përballë tij i ndritën sytë. Nxori nga çanta një numër të gazetës «Bashkimi» ku ishte botuar portreti i shokut Enver Hoxha.

— Qe, ja ku është në fotografi! — i tha ajo dhe afroi gazetën. Baca Shpend dhe nipi i tij, Haziri, e mbër-thyen vështrimin te fotografia.

— Pasha besën, në sy e shoh se Enver Hoxha asht trim e shikon larg, — tha baca Shpend dhe i ndriti ftyra.

Sërisht biseda shkoi nga Kosova në Vlorë dhe nga Vlora në Kosovë. I nipi i bacës Shpend, Haziri, përpinte cdo fjali. Kur flitej për trimëritë e partizanëve, atij i shkëlqenin sytë. Fjalët e kursyera të plakut godisnin në shenjë si plumbat e shnaiperit. Kur Dino Çinoja zuri në gojë Cen Gozhiten, ai tha:

— Pasha besën, ata që janë ba bishti i të huejti në këto

troje gjithherë kanë shkue gjakupun e faqezit si Abdulla h pashë Dreni. Dushmanin e shkelësit e besës nuk i duron kjo tokë...

Gjëmimet e luftës nuk kishim të sosur. Dy batalione të brigadës sonë sulmuani në drejtësim të Gjakovës. Predhat e një topi të madh armik tek Ura mbi Drin filluan të gjuanin kodrat mbi fshatin Batin. Oshëtimën e krismave të rënda të luftës që bënin në Voksh e në Deçan brigadat e tjera të Shqipërisë së bashku me atë të Kosovës, i rrëmbejnë malet, pastaj e kthenin jehonën në një gjëmim të pandërprerë.

Baca Shpend ngriti kokën, iu afroa dritares, nguli veshtrimin të Bjeshkët e Nemuna. Brenga që bluan ai është më e rëndë se pesha e atij mali. Ajo rëndon mbi supet e tij sic réndoja dramat e mëdha në ndërgjegjen e njérëzve. Vështrimi dhe mendja e tij ishin ngulitur fortatyt te maja e lartë që të dukej se mbante kupën e quillit plot mjegull.

Bjeshka, ashtu si shuen rrufenë, shuen edhe dertin, — tha baca Shpend. — Bjeshka asht kurmi i përbashkët i armëve. Batinasit dhe gjithë katundet e krahinës e shikojnë forcën e bashkueme të tyne si qendrën e malit më furtunë. Ata në ditë të vështira i shtrëngojnë radhët, zemrat e supet e tyne i shkrijnë në nji të vetme dhe lartohien si mali, qëndrojnë si mali!

Sérish biseda kaloi nga Kosova në Vlorë dhe nga Vlora në Kosovë. Folëm prapë për esesët e divisionit «Brădenburg», për luftën, për të ardhmen.

— Të gjitha kralitë i kanë lakuar e do t'i lakojnë këto trojet tonë, more bir! Eh, sa gjak kanë derdhë të parët tanë për këto troje! Hazir, u këndo një kangë këtyre trimave, — tha baca Shpend. I nipi mori giftelinë, u ulë këmbëkryq, i tendosi telat dhe nisi këngën për një-

rën nga betejat e Kaçanikut e të Ernalevës, që mixha Shpend kishte dëshirë të këndohej në shtëpinë e tij nga të parat këngë:

C'ka ka dielli që s'ban dritë?

Krisi pushka në Kaçanik.

Kaçanikut i raftë pika,

hiç s'po din se çka asht frika,

nandë sahat janë therë më thika.

Djaloshi rreh qerpikum, ngre hark vetullën e syrit të pushkës dhe vazhdon këngën për heronjtë e Ernalevës.

Turgut Pasha me njiqind mijë,

Isa begi me shqiptari.

Kënga na rrëmbeu. Ajo na çoi nga trimëria në trimëri, nga beteja në betejë.... Nëpër telat e çiftelisë dhe zërit të thekshëm të djaloshit, që nuk i rrihte qerpiku, ndienim hovin e sulmeve të shqiptarëve për të shporrur të huajt nga vratat e tyre stërgjyshore.

— Kam kerië me Isën në lufën e Ernalevës, — tha baca Shpend. Na foli për betejën e madhe, për Isa Boletini, për trimë të tjerë, po asnjë fjalë për vete. Përparrasyje tanë të mendjes lartësohej si një majë e lartë mal Isa Boletini i veshur me opinga më tirq sharana e kapuc të bardhë të ulur mbi sy.

— Të këndoftë zemra, — uruam ne djaloshin.

Baca Shpend qëndronte i heshtur. Jetonte me oshëtimën e betejës së Ernalevës. Thithi më afsh llullën dhë pyeti Dino Cinoni:

— A ke babë?

— Ma vranë fashistët, baca Shpend. Edhe ai ka qenë në dymbëdhjetë kur u ngrit flamuri.

— Baba të ka lanë mbrapa, — tha baca Shpend. — Thiu do plumb, se ndryshe i hueji nuk shkulet nga trojet tona.

U ngritëm që të shkonim te shokët, që kishin zënë vend në vijën e parë, aty buzë Erenikut.

Baca Shpend na dha me vete tri bukë çerepi të ngrohta dhe djathë për t'ua guar shokëve që bënin rojë.

— Medet që më lanë këmbët e s'muj me ju ndjek. Ju priftë e mbara, trima! — na uroi plaku dhe i foli të nipit:

— A u gatitët, o Hazir?

Djaloshi zbriti shkallët, mibante një pushkë Italie në dorë dhe rrëthim në brez plot fishekë.

— Merre, merre edhe çiftelinë! — i tha plaku.

— Unë po shkoj në luftë e jo në dasmë, gjysh!

— Pushkën e këngën shqiptari nuk i ka nda kurrë, more bir.

I nipi hodhi dorën te pushka, vrapi i shkallëve të merrte çiftelinë dhe buzëgashi.

Në radhët e brigadës u shtua edhe një partizan i ri.

Kolonel Vilenbergu u ngjit në lartësinë mbi qytet, hapi hartën... Në planin e tij «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe» kishte parashikuar se q'duhet të bënte. Mori të gjitha masat për të goditur brigadën partizane që arriti në afërsi të qytetit. Ai mendoi që në drejtim të Batinit të realizonte një nga ato kurthe të përgatitura me kohë për asgjësimin e «dhelprave të kuqe».

Nga të dy kodrat tek Ura mbi Drin topat gjuajtën vargëzimin e kodrave përpëra Batinit.

Kolonel Vilenbergu kaloi nga njëri skaj i pozicioneve në tjetrin, shkeli gjithë pikëmbëshjet e rëndësishme përpëra qytetit të Gjakovës dhe nyjet kryesore rrugore. Bisedoi me oficerë dhe ushtarë, por në këto takime konstatoi se kishte ikur koha kur ushtari gjerman dehej me erën e barutit. Kësaj ere ai vazhdonte t'i frynte, ajo duhej të mbetej gjithnjë e ndezur për t'u bërë ballë goditjeve të partizanëve. Këtij qëllimi do t'i shër-

benin edhe goditjet që do t'u jepeshin forcave partizane. Ai donte të shikonte nga afër si po zbatohet plani i tij «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe». Mbës goditjes me artilleri shigjetat me kokë nepërkash lëvizën përpara. Ato lëvizën nga krahët tanë. Disa skuadra partizane që mbrojnë krahët e patën të vështirë t'i ndalonin dhe shigjetat me koka nepërkash ecën përpara.

Batalioni ynë u vargëzua me një vijë, zuri pozicione në kodrat përpara fshatit. Mbës pozicioneve të kompanisë sonë, te një shesh i vogël ishin vendosur dy topa të brigadës. Ata ishin maskuar mirë më gjethë. Topi i madh në lartësinë tek Ura mbi Drin buçiti me grahamë të rendë.

Zjarri ynë i stepi në vend esesët. U erdhë në ndihmë një tank që eci në krye, mbës tankut dy autoblinda. Tanku dhe autoblindat ishin të pajisura me topa e mitralloza në ballë e kryqe anash. Nga fërkimi i zinxhirëve ballta u shtyp dhe u ngjesh. Tanku, sapo doli ballas pozicioneve tona, papritmas ndaloi. Përsëri eci edhe në ecje u drodh, lëshoi përpara një fjollë tymi. Gjuajti me ca predha topi dhe eci përpara, kurse autoblindat imbetën te kodra. Esesët që erdhën mbës tankut u hapën në formacion luftimi dhe fuqizuan vijën e sulmit. Esesët morën zemër nga tanku dhe ecën me kërcime e më rripin e automatikut të liruar në qafë, më armën të shtrënguar në duar.

Ishin të bindur në forcën e tyre, ndaj vraponin. Në vrapi e sipër disa nga ata plumbat tanë i gozhduan në vend, rreshti i tyre u rrallua, hovi i vraptit të esesëve më në fund u mpi.

Këtë rast e prisnin. U lëshuam në drejtim të tyre me granata.

\* \* \*

Edhe burrat e Batinit kishin ardhur në vijën e lutfës. Lëshuan një sokëllimë ngjethëse dhe shtinë mbi esesët. Ata shtinin rrallë, po plumbat e tyre godisnin në

shenjë. Ndjeva një zë të njohur. Ktheva kokën. Ishte baca Shpend. Pushkën e kishte për faqe.

Te bregu sulmoi një partizane. Ishte Bukuria. Ajo eci përpara. Edhe tanku eci vrullshëm në drejtim të saj. Mitralozi i tankut ia bëri tym rrugën me plumbë.

— Bash shqipe bjeshke! — murmuriti në pozicion baca Shpend.

Vrapuam edhe në të tjerët përpara të zinim pozicion luftimi në një vije me Bulkurién. Breshëria e plumbave të tankut na bëri njësh me dheun. Tanku qëlloi përsëri me mitraloz dhe me top. Bukuria shtrëngoi dhëmbët, nxori një granatë, e përgatiti për ta hedhur, por tanku u ndal në vend dhe qëllonte që nga larg.

— Lajmëroni topat! — thirri Bukuria që nga vija e pare.

Tanku, me krifën të ngritur, harboi te bërryli i rruges si një egërsirë. Fill imbas tij doli aty edhe një tank tjeter.

Lajmëroni topat! Lajmëroni të hapin zjarr topat e brigadës, — thirri përsëri Bukuria.

Topat e brigadës buçitën njëherësh. Predhat ranë para e prapa tankut. Tankisti nuk ishte nga ata që nuk e ndiejnë frikën. Makina u zhduk prapa kodrinave.

— O, pritni trimat e shqipes, breee!? — sokëllinë maledorët dhe bashkë me ne u hodhën përpara.

—

—

—

## XI

Në bjeshkën e Batinit takuam një burrë të moçëm shtatlartë. Ai ngjan me një copë shkëmb të bjeshkës. Pëershëndëtemi me të dhe shtrohemi në bisedë. Na bëhet se bisedojmë me lëshësinë e këtij trualli.

— Na ke kërkuar, mixhë? — i tha Skifteri.

— Keni një trim këtu në bjeshkë, bre vëllazën, — u përgjigj.

Disa ditë radhazi e kishim kërkuar në bjeshkë varrin e Mustës, mitralierit të kompanisë sonë, po nuk po e gjenim.

— Kur luftimet bëheshin në Batin, erdhën asaj ane nga Peja esesë të tjerë. Ata u ngjitën aty te pylli me gështenja, — tha Skifteri dhe hodhi vështrimin te pylli.

— Bash nj'ashtu asht, — pohoi burri i moshuar që punonte në mullirin e vogël të bjeshkës. Kutinë me duhan ua kaloi dorazi.

— Më prismi pak, — tha burri me mustaqe të bardha dhe iku.

Mbas pak u kthye me një nagaçe të hedhur në qafën e dorës. Ecëm derisa arritëm përballë mullirit të vogël. Aty te gështenja e madhe ai ndaloi.

— Qe, këtu ishte një ushtar i nemces, aty përballë, tek ai guri i zi ishte partizani juej. Të dy kishin mitraloza. Grah njëri me plumbë e grah tjetri. S'i prajti pushka as njanit, as tjetrit, — tha plaku, u soll rrrotull trungut të gështenjës së lashtë, goditi me nagaçe dhe vazhdoi:

— Qe plumbat, qe! Janë plumbat e mitralozit të partizanit. — E godiste trungun me sëpatë, dhe, sa herë nxirrte plumbë, thoshte: — Qe, vëllazën, qe plumbat!

Vështrimi ynë ngulet aty ku godet sëpata, marrim plumbat në duar. Eshtë urrejtja e Mustës e derdhur në plumb. Druri u ka ruajtur plumbave formën...

— Ky trung gështenje mban mbi njëqind plumbë, — tha plaku. — Të huejt na vranë njerëzit, bre vëllazën!...

— Objekt që duhet ruajtur, — tha Skifteri. Njëri nga shokët e komunales, Nehati i numëroi plumbat, shënoi vendin ku u gjetën, emrin e Deli Mehmetit, që i tregoi dhe i vendosi në një qeskë najloni. Plakut iu bë qejfi përkujdesin që treguam dhe e goditi me sëpatë edhe me dendur trungun e gështenjës gjersa nxori prej saj të gjithë plumbat.

— U lodhët, mixhë, ndize një cigare «Arbëria».

— Arbëria? — tha dhe e vërtiti nëpër duar paqetën, u mundua të lexonte gërmat e ndezura e të kuqe. — Arbëria, — murmuriti me sy të ndezur. E falënderova plakun.

— Mos e thuej atë fjalë, bre burrë. Vëllai vëllait i ka borxh djersë e gjak... — Heshti një çast, thithi duhan e tha: — Ndera u takon trimave, bre vëllazën! Unë isha afër, ja, bash aty te mullini i rrëzuem, aty isha. Ushtarët e nemces që erdhën me makina nga Peja më morën me zor. Më sollën deri këtu, te ky trung gështenje.

E ndiejmë rrahjen e damarëve në témthat, na rrahin me ritmin e zemrës. Ndiejmë vrullin e papërmabjatur të kujtimeve të luftës, në fillim butë, mandej vrullshëm. Eshtë dashuria dhe dhimbja për shokun.

— Nemcelinë që ishte me mitraloz te kjo gështenjë e

goditi partizani me disa plumba, — tha mixha. — Boll rändë e kishin marrë. Zagari i zi, Cen Gozhita, ishte me ta. «Merre në shpinë, Deli Mehmeti!» — më tha. Mu duk se më zuni mali. Si me ba? Mbahet në shpinë ai që i ka vu pishën vatanit!

Atë ditë gjëmonte lufta, gjëmonte edhe moti. Ishte ditë me gjëmimë të randa. Sulmonin gjermanët që erdhën nga Peja e Gjakova në drejtim të Batinit, sulmonin dhe partizanët.

«Zbrita në xhade ushtarin e plagosun!» — më tha Ceni dhe ma ngjeshi në shpinë. Ishte një zdap i gjatë e gjithë tule. Si kotorr bullcie. Thi e bir thiut ishte, po m'u desh me e mbajtë në krah. — Iu kthyte Skifterit: — Eh, bre vëlla, zori nuk ka kufi. Mozomakeq! Binte shi e breshën kokërrmadh. Kur lëshon dufin bjeshka jonë, thue se po bjen qielli. Nemcelinjtë u ngjeshën malit përpjetë. Kërkonin t'u prisnin krahun partizanëve që luftonin në Batin. Nuk i la trimi me dalë, s'lëshonte pe, qe djale me zemër luani ai.

— Ashtu eshtë, mixhë, ashtu, — pohoi Skifteri. Kujtojmë Mustën. Mitralozi i Mustës nuk dinte të ndalur.

— E pra. Aty bani ballë ushtria e nemces, — e shtriu krahun andej plaku Deli Mehmeti. Shikuam vendet ku kishte vëzhguar syri dhe shënjestra e mitralozit të Mustës.

— Si bëre mandej me atë ushtarin e nemces? — pyeti Skifteri.

— Si bana? Mozomakeq, gjaku i nemcelisë ma fëlli-qi shtatin E ula deri te përroni i madh që vinte valë e shkumë nga bjeshka e lartë dhe i thashë: «Hajt, bani të fala krajlit tand» dhe e përplasa në përrue.

U ngjitëm te lëndina midis pyllit të madh me gështenja.

— Qe vendi i vorrit, — na tha. — Aty dolën ushtarët e nemces, këtu fill i vetëm ua preu rrugën ai me mitraloz. Vendin trimi e zgjodhi bukur mirë, por ishte vetëm bre! — Mimika e fytyrës shprehu dhimbjen që ndjeu atë ditë. Tha: — Tri herë heshturazi iu hodhën si ujq ushtarët e nemces dhe të të tri herët trimi i ktheu mbrapsht.

Ceni bërtiste me egërsi: «Dorëzohu, s'po të prishim, dorëzohu!» Ai i përgjigjej me plumba... Ata s'mujtën me iu afrue kurri sesi. Atëherë e kërkoi vendin rrëth tij mortaja. Predhat e para ranë afër e partizanin trim e mbuloi balta. Si këlyshë ujkonje lehnin predhat e mortajës. Më theri në zemër, Besa, burrni ma të fortë nuk e gjen. Ushtarët e nemces të egërsuar u hodhën drejt tij, por apet se apet u prapsën nga mitralozi. Trimnia i nalton njerëzit, kullat dhe bjeshkët. Mandej ranë të tjera predha mortaje, — tha plaku i dëshpëruar, drodhi duhan dhe vazhdoi: — U vra dhe mbeti aty. Ditën e nesërme mora nipat dhe e varrosém. Ka në vorr një tytë mitralozi, dy kasetë me gjëzhoja. Çdo gja që kishte me vete ia kam shiti në vorr...

Një piketë tjetër ngulet në bjeshkën mbi xhade.

— Në brigadën tuej kam pasë një mashkull timin, — tha Delia dhe pyeti: — Në vorret e Tiranës do t'i vendosni trimat?

— Në varrezat e kombit, krah shokëve të mbledhur nga të gjitha skajet e Atdheut... Aty, mixhë, aty.

— Pasha besën, kur nderon trimin, nderon veten dhe kombin, bre vëllazën, se shumëkush s'pyet për kësi punësh. Kam ndie se po i kërkoni të rënët e brigadave të Shqipnisë nga Serbia, Mali i Zi, Maqedonia e Bosnja. Ai shtet që s'le të bahet avull gjaku i luftëtarëve të tij, pasha besën, kurrë nuk ka me pasë mort! — tha plaku Deli Mehmeti dhe nguli vështrimin mbi horizontin e mjegulluar.

Mbas kundërsulmeve që bënë disa ditë rresht esesët e divisionit «Brandenburg», Cen Gozhita u rikthyte përsëri në Batin. I vendosi trupat e tij në disa kulla që i shpëtuan zjarrit. Esesët gjermanë zunë kodrat. Cenin e mundonte shuplaka që kishte marrë. Ishte bërë bishë. Besimi te forca e gjermanëve ishte lëkundur. E kishte nuk hatur hollë se ushtria gjermane po gremisej. Po e vriste

mendjen në ç'barkë të hidhej. Çdo mbrëmje në një radio me bateri dëgjonte lajmet. Më tepër ai dëgjonte Radio Londren dhe Radio Barin në gjuhën shqipe. Nganjëherë hapte dhe Radio Berlinin. Nga ato pak fjalë që kishte më-suar gjermanisht kuptonte që armatat gjermane për arsyen tē «taktikës» po tërhiqeshin. Cenit kjo fjalë «tërheqje tak-tike» ose «shkurtim strategjik i frontit», që përdorej në njoftimet gjermane, i ngjallte neveri. «Kështu e kishin filluar edhe italianët, me këto fjalë arriten gjerë në pikën e fundit në ditën kur thanë: «U dorëzuan!» Çfarë taktkike i thonë kësaj, lësho pozitat dhe ik!» Kishte kohë që në mendje i trokiste pyetja: «Cili kral do të vijë?»

Kësaj pyetjeje Ceni s'dinte t'i jepte dum, me njerëz tē tjerë s'guxonte të fliste. U mbyll në vetvete, jetonte me vetveten, bëhej pérherë e më i vrazhdë në fytyrë, më i egër në veprime, ditën i mbyllur në blindazh hekuri, shëtiste me autoblindë, natën mbyllej në kullë.

Me urdhër tē Cen Gozhitës u vunë në plumb tre aktivistë tē luftës. Ata kalonin natën nëpër Batin, vinin nga zona e fushës e kërkonin tē takoheshin me partizanët. Ky ishte shkaku që Ceni mbloodi burrat që mbetën në fshat në livadhet te gështenja e madhe. Kullat e Batinit binin erë shkrumb. «Më tē larta e më tē forta do t'i bëjmë», — thoshin batinasit. Ceni zgërdhihej dhe me zor i coi njerëzit në mbledhje. I kërcënoi. Nofulla iu shtrembërua.

Disa topa goditën malin e lartë tē Batinit. Nga gjë-mimi shungullonte pylli. Gjëmimi i topit i dha zemër.

— Hë, pra, qe edhe zjarrmin e pushkëve partizane e shuejti topi i nemces, e dëgjoni c'punon? — Te lartësitë buzë Drinit një top i madh gjëmonte rëndë.

— Ai zjarrm s'pran, o Cen, asht flakë që zor shpëton kush prej saj, — tha dikush.

— Ai asht hi, hi i ftohtë në votër, jo zjarrm. A s'po e shihni se kambë partizani s'mbeti, i bani topi i nemces pluhun! Dëgjoni topin, o shurdhanë! Keni ndie kësi topi, katër sahat larg asht dhe dridhen edhe kullat ma tē forta.

Era e shkrumbit tē kullave fshatarëve u mbushte hundët. Ceni i shikonte ata vëngër, kurse ata shikonin tokën.

— Kullat ton a kështu na i ka kallë i hueji gjithmonë, o Cen Gozhita, po ne prapë këtu jena. Medet për ata që hanë në kazan të dushmanit..., — tha një burrë i moshuar.

Vetullat e Cenit u kryqëzuan si dy anët e gérshérës në prerje. Atë kohë dy nga të bandës së tij prunë të shqëruar një grua.

— Zoti major, kemi zanë nji komunist, — i thanë.

— Ma sillni bre, se për allah në degë të gështenjës po e var! — gérthiti ai me ftyrë të çakërdisur.

Dy nga të Cenit e shtynë atë me bajonetë pushke përpara.

— Bre, bre, qenka vesh si loke, këqyrne dreqin me brina si qenka veshë?

— Asht grue ajo, o Cen Gozhita, është halla Shahe, — tha dikush.

— Asht dreqi vetë, komunisti tutësh ash veshë me rrrobe grash, — tha Ceni.

— Ku e kie trimninë ti, o Cen marrja, si merresh me një plakë. — Mercenarët e Cenit, të habitur vështruan njëri-tjetrin.

— Kujt ia shan trimninë ti, moj sorrë e keqe? — u hakerrye Ceni dhe zgurdulloi sytë e përgjakur. Gjaku i hipi në kokë. Iu duk sikur u përmbysh mali. Ftyra i mbeti si e ngrirë, çoi dorën në mes.

— Qit, he t'u thafshin krahët, ç'pret?

— Nji dhamb të ka mbetë, bre shtrigë e keqe, dhe kafshon ma idhshëm se gjarpni.

— S'le kral pa ia shitë lëkurën tandem, o bajraktar! Kralit të serbit ia shite, Duçes ia shite, Hitlerit ia shite, tash cilit kral do t'ia shesësh?...

— Mbylle gojën, moj bushtër, se t'i hedh trutë në erë, po ç'të baj se je grue!

— Ata që e kanë shitë lëkurën te dushmani gjithmonë gjakupun kanë shkue e pa vorr kanë mbetë në këto troje, o Cen Gozhita, — tha plaka me vetulla e grushte të mbledhura.

Ceni e ngriti dorën me forcë, kamxhiku fishkëlleu, u ngrit lart e bëri dredhë si një gjarpër dhe u përplas në këkën e hallës Shahe.

Bamp, shungulloj një armë. Cenit i mehu fryma, ndjeu éren e barutit. U zbeh në fytyrë, i ngrju dora në ajër. Ishte e dyta herë brenda tri ditëve që batinasit qëllonin mbi Cenin. Plumbi e rrëmbeu në gjoks rojën personale të Cenit. Ai ra në tokë i mbytur në gjak. Shtiu Abdyli, djalili i hallës Shahe. Ai u përpoq të ikte, s'mundi, gjithë shtigjet e rrugët ishin të zëna. E kapën.

— Konopi ka me ta tha shpirtin, he shtrigë e keqe! Kush ka gjuejtë mbi mue, asht ba pishman. Ma sillni në sheher, — i urdhëroi mercenarët, — aty kam me ia qitë kryet në konop, — tha Ceni. Dhe hipi në autoblindë. Iku në drejtim të Gjakovës.

Cen Gozhita hyri në Kafen e Madhe, papritmas, siç hyn era therëse e veriut në muajt e dimrit plot acar. Se pse iu kujtuan fjalët e të atit. Kur Ceni ende nuk i kishte mbushur të dymbëdhjetat, i ati, thërriste: «Çok jasha padishah!» Iu kujtua dhe «Pukva Gjashtë Car Aleksandra», ku Ceni kishte bërë ushtrinë dhe ishte njohur e miqësuar me pukovnik Stepanin. Në fillim sepse i lustroste bukur gjizmet, mandej sepse Ceni me pamjen e tij simpatike i kishte hyrë në zemër pukovnicës, një bëronje që s'lindi asnjëherë e Ceni me dëshirë e kujtonte edhe tanë që ishte pesëdhjetë vjeç. «Më ke trup kralice», — i thoshte Ceni dhe pukovnica linte mendtë mbas Cenit.

— Shtatin e ka nga raca jonë, gjakun të huej, — murmuritën ata që e shikonin të ulur në krye, me vështrim nga sheshi në qendër të qytetit. Vështronë e herë mbas here godiste tavolinën me kamxhikun, në fundin e të cilët mbështillej plumbi i rëndë me kokën sferike si kokë gjarpéri. Këtë zanat Cenit ia kishte dhënë probatini i tij, pukovnik Stepani. Nga kamxhiku me kokë sferike prej plumbi kishin vdekur më tepër njerëz sesa nga plumbat e nagantit. E fundit do të ishte gruaja e Batinit, halla Shahe. Ai s'donte ta vriste me plumb, kishte dëshirë që shpirtin t'ia nxirrte ayash-avash me kamxhikun e tij. Atë

që nuk e la plumbi i Abdylit ta bënte në fshatin Batin, ai do ta bënte në qelitë e errëta të Gestapos në qytet. I biri shtiu për nënën. Ngjarja në Batin Cenit nuk i largohej nga koka: «Për një qime kam shpëtue, krejt kot!» Trokiti dhe kamerieri vrapi lehtë në drejtim të tij. Porositi një kafe të fortë. Ceni e rrufiti kafen i babëzitur. Ndjeu se një tik nervor po ia dridhte buzën e sipërme dhe mustaqen e hollë. Mbërtheu vështrimin te sheshi aty ku era tundte litarin e varur në trekëmbësh. Ndjeu që bebëzat e syve po i lëvrinin, i rriteshin. «Ai i vjen hakut këtij pis mëleti. Ai...» Shikoi orën, duhej të kthehej në Batin sa më parë, por atë që shtiu kundër tij, atë djaloshin donte ta shikonte në litar që t'u thoshte batinasve: «Kush shtie mbi Cenin, e çon vetë kryet në litar!»

Një zhurmë e papritur. Tre autoblinda u endën në sheshin para Kafes së Madhe. Mitralozat e autoblindave qëlluan püllazet e shtëpive. Këtë gjë autoblindat e bënë disa herë dhe u sollën me zhurmë e me krisma. Cenit iu bë qejfi se, sipas mendimit të tij, Gjakova ua kishte bërë børxh. Atij i viinte plasja se asnjëherë nuk kishte arritur t'ua ulte kokën, t'i nénshtronte. «Hë, tash ta shikojnë? Ky u vjen hakut. Me siguri kolonel Vilenbergu do t'i bëjë të paqenë!» — tha Ceni me vete.

Nga autoblinda që ndaloi te shkallët e ndërtesës doli një stërhell i gjatë me mjekër të zezë. Iu duk aq i gjatë, sa-që s'i mbushej mendja se mund të rrinte gërmuq në autoblindën e vogël një stërhell i tillë. Njeriu që doli nga autoblinda kishte uniformën, mjekrën dhe çizmet e zeza. Ai hyri në kafe me vështrim të rëndë. Zuri vend afër drifates.

— Kush është ky? — murmuriti Ceni. Mjekroshi ktheu një herë kryet në drejtim të Cenit që ishte zbehur e struktur si i sëmuri rëndë nga frika e vdekjes. Ndjeu ca mor-

nica në trup, por e mblodhi veten. Në raste të tilla Cen Gozhita nuk rrëmbehej. Qëndroi si ujku në pusi. — Çetnik është, — shqiptoi me zë të ulët.

Mjekroshi e ktheu edhe një herë vështrimin nga Ceni dhe i foli kamerierit. «Si zë i dëgjuar», — tundi kokën Ceni. Nuk po i binte në të. Deshi të dilte nga salla, po nuk iu bë të ngrihej. Me bishtin e syrit shikoi vetullat e mjekroshit. Përsëri dëgjoi zérin e tij të vrazhdë. «Bash ai asht!» — tha me vete Ceni dhe brofi në këmbë. Shkoi drejt tij me hapa të shpejtë e i tha:

— Serca moj, bratski moj! Të kërkoj në qzell e më mbive në tokë! — Iu hodi në qafë. U ul përkarshi. I ndritën sytë e skuqur nga pagjumësia. Ceni nuk ia fshehu atë që po e gjerryente përbrenda dhe s'po e linte të shtinte gjumë në sy. Pukovnik Stepani i tregoi se bënte pjesë në shtabin e një korparmate çetnike dhe kishte ardhur nga Mitrovica.

— Zemra ime, ç'e mirë të solli këndeje? — i tha Cen Gozhita i përmalluar. Ai buzëqeshi lehtë dhe i shkeli syrin. Ata ishin miq të vjetër. Cen Gozhitës papritur i erdhë mendimi se e kishte takuar në kohën e duhur atë që kërkonte. Porositi një kafe. — Nuk i kam punët mirë, — iu hap Ceni. — Lavdia e këtyre po fundoset më thellë se ajo e Duçes. — Kolonel Stepani e bëri kular njëren vetull, kishte një vetull kaleshe, mbirë si degë mustaqeje poshtë ballit. Syri i majtë mbetej zbuluar; ia kishin prerë me brisk vetullën tjetër për një ngjarje turpi. Ceni e dinte mirë atë ngjarje. Car Aleksandari, kur e mësoi çështjen, tha: «Ani çka, vetullën e syrit të pushkës ma ka». Dhe mbeti pukovnik me një vetull. Ajo shëmtonte pukovnikun e vinte në pah në sytë e pukovnicës bukurinë e ushtar Cenit. Dhe ushtar Ceni u bë ushtar që s'flinte më në kazermë. Pukovnik Stepani e lëviz vetullën e syrit të pushkës si një gëershërë më një anë, një gjysmëgëershëre dhe mbeti si e ngriqe vetulla te iballi i tij. Atëherë, për të sjellë në mend fjalën që donte të thoshte, e hodhi dorën te mjekra, e shpupurishi me gishtërinj dhe syri i tij hetoi nëse ishin të vërteta fjalët: — Gjemi e mbytur, lum probatini! — shtoi Ceni përt bindur tjetrin për ato që i tha.

— Pastaj?! — e pyeti koloneli çetnik.

— S'di kah me ia mbajtë, lum miku. Sikur po u soset vaji i kandilit kralëve, — tha i lodhur Ceni, që e ndiente të lodhur veten në vrapimin e gjatë mbas kralëve.

— Ndodhet te ju një kapter nga anët e jugut?

— Po, ka disa javë që e kam pranue.

— Nën gradat e kapterit fshihet diçka tjetër më e madhe, bisedo me atë njeri.

— Aa, — bëri Ceni si guak.

Kolonel Stepani ia dha gazit, qeshi me të madhe, sa-që ata që shërbenin në kafe e kthyen vështrimin nga ai. Cen Gozhita e uli zërin, çuditej me kolonel Stepanin, ishte me qejf. «Mos mendja e tij kishte prerë gabim? Mos fuqia e kralit ishte ende e madhe dhe ai mendonte... «Jo, jo!» — tha me vete me vetulla të lëshuara, mandej me zë:

— Gjemia e tyre po mbytet.

— Pastaj? — e pyeti kolonel Stepani me vetullën të ngritur si çark pushke.

— Nga ky çast jam shurdh e memec, s'di kah me ia mbajtë, shtigjet gjithkoh janë të zana.

— A s'ban me e ndërrue stemën e esesit me ngjyrën e kuqe? — i tha pukovnik Stepani.

— Me mbërthye yllin e kuq të komunistave në kapele thue? — pyeti Cen Gozhita dhe e vështroi frikshëm.

— Pse jo, q'humbet?

— Nuk është kral si çdo kral ky i kuqi që po vjen, — u hutua si të kishte goditur një rrufe qielli afër. Belbëzoi pa kuptim.

— Ç'humbet të heqësh shenjat e esesit dhe të vësh yllin? — pyeti pukovniku. Cen Gozhitës i rrëshqiti nga cepi i syrit një shkëndijë dyshimi në fjalët e probatin Stepanit

— Mozomakeq! Cen Gozhita s'mundet me e pa veten komunist, ma mirë në vorr së gjalli! — tha Ceni i trembur si një heretik para forcës së zotit.

— Kurse unë kam fillue të eci nëpër këtë shteg.

— A! — bëri Ceni i shushatur prej fjalëve dhe drodhë një cigare me duhan të rëndë. Pukovnik Stepani i kalonte gishtat e dorës kreher nëpër mjekër dhe hetonte

me bishtin e syrit Cen Gozhitën që vendi vend s'po i zinte.

— A s'asht vonë? Ku me ia nisë tash kësaj pune? — pyeti Ceni me fytërë të shtrembëruar.

— Vonë s'asht asnjëherë, — i tha pukovnik Stepani. Ai e mori me mend që do të donte kohë t'i largohej hutimi Cenit. Autoblinda te shkallët u ndez. Vepro si të thashë. Për qdo të papritur tako popin e manastirit të Deçanit, aty trokit, — i tha dhe iku.

\* \* \*

Pukovnik Stepani ndaloi buzë Bistricës sé Deçanit. Shkaku i ndalesës në dukje ishte vizita e një vizitorë të zakonshëm. Në të vërtetë njeriu me vetull të prerë vajti të takonte pop Josifin. Biseduan kokë më kokë. Aty, në heshtjen e thellë të tempullit, i hapën letrat... Në mbarim popi dhe njeriu me vetull të prerë ecën nëpër rrugicat e tempullit. Mbretëronte heshtje e plotë.

Popi i ankohej njeriut me një vetull.

— Ushqeqi sa të duash këta më lëng kungulli, s'merr njomësi kaptina e tyre, mundohu të futësh disa gjëra që të besojnë se të paktën jemi kumbarët e tyre. Të gënjen mendja. Mundohu ta mbulosh rrënjen sa më thellë pemës, humbe po deshe në thellësi të dheut, kot e bën mundimin. Këta i shtinë varret e njerëzve edhe më thellë, ke dëgjuar c'flitet për Azem Galicën?

— Legjendë, — tha pukovniku.

— Legjendat e tyre ndërtohen mbi baza të vërteta. Kujton se kthen përmbyss tokën dhe s'ke mundur të shkulësh me rrënjjë asgjë. Një pret, dhjetë rriten, harlisën si bari i livadhit nga presa e kosës. U pret këmbët, u mbijnë krahët, s'bëhet derman me ta.

— Mos harro se plani ynë mbetet siç ka qenë. Orientimet e kolonel Meklinit mbetën deri në fund, ato kërkohet të zbatohen.

— Këtu po përmbyset qdo gjë, ai kapiteni i esesëve që më shkruanit nuk u duk.

— Ndoshata... Luftë është, qdo gjë ndodh... Dëgjove ç'gjémë e madhe u bë në Mitrovicë? Njëqind aeroplanë njëherësh bombarduan.

— Mandej?

— Bomba angleze që vjen nga qielli s'di të dallojë që një kapiten i esesëve qenka në shërbim të anglezëve.

— Jo, — tha popi.

— Mos e humb nordin kur ndodhemi në prag të suksesit. Sytë e Çercillit vështrojnë të etur mbi Ballkan, autoblindat e armatës angleze do të kalojnë detin, ato sikur i shoh duke mbuluar rrugët e Ballkanit. Kujto se në brigjet e Italisë është një armatë e blinduar që pret, kjo është një forcë e madhe goditëse, por më e madhe është fuqia jonë, fijet tona të endura aq mirë sa në të ardhmen priten fryte të atilla që do habitemi edhe ne vetë kur t'i shikojmë. Ka menduar Çercilli, në rrjetin tonë vërtiten aq shumë njerëz sa na bëjnë të jemi optimistë në të ardhmen.

— Kapiteni i esesëve humbi, atë duhet ta takoja, — tha popi.

— Do ta takosh patjetër, — i tha njeriu me një vetull të prerë dhe i dha dorën. Nuk u kuptua nëse popi iu përkul atij apo ai popit. Para se të hipte në autoblindë, njeriu me vetull të prerë i tha: — Ma ki kujdes Cen Gozhitén. I kam thënë në qdo rast kur ta ketë punën pisk të trokasë te ju.

Popi vuri midis pëllëmbëve kryqin dhe bëri atë përkuljen e zakonshme të zanatit me lutjen e amëshuar duke vështruar qielin.

Maska ia mbulonte mirë fytyrën...



Cen Gozhitës edhe në èndërr i dëftehej pukovnik Stepani. Zgjohej, fjalët e tij e kishin vënë në mendime. «Besa s'ka kurth që nuk e shkrëh mendja e tij, si nuk

shkova më parë ta takoja?» — qortonte veten. Stepani i kishte hedhur mizën dhe kishte ikur. Mendja e Cen Gozhitës tanë punonte, kërkonte shtegun. A do t'ia falnin komunistët ato që kishte bërë Cen Gozhita? E krahasoi veten me pukovnik Stepanin. Ku ai e ku Cen Gozhita? Dërisa kishte shteg te të kuqtë për çetnikun Stepan, si të mos gjendej një shteg edhe për esesin Cen Gozhita? U ngrit nga shtrati, ndezi llambën, mori një letër dhe shkroi:

«Komandantit të brigadës partizane,  
Zotit Sopot Golemi!

Ju shkruan një oficer që dallgët e luftës e përplasën në rrugë zigzage. I hymë në rrugë pa krye, i penduem për hapat që kam hedhë, kërkoj të rreshtohem në anën twej dhe jam gati të jap ndihmën time në dobi të Luftës Nacionalçlirimtare, duke më sigurue jetën!»

«Dorëzim me kushte nuk pranojmë. Ata që kanë lyer duart me gjak do të ndëshkohen nga gjyqi i popullit». Këtë përgjigje mori Cen Gozhita nga komendant Sopoti.

— A! — bëri Ceni posa lexi letrën. U hutua edhe më tepër, bloi truri i tij mendime nga më të ndryshmet, pyeti vvetveten. «A thue të kuqtë nuk qenkan njësoj, a? Po pukovnik Stepani si e hapi shtegun? Si e pranuan?!...» Rru-dhi buzët. S'diti t'i jepte rrugë mendimit.

Cen Gozhita u pendua për ato që kishte shkruar. Pukovnik Stepani e kishte nxitur të ecte nëpër një rrugë të rrezikshme. «Po sikur komunistat t'ia dërgojnë letrën kolonel Vilenbergut? — i shkrepit mendimi i kobshëm. Ai filloj të jetonte jo vetëm me shqetësimet e luftës, por edhe me atë copë letër që i dërgoi Sopot Golemit, njërit nga komendantët e brigadave partizane shqiptare që sulmonte pozitat e esesëve në drejtim të Gjakovës.

Mbas atentatit që iu bë në Batin, Cen Gozhita zërin e mbajti në vrazhdësi të paprerë, sytë hapur në gjallëri të dhjetëfishuar, veshët pipëz, armët nuk i hiqte nga brezi. Errej e gdhihej i veshur dhe i mbërthyer me dy granata të varura në rripin e mesit. E ndiente që ishte i huaj për dheun e kullat e Batinit, ndaj qëndronte në përgjim, e shtrëngonte më fort trupin me armët. Nuk i kishte mabetur asnjë shteg kalimi. «Bafti i zotit, do të qëndroj deri në pikën e fundit!...»

\* \* \*

Për Cen Gozhiten ishte një gëzim i papritur letra që mori prej njërit nga krerët e bandave. Kolë Bibë Miraka i shkruante: «Politika jonë është në ulli me anglezët, kërkohet të qëndrojmë». Ceni atë natë ia shtroi me raki e meze, thumb u bë. Dhe kur bëhej thumb, fliste me vveten, kujtonte rrugën e tij, thoshte: «Ç'pikon, bujurm, të vijë ngado që të vijë, në dashtë nga qelli, në dashtë nga deti, në dashtë nga toka, njëlloj asht. Nuk përbuz Ceni asnjë monedhë, në dashtë të ketë fytyrë mbreti ose mbretëreshe. E ka nuhatur Kolë topalli, ka gjuajtur bukur mirë në shenjë. Edhe pukovnik Stepanit në atë vend i vështron syri. U shembka bota pa inglizin. Ç'dérdëlliste ai plaku Belul në Tiranë, pihej e bëhej xurxull e këndon-te: «Ingliterë, o Ingliterë, e shpon botën me turjelë». Kështu këndonte plaku Belul e italianëve u pëlqente. Thoshin se gjemitë e tyre do t'i mbysnin gjemitë e inglizit. Hë, ku janë? Bornut në hundë qenë për inglizin, i vithisën në fundin e detit. Gëzimi, ashtu si erdhi ashtu edhe iku, Kolë topallit s'i dëgjohej më krisma e pushkës, i iku zëri nga teli. Humbi dhe ky, humbi. Të shkosh mbas të humburnit, asht si me shkue mbas të vdekunit», — thoshte Cen Gozhita dhe u mbyll në vëtmi, nuk i pëlqente të fliste me asnjeri. Ishte kthyer në një bishë që s'di të dalë nga kurthi që i kanë ngritur. Afër kullës ku qëndronte në

Batin Cen Gozhita disa ditë më parë erdhën grumbull nga të Ballit. Ishin mbi njëzet veta, vinin nga skaji më në jug të Shqipërisë. Cen Gozhita as e përfilli dukjen e tyre, veç njëri, një kapter i dhjamosur, i fryrë si vozë djathë, gjeti shteg të takohej me Cenin. Të tjerët i përzuri. «Ikni, thyeni qafën», — u tha. Kapter Idriz Pleshtani ishte i gojës. Ai në takimet me Cenin u tregua i matur.

— A s'ban me më tregue diçka ma tepër? — e shpoi Ceni i nxitur nga fjala që i kishte thënë pukovnik Stepani.

Idrizi natën e parë s'bëri zë. Ai e nguliti vështrimin në një pikë të vetme, në fundin e odës dhe heshti. Heshti aq gjatë sa Cen Gozhita mendoi se s'kishte përsë të priste nga ajo gojë bullafiqi një lajm për të qenë. «Ky di vetëm të hajë e të gérhasë si nji thi posterve», — tha Ceni me vete. Idrizi e dinte që Ceni ende dyshonte. Papritmas bullafiqi filloj të fliste. Major Ceni u bë sy e veshë. Ai që kishte menduar se ishte memec nisi ligjërimin.

— Nga rakia i ke këto fjalë, lum miku? — i tha Ceni.

— Nga rakia! Përse nga rakia? Unë isha aty...

Ai pak nga pak gjeti çelësin dhe hyri në zemrën e Cenit, u ul këmbëkryq dhe e ngazëllente zemrën e pikëlluar. Cen Gozhitës iu gjallëruan shpresat. Pa shtigje të reja nga mund të shkonte. «T'i ngrys këto ditë dosido, — tha me vete, — pastaj, siç dëgjoj, do duket këndej inglizi... Si s'po del në telefon ky Kolë topalli? A asht gjallë apo ka dekë?... Kurrgja s'paska dit dhe pukovnik Stepani, me vue Ceni yllë në kapën e oficerit. Bah, kjo asht punë që s'bahet. Kurrgja s'ditka pukovnik Stepani. Inglizi e vërtit botën, inglizi... Thanë italianët për detin Mesdhe: «Nostri mare! Nostri mare!» Ku janë vithisen në fund të detit. Mbretëresha e detit mbetet mbretëreshë e detit. Diçka dinë ai plaku Belul në Tiranë që i këndonte këngën inglizit».

— E njoh plakun Belul, e njoh, — tha Idriz Pleshtani. Ishte një çelës i përbashkët për të dy.

Një lajm ua ndërpren bisedën, u tha se pritej sulm nga partizanët. U gdhi në pozicion Cen Gozhita. Sulmi i partizanëve u bë në drejtime të tjera, Batini u la në hesh-tje.

— Një ditë do na e hedhin mirë lakun në qafë, s'na ngucin, po qafën në lakun e tyne e kemi, — tha Ceni.

— Përse nuk zbrisni në qytet? Ndryshe në qytet, — tha Idriz Pleshtani.

— S'do kolonel Vilenbergu, na ngujoj këtu. «Keni me la gjynahet!», thotë.

Çdo mbrëmje mbyllej në kullë dhe i thoshte ordinancës:

— Ma thirr Idriz Pleshtanin.

Bisedonin kokë më kokë. Pyeste Ceni:

— Kur ikët nga Jugu, i pe inglizët? — Këtë pyetje ia bënte thuajse çdo natë dhe Idriz Pleshtani përgjigjej:

— Siç shoh shishen e rakisë që kemi përpara.

— Heu, — thoshte Ceni, edhe i gjëzuar edhe i trembur. — Më thuej pash zotin, më thuej?

Idriz Pleshtani e niste nga e para tregimin e tij përanglezët:

— Kur po iknim në kolonë me gjermanët, anglezët na goditën me top.

— Njimend? Ku? Ku? Në det ishin inglizët?

— Jo, kishin zbritur në tokë.

— Edhe topat në tokë i kishte nxjerrë inglizi? — pyeste Cen Gozhita.

— Nga toka bubullinin topat, erdhën predhat breshër, u binin gjermanëve, për pak na varrosën në dhé.

— Hë, ata do kjo farë dreqi e kuqe që s'mbeti vend pa u ndezur. Inglizi u vjen hakut këtyne. — Në sytë e mendjes të Cenit u ndez fytyra e një krali tjetër, me atë Cenit i dukej se mund t'i shkonin më mirë punët. Ai e ndiente veten krejt të veçantë nga balta e njerëzit ku jetonte, ishte i përngjitur me të huajin, jashtë saj s'mund të qëndronte. Gjer vonë natën bisedonte me ballistik Idriz Peshtani dhe ditën tjetër, sa po takoheshin, Ceni e pyeste:

— I pe me sytë e tu inglizët?

— I pashë kur dolën nga deti në tokë... E goditi artilleria e tyre bregun gjer nxori ujë.

— Këta s'thonë gjë, heshtin, — tha Cen Gozhita për gjermanët.

— Orën e vdekjes askush s'ka dëshirë ta tregojë.

— Bash mirë je ka thue, ashtu asht.

Kapter Idriz Pleshtani, si një fallxheshë me përvojë, qdo ditë e ushqente me diçka Cenin. Filloi të thurte vetë, mjaft që ato t'i pëlqenin Cenit me shtat e fytyrë të madhe. Ceni tani po jetonte me shpresë që anglezët do të vinin sa më parë në Shqipëri. Ku ta dinte Idriz Pleshtani që padashur po i sillte vërvetes rrezikun.

— Dëgjo këtu, fjalët unë e ti i dimë. Asnjë tjetri mos ia thuej? Kujdes se dëgjon ai zebi dhe na përlau...

— Kështu i thoshte Ceni kolonel Vilenbergut, kështu u thoshin edhe njerëzit e tij nën oficerëve esesë që kishte në qdo togë të bandës.

— Kush, kush? — e pyeste Idriz Pleshtani i trembur.

— Kolonel Vilenbergu, mozomakeq, me ba me ditë që...

— Jo, jo! — e siguroi Idrizi dhe shtrëngoi buzët midis pëllëmbës së dorës. — Një kapiten të esesëve e kërkonte ta takonte, me anën e tij mund të boritej më tepër në drejtëm të Cen Gozhitës. Idrizi hidhte hapin më tutje. Njëherë Ceni i tha se, kur e kishin thirrur bashkë me kapitenin anglez në një takim me të në një kullë buzë Drinat, nuk kishte mundur të shkonte në atë takim dhe i kishët imbetur peng. Krismat e pushkëve të brigadës partizane i kishte trembur të dy; kapiteni anglez dhe Ceni ishin kthyer në rrugë. Ishte shpresa e madhe që syri i Cenit të shihte më larg, mendja e tij të kthjellohej dhe veshi të kapte qdo zë. Ai ngaherë e sillte fjalën tek anglezët:

— Në Sarandë u duk një gjeneral, kishte dhe një qen me vete, — tha Idrizi.

— A? — shprehu habi Ceni. — Fol, fol!

— Qeni kishte vetullën e ballin si të gjeneralit, thue se ishin vëllezër.

— Ku i shkon mendja inglizit, gjenerali i ve vetull qenit.

Idrizi nuk i tregoi Cenit që gjeneralit të inglizit partizanët, i kthyen tytën e pushkës dhe ai iku në det.

Dëgjuan një luftim të largët... Diku tej kodrave nga

ana e Deçanit dy brigada partizane, njëra prej tyre e Kosovës, kishin sulmuar. Andej gjëmonte lufta...

— Rojat, këqyrni rojat, — i thirri Ceni adjutantit të tij. — Thirri ata derrat e porositi të kenë kujdes.

Idriz Pleshtani që ditën që u struk në bandën e Cenit në Prizren iu duk se gjeti strehë që të mos lagej nga furtuna, por u gabua. Cen Gozhita e mori me vete. Bandën e Cen Gozhitës kolonel Vilenbergu e detyroi të qëndronte në fshatin Batin, në një vend me rrezik. Idriz Pleshtani qëndroi përkrah me major Cen Gozhitën. Një natë Cen Gozhita i tha:

— A po ve shenjat e esesit, si trupat e mia.

— E pse jo, — tha Idriz Pleshtani dhe ditën e nesërme ai doli i veshur me tesha të tjera dhe me shenja esesi.

— Qe ashtu asht ma mirë, — tha Cen Gozhita, i kënaqur. Dhe sérish e pyeti: — Inglizi kral mbi krala ka me dalë, qindin ka me u punue komunistave... Heu, pukovnik Stepani kurrgja s'paska ditë. Me të tjerët dhe ai, në dreq të shkojë...

Nisma e luftimeve për të asgjësuar ushtarët hitlerianë dhe banditët e Cen Gozhitës në Batin filloj përparrë mëngjesit, një ditë mbas goditjeve që iu bë kolonave me ushtarë në kalim në Deçan dhe bregdrinit. Në orët e para të asaj dite moti bëri edhe më keq. Frynte një erë e furishme. Dukej sikur shfrynin mushkëritë e mëdha të Alpeve që e habisnin njeriun me madhështinë e tyre. Lartësinë mbi fshat ku ishin vendosur esesët e kolonel Vilenbergut e morën me sulmin e parë. Befasia na ndihmoi ta merrnim atë pa u démtuar. Aty zumë edhe disa robër. Dardan Velishta na thirri:

— Drejtim kullave, përparrë!

Skuadra jonë u sul drejt një are, pastaj u ndal te një ledh, rrëshqiti dhe doli afër përballë një kulle. Unë dhe Dinoja zumë vend te cepi i kullës. Aty prisnim. Rastësishët më shkoi vështrimi te një letër e shkruar me ma-

kinë. Ishte një thirrje që u drejtohej esesëve të Cen Gozhitës. Si duket atyre që ishin brenda nuk u është dashur kjo thirrje, ndaj e kanë flakur. U kishte rënë në dorë thirrja e shtabit partizan për t'i braktisur radhët e armikut, por mendja e tyre ishte e farmakosur rëndë dhe të vërtetëtë e kuptuan me mundim. Në krismat e para të armëve tona dy nga ata që ishin brenda brofën te dera. Njëri bërtiti dhe doli te dera me sy të gatallisur. Aty, si të donte ta mbushte edhe më shumë krismën e armës, i dha një e nga një në grykë patikës të gjashtë fishekët dhe, si ngjeshi më fort në kokë kapelen ushtarake me shenja esesi, mori vrapin të dilte. Ishte çasti kur kullat zbrazen. Por hovin që mori ia preu flaka e automatikut të Dinos që kishte zënë qoshen e kullës.

Goxho Bërdëllima e vuri në syrin e pushkës një tjetër dhe pas krismës ai e humbi ekuilibrin, ra përbys, shtrëngonte baltën me gishtat e duarve, donte të shuan-te dhimbjen.

— Hë, ngordh aty, ngordh! — i foli. — S'ka varr Kosova për ty, he dreq.

Esesi ktheu vështrimin të shihte njeriun që iu gjend pranë; sytë e tij imbetën hapët, si të ngrirë...

— Përpara, partizanë! — ishte zëri i Bukuries. Eci përpara edhe Goxhoja me mendjen pas.

— Është goditur ai bullafiq apo mos ma kaloi nën rrogoz? — tha Goxhoja dhe u kthye. Ai e ndjeu hapin dhe brofi të ikte.

— Ndalo!

— Iku, po na ikën një bullafiq, — thirri Goxho Bërdëllima dhe ia dha një krismë maliheri. Huq i shkoi plumbi. E ndoqi prapa në gjurmë. Idriz Pleshtani brofi si derr i trembur nga prita. Duke gulçuar, ai i shkoi në grykë të mitralozit Lulos.

— U zu rob...

## XII

Ditë vjeshte. Mbi kurorën e bjeshkës endet një re e e murme. Mollët dhe gështenjat janë plot kokrra, misri eshtë bërë pér t'u vjelë. Grupi i ish-luftëtarëve të brigadave që luftuan në Kosovë në kërkim të vendeve ku kemi luftuar erdhi në Deçan. Makinat ndalën në xhade. Përballë eshtë një manastir. Ditën që batalioni ynë luttonte në këtë vend, nga ky manastir doli një hije e zezë, një pop me zhgun të zi.

— Ju kujtohet popi? — tha Skifteri. — E mbaj mend mirë atë ngjarje, ja aty te porta donte të dilte, pér pak na iku. Ishim të lodhur nga përleshjet në kodrat e Vokshit e në Deçan, tri brigada prunë forca në këto luftime, njëra brigadë ishte e Kosovës. Mbas luftimeve të paprera, të dy palët ndërluftuese qëndronin ballas njëri-tjetrit, këmbehej zjarri i armëve. S'mund të harrohet nga partizanët e kompanisë ajo që ndodhi kur hymë në ndërtuesat e manastirit.

«— Kapeni atë, mos i besoni atij, — thirri nipi i mi-  
xhës Shpend, Hazir Përdrini. U desh të kollitej dhjetësh-  
ja e Dardanit që të dorëzohej «popi» me zhgun të zi.

— Hëm, — ia bëri Luloja, — nën veladonin e popit  
fshihet djalli. — Ishte një kapiten eses i zbulimit... Çdo gjë  
është fshehur nën zhgunin e zi të këtyre njerëzve të «zo-  
tit» gjer te gradat që kanë mbajtur pukovnik i kralit, ko-  
lonel i Duçes, kolonel... Atë ditë pop Josifi endej përreth,  
kërkonte të dinte për kapitenin eses.

Manastirin thuhet se e ndërttoi në car, njerëzit që e  
vizitojnë atë janë: carë, mbretër, kryeministra, princër,  
gjeneralë, dhespotë. Të zotët e vendit nuk hyjnë në këtë  
vend.

— Ka erë mbytëse, nuk qëndrohet këtu, — tha Lulo  
Driza, posa hymë ne partizanët në sallonin verbues të  
manastirit. Bukuria vrapoi të dilte jashtë si njeriu që ka  
hyrë papritur në një dhomë me gaz helmues dhe turret  
të dalë në ajër të pastër. Çdo gjë vjen nga mesjeta dhe  
është ndërtuar në atë mënyrë që të peshojë sa më rëndë  
mbi mendjet e njerëzve, ashtu siç shtyp thundra e he-  
kurt e ushtarit të kralëve.

Këtu kanë pushuar mbretër, princër, kryeministra,  
peshkopë, diplomatë. I gjatë vargu i tyre. Dhe popi me  
emrin Josif zuri të na tregonte bukuritë e sallës. Fliste  
me ne e shante me zë të brendshëm kapitenin e esesëve.  
Nuk dyshoi. «Ai ka për të heshtur si varri», — tha me vete.

— Shkëlqim i rremë, — murmuriti Lulo Driza, në dal-  
je të derës, — floririn asnjëherë nuk e nxjerrin priftéri-  
njtë...

— Këto janë firma princësh, gjeneralësh, dhespotësh,  
— tha popi.

— Edhe ne, uratë, biem firmën tonë, firmon pushka  
jonë partizane, nën flakën e saj shihet fundi i errësirës, —  
tha Dardani. Popit i brodhën sytë lajkatarë, i bëri rrugë  
fjalës së atij që shitu me pushkë mbi kapitenin e esesë-  
ve, po Dardani s'pranoi të ecte fjala atij shtegu e tha:

— Të zotët e këtij trualli e kanë quajtur ofezë të he-  
dhin firmat. Ata, me djersën e tyre, uratë duke punuar  
tokën, i ruajtën rrënjet të thella, mbetën gjithnjë e më

të rëndë në truallin e tyre. — Popi heshti. Kapiteni nuk i shpëtoi plumbit të këtij partizani. Popi Josif nuk i bëri dot dredha fjalës së Dardanit. Ndjeu frikë nga prania e Dardanit, njeriut me yll në kapele, fjalët e të cilit, si plumbat e pushkës, vrisnin në të njëjtën shenjë».

\* \* \*

Nata e gjatë dimërore nuk e ka trullo sur kosovarin. Ai, edhe kur të duket se hapin e hedh ngadalë, vrullin në ecje ai e ruan për ditët me orteqe... Kur bisedon me kosovarin, të thotë: «Minarja e gjen shpresën në qiell, plori i plugut e kërkon në tokë.» Ky mendim i ka shtyrë thellë rrënjet e jetës në zemër të dheut.

Kosovarin mbas një kohe të gjatë që erdhëm këtu e shohim që lufton për të çuar edhe në viset më të thella shkollën amtare. Popët e hoxhallarët e priftërinjtë thonë: «O zot, a s'po e sheh se këta të pafe po na e prishin dynjanë!...» Jeta degëzon rrënjetë në thellësi të dheut. Të besuarit e Krishtit e të Muhametit, të egërsuar, duan t'i bëjnë ballë vëershimit të shkollës, endin rrjetin e merimangës, si kjo që ndeshim këtu, në kodrat e bukurat e Smaçit. Ky fshat në ditët e luftës u dogj. Aty u zhvilluan lufte të ashpra. Aty i kërkojmë gjurmët e një kishe të vjetër, se në afërsi të saj qenë varrosur tre luftëtarë të brigadave tonë.

Kaloi në rrugë një prift me veladon. M'u kujtua zhguni i zi i «pop» Josifit që doli nga manastiri i Deçanit. Nën veladonin e tij fshihej esesi. Shoqëruesi që nuk e di shqipen, mburret, flet në gjuhën e tij:

— Këtu në Smaç është duke u ndërtuar një kishë e madhe. — Ai krenohet që aty ndërtohet një kishë, kurse neve na kujtohen vitet e shkuara, kisha e Deçanit, njeriu i veshur me zhgun të zi. Ç'ndryshim ka njeriu i sotëm me zhgun të zi me atë të djeshmin? Më tutje, papritmas, nde-

shi vështrimi ynë në bregun piktoresk, ku ndërtohej pallati i lartë «shtëpia e zotit».

Hijet e zeza përpinqen të hedhin rrënje dhe të lëshojnë degë ... Ato e mbajnë vështrimin larg, në skutat e errëta, kurse kosovari mendon e lufton për ta mbajtur fort e për ta punuar thellë tokën stërgjyshore, për të ngritur sa më shumë shkolla amtare, për të sotmen e të nesërmen e tij.

Në vargëzimin e kodrave të Smaçit kërkojmë pika nga gjaku ynë. Kaloi afér njeriu me veladon të zi dhe vuri dorën para syve.

Drita e kuqe e arkivoleve ia errësoi pamjen, ia topiti mendimin....



Batini mbeti zonë e lirë. Të gjitha sulmet e armikut u thyen dhe ne, herë mbas here, që nga Batini niseshim për të sulmuar. Në mbledhjen e batalionit që bëmë fill mbas luftimeve të fundit, zëvendëskomisari i brigadës, Argjir Progri, lavdëroi veprimet e batalionit tonë. Ajo hije që kishte mbetur nga mbledhja e parë në batalion për kompaninë tonë dhe në veganti për komendantin e saj, Dardan Velishtën, u shua aty ku lindi. Gjysma e mercenarëve të Cen Gozhitës u dorëzua në saje të guximit të kompanisë e të veprimeve taktike të matura të Dardanit. Argjir Progri e përgëzoj komendantin e kompanisë. Ishte një gjëzim për të gjithë. Dardanit, njëloj, ashtu si edhe herën e parë, iu mbush balli më djersë. U bëra gati. Iu afrova që t'i shtrëngjoja dorën, por s'munda, nuk më la zëri i Pilos, një partizan i një kompanie tjeter. Ai i pezmatuar me dy-tri fjalë që nxori e gremisi gjëzimin tonë e tha:

— Të çohet këtu, të flasë para batalionit shoku Goxho Bërdëllima se veprimi që kreu ai nuk i ka hije një partizani.

— Si është puna? — e pyeti Pilon zëvendëskomisari i

brigadës. Ai e ndoqi me interes mbledhjen tonë, qortonte kur duhej, hetonte çdo gjë, mbante shënimë.

— Goxho Bërdëllima diçka ka bërë. Një proçkë që s'lejohet. Po ngatërrohet keq filli i skuadrës sonë, — më tha Luloja.

U bë qetësi. Batalioni përqendroi vështrimin te Piloja, po ai s'po fliste. Mënyra si e vështroi Argjir Progri e nxiti Pilon të fliste. Pasi e drejtoi vështrimin te Goxhoja që ishte hequr pak anash të tjerëve, i mbështetur te një gur, lëvizi duart, përpiquej të zgjidhte grykën e një çante, po i dridhej dora. Nuk besoja që Goxho Bërdëllima do ta bënte një gabim që të arrinte të gjykohej para batalionit. Ndoshta ishte një keqkuptim, ç'gabim kishte bërë xha Goxhoja? Pilos i erdhi keq të fliste kundër Goxhos dhe tha:

— Le të flasë vetë! — Kaq tha Piloja dhe u ul në tokë.

— Mos kérce si mëzi përpëra pelës, prit, djalo, merre me ngadalë, — foli që nga vendi Goxhoja dhe heshti. Piloja u pezmatua, nuk mund të heshtte, foli:

— Kur e zura xhandarin që po ikte me vrap...

— Nuk ishte xhandar, por kapter, — e ndërpren i inatosur Goxho Bërdëllima, — nuk e zure vetëm ti, atë e zuminë bashkë.

— Mos ma ngisni, ky më ra në pjesë, mos, thoshte sa herë dëgjonte afër krismat e armëve tona. Dhe humbi nënëkrisma, nga shkoi e ç'bëri, s'di ç'të them, mbapse edhe andej ka bërë ndonjë gjë.

— Bëra një top prej gorrice, nuk e pe? — Piloja u skuq në fytyrë.

— Lëre të flasë, lëre, xha Goxho, — i tha zëvendës-komisari i brigadës.

— Ç'do të thotë, s'e katandis veten Goxhoja të gjykohet para batalionit. — Ju drejtua Pilos: — Hë, nxirre llafin, ç'do të thuash, biri im?

— A vritet robi pa gjyq? — pyeti Piloja.

— Oj, ç'po thotë ky djalë? Për kapter Idriz Pleshtanin e ke fjalën? Apo për ndonjë tjetër? — e pyeti dhe veshin e mbajti në përgjim që ta dëgjonte kritikën që i bëhej.

Përséri mundohej tē hapse cantën prej lëkure. — Hë, dreq, hë, pse s'po hapes? — murmuriste. Mundohej ta zgjidhte e filli i ngatérrohej më tepér.

— Pse hesht? Le tē flasë Goxhoja, duhet ta dëgjojmë, — thanë disa.

Goxhoja e ktheu kokën mënjanë, s'donte t'i dëgjonte. Po fjalët s'ishin pér tē mos i dëgjuar. Sytë e Goxhos dhanë zjarrin e zemérimit:

— C'hyri në këto mesele ky Piloja?!... U kërrus mbi cantën, veshin e mbante te fjalët, sytë te gryka e cantës, mundohej ta zgjidhte. Gishterinxjë e duarve i lëvizte me një farë ankthi. Tha: — Uh, c'genka ky Piloja, kujt i bie kështu faqe gjithë batalionit? E pérse? Pér një ballist tē qelbur, pér një spiun tē fëlliçur! — Fjalët i tha me zë tē ulët, por veshi i Pilos i dëgjoi.

— C'rob tjetër mund tē zëmë? — tha Piloja. — Ai ose eses ose ballist eshtë.

— Mos harro xhandarët, Pilo! — tha Dinoja flokëverdhë. Më tepér foli që tē mos ngatérrohej filli i lëmshit. — Goxho Bërdëllima di se ku qëllon, e njeh mirë Goxhon.

— Ashtu eshtë, shoku Dino, por dimë edhe ne.

— Pritmë në fjalë, pritmë djalë, në fjalë, — thirri nga vendi xha Goxhoja. Më bëj pyetje, mandej gjykomë. Duhej t'ia kisha qepur gojën me plumb që atëherë që llomotiste se Italia eshtë shpëtimtarja jonë, s'ka gajle, më mi-rë vonë se kurrë, iu qep se iu qep, ngordhi qeni, ngordhi...

Mundohej tē shtinte dorën në cantë, tē nxirrte andej atë që kërkonte e tē thoshte: «Urdhëroni, i shikoni? C'janë këto? Di tē më thuash c'janë? Njerëz jemi, gjak kemi në trup, s'kemi ujë de! Gabim, e bëra këtë, m'u prish gjaku, e bëra. Ama shikoni këto plaçka që kishte grabitur qeni, dhe gjykomëni». Nxirrte prej cantës brez mëndafshi tē nuseve, vathë dhe unaza floriri. «Të motrave tona janë. E njihja, nga anët tona ishte, një ballist pulash që s'ta pret mendja, një dhelpér që u bë brekë e bythë me një oficer ingliz që erdhi atëherë tek ata tē Ballit. Hëm, edepsëzi, u drodh kur i afrova te goja grykën e dyfekut. Na, i thashë, puthe, ta kam taksur gjysmën e lekut me kohë. Di c'më tha qeni? «Edhe unë, tē tē kisha kapur, s'do ta kur-

seja plumbin. Shtjer!» më tha. Atëherë e humba durimin dhe luajta gishtin. Kaq de.»

— Atë që kërroi e gjeti, — foli një tjetër. Ishte nga fshati i xha Goxhos.

— Idriz Pleshtanin, kurrë nuk e falte gjyqi ynë partizan. Më lehtësove faqe shokëve, se në shpirt s'e ndiej të kem bërë keq, dëgjon?

Batalioni heshti. Vështrimet në drejtim të Goxho Bërdëllimës u bënë më zbutëse...

\*  
\* \* \*

Nga Batini zbritëm në kodrat e Smaçit, mandej, duke ecur buzë Drinit, qëndruam tek ura e gurtë. U mbësh-tetëm në parmakët e saj. Poshtë buçet Drini. Ai vjen drejt urës nëpër një kanal të gurtë e të thellë që për disa metra arrin në një kilometër i gjatë. Drini, ura dhe dy lartësitë anës rrugës na kujtojnë ngjarjet e ditëve të luftës. Sodisim dy lartësitë dhe urën. Atëherë në çdo pëllëmbë vend qëndronte në përgjim një grykë arme e sy të esesë-ve. Jetojmë me të kaluarën dhe të tashmen. Dhe sérish sytë tanë vëzhgojnë rrjedhën e rrëmbyer të lumit.

Drini vjen i bardhë, valët e tij përplasen në këmbët e urës. Është e vëtmja urë që ka lidhur dy anët e njerëzit e quajnë Ura e Shenjtë. Legjenda e saj është e ngjashme me atë të Rozafës. Nëna është ngurosur në murin e këmbës së urës me gjirin jashtë që t'i japë gji fëmijës. Dhe aty thuhet pikon qumësht i bardhë. Nëna kosovare ush-queu jetën dhe e zbardhi ujin e Drinit. Ndoshta nga kjo lumi i mbeti emri Drini i Bardhë.

Dhe prapë sytë tanë nguliten te vendi ku ishin vendosur topat e mëdhenj dhe në kodrat e Smaçit, ku atëherë mblodhëm celulën e kompanisë për aksionin që do të kryenim.

\* \* \*

Dardan Velishta atë mbasdite ecte nëpër pyllin e dendur me dushk. Ai, i ndjekur nga Bukuria, po nxitonte për të arritur në mbledhjen e celulës të partisë.

— Dardan, — i foli Bukuria. Ai ktheu kokën. Bukuries iu ndezën sytë, fytyra i mori flakërimën e njeriut që bën diçka që s'duhet ta bëjë. Ai i vuri dorën mbi sup, nën krahun e Bukuries uli grykën drejt tokës automatiku. Dardani e hoqi dorën si i trembur. Gjeti forcë t'i frenonte ndjenjat që i vëershuan.

Ata ecën në krah të njëri-tjetrit. Dardani i kishte tre-guar asaj legjendën e qumështit të nënës që i dha emrin lumit.

Dardani s'dinte nëse bëri mirë që ia tregoi legjendën Bukuries. Ajo legjendë kishte të bënte me... Piste të fliste Bukuria, ajo nuk nxori zë. Ecën në drejtim të bregut, te bungu i madh i prisnin shokët. Do të bisedohej në mbledhjen e celulës për aksionin.

— Legjendë e bukur, — i tha Bukuria.

— Ah, po, — tha Dardani pak i hutuar. Mendja e tij bluante mendime për luftën. Në celulë çdo komunist jep-te mendimin e vet për problemet që shtroheshin. Dardani po vriste mendjen për aksionin. Ai kishte soditur lartësitë ku ishte vendosur armiku, vendin ku ishin ngulur në pozicion topat e mëdhenj të kolonel Vilenbergut.

— Duhet t'ua mbyllim grykat atyre topave, — tha Dardani në mbledhje të celulës.

— C'ka duhet bërë? — tha Dino Çinoja me sy të ndezur e me flokët e verdhë të rënë mbi vetull.

— Një vend delikat ku mund të kapet e ka edhe djalili, — tha xha Goxhoja. Në mbledhje të komunistëve ishin thirrur edhe disa luftëtarë. Bukuria dy-tri herë mendoi të merrte fjalën dhe nuk e mori, ajo bluante në kokë legjendën. Përfytyronte tre vëllezërit dhe i vogli, ai që sakrifikoi dashurinë, i dukej më i forti. Njeriu pa forcë s'i bën dot ballë jetës. «Shqiptari trojet e veta i ka ujitur me

qumështin e nënës, me gjakun e vet... Të dyja bashkë ia ka dhënë Shqipërisë, tokës së vet, qumështin edhe gjakun,» — mendoi Bukuria.

■

\* \* \*

Ishët natë. Lajmëruam shoku-shokun me zë të ulët, u zvarritëm këmbadoras në drejtim të urës. Rrëshqitëm barkas me gishtin në këmbëzën e pushkës. Një rrëshqitje si kjo, e gjatë, deri në afërsi të pozicionit armik, sa hedh plumbin paticka, ishte e vështirë të kryhej pa u dëgjuar një zhurmë, zë njeriu qoftë, krismë metali apo trokitje guri. Asgjë s'ndodhi. Më tej ishte e pamundur të ecnim, sepse esesët te këmba e urës mund të dëgjonin frysma-rrjen tonë të rënduar nga lodhja. Komandanti i kompanisë, kur u nisëm, na tha:

— Në qoftë se ju duket e pamundur të ruajmë fsheh-tësinë gjer te këmba e urës, më mirë të mos shkojmë në sulm. — E kishte bërë mirë llogarinë Dardani. E njihte vendin dhe ua njihte djallëzitë esesëve. Një çast u gozduam në vend. Një mitraloz te këmba e urës e preu rreshtin tonë me plumbat dhe i vuri në pozicion luftimi ese-sët.

— Atë... atë..., — fjalën nuk e mbaroi zëvendëskomisiari i brigadës, Argjiri. I shkathët si një ketë u hodh përpëra dhe kompania eci mbas gjurmëve të tij. Papritur ndeshëm në trupin e njërit nga ata që provuan të kalojnë urën, të tjerët u zmbrapsën... Ura ndriçohej nga bunkeri i madh me drita të fuqishme. Ishte bunkeri ku koloneli i esesëve shtroi planin e tij «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe».

— Atë duhet ta vrashim, mjaft lehu ai. E shikoni që po na rrëmben jetën e shokëve? — tha Argjir Progri. Për cilin e kishte fjalën Argjiri, për mitralozin apo për bunkerin e kolonel Vilenbergut.

Dino Çinoja rrasi flokët e shpupuritura në kapele dhe e mori në shenjë, qëlloi frëngjinë e bunkerit me një

breshëri të shkurtër automatiku. Në këtë kohë zëvendës-komisari i brigadës u hodh në anën tjetër të xhadesë dhe u gjend më pranë bunkerit. U zvarrit këmbadorazi në drejtim të bunkerit të madh ndanë urës. Një gjëmim i shurdhët, një flakë verbuese u bë. Bunkeri heshti. Krismat e mitralozave përballë u gjallëruan edhe më shumë. Një nga tanët, Ago Ymeri, mbeti në vend pa ndjenja. E përplasi përtokë afshi i gjëmimit dhe s'po përmendej.

Krismat e armëve buçiten. Ato po i përcillnin valët e rrëmbyera të Drinit të Bardhë.

Një hap më tutje ishte ura e gurtë, poshtë dallgët e Drinit përplaseshin në faqet e shkëmbit dhe në këmbët e urës.

— Argjir! Shoku Argjir! — i foli dikush nga tanët zë-vendëskomisarit të brigadës. Gryka e thellë përplasi zërin me një jehonë të zgjatur. Zëri humbi në oshëtimën e parerë të krismave. — Argjir! Shoku Argjir! — u dëgjuai zë disa herë të tjera. Ku shkoi? Menduam se u vra, na ushtuan veshët, në atë çast dëgjuam zërin e tij të thekshëm: «Përpara, shokë, përpara!»

Shkuam më përpara, i kapërcyem telat përpara urës. Heroizmi çau rrugën...

Një gjëmim tjetër tronditës, kësaj here më afër.

Duhet guxim... Në vrullin që mori na u duk se zëvendëskomisari i brigadës fluturoi tutje, por në ecje e pamë që e përfshiu flaka.

— Mina! Kujdes, vendi është i minuar, — lajmëroi Argjir Progri. Është plagosur dhe i duron dhimbjet e, që të shpëtojnë shokët, thérret: «Kujdes, minat!...»

Afër tij një tjetër partizan i plagosur. U mundova ta ndihmoja. Ishte Ago Ymeri. Më foli me zë të prerë:

— Ecni përpara, përpara!

\*

\*

\*

Urën e kapërcyem nën vëzhgimin e syrit të qikllopit, kështu e quanim projektorin që shndriste nga frëngjia e bunkerit të madh ku ditën kolonel Vilenbergu shtrinte

hartat dhe planet e tij të luftës për të zbrazur sulmet e brigadave partizane. Kur kompania jonë kaloi mbi urë, mitralozat nga bregu në anën tjetër të Drinit vollën zjarr. Lartësia në anën tjetër të Drinit kishte nxjerrë grykat e armëve si derri i egër që nxjerr noçkën përpëra dhe kercëllin dhëmbët. Dardani u hodh dhe zuri vend. Sipër llogoreve të bregut dukej tyta e topit të madh dhe sfondi i qiellit të errët. Lartësia ishte mbuluar nga pozicionet. Dardani mundohej të deshifronte çdo veprim të armikut, të zbulonte shkaqet. Edhe në çaste si këto, në situata tepër të ndërlikuara dhe me të papritura të befasishme Dardani shihte qartë dhe orientohej shpejt.

— Shotë! Shotë! — foli Dardani. — Kujdes urën, kujdes urën, — dhe vrapi në drejtim të llogoreve. Projektori hodi dritë mbi urën dhe mbi formacionin luftarak të kompanisë.

\* \* \*

Skuadra jonë ishte ngarkuar që të siguronte urën nga çdo e papritur dhe të ngjitej sipër në lartësi, aty ku ishte vendosur topi. Me pjesën e skuadrës që zuri pozicion te këmba e urës, qëndroi edhe Bukuria. Aty erdhi edhe një partizan me pushkë kundërtank.

— Duhet të bëjmë kujdes, — porositi shokët Bukuria, — të ruash, urën do të thotë të shpëtosh kompaninë nga një rrezik i madh. — Kompania ishte përfshirë në luftime të ashpra. Bukuria dëgjoi zëra, dalloi zërin e Dardanit.

— Kujdes, Shotë, kujdes urën! — i tha Dardani dhe iku.

Mund të vinin tanket dhe ta bllokoni urën, atëherë kompania mbetej e rrrethuar. Ky ishte një rrezik që mbe-tej nga çasti në çast si një teh shpate mbi jetën e shokëve. Kundër tankeve ata kishin një pushkë kundërtanke dhe granatat. Tanket mund të vinin nga Prizreni, por qyteti ishte larg. Mandej dy nga partizanët e kompanisë xheniere te bërryli i rrugës vendosën disa mina kundërt-

tanke. Secili mendonte për të mbrojtur urën. I vetmi shteg nga mund të tërhiqeje kompania ishte ura. Bukuria endej nëpër pozicionet e shokëve, fjala e Dardanit: «Shotë, kujdes urën!» — i buçiste në vesh. Dëgjoi afër një breshiéri mitralozi. E njohu, ishte mitralozi i Lulos.

— Ç'është, Lulo? — pyeti Bukuria.

Një togë ushtarësh e nënrepartit që mbronte vaun e lumit, dy kilometra më poshtë, vinte anës së Drinit me synim të mbyllte shtegun tek ura. Bukuria kuptoi që ajo që u ishte besuar shokëve të saj ishte më e rëndësishme nga sa kishte menduar. Esesët te lartësia e kuptuan që ushtarët që vinin anës së lumit s'do të arrinin tek ura, ndaj dy prej tyre dolën nga bunkeri i madh dhe këmbadorazi zbritën breglumit. Bukuria i pa dhe i qëlloi. Ata mbetën në vend si dy njolla të zeza.

Një breshëri e granatave shpërtheu në llogore, u dëgjua zëri i Dardanit.

— Kujdes, Shotë!

Ajo, e trembur, hodhi vështrimin përreth. Nga duhej të tregonte më tepër kujdes? I hodhi sytë te kufomat e dy ushtarëve esesë. Aty ishte vetëm njëri. Ku shkoi tjetri? Mos syri i Dardanit e kishte vëzhguar lëvizjen e atij ushtari dhe foli? Ndoshëta! U shkund nga dremitja e hutimit të plumbave dhe ja, e dalloi siluetën e esesit që rrëshqiti anës së Drinit. Dardani me një pjesë të kompanisë vrapoi në drejtim të projektorit. Bukuria zuri vend te parmaku i urës dhe përgjoi. Ushtari eci anës së lumit. Bukuria e futi në shënjestër të automatikut. Një çast asaj esesi i doli nga shënjestra. Sytë iu gjallëruan, veshët i vuri në përgjim. Asgjë nuk shikonte, dallgët e Drinit godisnin me forcë këmbën e urës.

— Ku shkoi? — murmuriti ajo.

\* \* \*

Bukuria mbeti aty, afër valës së Drinit. Hija e zezë që kishte parë anës së lumit humbi si ta kishte përpire dheu. U pezmatua, për pak desh lëvizi nga vendi. Atë ko-

hë Dardani lëshoi në drejtim të qiellit shenjëzën ndriçuese. Ajo hodhi dritë mbi këmbëzën e urës. Sytë e Bukuries dalluan ushtarin me uniformë të murme. Ai diçka bënte. Ç'po bënte ai? E mori në shenjë, por nuk e tërhoqi këmbëzën e automatikut. Ajo ishte e përbajtur në veprime, e kujdeshme në çdo hap që hidhte. Ç'bënte esesi të këmba e urës? Ah, ai rregullonte telat, vinte në dinamit fitilat... Donte të hidhte në erë urën. Ç'egërsirë! Përse e hidhte në erë urën? Kolonel Vilenbergu i kishte parashikuar të gjitha veprimet tonë të mundshme, ai kishte menduar që kalimin në urë ta mbronte me zjarr të mitralozave, por tanë që kompania jonë kishte kapërcyer Drinin, duhej të hidhte në erë urën, të mbyllte kurthin dhe të mbeteshim midis tytave të armëve dhe lumit të rrëmbyeshëm.

— Kurth, — murmuriti Bukuria e trembur. Përfytyroi rrezikun që i kërcënohej kompanisë. Ishte një nga kurthet e ngritura nga koloneli i divizionit të esesëve, një nga ato nepërka lëvizte për të shkrehur çarkun, prandaj u hodh me rrëmbim. Zbriti nën këmbët e urës. Aty errësira ishte më e madhe. Ajo priti aty, mundohej të kapte ndonjë lëvizje, por dallga e Drinit që përplasej me tërbim shtuposte veshët, kurse errësira e thellë nuk e lejonte të kapte asnjë lëvizje. Qëndroi në përgjim.

Një shenjë tjetër e Dardanit arriti mbi dyshemenë e urës dhe ujët e dallgëzuar të Drinit. Bukuria jetonte me legjendën dhe ëndrrën e jetës, kurse ai ushtari me uniformë të murme me vdekjen... Ishin pranë e pranë ushtari dhe partizania, jeta dhe vdekja... Dëgjoi zë:

— Bukurie! Bukurie! — i folën shokët e skuadrës. Ajo e kishte në shenjestër esesin që po bëhej gati të ndizte fitilin. Dëgjoi zërin e shokëve të skuadrës. Nuk foli.

— S'ke për ta bërë kurrë atë që mendon, hej mace e murme..., ja ku po ta them që s'ke për ta hedhur në erë as qumështin e nënës shqiptare, as gjakun e bijve të kësaj toke!... — tha ajo dhe ia hoqi këmbëzën automatikut.

Esesit i ranë fitilat nga duart... Një njollë e zezë ra poshtë, bëlldum bëri dhe e përpinë valët.

\*

...Natën, te bunkerit i madh, projektori si një sy qikllopi dilte pérherë në përgjim. Ishte syri i kolonel Vilenbergut. Ditën ky sy binte në gjumë, bënte gjumin e gjatë të gjarprit, se koloneli ditën e vështronte horizontin me tejkëqyrësen e topit të madh. Edhe syri i qikllorit, edhe topi ishin ngulur në një vend.

Dardan Velishta, kur arriti në afërsi të bunkerit, vuuri dorën mbi ballin e gjerë. E verboi drita. Rrëshqiti këmbadorazi. Në vendin ku ishte vendosur projektori shpërthyen granatat. U shua një dritë, por u ndez një tjetër. Një kolonë e motorizuar, e dërguar nga Prizreni, vjen në drejtim të urës.

— Duhet të tërhiqemi. — Dardani e kuptoi që partizanëve nuk u erdhi mirë të tërhiqeshin. Murmuriti: «Megjithatë duhet...» — thirri Dardani. —

— Lajmëro shokët e skuadrës dhe tërhiquni, duhet ta kalojmë urën më parë se të arrijnë tanket.

Filloi tërheqja, kaluan forcat përsëri në anën tjetër të Drinit. Ne, disa partizanë, të tjerë me Dino Çinon që ishim afër topit, ende nuk e kishim marrë urdhrin pëtérheqje...

Gjuha e kolonelit eses Vilenberg (kështu e quanin topin e madh), kur luftimet bëheshin në afërsi, heshtte, po arma e rëndë, si një fantazmë, qëndronte aty e mbërthyer në shkëmb. Pamjen e tij është vështirë ta përshkruash, topi qëndronte te lartësia si një guak, kurse esesët nëpër bunker luftonin.

— Si dreqin e ngjitën këtë fantazmë në këta shkëmbinj, — tha Dinoja. Thuhej që ushtarët vetëm sa çelen rrugën, se topin e tërhoqën dymbëdhjetë pendë buaj Kosove, ata, me forcën e tyre përbindëshin e ngjitën gjer aty. Në të vërtetë atë e ngjitën disa traktorë, mbërthyen shtratin e tij për shkëmbi me çimento. Dha urdhër koloneli i esesëve: «Nuk do të lëvizin prej vendi as ushtarët dhe as topi edhe sikur kjo lartësi të shembet e të bjerë në Drin».

Kur zbrazej topi e kur binte predha, toka dridhej. Top deti, thuhej, top që me një predhë fundos vaporin. Ka forcë njeriu që ta durojë predhën gjëmëmadhe. M'u kujtuan fjalët që tha mixha Shpend kur topi qëlloi me predha kullat e Batinit. «I rrren mendja kralët, i besojnë më tepër topit se zemrës. Harrojnë se topi më i madh në botë asht atdhedashuria. Lakmia për ta sundue botën i çon drejt vorrit kralët dhe ushtritë e tyne...»

Nodheshim ballë për ballë topi dhe ne. Kush do ta gjunjëzojë njëri-tjetrin? Erdhi urdhri të têrhiqemi.

— Si, si? — tha i habitur Dinoja. — Të têrhiqemi? Këtë grykëziun që duket si një gojë lubie këtu ta lëmë? Hë de, më thuaj, ta lëmë? — Nuk i thashë as po, as jo. Derisa i vumë në heshtje pozicionet e esesëve te lartësia, duhet të têrhiqemi, shenja e têrheqjes ishte dhënë. — E shikoni atë top? — Dinoja nderi dorën drejt grykës së topit. U dëgjua grahma e topit, gjëmimi shurdhues.

— Hajde top që nxore, o t'u mbylltë, jerman katili, hajde! — foli Goxho Bërdëllima dhe kapelja iiku nga koka. — Bah, ç'zë nxjerr, o t'u mbylltë?! Pandeh jermani se, duke na goditur me top të madh, do t'ia lirojmë lakun? Të gënjen mendja, o jerman ditëziu. Pritna, qen bir qeni! Pritna, se deri në Berlin do të ta hamë hallvén!...

— Duhet të têrhiqemi, — i thashë Dinos, — i shikon autoblindat e tanket? — Ai s'priti, fup, si çakmaku, ndezi.

— Trupi ka një krye, ne këtu një komendant, dëgjon, shoku Agim? Më ndiqni prapa, — foli dhe mori drejtimin nga vendi ku zbrazej topi. Rrëshqitëm edhe ne të tjerët në drejtim të majës, ku topi villte zjarr e hekur. — Kush gremis atë top, gremis në tokë vetë malin, kështu na tha dje komandanti i kompanisë, Dardani. Na afrohet rrezi-ku? Nga kush? Nga gjashtë breshka hekuri që vijnë xadesë? Jo, kjo s'bëhet! Përse nuk bëhet? A, mos më pyesni, përsë, një herë e thotë fjalën burri, u tha ta përmbysim topin, hajde, ç'presim? Supin e në fund të dheut të shkojë. Nesër do të na pyesin në brigadë. E si u ndatë me topin gjëmimmadh? Hë, më thoni si t'u përgjigjemi? U trembëm se erdhën gjashtë breshka nga Prizreni? Këtë s'duhet ta bëjmë.

Pak më vonë, rreth vendit ku qëndronte me vështrim nga pozicionet tona topi grykëgjatë, shpërthyen breshëri granatat tona. Ushtarët e braktisën topin.

— Gremisni topin, — thirri me zë të lartë Dinoja.

U sollëm rreth topit pa ditur ku ta kapnim. Topi ishte i mbërthyer si i mbirë atje, ishte bërë një me shkëmbin. E shfrymë urrejtjen duke goditur instrumentet e topit me qytën e pushkëve. U munduam duke vënë supin që ta hidhnik topin në shkëmb dhe hajt, të kalbej në shtratin e Drinit. S'mundëm...

Dino Çinoja turfulloj nën hundë, dha urdhër që të mblidhnik rreth topit predha. Ashtu bëmë. Mua më mbajti aty, kurse të tjerët i urdhëroi që të largoheshin.

Nga larg, aty, ku kishin dalë esesët që erdhën me tanket, dukeshin flakët e pushkëve. E rrëmbeu vendin dhe breshëria e një mitralozi «Shars». Plumbat vinin pa pushim në drejtimin tonë.

— U dhimbset topi, e shikon ç'po bëjnë? Më mirë që i kanë ngulitur sytë këtu, te topi i madh, ta shikojnë me sytë e tyre. — Dhe në dorën e djathtë shtrëngoi fort granatën. Më pyeti: — Një, si thua, është mjaft? — tha Dinoja pasi u futëm pas shkëmbit. Gishtat e dorës kishin mbërthyer granatën. E mbajti dorën pezull në ajër, si të ngirrë. Pastaj nxori trupin dhe i dha vrull krahut, dora u spraps e trembur për t'i shpëtuar rrezikut, kurse granata shkoi tutje...

Një gjëmim aq i rëndë dhe një flakë aq e madhe nuk ishte parë tjetër herë në kodrat buzë Drinit. Kërpudha e tymit u ngrit vrullshëm në drejtim të qiellit.

## XIII

Djemtë e Batinit ëndërronin të rriteshin që të lëronin me plorin e parmendës thellë tokën e të hidhnin në sup armën. Parmendën dhe pushkën, të dyja bashkë i gjetëm në Batin. Dardanit iu kujtua mosha e fëmijërisë kur lodronte nëpër ato livadhe, sa e sa herë lodronin djemtë e Batinit rrëth gështenjës qindvjeçare të kuveneve, ku mblidheshin burrat dhe pleqëronin e vendosnin për fatet e vendit dhe shuanin grindjet që mbillte i huaji e rrogëtarët e tij të hapët apo tinëzarë.

Kujtimet e fëmijërisë i hodhën në harresë telashet e ditëve me luftime. Nga të gjitha drejtimet vinin lajme mbi sukseset që kishte arritur brigada. Dëgjoheshin krisma në drejtimet ku sulmonin brigadat e tjera.

— Ranë në gjunjë nepërkat e kolonel Vilenbergut, — i thashë Dardanit, — u strukën nëpër qytete.

— Është shpejt të flasim për këtë, — dhe përqendroi

vështrimin te bjeshkët e larta, atje ku dikur kishte kullo-tur delet dhe kishte hedhur gurapesh e luajtur rrashash.

Dardani me shokun e tij të vegjëlisë, djalin e hallës Shahe, Abdylin, kullo-nin bagëtitë në kullotat e pasura, por batinasve kullotat e bjeshkën ua rrëmbyen pukovnik Stepani e Cen Gozhita. Lënda e drurit të Batinit thithej nga «Srpska Mitrovica». Aty larg, në shkrepat e malit, djemtë shkelnin mbi gur siç shkel thundra e kaprollit. Hidhej karcini i vogël nga shkrepitë në shkrep, hidhëtë gjapi i këmborës këmbët në degët e lisit. Çdo hap që hidhëtë në fillim Dardani nëpër shkrepat e bjeshkët ishte një e dre-dhur zemre se në rrëshqitjen e parë e priste humnëra. Dardani ndiente që në atë bjeshkë i mbushej gjoksi me ajër, i shtohej shëndeti, i lartohej shtati dhe i bëhej më i sigurt të ecurit. Bjeshka atij i lartoi shtatin dhe e burrë-roi. Prandaj ai vështron me përmallim bjeshkën e kujton shokun e tij të vegjëlisë. Posa batalioni ynë arriti në Batin, Dardani pyeti për shokun e fëmijërisë. Abdylin.

— Si lis bjeshke ke me e pa dhe s'ke me e njohë, — i thanë batinasit.

\* \* \*

Fshati Batin është midis vendit, ngado që shkon, do të ndalesh aty, do të pushosh aty. Mbas disa ditësh me luftime erdhëm përsëri në Batin. Thuhet se në Batin ndër-thuren bjeshka e vrrini. Mollët mbushen me kokrra, arrat e gështenjat shtruar në shesh, prodhimi është i madh. «Hani, vëllazën», — na thoshin batinasit. E ne s'preknim asnjë kokërr. Në ditët e para s'na kuptonin përsë. Në çastin kur u kthyem nga luftimi i Gjakovës, kompania jonë po pushonte në një livadh. Endeshim pranë një molle të mbushur me kokrra.

— A s'ban me marrë mollë, lum lokja, a? — tha e zonja e shtëpisë. Ajo pa që molla nuk ishte prekur dhe zuri degën, e tundi me forcë, kokrrat e mollës mbushën

lëndinën. — Hani, djemtë e lokes, hani! — Dardani ktheu vështrimin. E njoju zërin që foli.

— Halla Shahe, — tha ai dhe shkoi e rroku pér qafe. Ajo shtangu. Një zë i njojur pér hallën Shahe, një zë i larguar, por jo i harruar. Kush mund të ishte?

— A, Dardan, bir i lokes, Dardan!... — Ajo hapi krahët, e priti si pret nëna birin e dëshiruar. — Bir, bir, — murmuritë halla Shahe me vështrim te bjeshka. Aty e ka hedhë vështrimin batinasi sa herë i është dashur ta gjelltisë lotin.

— Nënë, — belbëzoi Dardani.

Takoheshin mbas shumë vjetëve. Ajo e mbante mend Dardanin të vogël, dymbëdhjetë vjeç ishte kur lodronte me të birin Abdylin. Ata ishin shokë të ngushtë.

— Mbahu, nanëloke, — i tha Dardani hallës Shahe, e cila e kishte ushqyer atë me qumështin e saj.

— Besa helmi plas gurin lum lokja, po liria nuk vjen pa gjak. — Dardanit ia rrëmbeu kurmin një si e dridhur e paprovuar herë tjetër. Gjoksin e tij e mbyti dënesa e fjalës së nënës së shokut, vëllait të një gjiri. «Mos u ligështo?» Këtë fjalë e mbante mend nga vegjelia, me këso fjalësh batinasi u qëndronte derteve e hallevë në luftë me kralët, sic i qëndron bjeshka e lartë furtunës. Ai s'mundi tjetër të fliste, u ulën afër njëri-tjetrit e filluan të bise-dojnë:

— U gjëzue fort Abdyli i nanës kur mësoi që ju kishit ardhë me brigadat, ma pruni lajmin që kishe ardhë e më tha po shkoj me kërkue Dardanin. Nuk arriti, e dërguen me nji letër pér Deçan, në brigadën e Kosovës. Kur u kthyte, ju ishit largue. Biri i lokes, e këputi malli, don-te t'ju takonte. — Dardani dëgjon fjalët e nënëlokes e kujton jetën e tij. Është rritur në prehrin e saj, kujton shokun e vet, Abdylin, që shtiu mbi Cen Gozhitën, kujton fëmijërinë... Në Batin akti i Abdylit çmohej si guxim që kishte nderuar fshatin. Ky lajm u mësua edhe në brigadë. Abdyli kishte shtënë mbi Cen Gozhitën që të hakmerrej pér Dardanin e gjithë batinasit, por i shpëtoi qeni i tërbuar.

Dardani e dinte që nipi i mixhës Shpend, Hazir Për-

drini, i këndonte një këngë trimërie birit të hallës Shahe, Abdylit.

Cen Gozhita e kishte mbyllur shokun e Dardanit, Abdylin, në qeli që t'i hante kokën.

— Kësi shtegu me krye do ta paguajë Cen Gozhita,  
— tha Dardani.

— A thue, bre bir?

— Po, nana Shahe, — e siguroi Dardani.

Korrieri solli një lajm.

— Mirupafshim, nana Shahe! — i tha Dardani dhe u largua. Ajo nuk lëvizi prej vendi, shikonte Dàrdanin dhe bjeshtkën. Qëndroi aty gjersa Dardani i doli sysh, atëherë psherëtiu, zbrazi gjoksi i saj helmin në pikën e lotit që i ra, murmuriti: «Ju priftë e mbara, bijtë e nanës. Mirupafshim, bir. Mirupafshim, Dardan!...»

\* \* \*

Në fytyrat e luftëtarëve vërehej ashpërsia e përleshjes. Në lartësitë mbi qytetin e Gjakovës dhe rrugës nga Peja në Prizren fryshtoi thëllimi therës i plumbave, këmishëmurmët rezistojnë me egërsi.

— Së shpejti do ta qiliojmë Gjakovën dhe qytetet e tjera, — tha komandanti i brigadës, Sopot Golemi, kur po lexonte para luftëtarëve të brigadës një komunikatë mbi veprimet luftarake të brigadave partizane në Kosovë. Një ndalesë e papritur i ndodhi kur përmendi emrin e një dëshmori. Ai emër i futi pikëllimin në thelb të zemrës, rrudhat në ballë iu thelluan, fytyra i mori flakë. Ishte një shok i tij, kishte qenë bashkë me atë në një celulë në Tiranë, e kishin filluar nismën së bashku e Partia i dërgoi njërin në jug në malet e Gurshpatit e tjetrin në Kosovë. Një ditë më parë ai i dërgonte një letër nga brigada e Kosovës, i shkruante: «I dashur Sopot. Më ka marrë mali shumë, do të takohemi, fill mbas aksionit po vij». Ish-te komisar batalioni në njëren nga brigadat kosovare... Ai

erdhi në sytë e Sopotit, dhimbshëm, tha: «U vra... u vra...» Dhe sytë ndezës të komandant Sopotit, balli i tij i rrudhur treguan dhimbje e pikëllim.

— Dasmë pa mish s'bëhet, djem, — tha Goxho Bërdëllima. Ai foli aq sa pa që pikëllimi për humbjen e shokëve u kthye në urrejtje të shumëfishuar dhe në brigadë shpërthyen këngët e trimërisë dhe vallet luftarake.

\* \* \*

«Një muaj rresht, krahas me brigada të tjera, bashkarisht me partizanët e brigadave të Kosovës, brigadat tonë vazhduan luftimet për qirimin e Kosovës. Plani i kolonel Vilenbergut «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe» po bëhet pluhur. Nyjet e rezistencës së armikut në Deçan, Batin, tek Ura mbi Drin etj. mbetën si varre të hapura që trembin ata vetë. Goditjet e kolonave të shumta armike që kalojnë pa ndërprerje në rrugë bëhen të përherëshme. Por armiku ende paraqitet më i fortë se ne ushtarakisht, prandaj, që ta përballojmë këtë epërsi, nga ne kërkohet, — tha komandanti i brigadës, — që veprimet tona takte të jenë të larmishme, të atilla që të na japin në dorë atë që na duhet në vijën e luftimit për t'u paraqitur me epërsi mbi kundërshtarin. E gjithë brigada jonë sulmoi mbi garnizonin e armikut në qytetin e Gjakovës... — Ai foli për këtë veprim dhe u la radhën të flisin të tjerët. U ul midis shokëve e bluante atë q'do të bënin armiqëtë për t'iu kundërvënë goditjeve tona. Kërkonte të gjente pikat e dobëta të kundërshtarit. T'i bënte të pavlefshme kundërsulmet e armikut, të godiste e të shkatërronte pikëmbështetjet e tij. Nuk ishte punë e lehtë ajo që bënte, ndeshej me mend me kundërshtarin në Gjakovë para se të ndeshej me armë, kjo e lodhte. Ai nuk kishte kryer ndonjë akademi ushtarake si kolonel Vilenbergu, po kishte mësuar në llogoret e luftës popullore.

Komandanti i brigadës nuk rrëmbehej, po bluante

gjatë në kokë mendimin, dëgjoi mendimet e partizanëve, të komandantëve e të komisarëve, mandej me vështrimin në fytyrat tona foli:

— Do të sulmojmë, por koloneli na e ka shtruar kësaj here sofrën në Gjakovë me më shumë plumba, ky është realiteti dhe këtij realiteti duhet t'i bëjmë ballë. Ka bërë fortifikime të tjera, ka prurë armë e ushtarë të tjerë.

— E vështirë, po shpërthehet, — tha Skifter Velça. Sopot Golemi hetoi tek ai që foli pulsin e të gjithëve. Iu drejtua me emër.

— Ashtu them edhe unë, Skifter, me guxim e mjesh-tëri çdo rezistencë e esesëve përmbyset. Lehtë nuk ësh-të, por kalohet. Ja, aty buzë lumi do ca guxim, për të hequr qafe disa mitraloza, që rrinë në përgjim tek ura. Telave është më mirë t'u kalojmë anash, sesa nëpër ta, apo jo? Pozicionet në Çobrat s'bien po nuk u goditën me granata dore. — Pastaj kaloi në hollësira të tjera, pyeti për fishekët e bombat. Hynte edhe në hollësira të luftës.



Nipi i mixhës Shpend, Haziri, i kaloi me sukses provat e para të zjarrit. Atë në luftimet në qytet e fshiku një plumb në lëkurën e kokës.

— Kapuci i bardhë në kokën e luftëtarit tërheq plumbat e armikut, o Hazir, — i tha Bukurie Çabiri dhe i kérkoi Vasos një kapele partizani. Qeleshen borë të bardhë Haziri e futi në gji, mori kapelen që i dha Vasoja dhe, para se ta vinte në kokë, e rrotulloi nëpër duar e tha:

— Kjo nuk ban.

— Nuk të bie për kokë?

— S'ka yll, moj motër.

— Ylli të gjen motra jote. — Bukuria hapi çantën e vogël, nxori perin e kuq dhe gjilpërën dhe filloi të qëndiste një yll të kuq. Hazirit i ndritën sytë, fytyra.

\* \* \*

Në skuadër e ndienim veten si pjesëtarët e familjes që jetojnë rreth një vatre. Skuadra ishte vatra jonë e përbashkët. Të themi që s'kishim huqet tona, nuk shprehim të vërtetën, secili kishte nga një huq që nuk shkon. Dinoja zhëng nga koka, rrëmbehej edhe për gjëra të vogla. Luloja maniak pas armëve, kishte një vit nga dita e formimit të brigadës që mbante mitraloz «Breda» të lehtë. Gjithë mitraljerët e brigadës i ndërruan me mitralozza «Shars» gjermanë që u zunë gjatë luftimeve, kurse Luloja s'dëgjonte. «S'më duhet, — ngulte këmbë, — ka më saktësi në qitje «Breda» italiane nga «Sharsi» i gjermanit. Goxho Bërdëllima nuk dëgjonte të vishte rroba ushtarësh, mbante ato me të cilat erdhi partizan, rroba të punuara me vegjë, të ngrohta. Dallojmë nga njëri-tjetri jo vetëm nga mosha, por edhe nga tiparet: Luloja e Vasoja të gjatë si plepi, Dino Çinoja i shkurtër, ama i gjerë në gjoks, flokëverdhë aq sa e qesëndisnin: «E njeh babën, or qyq, pyete nënën, u ngjan në turinjtë e në flokët gjermanëve, tëpëkë gjerman duke». Dinoja vinte buzën në gaz, veç qeshte e qeshte, e mbante shakanë. Kur ishte në humor, thoshte: «Gjermanët s'ngjiten dot mbi retë, s'arrinë dot gjer aty në malet e Gurshpatit e gjetkë. Kush ngjitet në malet tona, aty kalbet.» Bukurie Çabiri flokëzezë, me fytyrë të hequr e vetullkurorë, me mollëza të faqeve të dala si burrë; Goxho Bërdëllima gjashtëdhjetë vjeç burrë, më i lehtë në të ecur se ne të tjerët, thumbues në bisedë saqë partizanët e kompanisë i ruheshin syrit të tij. Hazir Përdrini pak i druajtur, sa kishte ardhur partizan, ishte ende i ri në skuadër, por xha Goxhoja thoshte: «Dielli shihet që në mëngjes». Haziri i papërtuar dhe djalë me zemër të ngrohtë, djalë bese e pushke, secili kishte dëshirë ta kishte në krah. Adilja e palodhur, e kujt nuk i kishte mjekuar ndonjë plagë? Të mbrujtur me virtytet e larta të partizanit, askujt s'ia lejonin t'i pluhuroste ato. Ato ishin ligj i shenjtë për cilindo partizan. Kush

i pluhuroste ato, priste zemërimin e të tjerëve dhe zemërata e shokut në luftë ishte më e idhët se çdo plumb i armikut.

Ago Ymeri, bariun me shëndet mali që e kishte fyttyren gjak të kuqe, një fytyrë têrheqëse me vetulla kale-she e korb të zeza, ende nuk kishte vënë brisk në faqe, por që dukej më i madh nga c'ishte. Atë e hodhi në kllapi një shpërthim mëne afër urës. «Është gjallë apo i vdekur?» Kështu mendova gjer morëm lajmin se Ago Ymeri ishte më mirë. Lajmin e pruri një i plagosur. Tha që Agoja e kaloi rrezikun. Lajmi na gëzoi të gjithë. Bisedonim në skuadër për Ago Ymerin. «Më ruani mítralozin», — na kishte dërguar fjalë.

— Si u bë mitralozi i Agos? — pyeti Bukurie Çabiri.

— E ndreqi Vaso Lundra.

Vaso Lundra kishte duar të argjendta, sa herë duart e mekanikut na kanë ardhur në ndihmë. I njihte ar-mët Vasoja, i njihte mirë ato. I dërguam Agos letër:

### *Ago i dashur,*

*Mitralozi tê pret, shokët tê presin... U bëmë merak për jetën tënde, na pikoi në zemër sidomos kur lexuam në buletin edhe emrin tênd bashkarisht me tê vrarët. Të qamë një herë, kur tê kthehesh, tym do ta bëjmë, tê presim me padurim!*

*Përqafime  
Luftëtarët e skuadrës*

— Ama letër ke bërë, — më shfryu Dino Çinoja. — Si i shkruhen fjalë tê tillë një tê plagosuri që i dhëmbin ende plagët? I tregohen ato proçka që s'duhet tê ndodhin po ndodhin se ai sekretari në shtabin e brigadës mbyll sytë kur i shkruan emrat? Ndryshe duhet shkruar letra. Ulu ngadalë dhe qëndisi një letër që ta bëjë Ago Ymerin njëqind herë më të fortë nga c'është. Mund ta bësh një letër tê tillë? E bëre, tê lumtë, dërgoje, ndryshe lëre fare!

E ndjeva se fytyra më mori flakë, balli m'u mbush me djersë. Në skuadër u ndez biseda për Ago Ymerin, se-cili donte ta tregonte më parë ngjarjen. Ishte një veprim

i guximshëm, një ndodhi e rrallë ajo që i ndodhi Ago Ymerit. Biseda e pruri fjalën te luftimet, nga veprimet e njëri-tjetrit mësonim qdo ditë. «Plumbat vrasin më tepër kur je larg sesa kur i afrohesh armikut. I dridhet dora armikut kur të shikon afër që i turresh, s'ka saktësi në të shtënë», — na thoshte gjithnjë komandanti i kompanisë, Dardani.

— I vajisët armët, — pyeti komandantja e skuadrës. — Gatitemi për luftime... .

\* \* \*

Te bregu i kushtrimit ra lodra. Ishte sinjali që thërriste burrat e fshatit. Ata dolën me pushkë në dorë, vrapan drejt të gështenja e mogme, ku fshati mblidhet në kuvend. Gjithandej shiheshin lëvizjet e njësive partizane. Brigada përgatitej për goditje. Dëgjoheshin fjalë:

— Do sulmohet përsëri Gjakova...

Gishtat e Hazirit po dridhnin telat e çiftelisë. Ai po u këndonte trimërive të partizanëve:

*Bijtë e shqipes me yll në ballë,  
pëllambë e gjak e faqe bardhë.  
Krisi pushka, u ba duhi,  
ndal, gjerman, ku do me hi,  
se nuk e lamë n'dhë pa t'shti!...*

Skifter Velça dredh shaminë, heq valle dhe tund kokën, shenjë se do të nisemi në sulm e para sulmit si gjithnjë ne partizanët do të heqim vallen.

— Hajde, hajde këtu, ma jep shaminë vëllait, — doli në ballë të valles një tjetër, një lab si div, një bari që me krismat e para të pushkëve partizane la kërrabën dhe mori në dorë mitralozin. Ishte i pashëm nga fytyra, me leshra të dredhura e sy të gëzuar. Ai i dha më vrull valles, e çoi lart e më lart zërin. Ishte Dinoja ynë. Kur doli par-

tizan, Dinoja nuk dinte të shkruante as emrin e tij, po më-soi edhe të shkruante, edhe të lexonte.

Bashkë me Dinon hynë në rrithin e valles të gjithë shokët e skuadrës. Edhe Luloja zeshkan, me dy shenja plage në bulçinjtë, me dy dhëmbët e parë të prishur nga plumbi, hyri në valle. Luloja për këngë e valle mbahej në gojë nga e gjithë brigada, kurse kishte ca kohë që këngës nuk ia thoshte dot, vetëm mbante iso. Na vinte keq për Lulon, por kishte shpëtuar mirë nga ajo plagë plumbi që kishte marrë një muaj më parë, natën që sulmuau Prizrenin.

Lugina e Batinit mbushej me këngë. Lart dielli që po perëndonte u dha thepave të hirtë e të dhëmbëzuar të Alpeve një vezullim të portokallë, të ndezur.

Vështrimi i Dino Çinos ndeshi në vështrimin e Lulos, i cili atë që i iku zërit kërkon t'ia japë valles.

— Ishte bilbil Luloja, — më tha Dinoja dhe shprehu keqardhje për belbëzimin e tij. — Plumbi i armikut i pri-shi pamjen dhe ia vran zérin. Hej, Lulo, Lulo! — psherë-tiu Dinoja, pastaj tha: — Duron dot Luloja pa kënduar? Ja që duron, plas po deshe! I vdiq në buzë kënga Lulo Drizës. As ia merr e as ia kthen, s'del më në ballë të valles, Eh, Lulo, bilbil ishe, o Lulo, ç'e do, ai plumb dum-dum të shëmtoi fytyrën, hic gjë, po zérin, të mori zérin!

Luloja më i dëshpëruar ishte për zérin sesa për fytyrën, por nuk shfaqej dhe kurrë nuk rrinte i mënjanuar as nga vallja, as nga kënga.



Komandanti i brigadës, kur kaloi afër skuadrës sonë, ndaloi dhe u takua me Goxho Bërdëllimën, diçka i tha. Goxhoja, hazërxhevap në fjalë, godiste me pëllëmbën e dorës tytën e pushkës, prekte opingat e arnuara me tel dhe i thoshte:

— Deri në Berlin ta ndjekim egërsirën, deri atje, komandant Sopot.

U grumbulluan rreth komandantit të brigadës. Ai bisedoi me secilin, na pyeti. Pastaj e ndali vështrimin te një grumbull gurshpatarësh, ai që e heq në ballë vallen, është Dinoja, vëllai i Hysenit, komandantit të batalionit, që disa ditë më parë ra heroikisht në sulmet për të çarë rrugën drejt Kosovës. I ngjan të vëllait nga shtati, nga fytyra dhe nga zëri. Shpeshherë komandanti i brigadës i ngaterronte ata të dy me njëri-tjetrin, sa nuk i foli me emrin Hysen, por e dinte që komandantin hero, Hysenin, e kishë varrosur në malet që mbetën prapa dhe ky djalosh ishte i vëllai. Një qast mbeti i shtangur. Hidhërimi, kur shkon thellë në zemër, e jep shenjën në fytyrë. «Në emër të fitores do t'i thyejmë, shoku Sopot, nesër na zë dita në Gjakovë», — tha Dinoja dhe hodhi vallen e rrahu me këmbë tokën. Komandanti i brigadës ra në mendime.

— Kësaj radhe duhet t'i shkulim nga kazermat e fortifikatat, do ta çlrojmë se s'bën Gjakovën, — tha komandanti i brigadës kur pa përballë nesh partizanët e mortave që përgatisnin predhat. — Nga lartësia e Cobratit të hidhni sa më shumë predha në pozicionet e armikut, — urdhëroi Sopoti. Për saktësinë në të qëlluar, komandanti i brigadës nuk merakosej. Predhë e shenjtë!

Në lëndinën te gështena e madhe e kuvendit, në Batin u dëgjua mbi të gjithë zërat rropama e daulles. Ai që i binte daulles hyri midis një rrethi valltarësh, të cilët, të lidhur sup më sup, kërcenin. Qëndresa e valles varet te supet e te kryqëzimi i duarve të tyre në formë të purteka-ve që zënë radhë e ngjishen në gardh. Duart, supet, armët dhe hapi i tyre duashin si të shkrira në një të vetme. Rrethi i njerëzve, partizanë e fshatarë, që sodisnin valltarët, ngazëllehej me vrullin e valles e sidomos kur mblidheshin në formë kështjelle dhe hapeshin si në vijën e sulmit, me njëfarë largësie nga njëri-tjetri. Aty midis lëndinës vazhdoi të heqë vallen Dinoja. Vallja e rrëmbeu edhe komandant Sopotin, që u fut në mes të valltarëve. Zëri i Dino Çinos u lartësua më shumë, flokët e verdhë ia mbuluan ballin e djersitur.

\*       \*

Në lagjen përballë një grup partizanë kosovarë, që janë përgatitur edhe ata për të marrë pjesë në çlirimin e Gjakovës, këndojnë një këngë për Emin Durakun, disa të tjerë këngën e heronje të Shkodrës. Buçasin zërat e tyre:

*C'ka po thotë Perlati?  
— Burra, bahi gati,  
Se ka ardhë sahati,  
Të huejt me i dhanë barot.*

Dëgjohet pastaj zëri i një basi:

*Një zë thërret nga Gryka e Mezhgoranit,  
Në sulm, shqiptar, armikun ta dërrmojmë!..*

Pastaj kori i brigadës:

*Pushkët kërcasin, bombat po pëlcasin,  
Topa, mitraloza rrahin pa pushim.*

Mandej tinguj të bories. U rreshtuam. Në muzgun e mbrëmjes kolona u vu në ecje.

Shkuam në drejtim të Gjakovës....

## XIV

Koloneli i esesëve, Vilenbergu, erdhi në Gjakovë si një ujk i unshëm që gëlltit bishtin e vet, vështroi litarin e lyer me dyllë të varur te trekëmbëshi. Trekëmbëshi aty ishte! Dhe kufomat e të varurve lëkundeshin në litar.

Kolonel Vilenbergu që ditën e parë që i vendosi ushtarët e tij në Gjakovë në xhaketën e çdo ushtari dhe në gjoksin e vet kishte vendosur shenjën e vdekjes. Shpresat e veta i mbështeste te trekënbëshat.

I shoqëruar nga oficerë të tjerë madhorë Vilenbergu hipi në lartësinë e Çabratit dhe vështroi qytetin e Gjakovës që shtrihej përposh. Vështrimi i tij shkoi edhe më tutje, në drejtim të maleve, aty ku vija e qëndresës ishte përcaktuar si e pakalueshme në planin e tij «Gjuajtësit e dhelprave të kuqe». Kur kujtoi që në rrugën nga Peja në Prizren, nyjet e qëndresës, që ndërtonte ditën kolonel

Vilenbergu, i shembinin natën brigadat partizane, i kërycen sytë.

Nga lartësia e Çabratit përqendroi vështrimin mbi qytet, hietoi çdo mundësi qëndrese. Qyteti kishte plot minare të gjata, nga ku disa herë në ditë imamët thërrisinin ezanë.

— Mjaft gogësinë guakët, — tha për hoxhallarët. — Në çdo minare të vihet në përgjim një «Shars».

Majë minareve u dukën helmetat e esesëve.

Në çdo kryqëzim rruge pozacione. Midis qytetit, përparrë kafes së madhe, trekëmbëshi. Kolonel Vilenbergu e vështroi qytetin me sytë e ujkut. Ai e ktheu çdo gjë që mund të kthehej në pozicion lufte.

— Të kuqtë do të sulmojnë. Kjo është më se e sigurt që ata do të sulmojnë, — u tha oficerëve kolonel Vilenbergu. — Do të përplasen mbi qytet kësaj here me forcën e gurit që bie nga mali. Këtë do ta bëjnë më tepër nga dëshpërimi që herën e parë s'mundën ta merrnin qytetin. Sulmi i tyre do të jetë tri herë më i fortë, ndoshta më shumë. Në qoftë se radhën e parë prunë dy batalione, me siguri kësaj here bien brigadë. Cila brigadë do të jetë? — Koloneli i dinte numrat e brigadave. Me zë të brendshëm tha: «Ajo të mos jetë.» Mendoi për brigadën e Sopot Golemit. Sa herë ishin ndeshur ushtarët e tij me këtë brigadë, ai ishte detyruar t'i shkruante shtabit epëror: «Brigadë tepër e rrezikshme.»

— Fronti gllabëron qindra dhe mijëra njerëz. Po çdo njeri në front kryen një veprim, — u tha oficerëve dhe shtoi: — Secili duhet ta dijë mirë se nuk është gjë tjetër veçse një burmë në gjithë labirintin e madh ku rreshtohen armë dhe ushtarë siç është fronti. — Ai e dinte me hollësi sasinë e mitralozave, të mortajave e të topave që kishte vënë në pozicione bllokimi në çdo pjesë të qytetit. Kur besoi se çdo gjë ishte në rregull dhe ishin të qarta detyrat, zbriti nëpër dredhat e një rrugice në rrugën e dyqaneve që fillon afër urës së Erenikut dhe arrin gjer në qendër të qytetit. Ekte në kalldrëm më kë-

mbë, me roja para e pas. Qepenat e dyqaneve kishin ditë që nuk ishin hapur.

Nuk kishte arritur ende në qendër të qytetit, kur nën rrugë pa kangjellat prej hekuri që rrrethonin varrin e një pashai. Ai kishte dëgjuar për tragjedinë e pashait, por s'e dinte që varrin e kishte aty. E nxiti kureshtja të lexonte. Mbi gurin e varrit ishte shkruar turqisht emri i pashait. Mehmet Ali pasha kishte ardhur në këtë qytet me ferman të sultanicës, u kishte thënë vendësve të ulnin kryet. Ata e rrethuan. Tri ditë e tri net luftë rreth sarajeve. Në emër të lirisë bëhej luftë. Mbas tri ditëve pashai kishte thirrur: «Arnautë, më jepni një kovë me ujë t'ju jap një trajtë me flori.» Kryengritësit e Lidhjes Shqiptare ia kthyen: «As për një thes me ar nuk të japi më kovë ujë, as një trajtë me dhë të tokës shqiptare!...» Dhe kryengritësit i prenë kokën të dërguarit të sultanicës dhe të Fuqive të Mëdha.

Në ballin e një shtëpie përkarshë i tërroqën vëmendjen dy radhë të shkruara me një të kuqe të ndezur. Me mornica në trup përkthyesi shqiptoi:

*Kështu Shqipnia e ka adet,  
ka nji pashë me e myt' për vjet...*

— Këta duhen vënë të gjithë në trekëmbësh, — gérthiti kolonel Vilenbergu me fytyrë të shtremberuar.

Dielli ishte në të perënduar. Edhe rrezet e diellit i bëhej se rëndonin mbi supet e ushtarëve dhe të vetë atij. Asgjë s'pipëtinte në qytet. E siguroi komandantin e esesëve në Gjakovë që, në rast sulmi nga partizanët, do të dërgonte ndihma nga Prizreni dhe Peja. Ajo që ndodhi në Deçan dhe tek Ura mbi Drin s'do të përsëritez. Përsëri i vajti vështrimi te varri i pashait osman.

«O ironi e kohës, o shpatë e mprehtë!» — tha koloni i një frazë që mbante mend nga një dramë. Qëndroi si i ngurosur, nuk u besonte syve. «Njëri nga strategët më me zë të Perandorisë Osmane ta ketë varrin afër to-gut me plehra?! Sa fund tragjik!...» — tha ai me vete. Ai i dinte mirë ngjarjet e atij qyteti. Demonstrata të mëdha,

arrestime në masë, pushkatime dhe varje në litar, por më kot.

— Këtyre do t'ua rregulloj unë kokën, — pati thënë kolonel Vilenbergu atëherë kur erdhi me tërsëllimin e oficerit të Vermahitit të Tretë, të cilit për masakrat në Poloni vetë Fyhreri i kishte vënë në gjoks kryqin e hekurt.

Kolonel Vilenbergu nuk ishte nga ata ushtarakë që filozofojnë shumë, nuk pyeste. «Ushtarakut të Vermahit të Tretë i kërkohet të përdorë mirë automatikun e jo të mendojë kreun e fundin. Për ato mendon e vendos Fyhreri!» — mendoi ai me vete dhe eci i egërsuar.

Ishte mbrëmje. Duhej të kthehej në Prizren, që t'i qëndronte afér kështjellës. Në çastin kur po largohej nga qyteti ktheu vështrimin nga trekëmbëshi. Në litar ishin vënë dy njerëz të tjerë. Koloneli mendoi se, sa më shumë të gjakoseshin ushtarët e tij në atë qytet që mbante emër gjaku, aq më e fortë do të shkrepinte në sytë e ushtarit urrejtja, aq më i pathyeshëm do të bëhej divizioni i tij eses. Esesët e divisionit të tij mbanin të mbërrythyer në jakën e xhaketës shenjën që simbolizonte vdekjen, po kosovarët nuk e njihnin frikën. Kjo e kishte bëré bishë kolonel Vilenbergun.

— Pëllëmbë e trekëmbësh, pëllëmbë e trekëmbësh!  
— urdhëroi ai kur mori rrugën për në Prizren.

## XV

— Nuk mund tē ikim pa u përshëndetur me atë djaloshin, — tha fñjéri nga ish-luftëtarët për një djalë me shëndet tē plotë, tē gjallë në vështrim dhe tē afroueshëm në fjalë, tē cilin e takuam në qytetin e Gjakovës. Ai përmendi emrin e një shoku tē skuadrës sonë, Dino Çinos. Posa përmendi emrin e Dinos që e kishim në listën tonë, na shkoi mendja te djaloshi. Ishte i asaj shtëpisë që përbysën predhat e mortajës.

— Kam qenë në një skuadër me Dinon, — i thashë. Djaloshi donte tē dinte sa më shumë për jetën e Dinos. I tregova edhe ngjarjen që ndodhi në shtëpinë e tyre.

— E di, më ka kallëzuar nëna, — tha ai.

— Fëmija mbeti midis flakëve, — i thashë unë.

— Ai fëmijë isha unë, — tha Gjakovari.

Biseda bëhet më e përzemërt, ai m'u bë edhe më i afërt, më kujtohet ngjarja e asaj dite, shtëpia që mori

zjarr. Ishin predhat e fundit tē baterisë armike, pak minuta mē vonë, Skifter Velça, nē krye tē një kompanie, e vuri nē heshtje me granata dore. E ndiem heshtjen e mortajave dhe morëm frysë. Te shtëpia që digjej dë-gjuam zérin e një fëmije.

«Djali, djali», — Klithi nëna, e zonja e shtëpisë, sapo u përmend.

Dinos iu ndezën sytë prush kur pa nē parmakët e dritares fëmijën që po ulërinte i mbërthyer pas hekurave tē nxehjtë. Ai vrapoi atje, drejt flakës. Ne tē tjerët u përpoqëm tē qetësonim tē ëmën.

«Djali, djali», — klithte — ajo herë pas here. Dinoja doli nga shtëpia përmes tymit e flakës, erdhi drejt nesh, me fëmijën nē duar.

«Nënë», — foli djali i vogël me zérin tē ngjirur e me sy tē trembur pa asnjë pikë loti. Lotët i qenë tharë...

Është djaloshi që takuam nē kafe. Kërkon tē bëjmë një fotografi pér kujtim... Pastaj ecëm nē atë drejtim tē qytetit ku atëherë filloj sulmi ynë. Atë natë nga errësira i humbiste syrit tonë pamja e fushës dhe e shtëpive nē hyrje tē qytetit. Shihej përrpara nē mugëtirë një diçka si e mjegullt dhe e ngurtë. Duke shkelur nē vendet e luftimit, po jetonim me veprimet. Ishte natë kur formacioni luftarak i brigadës sonë u afrohej shtëpive tē para tē qytetit. Përballë batalionit tonë ishte lartësia e Çabratit. Asnjë lëvizje, asnjë shenjë jete nē pozicionë. Llogoret e armikut jepnin përshtypjen se esesët ishin nē gjumë, ose ishin tërhequr, kurse ata ishin nē përgjim.

Pa arritur tē hidhnik mbi llogoret e tyre granatat e para i hodhën ata. Luftimi përfshiu gjithë vijën e gjatë ku sulmuani nē krah tē njëri-tjetrit batalionet partizane. Buzët e llogoreve nē Çabrat mbetën disa sekonda si kafaze dritaresh tē ndezura. Nuk prante pushka nga asnjëra palë. Flakët ndizeshin e shuheshin afër, përrpara fytyrave.

— Luftë! Luftë! Kjo është luftë! — thirri Dino Çinona dhe hyri midis krismave, vrapuam tē zëmë një shtëpi tjetër, që do tē na shërbente si një pozicion i përshtat-

shëm pér qitje. I pari vuri këmbën në prag të portës Dinoja. U ndodhëm befas pérpara disa ushtarakëve. Ndodhi ai hutim e stepje e pashmangshme që ndodh në çaste të tilla. Jeta varej në një fije. Gishtat e esesëve têr-hoqën këmbézat e armëve, por automatiku i Dinos ua hëngri rendin.

Fitoi më i shpejti...

\* \* \*

Komandanti i brigadës, Sopot Golemi, doli te lartësia e Çabratit, andej mblođhi copëza nga flakët e pushkëve, dalloj gjer ku kishin arritur vijat e para të sulmit. Një çast via e luftës sikur zuri vend dhe s'po lëvizte.

— Borizani, ku është borizani! — thirri komandanti i brigadës.

Flakët e pushkëve u ndezën tejendanë qytetit.

Sopot Golemi thërret me zë të lartë:

— Me granata, me granata!

Në qytet sundon frysma marrja e rëndë e luftës.

\* \* \*

Ndoqëm prapa flakët e pushkëve. Ecëm nëpër rrugicat e qytetit. Nuk ishte lehtë të orientoheshë mbi luttimet. Një eses që lëvizi në dritare te shtëpia përballë e vrah me malihet xha Goxhoja. Atij i erdhi mirë kur Haziri i gëzuar tha:

— Ta lumsha synin, mirë ia dhe në lule të ballit!

Ushtari eses qëndroi gjysmë i varur në parmakun e dritares. Haziri, i gëzuar që qyteti pak nga pak po çliron hej, mori vrull e sulmoi duke thirrur:

— O, prite, skile, partizanin breee! — Zbrazi disa herë pushkën dhe nga pozicioni në pozicion fluturoi përpara, shtinte me pushkë e mbas çdo krisme sokëllinte thekshëm: — O, prite, partizanin, breee!

— Dre, dre, kujton se nuk e shpon plumbi, — tha Goxho Bërdëllima dhe i shkoi mbas Hazirit për ta këshi-luar.

Në vijën e parë të luftimit arriți edhe intendent Vasoja, solli në pozicion bukë dhe fishekë. Vasoja, sapo iu afrua pozicionit të skuadrës si përherë, edhe kësaj radhe tha:

*Asgjë nuk duam, nukë,  
vetëm ca plumba dhe pak bukë!*

— Vaso, — i foli në emër Dino Çinoja. — Vaso, vëlla, duam fishekë, duam granata!

— E bëtë fora, vëllezër. Fishekë e granata ju bie Vasoja. Sot s'ka bukë për ju, po pite kosovare, hak e keni, tym ua bëtë esesëve.

\* \* \*

Dardan Velishta vuri re që në pozicionet që zuri kompania dëçka nuk shkonte dhe duhej të ndreqejet. Duke u përkulur mbas mureve u dha ai gjer në pozicionin e skuadrës sonë.

— Agim, — më foli, — ku është Dinoja?

Dino Çinoja bashkë me Hazirin kanë dalë më përpara.

— Ata kanë zbritur nën rrugë, te varri i pashait, — iu përgjigja. Dardani i njinte pëllëmbë për pëllëmbë rrugët e rrugicat e qytetit. Mbas gurëve të varrit të pashait Dinoja ka fshehur trupin. Ne po qëllonim nga ndërtesa përballë. Pranë nesh zuri vend edhe Dardani. Përkarshi

u dukën ca esesë. Dardani priti gjersa u pa esesëve shenjën në kapele, kopsat në xhaketa.

— T'u biem, Dardan? — i thashë. — T'i godasim! S'duhet të presim. Zjarr! — thirra dhe vura armën për syri.

— Mos, q'po bën kështu, Agim, e humbët durimin, Agim, — më tha dhe më vuri dorën te supi. Unë shtanga në vend.

— Mos harro që zjarrin duhet ta hapim në një kohë të gjithë. — Nga heshtja jonë esesët morën hov dhe vrapuan në këmbë duke qëlluar me automatik. Esesët përpinqeshin të na zmbrapsnin. I pritëm në grykë të pushkës. Dardani në ato çaste kishte një pamje fare të qetë.

\* \* \*

Komandanti i brigadës, Sopot Golemi, po drejtonte luftimet nga lartësitë e Çabratit. Korrierët çonin lajme dhe merrnin urdhrat për në vijën e parë të luftimit. Komandanti i brigadës dëgjonte sokëllimat e thekshme të mbytura nga krismat e armëve: «Përpara, përpara!» Nga Çabratit, tani që ishte ditë, me dylbi ai vëzhgonte frontin në të gjashtë lagjet e qytetit. Vëzhgonte çdo veprim, dëgjonte krismat, zërat dhe shikonë zjarr e tym. Qyteti u mbyt tejendanë nga flakët e nga krismat.

Një çast u ndërprenë luftimet, dëgjoheshin vetëm krisma të rralla. Kjo i dha mundësi komandantit të brigadës të dëgjonte se në dy krahët e Gjakovës, tek Ura mbi Drin dhe në Deçan (afër Pejës), nga brigadat e tjera bëheshin luftime. Shpërthimet e luftimeve sado që larg arrinin në Gjakovë si moti me kërcëllima të paprera. Gjëmimet nga vende të largëta arrinin në veshët tanë, vinin si nga një humbëtirë e largët, me gjëmim të thellë e të rëndë. Përlleshjet rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi filluan përsëri në Gjakovë. Si një re e zymtë dhe e

rëndë gjithë paraditen qëndruan mbi qytet tysi dhe gjëmimi.

Gjakova është një qytet i mësuar me krisma. Gjakova s'di të nënshtrohet. Kolonel Vilenbergu u pendua që s'i kishte vënë zjarrin këtij qyteti, në të cilin, kur vriste një, ngriheshin njëqind, një mijë ku nga çdo shtëpi në gjoks dhe në shpinë të esesëve kërciste grykëholla.

Te kryqëzimi i rrugës, afër çezmës, Goxho Bërdëllima po i hakërrrehej një ushtari rob.

— Hape gojën, dhëmbë e dhëmballë kam për t'i shkulur, bindu, hape de, hape kamaren! — i thoshte Goxhoja robit që kapi nga pesë esesët që kaluan para armëve tonë. Tre u vranë, dy i kapëm.

— Jo ashtu, xha Goxho, jo! — ndërhyri Dinoja. Xha Goxhoja u egërsua.

— Koka e falur s'pritet, o xha Goxho, — i tha Bukuria. Fjala e saj e lëshoi në këllëf «Parabelin» e Goxhos. «Eh», — bëri sikur i doli shpirti në çastin kur pa armën të kyçur në këllëf. Murmuriti: — E di Goxhoja c'të takon, ta ka Goxhoja gjysmën e lekut, ta kam ruajtur, por... — I tregoi dorën e tij prej bujku, gjithë nyje, një tapanxhë që me një grusht të lë në vend, i foli ashtu e i dha të kuptojë esesit që s'ngopej ta piqte të gjallë në hell.

Skuadra vrapoi më përpëra, Goxhoja mbeti aty, pa ditur c'të bënte me robërit. Kaloi Skifter Velça. Goxho Bërdëllima u gëzua kur pa komisarin e batalionit. E pyeti:

— C'të bëj me këtë rrufjan, shoku Skifter? Më thuaj de, c'të bëj? — Fliste e lëvizte këmbëzën e maliherit.

— Tërhiqëmbas, bashkoje me të tjerët; — i tha Skifteri në vrapim e sipër.

Goxho Bërdëllima mbeti si hosteni që e ngul bujku në ugar, s'lëvizte. Tha: «Ku vriste fjala e komisar Skif-terit? Mo e kishte fjalën te «gjysma e lekut»? Si tha ai, si tha? Hëm, më duhet ta mendoj mirë këtë punë». Dhe një mendje i thoshte: «Një plumb do harxhoxh, një nga ata plumbat e çarë te maja», kurse tjetra i zinte dorën, i thoshte: «Mos, s'duhet!».

Esesi ishte i plagosur lehtë në kofshë. Adilja, sanitaria e kompanisë, u kthyte ta mjekonte.

— Mos, moj vajzë, mos i ndyj duart me gjak të zi.

Adilja gatiti ilaqet. Goxhoja rrudhi buzët...

— Ç'ti bëj batalionit që më heq malipherin, pa di Goxhoja si ta mprehë biçakun, dëgjon!... — iu hakërrye përsëri robit që diçka në gjuhën e vet po shfaqte dhe po e vështronte me egërsi Goxho Bërdëllimën. Në atë vështrim dukej përcëmimi i tij ndaj atij burri të moshuar me gjerdan në brez të punuar me ngut nga një këpuçar fshati. Ai nguli sytë tek opingat e grisura të xha Goxhos, te rrobat e shajakta dhe, padashur, e këmbeu vështrimin me çizmet e tij fringo, por të pluhuro-sura. Ai ishte rob i këtij partizani me opinga, të cilit ia kalonte me ç'kishte veshur në trup, por që nuk matej dot me ç'kishte në zemër.

\* \* \*

— Atë duhet ta përbysim sa më parë, — na tha Dardani.

Dinoja nuk foli. Përbysja e trekëmbëshit të vendosur midis qytetit ishte një dëshirë e mbetur përgjysmë nga sulmi i ditëve të mëparshme. Bisedojmë me vështrim te litari me dyllë. Dardani kujton Abdylin, djalin e hallës Shahe që qëlloi mbi Cenin. Ishte i gjallë apo?...

— Koloneli i esesëve është i ngjashëm me një bishë, po më në fund i ranë pendët, — pohoi Dinoja.

— Bisha e plagosur duhet varrosur, — tha Dardani.  
— Armiku po bën presion të madh nga krahët, dëgjon si gjëmon lufta asaj ane?

— Ehë, — bëri Dinoja, — dëgjoj. — Ai nuk i dallonte krismat në pritat larg qytetit nga ato të qytetit, zhurma e luftës shkrihej në një të vetme. Krëshqiti anës së një ndërtese që të vente te mitralozat e skuadrës, kurse Dardani ndoqi anën e përroit të vogël në drejtim të çezmave. Aty, dy shtëpi më tutje, larg urës së gurtë ishin në pozicionë esesët. Ai u habit nga e papritura që ndodhi, u hodh e zuri vend pas një ledhi kur pa dy ushtarë esesë dhe një nga të bandës së Cenit. Ata kishin vënë përpara dy djem të lidhur dhe ecnin në drejtim të urës.

— Mos shtini, — gérthiti ai i Cenit. Të lidhurit si dy lisa po ecnin me kokën lart. Dardani vuri në sy pushkën dhjetëshe, në dylbinë e pushkës dalloj ftyrën e shokut të tij të vegjëlisë, Abdylit.

— Qenka gjallë, — tha. Dardanit iu kujtua hallë Shahja e murmuriti: — Ku i çojnë? — Mblodhi supet, s'po kuptonte ku i çonin. Mos i çonin në litarin e trekëmbëshit? — Jo, kjo është e pamundur, trekëmbëshin ne e kemi nën zjarrin e mitralozave.

Dardani nuk po e hiqte syrin nga shënjestra e pushkës, dylbia e dhjetëshes ia binte dy hapa afër ftyrën e shokut të tij të fëmijërisë, Abdylit nga Batini që kishte bërë atentat kundër Cen Gozhitës. «Unë e dija se ai ishte varur, — tha me vete Dardani, — ende qenka gjallë.» I mbiu në mendje hallë Shahja, trupi i saj i bëshëm, ftyra e saj simpatike, sytë e zjarrtë, besimi në fitore.

— Ku shkon, ndaloni! — kumboi zëri i Dardanit.

— Mos na ngucni, apo të kalojmë vijën e luftës, ne do shkojmë te tanët, tuejt s'po i marrim me vete, — tha njeriu i Cenit. — I marrim peng me kusht që të mos na ngucni. — Një heshtje me drithma në shpinë për Dardanin. Si të vepron?

— Shtini, vëllazën, shtini! — thirri Abdyli me sa zë kishte. Esesët i shtynë të lidhurit në drejtim të urës.

— Hiç nuk tē dhimbet kryet, a? — foli njeriu i Cenit.

— Mos i kursemi plumbat, shtini, vëllazën! — thirri përsëri Abdyli.

Dardanit i hynte në shënjestër të pushkës në një kohë edhe helmeta e esesit, edhe Abdyli. U zbeh në fytërë. Donte tē shtinte e s'mundej.

— Secili shenjën e vet, kujdes, — porositi shokët Dardani me ballin tē djersitur. Tërhoqi këmbëzën. Trupi i esesit u përdrodh dhe u përplas në kalldrëm.

Edhe plumbat e pushkëve tē tjera goditën bukur mire në shenjë... Njeriu i Cenit mori vrap tē ikte, po s'mundi t'i shpëtonte syrit optik tē pushkës së Dardanit.

\* \* \*

Adilja, infermierja e kompanisë, po kalonte nga një pozicion në tjetrin për tē têrhequr e mjekuar një shok tē plagosur. Befas ndeshi në disa ushtarë armiq. Njëri nga ushtarët i foli. Adilja iu gjegj me pushkë. Ushtari gjerman kishte automatik, Adilja pushkë italiane tē shkurtër. Ndoqën njëri-tjetrin. Adilja vrapoi, kapërceu një hendek e zuri pozicion prapa një shtëpie. Esesi e ndoqi prapa. I zoti i shtëpisë nga dritarja vuri re dhe iu duk se gjermani e plagos i partizanen. Rrëmbeu armën e vrapoi në ndihmë. Adilja mori në shtat një plagë tē lehtë, u hoq pak dhe u mbështet në një mullar. I ndjeu këmbët tē prera. Esesi e ndoqi prapa, u hodh te ledhi në përgjim.

Nga ana tjetër gjakovari e mori esesin në shenjë. Donte tē shtinte mbi tē, por ai e kishte liruar trupin, arma i qe përplasur në tokë. Adilja e kishte qëlluar atë...

Gjakovari që doli nga shtëpia, shkoi përpara në sulm duke e pasur Adilen në krah. Ai u ul në gju, mori shenjë me pushkë, qëlloi e vrapoi duke thirrur:

— O priti partizanët, breee!

Ecëm përpara nëpër plumba...

Fjalët: «Erdhën partizanët!» ecën përpara vijave të formacionit luftarak të brigadave tonë.

Këto fjalë vërshonin me shpejtësinë e erës te populli, thellë fushave të pambarim të Kosovës.

Komandanti i brigadës mbante në vëzhgim sheshin në qendër të qytetit, aty ku dalin thuajse të gjitha rrugët e lagjeve. Rrugët prunë në qendër të qytetit esesët e periferisë, ata ranë nën zjarrin e armëve të partizanëve.

Komandanti i brigadës lëshoi tri shenjëza të tjera mbi qytet. Luftimet e brigadës në qytet arritën në përleshje me graniata. Në vijat e para përleshjet u bënë shumë të ashpra. Sopot Golemi, i rrahur në erërat e maleve dihe në krismat e luftës, zbriti nga kodrat e Çabratit e eci me hov në drejtim të vijave të para të përleshjeve trup me trup.

— Jo ashtu, shoku Sopot, jo! — i tha zëvendëskomisiari i brigadës, Argjir Progri, me dorën e thyer nga plumbi që e mbante të varur krahaqafë me shallin e kuq të partizanit. U përpinq ta ndalonte vrullin e tij.

— S'mundem ndryshe, Argjir, nuk mundem. — I shtrëngoi fort nofullat Sopoti dhe vrapi në drejtim të vijave të para të përleshjes.

E përfshiu vala e sulmit, doli në vijën e parë, por syrin e veshin e mbante në përgjim. Nga atje ai drejtonte luftimet, duke i bërë veprimet e armikut të pavlefshme. Përleshja ishte e madhe. Nga drejtimi i luftimeve varej suksesi mbi kundërshtarin. Ndaloj në vijat e sulmit dhe hodhi vështrimin mbi tërë formacionin luftarak të brigadës, dha urdhra dhe përsëri eci përpara. Dalja e tij në ballin e sulmit ndezi zemrat e gjithë luftëtarëve.

Në vijën e parë dëgjohen zëra:

— Me granata! Me granata!

\* \* \*

Në pozicionin që kishim zënë nuk ishim aq të sigurt nga qitjet e mitralozave që kishim përballë. Prej vendit ku ishim gjer te muri që ishte afër, me një kërcim mund ta arrnim, kështu zinim një pozicion më të sigurt për t'u mbrojtur nga plumbat, po do të ndodheshim në breshërinë e bombave të dorës, prandaj komandantja e skuadrës, Bukurie Çabiri, tha:

— Qëndroni në vend, qëndroni!

Më vonë provuam të merrnim një pozicion, esesët te trekëmbshi, me sy të ndezur derdhën si gjarpri helmin. Në hapat e parë që hodhëm plumbat kafshuan tokën. Provuam edhe një herë tjetër t'i afroheshim trekëmbëshit, por nuk mund ta arrnim, na e ndali hovin e sulmit një mitraloz. Nga gjithë mitralozat që rrithnin sheshin me plumba ai ishte më i rrezikshmi, s'mund t'i fshiheshim vëzhgimit të tij.

— Syri i zhindit, kujdes, nga ai, kujdes! — tha xha Goxhoja dhe shtiu disa herë radhazi. Plumbat i ranë mu pranë frëngjisë te minarja, por jo me rrezik për esesin. Plumbave të xha Goxhos esesi iu përgjigj me «Sharësin» e tij. Një nga vullnetarët e fshatit Batin që kishte zënë vend në krahun tonë mbeti i vrarë.

— Mitralozi i Lulos s'po dëgjohet. Mos i ka ndodhur gjë Lulos? — pyeti xha Goxhoja mbasi zbrazi ballin e fisejkëve dhe deshi të vraponte andej nga sheshi drejt mitralozit armik që na godiste.

— Mos lëviz nga vendi, dëgjon, — e qortoi Dinoja.

— Ama, karrçin bëhet nganjëherë ky Dinoja ynë, — tha xha Goxhoja ende me zemërim të pazbrazur. — Si mund të lihet shoku në çaste rreziku, — dhe fluturoi përmes plumbave drejt sheshit.

— Mos, mos, xha Goxho, — i tha Dinoja. Po Goxho Bërdëllima vrapoi. U shqetësuam të gjithë.

Nga minarja ku qëllonte «Sharsi» u dëgjuan krismat e mitralozit «Breda».

— Mitralozi i Lulos, mitralozi i Lulos, — tha i gë-zuar Dinoja. Ne e hoqëm vështrimin e armëve nga frëngjia. Aty ishte ngjitur Luloja.

Kështu kishte ndodhur edhe atëherë. Në majë të kësaj minareje doli Alush Alia<sup>1)</sup> e shtinte me martinë në drejtimin ku ishte struktur pashai turk. Aty, po në atë vend, shtinte edhe Luloja. Brezat ecnin me grykëhollën në dorë në gjurmë të njëri-tjetrit. Në vend të esesit Luloja... Esesët, që ndodheshin te trekëmbëshi, u hutuan, kurse skuadra jonë mori hov.

— Përpara mbi ta, — thirri thekshëm komandantja e skuadrës.

\*

\*

Era tundi litarin. Trekëmbëshi me atë litar të gjatë të lyer me dyllë, si një fantazmë, mbeti një kohë midis të dy palëve. Ngjante me një gjarpër të zi dhe të frikshëm.

U hodhëm drejt trekëmbëshit për ta përbysur. U sprapsëm nga plumbat e bunkerëve përballë. Luloja i papërbajtur nga zemërimi që nga maja e minares zbrazi një karikator në drejtim të trekëmbëshit, ku lëkundej nga era litari i lyer me dyllë.

— Nuk e dinë qenat e çartun se nuk tutet shqiptari nga konopi as nga trekëmbëshat, — tha partizani kosovar, Haziri, dhe zbrazi mauzerin në drejtim të esesëve.

— Atë duhet ta zhdukim, — tha Dinoja dhe i shkrep-tinë sytë.

Hazir Përdrini vështroi litarin që tundej nga era. Ndoshja i kujtohej ajo ngjarje që më kishte treguar për një nga plagët që i kishte shkaktuar qytetit ai trekë-

---

1) luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, pjesëmarrës në luftimet e Gjakovës (shtator 1878)

mëbësh... Disa kohë më parë Haziri me ungjin e tij, bëcen Shpend, kishte zbritur nga Batini në qytet. Atë ditë te ky trekëmbësh nazistët kishin varur vëlla e motër, Ganimet e Abedin Terbeshin. Po atë ditë kishte lindur në Kosovë një këngë e re për vajzën trime dhe këndohej gjithandej. Fjalët e këngës u ngajnjë tinguje të borisë për sulm. Haziri, me sytë të mbërthyer te litari që e tundte era, murmuriste fjalët e këngës:

*Ganimetja thërret:*

*— Abedin, o vëlla,  
çohu shikoje motrën tënde,  
afër teje ka ra.*

Të dukej se sytë e Hazirit po vështronin vajzën e bukur me ballë të lartë e të gjerë, me sytë e shkruar e vetullzezë, sypatemburën Ganimete Terbeshi në litar. Jo! Atë ditë në litar po tundeshin trupat e dy aktivistëve të luftës nga qyteti.

Gjakova e kuqe gjithë kohën nderoi me grusht.  
Haziri shtrëngoi nofullat, grushtet...

Nga llogorja te trekëmbëshi dolën njëherësh me automatik në duar disa esesë. Pritëm të dëgjonim zërin e komandantes së skuadrës. Ajo nuk foli, ia la radhën të flisnin granatat. Edhe Bukuria vërviti një granatë drejt tyre. Zhurma e saj u përzie me krisma e të bërtitura.

— Mbi ta! — thirri Bukuria. Dinoja shpejtoi si ketri e, si zbrazi automistikun, kërcëu përpara. Bukuria me automatik në dorë e ndoqi hap pas hapi.

Te bunkerët shpërthyen granatat e dorës. Njëri nga partizanët preu litarin. Ai, si gjarpri kur i shtypin kokën, ra në tokë e u mblodh kutulaç. Përsëri në veshët e Hazirit erdhi jehona e këngës për Ganimetin.

Te qoshja e murit u këmbyen krismat e armëve. Atë kohë një eses me automatik në duar u afroa drejt Bukturie Çabirit. Dinoja, që e vëzhgonte lëvizjen e tij, e kishte futur helmetën e hekurt të ushtarit në unazën e automatikut. Tërhoqi këmbëzën. Plumbat ranë në faqen e murit, afër Bukturies. Trupi i bëshëm i esesit bëri një rrotullim rrëth vetes dhe u përplas përmbyss.

Dinoja ra në gjunjë. Donte ta drejtonte armën drejt vrasësit që iu shfaq në krah, por nuk arriti. Tërhoqi gishtin, por plumbat e automatikut të tij shkuau në drejtim të qiellit. Ai e dëgjoi gjer në fund breshërinë. Ishte betuar që në çastin e qirimit të qytetit do të shtinte me automatik.

## XVI

— Mbi tokën e Kosovës janë derdhur si yje luftëtarët e brigadave partizane, — tha ai dhe heshti. U ul mbi gurin kilometrik dhe tymosi cigaren.

— Ka ardhur nga Gjermania, — na tha shoqëruesi.

Ishte djali i atij që kishte varrosur aty buzë rrugës, në arën e vet, partizanin Sokol Geci. Ishte punëtor në Gjermaninë Perëndimore.

U soll disa herë rrithen parcelës me jonxhë, u ndal në secilin cep të arës e balli i mbeti muzg e zemra vrer. E kishin rrëmbyer mendimet kur brigadat luftonin. Ato ditë kujtonte ai. Zenun Suhareka atë ditë qe nëntë vjeç. E mbante mend mirë që në njérën dritare të ballit të kullës së tij luftonte një partizan me automatik, kurse në tjetrën i zoti i kullës, babai i Zenunit. Në xhade autoblinë, që erdhi nga Prizreni, qëllonte ballin e kullës, kurse ata të dy autoblindën. Zenuni jetonte me ngjarjen, kujtonte çastin kur u godit partizani. Ishin më të shuar fla-

kët e pushkëve, dy minuta më vonë autoblinda u ndez flakë nga një shishe me benzinë që hodhi Dardan Velishta. Ai ia mbante mend emrin Sokol Gecit që mbeti i vrarë dhe Dardanit furtunë.

— Si thua, Zenun? — e pyeti Skifteri të zotin e arës. — Mund t'i biesh më të ku u varros partizani? — Ai drodhi një cigare. E thithi duhanin thellë dhe heshti. — Sa mirë që qëlluat këtu, — i tha njëri nga shokët tanë.

— Jo, besa, jo! Më lajmëroi familja, — tha dhe psħeretti me një buzëqeshje të hidhur. — Thithi më dendur duhanin. — Ma ka lënë amanet baba: «Duhet ta ruash!...», më tha. — Qe, këtu rrëth është varri i Sokolit, po e kërkojmë. — Eci tutje me hap të ngadalshëm. Ara e mbjellë me jonxhë shtrihej anës së xhadesë, asnjë shenjë s'dukej... Në mendjen tonë vjen Sokoli. E njihte gjithë brigada Sokol Gecin. Atij i kujtohet porosia e babës: «Kujdes, bir, amanet. Me i hupë eshtnat këtij trimi, mue s'më tret dhei!» Me këtë amanet është ndarë ngajeta babai i Zenun Suharekës. Zenuni kishte vite që ishte larguar, i humbur në dhë të huaj. Kurbeti si kurbeti!... Kishte menduar të kthehej e s'mundej. A mund të kthehej duar-bosh? Dhe ja telegrami, i kërkoheshin eshtrat e partizan Sokolit e s'po gjendeshin. Dhe erdhi... Amanetin s'e tret dhei, bre vëllazën!» — psheretti.

«Ruaje, bir! Do vijë dita që do ta kërkojnë, shqiptari nuk e harron kurrë njeriun e vet, ia do afér eshtnat...», — po i rrıhnin si çekan porositë e të atit. Ai që larguar në dhë të huaj për kafshatën e bukës dhe s'kishte mundur ta ruante e tanë po i binte arës sa andej — këtej mendueshëm.

— Mos u mërzit, do të gjendet, — i tha Skifter Velça. Donte t'ia lehtësonte brengën. Ai qëndroi midis arës me jonxhë i ulur mbi një gur të bardhë. Ishte i veshur me rrobat e malësorit, tymoste duhan e heshtte... Një traktori që endej anës së arës hyri në jonxhë. I dha shenjë dhe traktori lëshoi plugjet.

— Gjithë jonxhën do ta përbysësh? — e pyeti tractoristi.

— Besa po, vorri këtu asht, kemi me e gjetë. Mos u

mërzitni vëllazën, traktorin e kam pague, veç ta gjejmë, — i tha i zoti i arës, Zenuni. Ai kishte shkuar herët në qytet, kishte marrë traktorin dhe na priste.

U hoqën brazda. Asgjë s'po gjendej. Ai ishte ulur këmbëkryq mbi gurin kilometrik dhe thithëte cigaren me afsh. Kështu qëndroi një kohë, pastaj hipi në traktor, shikonte vendin. Ne heshtëm, s'donim t'i rëndonim brengën njeriut që kishte ardhur nga larg.

Mbas pak ai thirri i gëzuar:

— Qe vorri, qe vorri, bre vëllazën!

Në anë të rrugës, në parcelën me jonxhë ku ishte ngritur prita jonë partizane, te dredhat e rrugës, u vendos një piketë me emrin e partizan Sokolit.

Komandanti i brigadës, Sopot Golemi, dhe zëvendëskomisari, Argjir Progri, i cili ende nuk ishte shëruar mirë nga plagët, mbas çlirimtë qytetit të Gjakovës e kthyen vështrimin e brigadës në drejtim të Prizrenit. Lufta për çlirimin e qyteteve ishte në rendin e ditës.

— Duhet të përgatitemi seriozisht për ndeshjen, — tha Sopot Golemi.

— Toka po u digjet nën këmbë, krismat u rralluan..., — tha Argjir Progri.

— Mos harro që, kur rrallohen krismat, vrapojnë në sulm të zotët e armëve, — tha Sopoti. — Vilenbergu me kokëfortësi do të mbrojë tërheqjen, prandaj duhet t'i jepim grushtin dërrmues.

— Kjo është e vërtetë, por..., — zëvendëskomisari ndërpren fjalën për t'i dhënë vetes kohë të thoshte një fjalë më të studiuar. — Asgjësimi i garnizonit armik të Prizrenit i vë plotësisht në kushte rrëthimi divizionet e tyre në veri të Shkumbinit.

— Këtë ata s'do t'ia lejojnë vetes, nuk mund t'i lënë këto forca të rrighthohen.

— Kjo nuk varet vetëm nga ata, — tha Sopoti dhe i vetëtinë sytë. — Një batalion ra në luftim... Kockat e tyre duhet t'i lënë pikërisht në këto shtigje, doemos ne duhet ta çlrojimë qytetin dhe t'ua ndërpresim rrugën.

— Besoj se kanë nxjerrë mësime nga disfata që pësuan në Gjakovë e gjetkë...

— Mundet, — tha Sopoti, — po e dëgjove ç'na tha ai robi mbrëmë?

— Ndoshta gënjeu, jo qdo gjë mund t'i besohet një esesi, ndryshe bie në kurthe të papritura.

Esesi i zënë rob pos të tjeras hikste pohuar se, para se të largonte shtabin e tij nga Mitrovica (Trepçja) për në Sarajevë, gjenerali i Gruparmatës «E» thirri në raport pesë nga gjashtë gjeneralët e korparmatave dhe fill mbas tyre ishte paraqitur kolonel Vilenbergu. Korparma-ta XXI malore, forcat e së cilës ishin të gozhduara në vend, lëvizte ngadalë në drejtim të Shqipërisë së Veriut. Komandanti i Gruparmatës «E» ishte i shqetësuar. Një e katërtë e ushtrisë së tij, rrëth gjashtëdhjetë e pesë mijë ushtarë, rrezikoheshin të binin në rrëthim. Atyre ende u mbetej e lirë rruga që kalonte nëpër Kosovë. Sa kohë do të mbetej e lirë kjo rrugë? Komandanti i Gruparmatës «E» i hikste thënë kolonel Vilenbergut:

«Të ecësh nëpër këtë rrugë, është njësoj si të ecësh në një tel të hollë që nga çasti në çast mund të këputet, por rrugë tjetër s'na ka mbetur. E vëtmja gjë që mund të bëjmë për divizonet e përqendruara në zonën Tiranë-Shkodër është mbajtja e lirë e kësaj rruge gjë në ditët e fundit të nëntorit». Kolonel Vilenbergu mori urdhër: «Me qdo kusht do të mbash qytetin e Prizrenit dhe rrugën Prishtinë-Shkodër të lirë!» Ai u kthye në vendkomandën e tij në Prizren dhe mendonte për detyrën që iu ngarkua. Ndërsa po mendohej, hapi zarfin që i vinte nga komanda eprore.

Shtabi gjerman u drejtohej me një letër ushtarëve:  
*Ruga e Gruparmatës sonë është e gjatë. Qindra ki-*

*lometra për atë nuk ka linjë hekurudhore. Në vargmalet që kalojmë ka shkëmbinj, rrugët nuk janë të mira. Na duhet përsëri të bëjmë manovrime për têrheqje, por ato kërkojnë kohë të gjatë. Prandaj duhet të kemi durim... Secili ushtar i gruparmatës, në kuadrin e përgjithshëm të shkurtimit strategjik të vijës së frontit, realizon një detyrë të domosdoshme dhe kuptimplotë, qoftë kur ai kryen luftime të ashpra kundër armikut që sulmon, qoftë kur ai për javë të tëra, ditë dhe net, me pushime të shkurtra marshon, ase qoftë edhe atëherë kur diku bën rojë pranë stacioneve të trenave dhe të rrugëve për të sigruuar marshimin e kameradëve të tij.*

Kolonelit i pëlqeu përbajtja e saj. Fjalët shprehnin gjendjen e vërtetë. Kolonel Vilenbergu asnjëherë nuk dëshironte t'u tregonte të vërtetën vartësve të tij, por filli i ngjarjeve në zonën ku vepronin forcat e divizionit «Brandenburg» ishte i tillë që ai duhej të tregohej tepër i vëmendshëm.

Shprehja «shkurtim strategjik në vijën e frontit» ishte një term që fshihte atë që ndodhët, têrheqjen e përgjithshme të ushtrisë hitleriane nga gadishulli i Ballkanit. Ky term maskon të veprimet e kjo i duhej kolonel Vilenbergut.

\* \* \*

Luftimet bëheshin më pak të ashpra për t'u ngritur prapë dalngadalë si valët e detit më të fuqishme. Sopoti hodhi vështrimin me dylli mbi Prizren, dhe vazhdoi:

— Krismat në kësot raste, Argjir, ia lënë vendin hovit të zemrave... Në ditë me re të zeza në Kosovë zëri i pushkës ka një fuqi të quditshme.

— Kur zemërimi lëngon gjatë, shpërthen vrullshëm e me bubullimë, — tha Argjiri.

Çdo kosovar për kolonel Vilenbergun ishte bërë i dyshimtë, çdo burrë me tirq të bardhë që hynte e dilte

nëpër kullat buzë xhadesë, në çastin e parë mund të nxirrte në përgjim grykëhollën. Kullat e bardha të fshatrave të grumbulluara nëpër fushën e gjerë nxorën në frëngji syrin e pushkës... Kjo i fuqizoi veprimet tonë luftarake, se, po hodhi dorën kosovari te pushka, të huajin e pret varri.

Garnizonet me ushtarë esesë, të vendosura në pikat e ndryshme në afërsi të Prizrenit nën goditjet e brigadave partizane lëkundeshin. Ato, pasi harxhonin edhe pikën e fundit të energjisë së tyre, po të mos rezistonin dot, iknin ose dorëzoheshin. Ndërsa garnizoni i Prizrenit përforcohej e rritej me shpejtësi.

— Aty të godasim, — tha komandanti i brigadës, Sopot Golemi, me zë të prerë dhe me vështrim mbi Prizrenin.

Brigada në formacion luftimi lëvizi në drejtim të qytetit.

\* \* \*

Kolonel Vilenbergu për pak e shkruhu zemërimin e pritës sonë me mjetet e blinduara që dërgoi, por Dardani e pikasi që armiku kërkonte të na mashtonte dhe i shqetësuar thirri me zë të prerë e të lartë:

— Mos shtini! Le të kalojë autoblinda!

Luloja e shtrëngoi fort me të dy duart mitralozin dhe qytën e mbështeti në sup. Heshti ai, heshtëm ne të gjithë.

— Të huajt, kur na shkelin, mburren se na gjunjëzuan e, kur ikin, s'dinë nga të dalin, përplasen si qorri, — tha një partizan kosovar. — Ku dreqin shkon ky xhind hekuri?

— Erdhën nga ana e anës dhe na e gjerryejnë dhe un tonë me zinxhirë tanku, — tha Lulo Driza e ofshau.

— Këtu do t'i lënë eshtrat, — tha Haziri dhe shtrë-

ngoi nofullat i zemëruar që s'iu dha rasti të zbrazte granatat mbi autoblindën.

Lulo Driza, shtrirë mbi tokën e lagur, në anë të xhadesë, te guri kilometrik, qëndronte me gishtin në këmbëzën e armës dhe syrin te shënjestra. Mbas autoblindës erdhë një kolonë në tetë makina të lyera me bojë dheu. Komandantin e kompanisë, Dardanin, e rrëmbeu gëzimi që kolona u befasua e thirri:

— Zjarr! — dhe zbrazi dhjetëshen e tij. Plumbat e mitralozit të Lulos dhe plumbat e armëve të pritës prenë në një kohë trupin e kolonës armike si pret kosa barin.

Luloja shkruante vjersha dhe këndonte bukur. S'mund të përcaktohet se kush e bëri atë aq të njojur në të gjithë brigadën, kënga, se Lulo Driza i kishte marrë zërin bilbilit, vjershat e goditura që botoi në bulletinin e brigadës, skeçet që luante në skenën e teatrit të brigadës, apo krismat e mitralozit? Njëra pa tjetrën e cungojnë portretin e Lulos.

Haziri, i rrëmbyer nga gëzimi i sukseseve që arritëm në luftime, pranë Lulos zuri të këndonte një këngë maje krahу. Mitralozin e gjuajti mortaja. U dukën afër nazistë të tjerë. Filloi këngën mitralozi i Lulos që shtinte mbi armiqtë, po mitralozin e tij e kishte vënë në shënjestës mortaja armike.

— Heu, si leh si qen, — tha Haziri dhe qëllonte. Një predhë shpërtheu afër tyre. Lulon e Hazirin i mbuloi baltë. Kur ndërruan vend, këmbë e kokë ata ishin tërë baltë.

Një re e dendur kaloi faqes së malit...

■ ■ ■

Kolonel Vilenbergu, kur i thanë se natën partizanët po u afroheshin kalasë dhe qytetit, e ngriti krifën si një tigër. Vilenbergu u lidh me telefon e radio me vartësit e tij, veshi kapotën e ushtarit e doli me ngut. Bubullimat

e luftës po i shponin veshët, deshi të ngjitej në kala, po kësaj here nuk guxoi të ngjitej pa autoblindë.

Në muret e kështjellës tytat e mitralozave dhe sytë e esesëve të egërsuar përgjonin me ankth. Ata kishin mbështetur gjoksin në muret e gurta e faqet në armët e ftohta dhe vështronin rrugët dhe malin. Dritat e prozhektorit rrëmbyen pllajën e malit dhe pullazet e shtëpive të qytetit. Dritat lodronin herë mbi mal e herë mbi qytet. Rrugëve në qytet, në të dy anët e lumit Bistrica, gumëzhinin si përbindësh disa autoblinda e tanke. Ato i binin rrugës nga kreu në fund.

— Në sulm, përpara! — thirri komandanti i brigadës.

Krismat dhe flakët e armëve vërvshuan nga lagjet e jashtme në qendër të qytetit. Gjëmimet e krismave në qytet erdhën e u bënë më të ngjeshura, më bubulluese. Dëgjohen zëra: «Përpara, partizanë!»

Luftimet po zhvilloheshin shtëpi më shtëpi dhe rrugë më rrugë.

Sopot Golemi e kuptonte se kishte pak eksperiencë nga luftimet në qytet. Kjo ia bënte më të rëndë drejtimin e luftimeve, prandaj ai me ballin të vrenjtur jepte urdhra dhe e cte edhe vetë përpara, duke e çarë rrugën me breshëri plumbash.

Brigada vërshoi nëpër rrugët e rrugicat e qytetit. Kompanitë me ushtarë të kolonel Vilenbergut dolën rrugëve si zvarranikët kur bie tërmët.

Ata i lanë pozicionet dhe ikën si hije...

Cen Gozhita me një grup oficerësh kërkonte të ikte, por as që dinte drejtimin nga mund të largohej. Nga jug-perëndimi apo nga veriu.

Atë natë Ceni e ndiente kokën fare-fare të mpirë. U përsërishtë kolegëve të vet të njëjtat fjalë. E kuptonte se varka e tij përpëlitez midis dallgëve.

Hitlerianët nën goditjen e armëve partizane po largoheshin për të shpëtuar lëkurën. Ata po iknin si hijet e natës.

U dëgjuan afër ndërtësës pushkë dhe zëra.

Cen Gozhita e ndjeu veten të zënë si një egërsirë në kurth, po egërsira për t'i shpëtuar kurthit pret dhe një nga gjymtyrët e saj, kurse Cenit i mungonte guximi. Kishte parasysh një fund tjetër nga ajo që i doli. Trupin e ndjeu të ftohtë, një me kufomën, ashtu e ndjeu. S'deshi t'i dorëzohej frikës dhe brofi në këmbë e thirri:

— Armët, burra! — U zbeh... Asnjeri s'guxonte të dilte në derë, dera u dukej një gropë varri, nuk i afroheshin. Tradhtanit i vjen e dyfishtë frika.

Cen Gozhitës i dridhej naganti në dorë. Ata që ishin rrëth tij u habitën. Asnjëherë nuk e kishin parë me ftyrë të zbehur Cenin. Disa gaste ata i kaluan ashtu me sy të zgurdulluar, duke parë njëri-tjetrin.

Cen Gozhita vilte frytet e asaj që kishte mbjellë.

Ceni e ndjeu helmin më afër buzëve të tij.



Kolonel Vilenbergu fërkoi sytë e skuqur nga pagjumësia. Nuk po dinte ç'drejtëm të merrte. Ushtarët e tij si një kope e trembur dolën nga qyteti dhe ecën ca në drejtëm të Prishtinës, ca të tjerë në drejtëm të Kukësit. Po ai në cilin drejtëm të shkonte? Kishte marrë urdhër të mbulonte tërheqjen. Braktisja e qytetit nga ushtarët e tij e bëri bishë. Fytyra e hollë dhe e gjatë iu shtrembërua. Sytë e pangjyrë iu venitën. E kuptoi që divizioni i tij rrëshqiti drejt një humnere.

Mendoi për detyrën. Gjenerali i gruparmatës «E» në Mitrovicë i kishte thënë: «Kujdes, është e vëtmja rrugë që na lidh me forcat që luftojnë në Shqipërinë e Veriut!» Kolonel Vilenbergu e vlerësonte detyrën.

Rruga Prizren-Shkodër ishte si një litar që i hidhet

atij që e rrëmbejn vërshimi i lumiit për t'u kapur, por brigada partizane, e komanduar nga Sopot Golemi dhe partizanët vendas, me një goditje të fortë e prenë më dysh zvarranikun që shtrihej me kokën në afërsi të Prishtinës e gjer në Kukës. Kolonel Vilenbergut i takonte të ishte nga koka e jo nga bishti, ndaj, megjithëse ra nën një breshëri plumbash, kaloi çezmat e ftohta dhe deshi të hidhej në anën tjetër të Bistricës. Aty afër urës së gurtë ia prenë rrugën dhe breshka e hekurt u zmbraips duke qëlluar me mitraloz, mandej mori rrugën në drejtëtim të Kukësit.

\* \* \*

Mbi majën e Koritnikut u shfaq Ylli i Mëngjesit dhe pritej të gdhihej. Por ende ishte natë kur filluan luftimet e ditës së dytë te prita. Edhe kësaj here makinat na erdhën në grykë të pushkëve.

Nga kolona që doli nga qyteti me pushkët e para një makinë mbeti në xhade te kthesa. Shoferi u godit dhe ra përmbyss mbi timon. Dritat e makinës i ranë në fytyrë Bukurie Çabirit që kishte zënë pozicion përballë. Ajo mori në shenjë dritat e makinës, por ato ishin afër dhe e verbuan. Shtiu me automatik. U shuan dritat, por mbiu aty një zjarr tjetër. Digjek motori. Disa ushtarë lëvizën si silueta të quditshme pranë Bukuries. Ajo hodhi mbi ta një granatë.

— Bukurie motër, Bukurie, — i thirri Haziri dhe shkoi andej.

Bukuria rrëshqiti në drejtëtim të makinës. Në fillim eci këmbadorazi, me rripin e automatikut të hedhur në bërrylin e dorës. Nuk kishte ecur asnjëherë kështu, por nën breshërinë e dendur dhe të paprerë të plumbave që qethnin vendin vetëm kështu mund të ecej.

U ndodh ballë për ballë me një ushtar eses. Urrej-tja i vloj në gjoks. Bukuria dhe esesi i zbrazën njëri-tje-

trit ç'kishin në karikatorët e automatikut. Goxho Bërdëllima rrëshqiti në drejtim të Bukuries. Përsëri u zbraz papritur një armë. Afër u dëgjua zëri i Vasos.

— Vaso, — i foli Bukuria.

Intendenti u hodh andej nga ajo, zuri pozicion afër saj e qëlloi. Një makinë me arka me fishekë ishte afër, kishte mbetur në rrugë.

— Kujdes, mos shtini mbi atë, kujdes! — foli me zë të lartë e me frikë intendenti. Rrëshqiti këmbadorazi, iu afrua makinës e murmuriti vargjet e tij të preferuara. Thirri:

— Mos shtini! Mos!

Vasoja mundohej të shkarkonte nga karroceria arkat me fishekë. Kishte në rrugë arka me fishekë e granata, por Vaso i therte në zemër kur shikonte flakën që afrohej në drejtim të tyre.

Mbetën në rrugë trupa pa jetë, u kapën robër... Një pjesë e esesëve mundën të kalonin, shkuan në drejtim të Kukësit.

Kompani të tjera të batalionit tonë ishin në pritë... Shpresat e kolonel Vilenbergut për ta nxjerrë kolonën nga pritat humbën.

— Dridhu, armik! Dridhu, armik! — Luloja e njuhu zërin, ishte zëri i Bukuries, komandantes së skuadres.

Arkat me fishekë, granata dhe armë u mblodhën në xhade. Intendent Vasoja nuk përmbahej nga gjëzimi.

\* \* \*

Drini është i bardhë. Flakët e pushkëve të kuqe. Drifta e ditës shfaqi para syve të njerëzve në xhade kufomat e armiqve dhe makinat e djegura.

U zunë nga brigada në qytetin e Prizrenit: depo, kazerma, armë..., topa dhe armë në fortifikata. Për kolonel Vilenbergun nuk u fol gjë. Goxho Bërdëllima nga

një autobblindë që po digjej nxori një xhaketë ushtarake me grada koloneli.

Ndoshta ishte ai...

Këngët, brohoritjet e krismat qëndruan të ndezura gjithë ditën e gjithë natën në Prizren. Ditën tjetër në mëngjes herët brigada u rreshtua. Foli komandanti i brigadës, Sopot Golemi. Në çastin që ai po fliste, radisti i brigadës i dha një fonogram. Nga vështrimi i syve kuptuam që erdhi një lajm i gëzueshëm. Çfarë njoftohej në atë fonogram? Sopot Golemi hoqi nga mesi dhjetëshen dhe, duke e zbrazur atë, mbas çdo krisme tha:

— Tirana u çlirual!

Kudo: në kazerma, në rrugë, në shtëpi, gjëzim i papërbajtur. Brohoritjet e partizanëve dhe të popullit nuk kishin të sosur. Midis qytetit, në sheshin me kalldrëm, te çezmat, një grup partizanësh po hiqnin një valle të vrullshme, të tjerë ia thoshin këngës. Në ballë të valles doli xha Goxhoja, e kishte hequr kapelen dhe e tundte në vend të shamisë. Xhaketa e kolonelit i binte pak e gjatë. Këndonte xha Goxhoja:

*Kurvelesh e Gegëri,  
ç'u mblodhë në Ergjëri.  
Ky Abdyl bej Frashëri,  
ç'u përpoq për Shqipëri.*

Komandanti i brigadës vazhdoi ligjërimin e tij. Ai tha:

— Rruga që kemi pëershkuar ngjan me shigjetën e kuqe të vetëtimës që çan midis errësirës së reve. Ju shoh që syri ju bën shtatë palë drita. Bashkë me brigadat e tjera dhe popullin trim e patriot të Kosovës i hoqëm ar-mikut një brinjë, ai e ndien atë, i dhemb; por kjo nuk e

ktheu trupin e divizionit «Brandenberg» në kufomë. Do të kemi ende punë me esesët e këtij divizioni. Prandaj të shtrëngojmë radhët, t'i ngjeshim armët edhe më fort dhe t'i ndjekim esesët këmba-këmbës.

— Gjer në Berlin, t'i ndjekim, komandant, gjer aty që ta varrosim përgjithmonë kufomën e nazizmit, — tha Dardan Velishta dhe ngriti lart pushkën dhjetëshe.

Zëri që dëgjoi Sopotit iu duk zë i njojur, vështroi që të dallonte atë që foli, por nuk e pa, ngaqë brigada ngriti armët e thirri:

— Këmba-këmbës t'i ndjekim názistët, këmba-këmbës!

U nisëm në drejtim të veriut...

## XVII

— Tungjatjeta, burra! — na përshëndeti një fshatar që na priste në hyrje të fshatit. Nuk mund të kalosh afër kosovarit pa të përshëndetur ai. Takuam vështrimet e duart, mandej këmbyem nga një cigare.

— Ku shkon? — na pyjeti.

I treguam.

— Të brigadës së Sopot Golemit jeni? — tha. Bise-duam për brigadat. Përmendim emra të brigadave. Brigada e Parë, Brigada e Tretë, Brigada e Katërt, Brigada e Pestë, batalioni i Dibrës, Brigada e Gjashtë, e Shtatë, e Tetë, e Tetëmbëdhjetë, e Njëzetedytë, e Njëzetepestë dhe vendet ku kanë mbetur gjurmët e gjakut tonë në Maqedoni, Serbi, Mal të zi, Sanxhak e Bosnjë. Ato i gjejmë edhe këtu në Kosovë në trojet shqiptare ku banojnë vëllezërit tanë, i kanë ruajtur ashtu si ruan vëllai vëllanë.

— Më thanë se kërkoni eshtnat e Sadik Ramës, — tha ai

për dëshmorin që kërkonim dhe vazhdoi: — Bash afër ndodhen, qe, aty te bungu i madh, në rranjët e lisit e kenë. — Foli për Sadikun. — Qebesa, kot kemi shpëtue atë ditë. Ishin mal gjylet e topit e baruti në atë shtëpi. I kishin lanë esesët në vend. Nga nji gacë mori zjarr arka me barut. Sadiku burrë me zemër ishte! Brofi në kambë, e rrëmbeu arkën dhe u hodh nga shkallët bashkë me flakën. U dogj... Ama ne të tjerët, mbi njizet shpirt ishim, shpëtuem. U munduem ta shpëtonim, s'qe e mundun, ishte ndezë i gjithë. Vdiq për të shpëtue shokët e vet dhe shtëpinë ku ishim!

— Ju e dini ngjarjen, ashtu ka ndodhur, — tha Skifteri. Rrudhat në ballë iu thelluan. Është dhimbja e shokut për shokun. — Nga ky fshat jeni? — e pyeti Skifteri atë.

— Jo, jo! — tha ai. — Dëgjova që po vinit dhe erdha. Ato ditë isha bashkue edhe unë me partizanët e brigadës së Sopotit.

— Në cilin batalion? — e pyeti Skifteri. Ai tregoi batalionin.

— Ke qenë në luftimet e Sanxhakut?

— Me brigadën deri në Bosnjë, deri në mbarim të luftës. Edhe në parakalimin që bëmë në Tiranë kam qenë. Edhe Komandantin e kaim pa, kur parakaluem parat e kur erdhë dhe na foli.

— Fytyrë e njojur, — belbëzoi me vete Skifter Velça. E pyeti: — Kush ka qenë komisari i batalionit tuaj?

— Komisar? — Kosovari ia nguli sytë Skifterit, hetonte ballin, sytë, flokët... — Mali me mal nuk takohet, njeriu me njeriun takohen, o Skifter Velça, — i tha kosovari.

Ky takim s'ishte si takimet e tjera. Ky takim midis vellezërish. midis luftëtarësh ishte ndryshe...

Ecën dhe ai si atëherë në kolonë, ecën në gjurmët tonë që mbeten të ndezura. U nisëm në drejtim të Grykës së Ernalevës, në shtigjet nga kaloi brigada,

Brigada nē ecje ishte e lehtë, e gëzuar, energjike.

Gryka e Ernalevës zë fill me livadhe tē bukura, me tokë tē butë, me kodra tē pyllëzuara. Ajo nis nē fillim pak e gjerë, nē zbritje nē drejtum tē Shtimjes ngushthohet, aq sa ngjan se dy anët e maleve puqen me njëri-tjetrin.

Xhadeja dredhonte nëpër grykë.

— Në Grykën e Erërave jemi?

— Qebesa nē këtë grykë kurrrë s'kanë pushue ernat..., — tha një partizan kosovar.

Kaluam Qafën e Dulit e hymë nē grykë. Kolona e ndjeu erën e Ernalevës dhe hapi i luftëtarëve u bë më i shpejtë, vështrimi ynë më i largët dhe iku nga rrështi pësha e lodhjes. Hyri nē kolonë fjala:

— Ernaleva! Ernaleva!

Ne dinim hollësira për këtë vend, na kishte folur disa ditë më parë nē mbledhjen e batalionit baca Shpend. Gjer këtu nē Qafën e Dulit, te Gryka e Erërave, na pati përcjellë baca Shpend. Burri i Batinit, baca Shpend, na kujtoi njerëzit e Batinit e vështrimi ynë mbeti prapa, nē fund tē bjeshkëve e nē anë tē fushës së fshatit Batin. Diemtë e Batinit erdhën me brigadën, vunë nē kapele yllin partizan dhe ecën nē rrësht me ne.

Baca Shpend bisedonte me komandantin e brigadës, anash kalonin tē njohur, i flisnin nē emër. E përshëndesnin tē gjithë, shumica e luftëtarëve tē brigadës e njihnin bacën Shpend. Ai mbi kalë mbante tē hedhur mbi gjunjët mauzerin, nē brez nagantin dorezëbardhë ku ishte shkruar: «Vlorë, 28 nëntor 1912.» Më kujtohet biseda që bëri kur bujtëm nē shtëpinë e tij. Ai na foli edhe për këtë grykë me erë. Ernalevë! Emër i bukur.

— Qe búngu që tē kam folur, — i tha baca Shpend komandantit tē brigadës. Ai që s'dinte t'i rrihte qerpiku ndjeu një dridhje tē fortë dhe iu ndez kureshtja tē dinte. Syrit tē burrit tē moçëm tē Batinit nuk i shpëtoi asgjë dhe shtoj; — Bash aty qëndronte, pesë hapa nē krah tē

bungut. Isha afér tij kur i binin predhat e topit pranë e ai atje se atje, s'dinte të ulej, luftonte në këmbë.

Sopot Golemi i shtrëngonte frerin kalit, donte të dëgjonte për betejën e Ernalevës. Ai, baca Shpend, fliste si dëshmitar i saj.

— Rrjedhë e përbashkët, — tha baca Shpend me vështrim te bungu në shpatin e malit ku i përfytyrohej kryetrimi Isa Boletini. Ata biseduan gjatë, shtrënguan duart fort dhe aty u ndanë. Sopot Golemi e bëri veri kalin gjersa doli përsëri në krye. Kolona ecte anash një shkëmbi, një shkëmb që ngjante si një digë e mbyllte njërin shpat të grykës.

— Shkëmbi i Mic Sokolit! Shkëmbi i Mic Sokolit! — thanë partizanët kosovarë që ecnin në kolonë. U mbërthye vështrimi i tyre mbi shkëmb.

Fliste gjaku... Kishin dëgjuar nga gjyshërit e tyre për këtë shkëmb, për këtë grykë, për topat «Krup» të Perandorisë Osmane, për gjoksin legjendar të Mic Sokolit në grykë të topit, për...

Tej kësaj shtrihej përsëri fusha e Kosovës.

Fusha e Kosovës: e sheshtë, e gjerë, e gjatë, të duket e pambarim. Kërkon syri një gur apo një shkrep ku të mbështetet pushka në pozicion. Mos kërko, se nuk e gjen, as gurin, as kodrën dhe as gérkhin. Gjerësia e fushës shtrihet si gjerësia e detit. Këtë shtrirje të gjerë të fushës së Kosovës e vë re vetëm kur i shëtit të gjitha skajet e saj. Ecja në rresht me shokët dhe mendoja:

«Kosovë! I pashë fushat dhe malet e tua, fshatrat e qytetet. U mahnitë nga vështrimi mbi bukuritë e tua ku fusha shtrihet në të gjitha drejtimet e butë, e blertë, e... Në bjeshkët e tua të larta pashë lisin trupgjerë, ahun e pishën që shkojnë drejt qiellit gjer ku të merren mendtë kur u vështron kurorën. Pashë...»

Mendimet m'u ndërprenë nga vuvurima e qiellit dhe nga thirrrja e Dardanit: «Mos lëvizni!» Papritmas mbi kolonën e brigadës kaluan gjuajtës gjermanë, mandej Hazziri, me zërin e tij të thekshëm, këndoi një këngë për Isa Boletinin, komandantin me opinga dhe tesha bardhezi e

qylaf të bardhë si bora në bjeshkë. Kjo llogore i lartësoi zërin kryetrimit të Mitrovicës që Shqipëria e thërriste Isa Boletini i Shqipërisë dhe Evropa Garibaldi i Ballkanit. Isa Boletini, Isa i Shqipërisë! Në sytë e mi erdhi ai shtatlarti me dy nagante dorezëbardha në brez, erdhi ashtu siç na e kishte përshkruar baca Shpend, burrin dyzetegjashtëvjeçar që drejtoi betejën e Ernalevës kundër hordhive të Turgut pashës, burrin që i dha krahun e fuqinë Shqipërisë.

\* \* \*

Ecëm nëpër grykën e Ernalevës. Në anë të rrugës një varr partizani. Në dalje të grykës, ende pa arritur në Shtimje, në shpatin që zbret në fushë u godit nga plumbat armiq Emin Duraku. Thuhej se në këtë grykë preheshin kockat e Mic Sokolit me tre trima. Mici e mbylli grykën e topit me gjoks. Emin Duraku mbolli lule të kuqe në fushat e Kosovës dhe u qëllua këtu me dy plumba pas shpine. Nga erdhën ata plumba? Kush shtiu mbi Emin Durakun?

Haziri bashkë me një partizan tjetër kosovar kënduan këngë maje krahu, këngën e Kaçanikut e të Ernalevës. Këto janë këngë kushtimi. Kori i brigadës këndoi këngën e Emin Durakut...

Marshimi është i gjatë. Nga kreu në fund të kolonës erdhi urdhri i komandantit të brigadës.

— Më shpejt, shokë, më shpejt!

Rrugës ndeshëm ura të prishura, njerëz të masakruar. Ndiqnim këmba-këmbës esesët e kolonel Vilenbergut.

Nga marshimi i gjatë ishim djersitur, një shi i imët vazhdonte të binte. Shiu na dukej i butë, i ëmbël. Toka nxirrte avuj të ngrohtë, mbi fushë një hark ylberi. Marshuam pa u ndalur. Iu afroam Prishtinës...

Në rrugë afër Prishtinës një fshat i madh. Shtëpitë e bardha të fshatit janë midis fushës. Anës së fshatit kalloni xhadeja. Përpara është Prishtina. Këtu u vra Sadiku. Atë ditë ecnin në këtë rrugë batalione e brigada. Në kolona zbardhonin bardhë si bora qeleshet e bardha, opingat me syprina të bardha... Qindra e mijëra kosovarë që hodhën dorën te pushka, vunë yllin në ballë. Ecnim të gjithë në një hap.

Në krye të kolonës komandanti i brigadës, Sopot Golemi, mbante në sy dylbinë. Në çdo hap që hidhним па-pritur mund të ndeshnim në esesët. Në çdo hap që hidhним në Kosovë ndeshnim gjurmët e luftës. Gjashtë korparmata naziste ishin tërhequr nëpër këto rrugë. Si një vllagë vullkani përvëlues u ndie në Kosovë lëvizja e Grup-armatës naziste të Ballkanit e të detit. Egje. Divizioni i kolonel Vilenbergut mbronte ato nga goditjet në brinjë. Ne i ndjekim këmba-këmbës...

Një djalosh shtatgjatë, me mustaqe të zeza e me mauzer në krahë, i pret rrugën komandantit të brigadës, nderon me grusht dhe kërkon të vijë partizan. E quajnë Azem. Komandanti i brigadës i tha të hynte në rresht. Azemi nuk hyri në rresht, diçka tjetër kërkonte. Ai tha:

— Shoku komandant, due pak kohë sa të marr pushkën!

— Pushkën? — pyeti Sopoti dhe e vështroi me kurreshtje.

— Po, — tha ai dhe vështroi te mullari me bar. Komandant Sopoti kuptoi që fjala e djaloshit kishte një domethënje tjetër.

Azemi shkoi me vrap në drejtim të një mullari me bar. Me ndihmën e shokëve nxori andej një top dhe disa arka me predha. U mblodhëm rrëth topit.

— Ku e gjetët? — e pyeti komandanti i brigadës.

— Në çastin kur mitraloi aeroplani, ata e braktisën topin. Bashkë me disa fshatarë të mi shpejt e shpejt •

fshehëm në mullarin e barit. Erdhën ushtarët dhe e kërkuant topin.

— Nuk e gjetën? — pyeti dikush nga ne.

— Nuk e gjetën, ikën duarhatë në Prishtinë.

U shtua në brigadë edhe një partizan. U shtua edhe një armë lufte...

\* \* \*

Ushtarët e divizionit «Brandenburg» ishin tèrhequr me ngut nga ky fshat afër Prishtinës ku na mbeti i vratë shoku ynë, Sadiku. Ata kishin lënë në vend municipione. Vasoja e furnizoi kompaninë me fishekë, ngarkoi mushkën e mitralozit të rëndë, por kërkonte ende. Ku ngej syri i Vasos me fishekë!

— Ç'janë ata fishekë për kompaninë? Hic gjë! Një ditë lufte dhe shokët kërkojnë: «Fishekë, Vaso! Granata, Vaso!» E ku t'i gjejë Vasoja? Partizani në radhë të parë kërkon fishekë, ku t'i gjejë fishekët Vasoja? Hë de, fol, ku t'i gjejë? — Prandaj nuk i bëhej të largohej! Mbeti në vend, qëndroi me sytë ziliqarë të ngulitur tek arkat, si njeriu i uritur që është ulur pranë sofrës, por duarli-dhur.

— Më ndihmo, të lutem, më ndihmo, vëlla, — i thoshte Vasoja, një kosovarit që kaloi aty me dy kuaj të lartë e të bukur të mbrehur në karrocë.

Intendenti u erdhi njéherë rrëth kuajve e u përkëdheli lelet e gjata. Arkat me fishekë e granata që kishin lënë në vend esesët i vuri një e nga një në karrocë.

U nisën në drejtim të Prishtinës.

— Shumë rëndë, — u ankua i zoti i kuajve.

— Ç'të bëjmë, vëlla, na duhen më shumë predhat se buka! — tha Vasoja me zë lutës që ta kuptonte tjetri se ajo punë duhet të çohej gjer në fund.

— Po besa, — pohoi kosovari. — Trimat duan municipion. Trimat duan...

Afër lisit, në anë të rrugës, një varr. — Sadik, shok,  
— murmuriti Vasoja.

— Yaaa! — u thirri i zoti kuajve e ata të hazdisur  
vrapuan xhadesë. Vasoja kolovitej në karrocë midis ar-  
kave me fishekë e granata e murmuriste vjershën e tij  
të preferuar:

*Asgjë nuk duam, nukë,  
vetëm plumbë dhe pak bukë...*

— Po besa, u duhen trimave fishekë..., po besa! —  
tha fshatari kosovar dhe u grahu kuajve; — Yaaa, yaaa!

— Eshtë larg Prishtina? — pyeti Vasoja. Brigada  
ishte bërë erë. Mbi ta u ndie papritmas vuvurima e një  
motori. Vasoja vuri dorën mbi ballë dhe vështroi qielin.  
Nuk pa asgjë. Dëgjohej diku larg mitralimi që bënte ae-  
roplani.

— Më duket mitralon brigadën, eh, kjo sorrë, — u  
ankua Vasoja. — Jepu, vëlla, jepu kuajve...

Karroca u bë veri. Ecnin xhadesë, në drejtim të Pri-  
shtinës. Kërkoheshin në vijat e luftës fishekë e granata...

Papritur një gjuajtës me kryqe në krahët u ul afër  
tokës dhe volli plumbë. Tymi i xhadesë përpëra karrocës  
u ngrit lart. Kuajt harbuan të trembur.

— Më shpejt, vëlla, më shpejt... Ah, nga mbiu kjo  
grifshë në qiel! — u ankua Vasoja. Kosovari u grahu  
kuajve.

Nuk arriten në kompani. Në mitralimin e dytë njëri  
nga kuajt ra në tokë i copëtar, qerrja u përbys në anë  
të rrugës. Vasoja, sapo mori veten nga hutimi, e ktheu  
pushkën në drejtim të qielit.

Ishë vonë. Avioni qe larguar...

\* \* \*

Rruga e hekurudha ndërmjet qyteteve Ferizaj-Prish-  
tinë-Mitrovicë është mbushur me makina e vagona tre-  
ni të markave gjermane, greke, serbe, bullgare, france-

ze... Dhe kufoma... krimi i qëndron pranë ushtrisë hitleriane si era kërmës.

Brigada jonë hyri në Prishtinë e rreshtuar në kuadrate. Populli ishte derdhur nëpër rrugë e sheshe. Ai na priti me flamurë kuqezi në duar, me këngë në buzë, me drithë ndër sy... Në sytë e tyre ende qëndronte ankthi i ditëve me lëngatë të gjatë nën shtypjen e huaj. Mbi qytetet si në gjithë Kosovën frynte një fillad i këndshëm. Disa partizanë, të rrëmbyer nga gëzimi, zunë të hiqnin valle. Ndër ta njoha Dardan Velishtën, Bukurien e xha Goxhon, që po dridhnin vallen e po rrithnin fort tokën me këmbë. E heq vallen Dardani, ia mban Bukuria. Xha Goxhoja po dridhte shaminë. Buçiti kënga:

*Urdhri nga Shtabi: sulm mbi qytete,  
topat buçasin, pushkët batare,  
mitralozat rrabin qoshe më qoshe!*

• • • • •

Mbas dy muajsh lufte e përpjekjesh në Kosovë u përqendruam në Prishtinë, fjetëm e gjetëm gosti në çdo familje qytetare e fshatave, u ulëm këmbëkryq dhe shtruam pranë vatrësë ëndërrat, duke biseduar bashkarisht për të ardhmen... .

— Kë shëtitë tashatit Perëgjak? — përfundon.  
— Mbas mëjetë — us tifitë —  
n pë jetë. E cëtu un ësë gjithmonë e fiti. Ka  
në që orë që do që kohëtun e vogël.  
Në gjithë shtëpi i tashin. Kështu ishin atë u lid

## XVIII

«Kudo, që shkuam në Kosovë, e gjetëm të  
gdhëndur shqiponjën: në çifteli e në puhkë,  
në pragun e derës dhe në ballin e  
oxhakut, në djepin e lindjes dhe në bajrakun e  
krushqve që bien nusen...»

(Shënime nga ditari i dëshmorit  
Andrea Sotiri)

Një lajmëtar vraponte për në Vuçitern. Ai erdhi nga fshati i vogël Pergjak. Në rrugë takoi Skifter Velçën dhe bashkë me një partizan ai pruri një letër në kompaninë tonë. Atë çka binte lajmëtari, e shkruante hollësishët në letër komisari i batalionit, Skifteri.

— Mbas meje, — na thirri Dardani dhe si gjithnjë u bë erë. Ecëm në gjurmët e tij. Katër orë rrugë i bëmë në dy orë dhe dolëm në kodrën e vogël, buzë lumit Kaçanoll.

— Ky është fshati Pergjak? — pyetëm ne.  
Një grusht shtëpi ishin. Kush ishin ata ujq që s'ngo-

peshin me gjak? Lajmëtari thoshte se ata mbanin yje të kuqe.

Pa formacion të rregullt luftimi shkuam në drejtim të fshatit. Na thithë dashuria e vëllait për vëllanë e aspak s'mendonim për rrezikun. Zbritëm nëpër bokërima, nëpër rrugët më të shkurtra, në një kohë të gjithë ramë në fshat. Portat e kullave ishin të kyçura. Për ata që ikën në drejtim të malit vendësit na thanë që ishin më yje të kuqe në kapele(!). Mosbesimi ishte shtruar këmbëkryq nëpër vatra.

— Kush janë ata banditë? — pyetëm dhe i ndoqëm këmba-këmbës.

— Ish-ushtarët e car Borisit, me siguri ata janë, — thoshin për ushtarët bullgarë. Kishte disa ditë që në Prishatinë e në Vuçitern kishin vajtur ushtarët bullgarë.

Ata që gjakosën fshatin kishin yje në kapele, — na tha lajmëtari, i tronditur. — U shkëputën nga një kolonë dhe erdhën natën, bastisën, plaçkitën e vranë deri edhe gra e fëmijë, pleq e plaka.

— Ushtarë mbreti kanë qenë. Ku kalon ushtari i mbretit, nuk mbin bar...

— Ata sot luftojnë kundër hitlerianëve, s'd ihet folur kështu, xha Goxho, — e qortoi komisari i kompanisë që erdhi dje në kompani nga spitali i Dibrës ku mjekohej nga plagët.

Goxho Bërdëllima bëri fjalë me komisarin, Andrea Sotirin. M'u desh të ndërhyja por ndërhyrja ime pa takt, e nxehu më tepër xha Goxhon.

— E si të flas, më thuaj, Agim! Hë, një fjalë më mëso, si t'u 'them? U bënë partizanë këta kolenelë me pesë ditë? Ç'pret prej atyre që gjer dje thoshin: «Rroftë mbreti!» — M'u hakërrye; — Mos të t'i dëgjoj më ato fjalë, dëgjon? Aq shpejt u zbraszët dhe u mbushet koka pukovnikëve! Ende bien erë nga të car Borisit. Aq lehtë bëhen këto punë, je dhe komunist ti, Agim, pa le, këto punëra duhet t'i dish mirë. Më thuaj, pak punë u desh të bënë komisarët që të hiqnin ferrat e gjembar nga secili prej nesh që mbajmë më ballë yllin partizan? Mos kuko se pu-

kovnikët e car Borisit hoqën stemën e mbretit dhe vunë yje të kuqe e u bënë menjëherë partizanë, jo më komunistë? Jo, Agim, Jo!

— Nuk janë bullgarë, s'janë bullgarë, — nguli këmbë lajmëtarë që e kishte dërguar në brigadën tonë fshati Pergjak.

— Kush djalli është, nga qelli s'na ranë njerëz me yje! Ç'dreqin kërkojnë? Jermani shkon nga Mitrovica, ata e kërkojnë në Podujevë! Hane Shan, hane Bagdad! S'merrat vesh ç'bëhet? — pshëritiu xha Goxhoja.

— Është me ta një pukovnik. Pukovniku me një vetull, — tha lajmësi.

— Pukovnik me një vetull? — murmuriti Dardani, i habitur. — Ç'mund të jenë këta njerëz që ikën si hije në drejtim të maleve posa na panë?!

Përse këta njerëz mbajnë në kapele yje dhe veprojnë si çetnikë? E pukovniku me një vetull kush do të ishte?

Dardanit iu kujtua pukovnik Stepani...



Lulo Driza që zuri pozicion mbi fshatin Pergjak i vu-ri njerëzit e bandës në shënjestër të mitralozit, por asnjë s'mundi të mbante, as të plagosur, as të vrarë. Asnjë she-një, vetëm ca pika gjaku.

— E kam unë fajin, — tha Lulo Driza. — Po, unë, — dhe e goditi me pëllëmbë tytën e mitralozit si ta kishte arma fajin.

Gjurmët e ushtarëve me uniformë të murme që kallionin nëpër Kosovë s'arritën në fshatin Pergjak, po tehu i sépatës nën gunë e goditi fshatin e vogël. Kur u nisëm nga Vuçiterni, na thanë se ishin pushkatuar e hedhur në një gropë të përbashkët njëzet burra. Ishin pushkatuar nga «çetnikët me yje». Çfarë janë këta çetnikë që mbajnë yje?

Trokitëm te një kullë, hungëroi një qen i lidhur me

zinxhir dhe nuk u përgjigj njeri. Trokitëm në një kullë tjetër. Edhe në një tjetër. Shtëpitë e fshatit ishin boshatisur.

— Ku janë njerëzit? — pyetëm njëri-tjetrin.

Më në fund skuadra jonë zbriti gjer te nulla e vëguar. Aty në ndërtesën dykatëshe gjetëm një burrë të moçëm. Hymë në dhomë dhe nuk e pyetëm të zotin e shtëpisë as përfëmijët dhe as përfshatarët. Hija e krimit ishte ulur në Pergjak këmbëkryq...

I zoti i shtëpisë mundohet ta mposhtë dhimbjen. Kosovari s'do t'ia lëndoje zemrën luftëtarit që hyn në ndeshje me armikun. Ai dhimbjen e shuan në gjoksin e vet si aparati i vogël që shuan forcën e rrufesë. Për luftëtarin që shkon në luftë është zakon që në vatrën kosovare ka fjalë e kuwend, këngë trimërie e urim: «Ju priftë pushka!»

Ndryshe s'mund të bëjë burri i moçëm i këtij fshati. Në çdo hap që hedhim ndeshin në shqetësime.

— Erdhët ju e hupën ata, — tha mixha Arif. — Cfarë ishin ata? Ndizni nga një duhan, bre vëllezen! — Kutia e duhanit erdhi rrëth dorë më dorë. — Derti s'ka mbaram, vëllazën, — psherëtiu mixha Arif. Drodhi edhe përvete një cigare, e thithi me afsh, rrudhi ballin e tendosi vështrimin.

— Sa morën vesh që arriten brigadat e Shqipërisë, ikën me vrapi, por...

C'ishin ata që kishin ikur?  
...?

\* \* \*

Atë natë një mashkull tjetër i kësaj shtëpie doli nga pylli dhe ecte nëpër shpatin e bardhë. Njérën dorë e mbante të kërrusur nga një plagë plumbi të hershme, kurse në tjetërën shtrëngonte armën. Pushka kishte marrë në gojë fishekun, i zoti i saj zemërimin. Ai iu afroa kullës.

Në kullë kishte dritë. Ne që hymë në kullën e tij për atë jemi «çetnikët me yje,» ata që shtinë në gropë njëherësh njëzet burra të fshatit. Kështu mendonte njeriu që i afrohej kullës për të derdhur zemërimin. Ai ecte shpatit të bardhë, jashtë, më poshtë, në sheshin e bardhë afër përroit shihej një njollë e zezë. Ishte njolla e madhe e gjakut të njëzet burrave të fshatit. Aty, hedhur me të tjerët në një gropë, dergjet edhe i vëllai. Ngadalë e me kujdes, iu afrua, i bëri dredhë syrit të rojës dhe rrëshqiti afër themeleve të kullës.

Ku shkonte?

Ai qe pushtuar i gjithë nga ndjenja e hakmarrjes. Nga larg pa «çetnikët me yje» që hynë në kullën e tij dhe pushkës i erdhi rasti të derdhët helmin që i vlonë në gjoks.

Kulla ishte një ndërtesë e bukur, me mure të bardha. Ai ishte mjeshtri më i mirë i punimit të gurit në krajinë malore. Kullën vetë e kishte ndërtuar me gur të skalitur, me oda të mëdha e me dysheme si në shtëpitë e qytetit.

Roja jonë përgjon, njeriu që doli nga bjeshka afron veshin te muri i kullës, dëgjon mbeturazi fjalët në odën e burrave. «Ka me ju ngri në buzë fjala, qeshni edhe pak, qeshni, he dreqën me brina», — thotë dhe hyn nga dera e pasme brenda në katin e parë të kullës. Delet u trembën. Ai i dha krahët murit, qëndroi në heshtje, s'donte të bëhej zhurmë. «Mirë që nuk ë lëvizi ogicë i kumbonës», — tha ai. Eci ngadalë anës së murit, dora e tij kapi diçka të njomë, ndeshi në lëkurën e dashit. «E kanë therur. Ani, këtu me lëkurën e ogicit kanë me lanë edhe lëkurën e tyne!» Dhe hipi një kat më lart, iu afrua odës së madhe dhe mendoi për zjarrin. Do t'i vinte zjarrin kullës. Dhe të digjeshin si minj njerëzit që ishin shtruar në odën e kullës së tij, kështu hakmerrej. Vetëm muret e kullës do të mbeteshin. «Ani, kam me e bamë përsëri, bile ma të

fortë e ma të bukur. Ka me i dalë tymi kullës shenjë që va ka me e këndue në sharki. Zjarrm! Sa me Ymeri zjarrm!» — tha dhe u bë gati. Kaloi njëri nga shoketaroi! në korridor. Ai u zmbraps anash në hijen e murit. M<sub>m</sub>uriti: «Çetnik asht, ka vu yllin në kapele». Rexha (këshfu e quanin njeriun që donte të digjte kullën e 'vet') u afroa te bari që mbushte njérën dhomë. «Vdekjen mbollën, vdekja ka me i korrë», — tha. Befas u mbraps i trembur. Dëgjoi fjalë shqip, dëgjoi plakun të bënte muhabet, dëgjoi një zë vajze. Dhe mbështeti këmbët te një dru, u afroa te podi, pa rrëth zjarrit njerëz të gëzuar, plakun që i bënte muhabet. Pa Bukurie Çabirin që nën dritën e flakës i dilte në pah bukuria e syve dhe e ballit. Atë kohë njëri nisi t'i binte çiftelisë dhe të këndonte një këngë trimërie.

— Ata këndojnë këngë tonat, ata janë vëllaznit e mi dhe unë... — U tremb si njeriu që i drejton vëllait gryken e armës. — Mos, mos, he t'u thafshin krahët! — i tha vetes dhe i zbehur në fytyrë u dha në derë.

— Tungjatjeta, burra, → përhëndeti.

Ishte njeriu i parë që takuan prej njerëzve të arratisur në bjeshkë.

\* \* \*

Qyteti i madh midis tri malesh, Mitrovica, disa ditë e net gumëzhit nga zinxhirët e tankeve. Era therëse e luftës ka fryrë këto ditë në Mitrovicë me gjithë hovin e saj, me egërsi. Nuk janë çaste të lehta pér një qytet kur ende nëpër rrugët e tij kalojnë ushtritë ndërluftuëse.

Qdo ushtri ka fytyrën e saj dhe kudo që kalon lë gjurmët e saj. Lugina e lumit Ibër,<sup>1)</sup> fshatrat dhe qyteti ruajnë shenjat e ushtrisë që kaloi. Rruja dhe hekurudha që ecin

1) Lumë që kalon nëpër Mitrovicë e shkon në drejtim të veriut.

paralel anës së lumi janë prishur. Qyteti ndien dhimbjen e plagëve të rënda që mori. Bombardimet ajrore gjithandjej kanë hapur gropat e mëdha. Lugina me male të larta nga të dy anët përcollit njëra pas tjetrës divizionet e Gruparmatës «E» në drejtim të Sanxhakut e Bosnjës. Kaluan nëpër këtë luginë pesë korparmata dhe dhjetëra mijëra ushtarë. Kaluan mijëra automjete dhe mjete të blinduara. Kaluan këtu me rrëmbim, të ngjeshura njëri me tjetrin divisionet dhe nën goditje armësh, kaluan edhe esesët e divizonit «Brandenburg». Pamja pas kalimit të tyre në qytet jep shenjat e betejës së vërtetë, mban vu-lën e tyre. Rruga nga janë tërhequr, breglumi nga Mitrovica në qytetin e vogël Rashkë është mbushur me automjete dhe kufoma të tyre... «Kush kërkon të mbytë në lot të tjerët mbytet në gjakun e vet». Këto fjalë të thëna nga një burrë i këtij qyteti u shkruan në revistën e brigadës me germa të dukshme.

Ago Ymeri, i rrëmbyer nga krismat e armëve që lajmëruan çlirimin e Mitrovicës, me sy të ndezur, i pushtuar i téri nga një gëzim i papërmabjatur, thërrret:

— Mbaroi lufta, mbaroi lufta, fituam!

Dita me diell e 29 nëntorit i ngrohu njerëzit. U tretën retë, u tretën nga flakët e armëve. Qytetin e ka rrëmbyer gëzimi, jeton me zëra të qeshur e krisma armësh. Qyteti bën frymëmarrjen e parë në një ditë të lirë, në qytet ndihet shkrirja e madhe e akullit. Disa herë e pëershkuam qytetin në këmbë nga ura mbi Iumin Sitnica në lindje deri afér bregut të Ibrit në perëndim. Në sheshin qendror të qytetit turma u ngjesh, s'ka vend ku të hedhësh mollën, aq shumë popull e partizanë janë grumbulluar në qendër të qytetit.

— Mbaroi lufta, — thërrret Ago Ymeri. — Fituam!

Fituam! — Dardani e goditi me bërryl në krah, shenjë që i thoshte: «Ende s'ka mbaruar». Ku dëgjon Ago Ymeri nga munxa e një bërryli, thërret: — Mbaroi lufta, mbaroi!

Në tribunën te sheshi qendror ngjiten njerëz të armatosur dhe burra me veshje kosovari. Sytë tanë vështruan aty, te tribuna. Dalluam trupin e luftëtarit të ngjeshur me armë dhe veshur për merak.

— Sopot Golemi, komandanti i brigadës sonë është apo më bëjnë sytë? — pyeti Goxho Bërdëllima. Në krah të Sopotit Argjir Progri, është emëruar komisar i brigadës. Ngjiten në tribunë edhe të tjerë komandantë e komisarë brigadash. Argjir Progri përshëndet popullin e qytetit, përshëndet partizanët. Populli shpërthen në brohoritje, Ago Ymerit i është ndezur fytyra flakë. Më flet në emër:

— Dëgjon, Agim, mbaroi lufta, — M'u desh ta godisja me bërryl që të heshtte. Ai nuk heshti. — Ushtria me uniformën e vdekjes iku, përsë nuk ka mbaruar lufta? Oshiëtima e gjëmimit të topit u shua, përsë më ngacmon? — thoshte Agoja, i dehur nga lajmi i gëzuar që u dha. Në fund ai i dëgjoi me vëmendje fjalët e komisarit të brigadës. Argjir Progri me zë të lartë, siç flasin devollinjtë, tha:

— Mbas pesë vjetësh lufte e çliruam atdheun, por lufta ende s'ka mbaruar!...

— A? — ia bëri Agoja. — Si tha komisari? Më thuaj si tha?

Goxho Bërdëllima po jetonte me gëzimin e madh të të gjithëve. Mundohej të harronte plagën që i dhanë ese-sët kur i vranë të birin, Halimin.

«Halim», — psherëtiu. Derisa fantazma e hijes së vdekjes nuk ishte shuar, dora i shtrëngoi pushkën. Foli me zë:

— Deri në Berlin t'i ndjekim, aty në strofkullën e saj ta mbysim kuçedrën, na myti në gjak, s'i ndahemi gjer të ngordhë... — Dhe vështrimi i Goxho Bërdëllimës shkoi tutje, mbas gjurmëve të vrasësve...

\* \* \*

Në shtëpinë ku bujtëm në qytet për të fjetur mbas kthimit nga Shala e Bajguri kishte radio. Radioja zhurmoi, dha lajme në gjuhë të ndryshme, komunikata luftarake dhe marshe.

— Dridhet bota, dridhet! — tha Goxho Bërdëllima. Duke kërkuar stacione të tjera, dëgjuam shqip zérin e spikerit:

«Ju flet Tirana! Ju flet Tirana!»

Ishë e para herë që e dëgjuam zérin e Radio Tiranes. U mblodhëm rrëth radios, dëgjuam lajmet. Spikeri dha njoftimin:

«Luftime të ashpra bëhen nga forcat tona në Mal të Zi...»

— Çfarë flet, vëri mirë veshin radios, Agim, e dëgjon ç'thotë? — më tha Goxho Bërdëllima.

— Flet për shokët tanë.

— Ede, i kanë hyrë asaj ane ata, nga malet e Karadakut. Dëgjoni, djem, dëgjoni!

Spikeri vazhdon:

«U goditën pozitat e armikut para Medunit... Armiku i rrëthuar në Mal të Zi kërkon të çajë nga Sanxhaku që të dalë në Bosnjë, por rruga është bllokuar nga brigadat tona në Bioçë, Verushë dhe Brskut.<sup>1)</sup> Luftime të parprera në... Armiku la në fushën e luftimit...»

— I paskan mbërthyer mirë djemtë e çëçove, ç'e dite, jerman, e cingërise çëçon, po çëçua ka bicak, hë tanë, pritna de, dëgjon! — Na vështron në sy të gjithë, thotë:

— Hëm, duhet të shtrëngohemi, do të na bjerë edhe neve pjesa jonë. Ndoshta i takojmë përsëri ata esesët e atij qafëthyerit, kolonelit Brek... — Nuk ia shqiptonte dot emrin kolonel Vilenbergut. Ndali një çast që ta kujtonte emrin. — Ede atij, që e la shkretë këtë, — dhe zuri më

1) vende ku brigadat tona në Mal të Zi zhvilluan luftime të ashpra.

dorë jakën e xhaketës së tij. Ajo kishte qenë një muaj më parë e kolenel Vilenbergut. Goxho Bërdëllima e nxori nga një autoblindë që u dogj, në pritën në dalje të Prizrenit. Ai tha: — Dëgjoni Goxhon ju, do ta ndezim me ta prapë, shokë të dashur. — Ligjërimin e ndërpërreut, ngaqë i erdhë keq, aty, në skuadër kishte edhe shoqë.

— S'bën kështu, xha Goxho, s'duhet të nënveftësosh shoqet, — i thashë më shakë. Goxho Bërdëllima kërceu përpjetë si t'i kishte hyrë gjembi në këmbë. I hakërryer m'u kthyte:

— Kush ka folur keq për çupat, Goxhoja? Pse q'më bëre mua ti, ndonjë gojëgelbur nga ata të Ballit? Hiqmu qafe të kam rixhanë! Me mua mos i zër qetë, dëgjon! — Më mori flakë fityra, ula sytë i turpëruar. Goxhoja qëndroi në vend me zemërim ende të paderdhur.

Nuk guxova t'i afrohesha. Gjithë kohën hundë më hundë e kam kaluar më Goxho Bërdëllimën. S'të fal as gjë, për shkakun më të vogël bëmb me kritikë. «Mos i thuaj vetes komunist kur s'bën dot atë që bëjnë komunis-tët në fjalë, në sakrifica e në luajtjen e gishtit, dëgjon? Eshëtë njëqind herë komunist më i mirë Goxhoja nga ti, ndrequ të them... Ndrequ!» Këto fjalë i ka në gojë sa herë e qortoj për ndonjë fjalë që s'shkon! Po kësaj here heshta. Dhe heshtja ime e bëri të pendohej, vuri buzën në gaz e tha:

— Kam filluar të nxehem kot së koti, shkrep si çak-mak i ziu unë. S'ka për të më pranuar plaka më në shtëpi.

Dhoma u mbush më gaz nga shakaja. Radio Tirana dha përsëri komunikatën mbi veprimet luftarakë të forcave tonë në Mal të Zi...

Në mëngjes dolëm shëtitje. Rrugës takuam një pukovnik të komandës së nozullimeve. Ish te me shtat mesatar, i dhjamosur, me vështrim të vëngër dhe me një yetull të prerë.

— Ka qenë në korparmatën e çetnikëve, — na tha një partizan vendës. — Ai gjer dje kishte mjekër dhe stemën e zezë të çetnikut. Pasha besën kjo po më çudit!...

— Ç'pret kur merren në shërbim njerëz si ky?! — u ankua Azem Bajguri, që erdhi partizan bashkë me topin.

Pukovniku i nozullimeve na vështroi vëngër, ai si kur e kuptoi që ne diçka folëm për atë.

Azem Bajguri e hodhi befas dorën te pushka. Është që bëri. Ajo s'duhej të bëhej pikërisht aty. Azemi mendoi që atij duhej t'i jepej plumbi. Njëri nga tanët tha:

— Eshtë maskuar, nuk e njohin.

— Ai njihet prej të gjithëve, — tha Azemi mendueshmëri.

— Njihet? — Pyetja jonë ishte habitëse. — Ngatërsat që ndodhën këto ditë mos zënë fill te ky pukovnik i maskuar që eshtë dukur buzë lumiit Kaçanoll, në fshatin Përgjak?

Azemi në vitin dyzet e një kishte qenë ushtar. Komendant kishte qenë pukovnik Stepani. Ushtarët kishin lëvizur kur pukovnik Stepani u kishte kërkuar t'u dorëzoheshin gjermanëve që po vinin me tersëllëm nëpër luginën e Ibrit.

— Ne s'deshëm të binim në dorën e tyre, t'u shërbënim vrasësve dhe organizuam ikjen tonë, — tha Azemi. — Ishim njëzet ushtarë. Na spiunuan te pukovniku me një vetull dhe natën një e nga një na lidhën, na nxorën jashtë qytetit, matanë hekurudhës, këtej kishës që shikojmë. — Fliste Azemi, ne të tjerët dëgjonim. — Ky eshtë vendi i pushkatimit, — tha Azemi. Hazir Pëdrini çakarriti sytë. Fjala e Azemit e mpiu.

Azemi na tregoi hollësishët ngjarjen që kishte ndodhur tek ura buzë lumit Sitnica.

— Unë mbeta gjallë, — tha Azemi. — Jam dëshmitari i vetëm i ngjarjes. Pukovnik Stepani i mbajti grumbull forcat dhe ua dorëzoi gjermanëve, që të mbetej kolonel siç mbeti. Ai e organizoi masakrën, na vrau dhe na mbuloi këtu, në shtratin e Sitnicës.

— Duhet denonuar ky rast, — u thashë, — patjetër ai ka hyrë kontrabandë.

— Nuk besojmë që nuk njihen veprimet e pukovnik Stepanit. Ai...

## XIX

Aeroplani u shkëput nga pista. Mbi male, në çastet kur kërkonte të çante nëpër re, aeroplani u drodh nga një boshllék ajri.

— Kohë e keqe, — u ankua Skifter Velça. Piloti e drejtoi aeroplanin nga deti dhe, si bëri një rrrotullim në det, kaluam mbi qytetin e Ulqinit. Dhe përsëri mbi malet e larta. Nga Mali i Zi shkuam në drejtim të Bosnjës. Skiftri nga dritarja hodhi vështrimin tutje, te malet e përhima që u shfaqën papritmas.

— Po u afrohemë majave, — tha Skifteri për malet e larta.

Në këto shkrepë e lugina të Malit të Zi gjatë muajit dhjetor të vitit 1944 u kryen veprime luftarake nga brigadat tonë. Aeroplani fluturon lart, po lartësia nuk e zbut ashpërsinë e maleve ku kemi luftuar.

— Në këto male bie shumë borë, — tha njëri.

— U kalbëm, natë e ditë shi e borë, ju kujtohet ajo kënga:

*Moj Verusha e Malit të Zi,  
natë e ditë borë e shi.*

Aeroplani rrëshqet mbi male. Njëri nga shokët tanë që vështron te dritarja thotë:

— Fluturojmë mbi malet e Suhagorës, në jug të Vishesgradit. — Fjala na çoi te dritaret nga shiheshin mirë vargmalet.

Nga aeroplani vështrojmë reliefin e tokës, dallojmë shtigjet, rrugët, majat e larta nga kaluan e luftuan brigadat tona.

— Ariu i Bardhë! Ariu i Bardhë! — tha Isa Meta, sapo u shfaq mali më i lartë. Udhëtarëve që ishin në bortin e aeroplanit iu nxit kureshtja të mësonin për çfarë flitej. U bëri përshtypje që ne përmendnim vetëm emrat e maleve, fisionim vetëm për luftën. Vështrimet tona mbetën mbi malet e larta të Malit të Zi, Sanxhakut e Bosnjës. Malet erdhën më afër syve tanë, erdhën me dimër e acar: të bardha nga bora, të kuqe nga gjaku dhe të zjarrta nga krismat e armëve tona dhe të këngëve tona partizane.

\* \* \*

Brigada jonë doli nga Mitrovica dhe ecte në kolonë brëgut të Ibrit. Çdo gjë, bora, shtrati i lumit, rrugët ishin të ngrira. Përpara na prisin rrugë të gjata e male të larta të ngarkuar me borë. Dy ditë radhazi ra borë e breshër. Pastaj retë, si shfrynë dufin dhe shkarkuan në tokë borën e breshrin, u ngritën në qiell të lehtësuara e të bardha aq sa edhe bora që ato hodhën në tokë.

— Eshtë larg Sanxhaku e Bosnja? — pyeti Lulaja me vështrim përpara, në bardhësinë e vargmaleve.

— Në anë të botës eshtë, por shtrëngohu, Lulo. Ja

kërkojmë zemrën kuçedrës në Berlin, shtrëngohu përrugë të gjata, — i tha Bukuria.

— Dhe për luftime të tjera të ashpra, — plotësoi një tjetër.

— Lamturnirë, Kosovë! — psherëtiu Luloja dhe hodhi mitralozin nga njëri sup në tjetrin. Ekte e fundosej në borë.

— Nuk është e nxehtë si ajo sera e Selenicës.

— Ah, ku ma ke, — tha Luloja dhe kujtoi afshin e nxehtë në thellësi të dheut ku nxirret sera.

— Lamturnirë, Kosovë! — psherëtiu edhe Vaso Lundra dhe hodhi thesin e bukës mbi supe. I menduar tha: — Thuhet që këndej nga shkojmë ka shumë male e shumë borë. Keq do ta kemi për bukë, se në Kosovë vetëm përfishekë mendoja.

Mbi borën e bardhë mbetën gjurmë...

Filloi e përpjeta e malit...

Thëllimi i madh i dhjetorit tkurr edhe drurët, hyn në palcën e bririt të kaut jo më te njerëzit. Ecnim përpara në ndjekje të esesëve. Malet lartoheshin të bardha e të ftohta.

Në grykën e thellë, aty ku rrihnin më pak erërat, ndaluam. Komisari i brigadës, Argjir Progri, na lexoi thirrjen e komitetit të partisë të brigadës. Thirrjen e dëgjuam me vëmendje. Ai e lexoi me zë të lartë:

### *Partizane dhe partizanë,*

Fitorja përfundimtare u arrit. Shqipëria mbas pesë vjet lufte u qirua, kjo është fitorja më e madhe historike që arriti populli shqiptar, i bashkuar në Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar të udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare. Kjo fitore historike, që u arrit me kaq gjak e sakrifica, do të mbrohet me gjak dhe do të kujtohet brez pas brezi. Populli shqiptar do të kujtojë me respekt të thellë shokët e shoqet tona që ranë në ballin e luftës...

Goxho Bërdëllima hodhi vështrimin tutje pa ditur ku vështronë, kujtoi të birin, Halimin që u vra, shokët e rënë... « U vranë, shumë u vranë, por ne dhe bota mësu-

am shumë nga tundimi i madh i kësaj luftë botërore. Fqinji dhe vëllai i mirë provohen në ditë irreziku, ashtu si floriri që provohet në zjarr.

Komisari i brigadës me zërin e tij të thekshëm vazhdoi leximin e thirrjes së komitetit të partisë të brigadës:

*Shpresat e fashizmit perënduan. Ushtria çlirimtare sovjétique e komanduar nga Stalini i madh dhe popujt antifashistë të botës po godasin me ashpërsi bishën naziste, armët e popujve së shpejti do ta varrosin përgjithmonë kufomën e bishës naziste që ende edhe tani në prag të ngordhjes kërcéllet dhëmbët, sepse po e sheh veten në buzë të greminës...*

... Brigada jonë, krahas brigadave të tjera, dy muaj rresht zhvilloi luftime të paprera në Kosovë. Kudo që kemi kaluar grushte vdekjeje i kemi dhënë armikut. Po tani do të luftojmë në vende të tjera, në një llogore me popuj të tjerë e me ushtri të tjera, prandaj më e ashpër e më vendimtare duhet të jetë lufta jonë. Duke luftuar jashtë atdheut, në Jugosllavi, na bie detyrë që ta përfaqësojmë denjësisht popullin tonë, Ushtrinë e tij, ta ruajmë të pastër figurën morale të partizanit shqiptar, virtytet e tij të larta, shpirtin internacionalist me të cilin na kanë edukuar Partia jonë e lavdishme Komuniste dhe Komandanti i Përgjithshëm, shokù Enver Hoxha.

... Kalimi i brigadave tona nëpër ato anë në fillim dukej sikur s'po u tërhoqte vëmendjen vendësve, sikur na shikonin me mospërfillje, por ata mbas xhamave të dritareve përgjonin. Ushtria që kaloi para brigadave të divisionit tonë me zjarrin e armëve kishte mbjellë vdekjen dhe ata u ruheshin kolonave.

Në fundin e një kodre në anë të pyllit dy njerëz nga fshati më i afërt kishin dälë e vrojtonin kolonën. Në ballë

të kolonës printe dhe valëvitej flamuri i kuq me shqiponjën dykrenore. Në bardhësinë e borës ngjyra e kuqe e flamurit bëhej edhe më e ndezur. Të dy burrat që kishtë dërguar fshati për të hetuar mbanin, të lidhur rrëth mesit brez leshi. Kur na panë yjet në kapele, i rrëmbeu gëzimi e thirrën:

— Partizanë! Partizanë!

U shfaqën para kolonës dhe përshëndetën në gjuhën e tyre:

— Smërt fashizmu!¹)

Ndodheshim larg Kosovës, në zona ku flitet gjuhë tjeter...

Fshatin e parë që ndeshëm e lamë prapa, kolona e cte drejt maleve të larta të ngarkuara me borë. Tymi i shtepive anonte nga krahu që mbetën prapa gjurmët e kolonës.

— Do të ngasë veriu, dëgjon, — i tha Goxho Bërdëllima komandantes së skuadrës, Bukurie Çabirit. Ai është bari dhe barinjtë e nuhasin të parët ndryshimin e motit. Udhëtimi nëpër borë na i preu gjunjët. Lagështia e bora e qullët rëndonin mbi supet tona të djersitura. Vështrimi ynë rrëmbeu vargëzimin e maleve. Ato, të bardha e të ftohta, dukej sikur na thoshin: «Mos guxoni të afroheni! Shtigjet janë të zëna!»

Nga larg vinin gjëmime.

— Gjëmon moti, — tha Luloja, — do të kemi përsëri borë.

— Je mësuar me avullin e zjarrit të serës dhe me gjëmime të rënda deti, jo me rrufetë e maleve, o Lulo! Nuk është moti që gjëmon, është topi i gjermanit, —

1) (serbisht) — Vdekje fashizmit!

ngau fjalën Vasoja. — E dëgjon si leh topi, si një qen i zemëruar? Kupton topi si dhe qeni, e ndien erën e rrezikut nga larg dhe leh si qeni. — Mandej murmuriti me vete: «Keq do ta kemi për bukë...»

Nga kreu i kompanisë erdhi urdhri i Dardan Velish-tës:

— Mos e ndërprisni rreshtin. Ecni!

I afroheshim vijës së frontit...

— Më shpejt, — tha përsëri Dardani. Eci në krye, arri-  
ti aty ku të parët fundoseshin në borë. Një çast vështroi  
dorezat prej leshi që ia mbanin ngrohtë duart. Ato ia pati  
dhënë një nënë në Kosovë. Ajo ditën e qytetit  
të Mitrovicës ia hodhi mbi supet dorashkat me lule. Afér  
kaloi Bukuria, ajo mundohej të ngrohte duart me frymën  
e saj. Dardani e pa dhe hoqi dorezat e leshta. — Merri,  
unë duroj, — i tha dhe shkoi më përpara për të dalë në  
krye të rreshtit.

Nga një shtëpi e veçuar, kur po kalonim me Darda-  
nin nëpër një monopat për të dalë në krye të vargut të  
kompanisë, një grua e moshuar na foli në gjuhën e saj:

— Partizanë, ndalon! — Ajo foli disa herë gjersa ne  
e kuptuam që po na fliste neve. Erdhi drejt nesh e dru-  
ajtur, kishte në dorë një copë bukë thekri. — Merreni, —  
tha. Nga shprehja e fytyrës kuptuam që s'kishte më te-  
për. Bukën e mora unë. E falënderuam dhe i shtrënguan  
dorën.

— Kemi një shok të sëmurë, ruaje bukën, — më tha  
Dardani.



Në dalje të fshatit ndeshëm në një patrullë të armi-  
kut dhe kapëm dy ushtarë rob. Na pyeti Sopot Golemi.

— C'raparte ndodhen përpara? — Ne s'ditëm të për-  
gjigjeshim. Folën robërit që kapëm. Ata sqaruan se: «For-  
macione të brigadave 993 «Fest» dhe 996 që bëjnë pjesë

në divisionin e kolonel Vilenbergut kanë zënë pozicionë bllokimi për të mos i lejuar brigadat tona të dalin buzë lumit që të presin xhadënë që kalon nga Mali i Zi në Bosnjë».

Komandanti i brigadës donte të dinte për komandan-  
tin e divisionit «Brandenburg», kolonel Vilenbergun. Ro-  
bërit mblodhën supet. Ata s'dinin gjë për përfundimin e  
fatit të kolonelit të tyre.

«Duhet të jetë vrarë, — mendova, patjetër që është  
vrarë», — dhe m'u kujtua njoftimi që u dha ditën që u  
çlirua Prizreni se në pritën në dalje të qytetit Goxho Bërdëllima  
nga një autoblindë që digjë kishte marrë një  
xhaketë me grada koloneli.

\* \* \*

Kuajt e ekonomatës dhe të mitralozit të rëndë erdhën  
si erdhën gjerati. Më tutje nuk mund të shkonin. Pot-  
konjtë u shkisnin në akull. Vendësit e këshilluan Vason  
t'u bënte potkonj me kanale që të mos rrëshqisin. Me vësh-  
tirësi Vasoja i siguroi potkonjtë, i mbathë kafshët, por  
bora e ngrirë u rropi kafshëve lëkurën e këmbëve. U de-  
tyrua Vasoja të shkurtonte fundin e kapotës së tij që  
t'u mbështillte këmbët kafshëve.

— Nuk është e lehtë për kafshën të ecë në këto rru-  
gë, — murmuritë Vasoja i dëshpëruar.

\* \* \*

Ndodhemi ballë për ballë me armikun. Vështrimi  
ynë u mbërthyen mbi bardhësinë e ftohtë të pesë lartësive  
që u shfaqën si papritur sapo dolëm sipër mjegullës. Pesë  
lartësi si pesë ishuj të bardhë dukeshin mbi mjegullën e

dendur që dukej si një det i bardhë nëpër lugina dhe copëtonte vargëzimin e maleve, majat e larta nga njëri-tjetri. Lartësitë shndrisnin nga një bardhësi që na merrte sytë. Ato shkëlqenin si të ishin të veshura me akull.

— Hapuni, hapuni! — thirri patrulla nga kreu. Kompania u hap në formacion luftimi!

— Aty ka gjermanë, ata janë, aty, në mal, — tha Dardani.

Vështrimi i luftëtarëve të kompanisë rrëmbeu bardhësinë e lartësive. Qëndruam aty, me vështrim te lartësitë e bardha.

Përparrë kishim një labirint pa mbarim kurthesh. Nga çdo pikë që mund t'u afroheshim pozicioneve ne viheshim në shënjestër të armikut. Lartësitë pa mbarim ishin mbushur me zgavra. Esesët u kishin mbërthyer «Sharsve» në gojë shiritat e gjatë me plumba. Mitraljerët e tyre qëndronin në përgjim...

— Këto male qenkan bërë strofka e gjarpërinjeve vdekjeprurës, — u thashë shokëve.

— Hesht, mos ta dëgjojmë më atë llaf, — më qortoi Goxho Bërdëllima. — Bën mirë të heshtësh, dëgjon!

— Në këto llogore është struktur fryma e vdekjes, aty...

— Ede, e dimë, por djallin mos e bëj më të zi nga çështë, o Agim Noka, — shfryu zemërimin Goxho Bërdëllima. Ai egërsohej edhe kur e mbivlerësonim armikun edhe kur e nënvlérësonim.

Duke ecur, m'u afrua xha Goxhoja dhe më tha:

— Mos u rrëmbe në mendime. Peshoje mirë fjalën, je partizan i vjetër, ua njeh dhëmbë e dhëmballë esesëve, nuk jepen aq lehtë, përsë...

Heshta! «Ka të drejtë», — thashë me vete.

## XX

Andrea Sotiri, komisari i kompanisë sonë, qe varrosur te këmba e Urës së Vishegradit në Bosnjë. Në vart i gjetëm një prëdhë topi.

Midis dy shokëve tanë, Isasë dhe Skifterit, u zhvillua një dialog i shkurtër:

— Ky me siguri ka qenë artiljer, — tha Isaja.

— Nuk ka qenë artiljer, e kam njojur atë, — tha Skifteri.

— Duhet të ketë qenë në artilerinë e brigadës, — nguli këmbë Isaja.

— Predha si këto nuk kishte artileria e brigadës, tjetër kalibër është ky top, e shikon madhësinë e predhës?

— Mos është nga të topit të Azem Bajgurit? Me siguri do të ketë shërbyer në topin që pruri në brigadë kosovari Azem Bajguri?

— Jo, jo! — këmbënguli Skifter Velça. — Unë e kam

njohur, u vra kur sulmuam pér tē ćliruar qytetin e Vishegradit, atéherë e varrosëm këtu, afér këmbës së Urës së madhe.

— Përse është vënë në varrin e tij kjo predhë topi? — pyeti një tjeter.

— E sheh, predha e topit është vënë me grykë poshtë pér tē ruajtur fletoret nga lagështira, — tha Skifteri.

Eshtrat e Andresë u vendosën në arkivolin e kuq. Fletoret që gjetëm i mbajtëm. Janë dy fletore me kapakë tē trashë. Në kopertinën e njërsë është shkruar: «Luftimet në malet e Sanxhakut» dhe në tjetrën: «Heroizëm i papërshkruar». Poshtë saj: (Ditar mbi veprimet gjatë vitit 1945 në Bosnjë).

Nga Vishegradi u rikthyem përsëri në malet ku brigada jonë bëri përleshje tē tjera dhe me sulm e çoi vijën e parë tē luftimeve në portat e qytetit Stari-Varosh. Me një kureshtje tē madhe lexoj shënimet e Andrea Sotirit pér luftimet që bëri brigada që t'i merrte armikut pesë lartësitë e bardha. Ai shkruan:

«Esesët kanë zënë vargëzimin e kodrave në fund tē malit. Aty ka zjarr, shtëpi banimi dhe një rrugë automobilistike që zbret nëpër luginë në drejtim tē qytetit. Kur se në pozicionet tona veriu na goditi gjithë kohën me tufanin e tij tē ftohtë. Fytyrat tona u nxinë nga thëllimi dhe gjymtyrët na u mbinë. Kushedi sa gradë nën zero është. Na duhet t'u bëjmë ballë esesëve tē divizonit «Brandenburg» dhe dimrit».

Predhat e topave tē atyre që duan tē mbajnë popujt nën zgjedhë, që duan tē varrozin gjakun e tyre, nuk e vrasin dot trimërinë e atyre që dinë përsë luftojnë, përsë e derdhin gjakun. Llogorja e frontit filtron vetë kohën, zbulon fytyrën e ushtrive, ndez ëndrrat në njëren anë dhe shtazërinë në anën tjeter... Nazistët i kemi përpara. Përgatitemi pér tē bërë një sulm tjetër.

«Do t'i sulmojmë, aty ku janë, do t'i sulmojmë», — thonë partizanët.

«Pleħ, do t'i bëjmë derrat e derrit», — më tha Goxho Bërdëllima. «E de, pleħ, — thashë, — dëgjove?» Ai u

shkund. Gjithnjë kur mëson që do të hidhemi në sulm gjallërohet.

E priten me dëshirë të veçantë të gjithë partizanët sulmin...

Dëgjohej në vijën e sulmit zë:

— Përpara, brigadë partizane!

Ishë zëri i komandantit të brigadës, Sopot Golemit.

Natën iu afroam pozicioneve të esesëve. Befas mali që sulmuam dha një gjëmim të rëndë, na goditën me plumbë.

— Kujdes, — thirri Dardani.

U hapëm në formacion luftimi.

— Përpara! — thirri ai dhe zbrazi dhjetëshen, vrapoi nëpër plumbë.

Sulmi na përtériu fuqitë. As plumbat, as predhat e topit nuk ndaluan dot sulmin tonë. Ecëm përpara me sulm, u hodhëm nga gropë, nga lisi në lis, nga guri në gur dhe...

I erdhë radha përdorimit të granatave të dorës...

Ushtarët nazistë përpiken të zmbropsin sulmin tonë të furishëm,urrejtjen e popujve që përplaset si uragan mbi ata që kanë bërë lloj-lloj krimesh. Sa më shumë u afroheshim pozicioneve të tyre, aq më të egër bëheshin ata. Pozicionet e tyre i goditëm me granata dore, dëgjoheshin vetëm krismat e armëve...»

\* \* \*

— Dardan, Dardan, — u dëgjua afër tij një zë vajze. Ai s'mundi të ndalonte hovin që kishte marrë, ecte plumb në drejtim të esesit, mandej zuri vend e syrin e vuri në përgjim. Plumbat e mitralozit të esesit nxorën tym te guri përpara fytyrës së tij. Duhej kujdes, esesi ishte afér... Kur vështrimi i syve të Dardanit dalloi afér tytën e «Sharrit», në çastin që ai rrudhosi sýrin e pushkës dhe tërhoqi gishtin, dëgjoi dihatjen e vajzës, ajo kishte zënë

vend në krah të tij. Arriti aty duke vrapuar nëpër plumbaba.

— Ju këtu? — i foli i trembur.

— Kujdes veten, Dardan! — belbëzoi Bukuria afër. Ajo disa herë e kishte shpëtuar Dardanin nga kthethrat e vdekjes. Ajo do të hidhej përsëri në një mijë rreziqe që ta shpëtonte atë.

— Përse endeni nëpër plumbaba! — e qortoi ai. — Apo...

— Jo, po... — Heshti. Ajo nuk e nxori fjalën që don-te të thoshte: «Ruhu, Dardan!»

Ata s'kishin mundësi të flisnin me njëri-tjetrin më tepër. Ecën si era mbas plumbave të armëve të tyre...

Dardan Velishta shpejton t'u hidhet esesëve në pozicione. Ndërkokë dëgjoi përsëri zérin e Bukuries:

— Ruaje veten, Dardan! — Ai eci përpara dhe hodhi dy granata në grumbull të tyre. Atëherë pa se Bukuria përsëri ishte në krah të tij.

Goxho Bërdëllima e pikasi që Dardani e Bukuria ishin në rrezik.

— Hë, — më tha. — Vritet njeriu edhe nga dashuria, s'duhet kështu, shoku Agim, dëgjon? Ku shkoi ajo ashtu nëpër plumbaba? Di të më thuash ku shkoi? — Unë rrudha supet. — Atëherë më dëgjo: meraku se mos vritet njëri e shtyn tjetrin të hidhet drejt rrezikut.

Në mbrëmje zbrita nga kompania në fshat te ndërtesa ku ishte vendosur shtabi i brigadës. Dritaret e shtëpisë ishin mbyllur nga bora; çatia rrezikohej të shembej. Disa partizanë me lopata hiqnin borën nga çatia. Thellë në luginë mbyturazi dëgjohet larg një gjëmim topi, pastaj fishkëllyen mbi fshat predhat që s'dihej ku binin mbas fshatit në pllajat e malit. M'u desh të qëndroja aty në redaksinë e revistës së brigadës, bisedova me redaktorin për shkrimin që kisha bërë. Aty m'u dha rasti të njihem me veprimet e gjithë brigadës, lexova njoftimet që jepeshin për atë ditë.

Nëpër copa letrash, shkurt, me fjalë tepër të kursyerë ishte regjistruar qđo gjë që kishte ndodhur në vijën e parë të sulmit. Disa nga ato:

«Luftën e filluam ne të parët. I goditëm nga afër dhe në bafasi pozicionet e hitlerianëve. Përdorëm më shumë granatat sesa armët. Mbështetje ky qe shkaku që ata ikën. Dëme nuk kemi, vetëm dy të plagosur lehtë.»

«Shenjën e dhënë me pistoletë s'na la mjegulla ta shikonim, ndaj e filluam pak me vonesë sulmin. Kjo na kushtoi jetën e tre shokëve. Pozicionet i morëm. Kemi zënë katër kasetë me granata dhe dy mitraloza.»

«Dëmet i kemi të rënda, katër shokë të vrarë - dhe shtatë të plagosur. Kjo ndodhi se nazistët qëndruan qence, u mbajtën gjer në pikën e fundit.»

«Menduam se kishim përpëra dy skuadra me ushtarrë, na doli krejt e kundërtë, zjarri i mitralozave armiq qe shumë i dendur. Duket që informatat e marra kanë qenë të gabuara. Pozitat i morëm. Fishekët që harxhuam i zëvendësuam dhe tetë armë me fishekë belgjiku jua dërgojmë aty, bashkë me të plagosurit. Lamë pa shkrurar një gjë. Një mitraloz të rëndë që u zumë esesëve e mbajtëm, na duhet që të zëvendësojmë «Bredën», sepse nuk i gjenden fishekë.»

«Dështoi sulmi ynë. Shkaqet janë shumië, por, nga që bën shumë ftohtë, asnjë armë automatike nuk na punoi. E përsëritëm sulmin duke e goditur lartësinë nga krahu i majtë dhe nuk mundëm. Do të qe mirë të qëllonim mbi këto pozicione me mortajat e brigadës. Prësim njoftimin tuaj si të veprojmë. Kemi nevojë për bombadore.»

«Në kohën kur iu afroam lartësisë hitlerianët na qëlluan me mortaja. Një predhë ra mbi samarin e mushkës dhe tabela e zezë që partizanët mësonin shkrim e këna-

dim na u prish. Nëse gjendet ndonjë tabelë e zezë, na e dërgoni. Mundësítë pér të zhdukur analfabetizmin janë të mira, sepse, megjithëse jemi në borë, pozicionet që lanë gjermanët janë të mbyllura dhe ka soba pér të ndezur zjarr.»

«Bukë nuk kemi... Në asnjë vend tjetër nuk bën kaq ftohtë. Natën do të lëmë rojë, do të nxjerrim përparrë patrulla dhe do t'i fusim shokët në llogoret e mbuluar, ku kemi edhe zjarr.» Këtë njoftim e jepte komandanți i kompanisë sonë, Dardan Velishta.

Duke lexuar këto njoftime të komandantëve e komisarëve të kompanive, njoha jetën e vërtetë në vijën e luftimeve, përleshjet që zhvilloi brigada asaj nate në vargmalet e bardha dhe të ftohta...

\* \* \*

Ballafaqimin më esesët e kolonel Vilenbergut e bëmë edhe kësaj here gjoks pér gjoks. Mbas këtij sulmi në pesë lartësitë e bardha këndohet pér pushkët që nxorën flakë, «pér flakët që morën dhenë». Në krismat e armëve shikonim rritjen tonë. Përfytyroj çastin e sulmit, shoh shokët e skuadrës dhe të kompanisë sime të hidhen përmes flakëve e krismave në vijën e parë të luftës, shoh Bukurie Çabirin kur u ngrit prej vendit që kishte zënë dhe u hodh te njëra nga gropat që hapi predha e topit.

— Nuk bën kështu, motër, — i foli Hazir Pëdrini i shqetësuar.

— Mos ki dert, vëlla, nuk bie dy herë në një vend predha e topit, — tha Bukuria.

— Aaa? — ia bëri Haziri i habitur. Ai nuk e di që predha e topit s'bie dy herë në të njëjtin vend. Qëndron-te pas gurit, lëvizti vetullën e syrit të pushkës. Iu kujtua porosia që i dha baca Shpend: «Këndoi këngët e trima-

ve në krah të trimave.» Dhe telat e çiftelisë lëshuan tinguj, i pruri telat e çiftelisë në tonin e zërit të vet. Dukej që ishte këngëtar. Në thellësi, tej maleve, buçisnin më dendur topat. Ishin gjëmime të largëta. Dëgjonim tingujt e çiftelisë dhe zërin e lartë të këngëtarit që këndonte për betejën e parë, kënga jepte tablonë e luftimit të ditës së parë të zhvilluar nga brigadat e divizionit tonë në këto male.

*Andej gardh me mitraloza,  
divizione që lëvrijnë,  
këndeje sulme me granata,  
lufton një, sa për një mijë!*

## XXI

- Këtu te ky shkëmb ra një partizane, ju kujtohet?
- tha Skifter Vëlça sapo erdhëm në qytetin buzë lumit. Pastaj shqiptoi me zë të ulët ca vargje të asaj këngë. — Sa më pëlqen kjo këngë, — tha ai.
- Këngët partizane i kërkojnë shumë dëgjuesit e Radio Tiranës, — i thashë unë.
- Kënga partizane te ne qëndron në krye të këngëve,
- tha Skifteri.
- Radio Tirana jep konkursin e këngëve partizane, — tha Isa Meta dhe ndezi radion me bateri. Kënga buçiti shpatit ku dredhon rruga për të shkuar te shkëmbi ku kishte rënë partizanja. Mendja e Skifterit bridhte nëpër shpatin e bardhë të malit ku sulmoi brigada, te lartësitë. Mes këngës dhe botës që na rrrethon ka një kontrast. Ne e ndiejmë atë. Na pëlqen të jetojmë gjatë me këngën... Kënga ka forcë të fluturojë nëpër peizazhe të mjegullura.

— Këtu do ta kërkojmë, — tha Skifteri dhe përmendi emrin e partizanes.

Vështruam pjerrtas shkëmbin ku kemi luftuar. Ven-dosëm një piketë tjetër. Në listë vumë shenjë bri emrit të partizanes dhe përfytyruam veprimet e esesëve të kolonel Vilenbergut.

\* \* \*

Kolonel Vilenbergu kishte udhëtuar tri ditë rrësht i mbyllur në një autoblindë të vogël me zinxhirë tanku dhe ja, më në fund, autoblinda, një breshkë e vogël turishtypur me kolonel Vilenbergun arriti në qytetin Stari-Varosh. Mbas tri javësh i mbetur në rrëthim me forcat e Korparmatës Njëzet e një në Mal të Zi kolonel Vilenbergu u kthyte përsëri në divisionin e tij. Ai si njeri i njohur për veprime energjike, sa po arriti në vendkomandën e divisionit, pyeti:

— Ç'forca na sulmojnë? — Mbeti me vështrim te dritarja. Ishte ende natë dhe perdja e zezë e dritares ishte ulur. Vartësit e kuptuan që ai e priste me padurim ditën. I hodhi gurmazit një gotë shlivë. I pëlqeu.

— Pije e mirë, — tha një nga oficerët e shtabit dhe i mbushi përsëri gotën. Kishte dëshirë të pinte.

— Nuk është vetëm pije. Kjo është edhe armë, — tha koloneli dhe sytë e skuqur i vuri në përgjim.

— Armë? Si mund të jetë shlivovica armë? — pyeti tjetri. Koloneli tendosi fytyrën e gjatë e thatime, mori një pozë ashtu si të thoshte një gjë të panjohur nga vartësit e tij dhe tha: — Armë pér ta hedhur ushtarin në sulm, — dhe vështroi vëngër tjetrin. — Ushtari nuk filozofon shumë kur ia mbush pagurin me shlivovicë si kjo, ai i trembet më pak plumbit, është kështu?

Ato që shikoi në hartë donte t'i shikonte me sy, ndaj, sa po zbardi, doli në verandën e shtëpisë e soditi rrëth qytetin.

Pamja ishte e kufizuar, qyteti Stari-Varosh ndodhej në luginën midis vargmaleve. Kjo e dëshpëroi. Kërkonte të shihte larg vargëzimin e maleve ku ishin dislokuar forcat, por ato nuk shiheshin. Qyteti ishte si në gropë, s'shikonte më tepër se një kilometër përpëra tij.

— Këtu e ndiej veten si në varr, — u ankua koloneli.

— Vendvroatimin e kemi sipër, tek ajo maja që duket, andej... .

— Shkojmë aty, — tha koloneli, duke shprehur padurimin që kishte për të shikuar vargmalin.

U nisën me dy kuaj shale në drejtim të lartësisë, të shoqëruar nga ushtarë.

Nga lartësia shihte përballë malin «Ariu i Bardhë», shihte në njërin krah brinjazi në varg lartësitë e bardha mbi vargmale, ku qëndronte në pozicione luftimi brigada jonë, dhe më në jug brigadat e tjera të divizionit tonë. Në krahun tjetër, brinjazi ecte kolona e gjatë që vinte nga Mali i Zi. Donte t'i shikonte në një kohë vargmalet ku ishin partizanët dhe kolonën. Rrudhi sytë, ajo që shikoi në luginë nuk i pëlqeu. Eceja e nxituar e kolonës në xhade shprehte frikën se mos rruga e tërheqjes u mbyllej përsëri.

Në mbrëmje ai zbriti në qytet. Në qytet nuk frynte era me atë furi që frynte në male. Zhurmën e erës e mbyste zhurma shurdhue e automjeteve të blinduara të kolonave që tërhiqeshin me shpejtësi duke kaluar mespërmes qytetit.

Ishte natë pa mjegull, me quell të kthjellët dhe koloneli qëndroi një kohë buzë xhadesë. Në vargun e ushtarëve që tërhiqeshin ai kërkoi mos njihte ndonjë oficer.

— Këta janë kthyer në një tufë delesh që s'dinë ku shkojnë, — pshëretiu. E ndjeu veten të pafuqishëm të vinte rregull në kolonën që rridhët paprerë ushtarë dhe mjete të blinduara, ama dhëmbin do ta ngulte aq sa të ndihej emri i tij. Dhe ditën e nesërme në Stari-Varosh u bë një gjyq ushtarak. Vendimi i gjyqit i dënoi me pushkatim dy komandantë kompanish që kishin shkelur grafikun e marshimit...

Mbas bisedës me gjeneralin e korparmatës, koloneli e humbi qetësinë e ditës së parë, vajti përsëri në vendvroatim dhe vështroi nga vargmali lartësitë e bardha. Ishte tepër i egërsuar, vendi vend s'po i zinte. Mblodhi oficerët e repartit të vendosur në malin më të lartë e u tha:

— Depërtimi në thellësi i brigadave partizane do të jetë i pamundur, në qoftë se mbahet mali «Ariu i bardhë». Tërheqja andej është vdekje pér ne, — tha dhe përkëdhëli «Valterin» e ftohtë që kishte në brez. — Tërheqje s'ka, — tha ai. Atë fjalë i kishte thënë edhe atij gjenerali i korparmatës.

Oficerët ikën, të bindur që më mirë të vdisnin, sesa të tertiqeshin nga mali «Ariu i bardhë».

## XXII

Skifter Velça fshiu djersët dhe u mbështet mbas një guri. Dukej i zhytur në mendime, përpiquej t'i afronte ngjarjet e kohës. Nuk tha asnjë fjalë, soditi malin e lartë, pesë lartësitë e bardha. Ishë zhytur në burimet e informacionit që kishin për të rënët në luftime, mbante shënimë tă hollësishme për secilin. Grimcat e vogla ngajeta e tyre ndriçojnë betejën e madhe. Qartësohen me hollësi veprimet luftarake tă dy palëvë ndërluftuëse. Skifteri ma ata sytë e zjarrtë nén ato vetulla tă trasha e korbi tă zeza vështronje malet e larta dhe ndiqte mie vëmendje bisedën e seclit prej nesh. Ai jetonte tërësisht me ditët e luftimeve në këtë mal me pesë lartësi si njëra tjetra e secula më sogjetare nga tjetra. Nuk më besohej se do të kisha tă fiksuar vendet në kujtesën time me një saktësi kaq të madhe. E përfytyrojmë këtë vend si atëherë tă prerë kryq e tërthor nga llogoret. Ato çka shikonim

mot e një kohë janë tshirë, kujtesa jonë hyn në vijëzat e llogores bashkarisht me kazmën që rrëmih e nxjerr nga dheu predha, heqës granatash, gëzhoja, skelete heku-ri të armëve. I ruan toka, ruan shumë gjëra që dëshmojnë ç'është bërë në këto lartësi.

— Nga ky vend u nisëm kur kryem aksionin në xha-de, ju kujtohet? — na tha Skifteri dhe shtriu dorën an-dej nga zgresin rrugët e shtigjet në drejtim të luginës.

— Atë ditë Azem Bajgurit i erdhi keq që s'mundi ta binte topin në vendin e pritës, — tha Isaja.

— Ky vend më duket më i thepisur nga ajo ditë, — tha Skifteri.

Përse na duket vendi më i thepisur nga ajo ditë? Ngjarja e asaj dite është ngulitur në kujtesën tonë siç ngulitet në jetën e njeriut qdo ngjarje e veçantë nga të tjerat. Për këtë aksion në blokun e shënimave të Andrea Sotirit që gjetëm të mbyllur në predhën e topit te këm-ba e urës afër Vishegradit lexoj:

«Sot më njëzet e pesë dhjetor u mblohdh celula e Partisë. Në mbledhje erdhi dhe komisari i batalionit, shoku Skifter. Celula diskutoi për detyrat që na dalin. Do të bëjmë një goditje të armikut në xhade. Veprimi është i vështirë, kërkohet që në fshehtësi të kalojmë vijën e frontit, ta godasim, ta dëmtojmë armikun dhe të largohemi nga prita pa u dëmtuar. Kërkohet...»

Shënimet hedhin dritë mbi çdo veprim tonin.

— Të kujtohet, Agim, ajo natë që s'shihnim njëri-tjetrin nga suferina, tonin nga i huaji? — më tha Isaja dhe vështroi lartësitë në juglindje të qytetit Stari-Va-rosh. — Ja, aty u bë përlleshja. — Tregoi luftimin dhe përmendi emra të shokëve të rënë në atë luftim. — Aty, mbështetur në pozicion nga lodhja e pagjumësia, m'u rënduan qepallat, plumb m'u bënë. U hoqa anash, zura një vend më pak të rrahir nga era e suferina dhe u mbë-shteta mbas kapotës së një tjetri. E ndjeva të më ngrroj shpina. Kur u përmenda nga gjumi, ishte gdhirë. Ai që kisha mbrapa më ngrrohte shpinën, por më shqetësonë me rënkimin e rëndë. Qenka i sëmurë i ziu, i qava hallin

atij që rënkonte. Befas, afër meje u zbras një automatik. Mbas krismës dëgjova zë:

«Të vrua! Të vrua!»

Esesi i plagosur kishte mbetur në pozicion dhe, kur më pa afër, ngjitur me shpinën e tij, nxori thikën të më godiste. U ktheva me rrëmbim. Një krismë çau ajrin. Ai nuk rënkonte më, kishte vdekur.

Çdo pozicion që merrej nga brigadat partizane ngush-tonte lakun e rrithimit të forcave naziste dhe u pritej rruga e tërheqjes kolonave që largoheshin nga Mali i Zi. Ato e ndienin këtë rrezik si mushkëria e azmatikut munge-sën e ajrit. Shpejtonin të çanin në drejtim të Bosnjës, prandaj i mbronin lartësitë me aq egërsi, kërkonin me çdo kusht të na largonin nga pozicionet që kishim zënë dhe bashkarisht me esesët e kolonel Vilenbergut godisnin anash, në drejtim të pozicioneve tona. Por, sa herë godis-nin, ktheheshin përsëri në vendet ku ishin, që të lëpinin plagët, që të shuanin dhimbjet.

Qëndroja në pozicion, mbështetur te buza e llogores. Përpara nesh ishte kolona e gjatë armike si një gjarpër që koka i arrinte në Bosnjë, por bishtin e kishte një Mal të Zi. Ky gjarpër gjigant që përvite me radhë përpiquej të gëlltiste botën, tani po trëtej nën goditjen e armëve të popujve. Dëgjohen në llogore fjalë në gjuhë të ndryshme: «Godisni errësirën, zjarr!»

Me dy batalionet që do t'u bënim pritë kolonave të armikut erdhë dhe komandanti i brigadës. Ishte ende ditë

kur u rreshtuam. Frynte një erë e fortë, të ftohit na pris-te si brisk, këmbët i ndienim të mpira, kokrriza bore na godisnin.

— Nisemi, — tha komandanti i brigadës, Sopot Golemi.

Djathtas nesh male... majtas male... përpara nesh male..., nga çdo anë male të larta e gryka të thella. Bora dhe akulli kishte fshirë gjurmët e rrugëve e të shti-gjeve.

— Ku shkojmë nëpër këto male të bardha? — e gërgau Ago Ymeri xha Goxhon, apo kolona u vargëzua nëpër mal.

— Ec, Ago, mos e ndërpre rreshtin, — ia ktheu i zemëruar tjetri.

Agoja heshti, nuk deshi ta ngacmonte më tej, e dinte që Goxho Bërdëllimës nuk i gremisej lehtë zemërimi. E ndeze me inat, prit pastaj të shuhet, s'të ndahet me thumba.

Komandanti i brigadës nga një vend zotërues u mundua të shikonte luginën, lumin dhe xhadënë. Ai qëndroi gjersa luginën e liroi mjegulla dhe gryka u shfaq papritur poshtë, në thellësi. Projektori hodhi dritë mbi kreshtat e maleve dhe errësira u tret, malet u shfaqën në sytë tanë papritur, me një bardhësi të shndritshme. Sopot Golemi e pa veten të zbuluar në bardhësinë e borës dhe u dalloj fytyrën shokëve që kishte afër. Kërkohet që prita të mbetej e fshehtë. Sopoti hodhi vështrimin mbi lartësitë anës lutit e përballë xhadesë ku qëndronin në pritë partizanët. Ndriçimi i dritës binte vetëm mbi ballin e maleve, kurse në vendin e pritës errësira si edhe më parë mbetej e thellë.

— Do të presim këtu, — tha Sopoti. Qëndruam gjatë në pritë me vështrimin mbi xhadënë. Nuk është e lehtë të qëndrosh pa lëvizur nga vendi, na ngrinte dora në he-kurin e armës.

Pritën e zumë një orë larg nga qyteti, aty ku të duket sikur dy anët e luginës puqen e shtrati i lumit zbret zhurmshëm nëpër një hon të thellë.

— Ky vend është shumë i mirë për prita, — tha Dardani.

— Erdhën? Ata po vijnë! — Fjala e partizanit që foli kaloi gojë më gojë. Lajmin e mësuam të gjithë.

Dardani ngriti kokën mbi gurin ku kishte vënë në përgjim dhjetëshen. Mundohej të shquante në errësirë luftëtarët e kompanisë që rrinin në pozicione me armët në përgjim. Ai lëvizti qafën e gjatë dhe vështrimin e ktheu nga shoku. Nuk mundi ta shquante. Dëgjoi që kaloi me zë të ulët urdhri i komandanit të brigadës nga njëri skaj i kompanisë në tjetrin!

Gumëzhitja e rëndë e motorëve erdhi te prita jonë në fillim e mbetur, e largët, pastaj e rëndë dhe shurdhuese. U mbush lugina e lumit me një zhurmë monotone motorësh. Një veshi i mësuar me zhurmën e madhe i vëconte makinat nga autoblindat dhe autoblindat nga tanku që ekte në ballë të kolonës.

Një autoblindë me zinxhirë tanku, me dy kryqe anash dhe një të vogël ballas, si një ujkonjë e murmë e tërbuar që kërkon këlyshët e saj, hyri në ngushticën e grykës. Autoblinda kaloi përballë armëve të kompanisë sonë, eci në udhë e pa udhë nëpër borën e ngrirë e të ngjeshur.

— Hëmm, — ia bëri Agoja, kafshoi buzën e shtrëngoi fort granatën. Secili nga ne mbante në duar granatat, gati për t'i hedhur në xhade, por komandanti i brigadës ende nuk e kishte dhënë shenjën. Autoblinda në krye të kolonës shtypi borën, kaluan zinxhirët buzë xhadesë. Krak, diçka u thye, jo zinxhirët, diçka tjeter u thye. Autoblinda shtoi gazin e ndërroi marshet. Krak-krok, lëvizën nga buza e xhadesë trupat e njerëzve të ngrirë që kishin ngulur esesët anës së xhadesë. Ishin si një stivosje trungjesh, trupa njerëzish të pushkatuar. Sytë tanë mbetën aty, te përbindëshi dhe te kufomat e masakruara anës së rrugës. Në çaste si këto vështirë të përmblahej dora e Goxho Bërdëllimës. Po komandanti i brigadës kishte dhënë urdhër të prerë: «Mos shtini!»

— Bridh, moj breshkë uji, bridh, përsë të mos bëdhësh, — psherëtiu Goxho Bërdëllima. Zinxhirët e auto-

blindës ngjeshnin borën. Mbas vinte zhaurima e madhe e kolonës.

Agoi dita. Kolona armike ishte nën vëzhgimin e armëve tonë.

Afër komandantit të brigadës kishte zënë pozicion Lulo Driza. Sopot Golemi, në pritje të dhënies së shenjës, bisedonte me Lulon.

— Jemi në tokë të huaj, kërkohet t'u japim forcë të re zemrës e pushkës, — i tha Luloja. Sopot Golemi e dëgjoi fjalën e s'pati kohë të përgjigjej. Kolona me automjete e mbushi grykën. Ai vuri njëherë dylbinë të shikonte. Ende ishte shpejt të jepte shenjën. E hoqi syrin nga dylbia. Iu kujtua kolonel Vilenbergu dhe tha me vete: «Do të çohet nga shtrati i llahtarisor, si ariu që e sheh luanin përsipër. Ai, njëherë, kur Goxho Bërdëllima hoqi nga një autoblindë që po digjej në pritën afër Prizrenit një xhaketë koloneli, mendoi se me kufomat që digjeshin kishte marrë fund edhe kolonel Vilenbergu. Podhelpra i kishte bërë dredhi çarkut dhe Sopot Golemi mendonte se do të ishte e vështirë të binte tjetër herë në pritë kolonel Vilenbergu. Me rrëmbim nxori pistoletët dhe hodhi shenjën.

Prita hapi zjarr në një kohë. Ishte një zjarr i përpiktë kositës. Plumbat ranë breshëri dhe në xhade u ndezën flakët...



— Mbarë na shkoi dyfeku edhe kësaj here. U vra njeri? — pyeti Goxho Bërdëllima kur zbritën të gjithë në xhade.

Xhadeja ishte mbushur me kufoma dhe automjete të djegjura.

— Fishekë! Mblidhni fishekët! — na thirri Vasoja. Pastaj u end nëpër makina. Kërkoi bukë. Nuk gjeti as bukë, as miell... — Borë gjendet në këto male, vetëm

borë, — psherëtiu me një ofshamë që i doli nga thellësia e gjoksit.

Mbas një makine të djegur, një grykë topi zgjatej tutje me vështrim nga mali. Një top i rëndë dhe grykë-gjatë që volli hekur ditë me radhë mbi tanët, mbeti në vend. Përbindëshi qe shfaqur sa herë si fantazmë nëpër atdheun tonë dhe kishte vjellë flakë e predha pa mbarim. Në fund iku i trembur dhe i ndjekur këmba-këmbës. Tani kishte heshtur si një kufomë. Mbi grykën e topit komandanti i brigadës pa të shalonte Goxho Bërdëllima. Tundi këmbët Goxhoja si të ishte mbi një kalë shale që merr vrap.

— Sa bukur, — i thashë. — Prit aty, xha Goxho, të fiksojmë një fotografi.

— Hë de, fol të ujdisem, të rri një çikë më mirë. — Ndezi llullën, shtroi mustaqet me pëllëmbën e dorës dhe hodhi këmbën mbi këmbë sipër grykës së topit.

Zemërata e brigadës u derdh e gjitha mbi kolonën.

— Këta nuk janë njerëz, e bënë botën shkrumb. Mirë ua bëmë, hë, kërmat! — fliste me zemërim ende të pader-dhur gjer në fund xha Goxhoja që sipër grykës së topit.

— Mbaroi, i erdhi fundi edhe kësaj armate të Hitlerit, i ranë potkonjtë, mbaroi, — tha i entuziazmuar Ago Ymeri.

— Ka dava Janina, Ago, — i foli atij Goxho Bërdëllima që priste sipër grykës së topit të madh për të bërë fotografinë. — Çështë kështu me ty, Ago, një e dy e mbaroi lufta. Ata që e filluan luftën nuk vrapojnë drejt buzës pa i shtyrë, dëgjon?

— Goditëm dhe shkatërruam një autokolonë, jo gjithë forcën e tyre, — plotësoi Dardan Velishta. — Fjala i drejtohej Agos, por na tregonte edhe neve që luftimet do të vazhdonin deri në varrosjen e nazizmit.

Të vrarët e armikut mbetën aty pranë hekuriştave të makinave që digjeshin, ndonjë ushtar rob dhe armët i tërhoqëm në thellësi.

Topi i rëndë ngeci në vend..

— Ngordhe edhe ti, ngordhe, ta vulosi lala grykën

me bajgë, — i tha Goxho Bërdëllima i shaluar mbi top dhe, si i ra me grusht, përsëriti të njëjtat fjalë.

U afrua te topi Bukurie Çabiri, kishte hedhur kra-hëve një pelerinë të bardhë. Edhe ajo donte të bënte një fotografi, por nga borizani u dha një sinjal alarmi. U ha-pëm me shpejtësi mbi xhade, në shpatin e malit. Dëgjuam uturima motorësh.

Fluturuan mbi luginë aeroplanë...

Kolonel Vilenbergu dërgoi esesët në kërkimin tonë. U dhamë një goditje të ashpër dhe u humbëm nga sytë...

## XXIII

Në ditarin e tij Andrea Sotiri shkruan:

«Po u ngule në një vend në pritje, mos u anko që mendja jote emigron nëpër luftime të kaluara ose ecën nëpër gjurmë të asaj që pritet. Mbas luftimeve të ditës së djeshme në pritë më rikujtohen çastet e luftimit. Ishin luftime të ashpra. Në këto luftime Agoja, si gjithnjë, u tregua trim. Ago Ymerin do t'ia rekmandoj celulës për ta pranuar në parti... Dje, kur u tërhoqëm nga vendi i pritës e kur pushkët pushuan, goja e mitralozit të Agos ende hante nazistë.» (Shënim pér Ago Ymerin.)

«Lisi nuk i merr leje furtunës kur hedh shtat». (Shënim pér partizanët më të rinj të kompanisë, Hazirin e Azemin.)

«Dita është në mbarim, po intendenti i kompanisë, Vaso Çika, me dy partizanë që shkuan pér ushqim s'po duken. Më bëri përshtypje të vecantë një ngjarje: Vasoja

u ndau soi shokëve të kompanisë nga një palë çorape leshi. I kishte ruajtur. Ai e sakrifikon velen për shokët... Ku ndodhet në këto çaste Vasoja?... (Shënime për Vason.)

\* \* \*

Intedenti i kompanisë, Vaso Çika, dhe dy partizanët që mori me vete vunë rrathë druri në këmbë për të mos u fundosur në borë dhe u nisen. Kërkonin ushqim. Njëri nga partizanët, Azem Bajguri, e dinte serbokroatishen, kurse ata të dy s'ia bënин shkrap, s'dinin veç: «Ima hleba?» dhe «Gde puc?»<sup>1)</sup>) Kérkuan çdo vend ku dukej stan e dilte tym. Asgjë nuk gjetën. Uria e kishte pllakosur krahinën ku zunë pozicione luftimi brigadat tonë.

— Zbresim në sheher, — u tha Vasoja, — ndoshta aty... Qyteti i vogël midis rrafshnaltës nga fshati ku ishin ata u duk afër, por rrafshnaltë e bardhë s'kishte mbarim. Kur arritën në qytet, ata ishin të rraskapitur nga rruga e gjatë. Pjetën për komandën e nozullimit. U trenguan se ajo ndodhej në të dalë të qytetit. Ecën në drejtimin që u thanë, po këmbët i ndienin të mpira, nga të ftohen. Posa arritën në oborrin e godinës dykatëshe, aty ndeshën një kolonel, i cili u fut brenda. Me të u ndeshën ballë për ballë. Azemi shtangu në vend. Vaso Çikës i ra në sy shqetësimi i Azemit, po aty për aty psenë nuk e kuptoi.

— Ç'ke, Azem? — e pyeti Vasoja i shqetësuar.

— Ky që hyri asht ai gjarpni për të cilin ju kam kallxue!...

— Për cilin gjarpër e ke fjalën, bre vëlla?

— Për pukovnik Stepanin, pra, që ju kallxova në Mitrovicë, po nuk ma besuet. Ai vetë asht.

---

1) (sërbisht) — Keni bukë? Ku është rruga?

— A?

— Po, Vaso, ai vetë, — pohoi Azemi dhe iu afrua rojës te porta e i tha: — Duem të takohemi me pukovnikun.

— Prisni, nuk di pret apo...

Azemi me sy të egërsuar iu afrua Vasos dhe shokut tjetër dhe u tregoi për ato që i tha roja. Vasoja s'po dinte q'të bënte. Të shkonte te pukovnik Stepani? Një mendje i thoshte po dhe një tjetër jo.

«Ujku ndërron qimen, po kurrë lëkurën, as vesin!...»

— shqiptoi nëpër dnëmbë Vasoja. Azem Bajguri rrahu këmbët përtokë dhe shtrëngoi tytën e armës. Mendja e tij vajti në ditët e vinit dyzet e një te fytyra e egër e pukovnik Stepanit. Kujtonte krejt ngjarjen në hyrje të Mitrovicës, çastin kur qëndronte i lidhur bashkë me njëzet ushtarë tek Ura e Sitnicës. I tingëlloi në vesh zëri i egër i pukovnik Stepanit që thirri: «Zjarr!» dhe krismat e armëve që qëlluan mbi ata të njëzetë. Nga të gjithë mbeni gjallë vetëm Azem Bajguri. Ai ishte i vetmi dëshmitar që tregonte ngjarjen e asaj nate.

— Me shkue te pukovnik Stepani, hiç nuk asht e udhës, shoku Vaso, — foli Azemi i bindur në të tijën.

— E di, e di, — tha Vasoja dhe lëvizi këmbët e mpira. I ndjeu më të rënda. — Hej, ku na mbiu ky djall pukovniku, si t'ia bëj? E kemi kompaninë pa bukë, bre Azem... — Ai nuk donte të kthehej duarbosh në lartësi-të e bardha të malit të lartë e të ftohtë.

Kompania priste Vason. Ai duhej të siguronte bukë. Fishekët e granatat që harxhuan partizanët e kompanisë përmarrjen e lartësive të bardha i zëvendësuant me municionin që i kapën armikut në pritë. Duhej bukë, vetëm bukë...

Në komandën e nozullimeve kishte konservë, miell, patate... Vasoja sa s'fluturonte nga gjëzimi. Nuk do të kthehej duarbosh. Trokiti në zyrat. Në çdo portë që trokiti i thanë: «Vetëm me urdhër të pukovnik Stepanit...» Vasoja nuk donte kurrsesi të kërkonte gjë nga pukovnik Stepani, por përpjeket e tij për të marrë diçka pa urdhër të pukovnik Stepanit u shembën.

Tha me vete: «Ç'po ndodh kështu?» Kur s'gjeti asnjë shtegjalje, i menduar iu lut Azemit që të shkonin te pukovnik Stepani.

— Kjo nuk bëhet, o Vaso, — i tha vetullvrenjtur Azem Bajguri.

— Eh, vëlla, — psherëtiu intendanti, — i kemi shokët në front pa bukë...

Godina e komandës së nozullimeve ishte një vilë e vogël midis pemëve. Ajo ishte e bukur dhe me çati të pjerrët. Vasoja me Azemin ngjitën shkallët me pishmankë, ndërsa shokun tjetër e porositën të priste përjashtë. Avulli i ngrohtë i zyrës së pukovnik Stepanit sikur ua zuri frymën. Azemit iu duk sikur koka e pukovnik Stepanit me heqjen e mjekrës ishte zvogëluar.

Vasos, apo hyri në dhomë, iu ngacmuān hundët nga era e bukës dhe e shlivës.

— Çfarë doni? — i pyeti pukovnik Stepani me një zë të ashpër e vështrim mospërfillës.

— Bukë për shokët, — i tha Vasoja, — bukë...

Pukovnik Stepani nduku një anë të mustaqes nga inati pak i çuditur me këmbënguljen e njeriut që i erdhë e hungëroi si ari.

— Ç'njerëz të pagdhendur, — tha pukovnik Stepani me buzë të shtrembüra. — Ikin nga fronti dhe na kërkojnë... në komandën e nozullimeve!... Nuk ka ushqime, — tha ai dhe u qua në këmbë, futi gishtat brenda rripit të mesit të oficerit për të zhdukur rrudhat e xhaketës, e rrasni mbi ballë kapelen me strehë që i shkëlgente. Vështrimi i tij ndeshi në vështrimin e Azemit që i foli në

gjuhën e tij. Sytë e tyre u përpëlitën. Njëri kujtoi të vde-kurin e tjetri vrasësin.

— Nuk kemi ushqime, shok. Ne s'po furnizojmë dot forcat tonë në front, — tha pukovnik Stepani, i pezmatuar. — Megjithatë do t'ju japim një autorizim që të furnizoheni në fshatin..., — shtoi dhe i dha një zarf. Vasoja e shikoi vëngër e murmuriti me vete: «Ky çetnik ka qenë, çetnik ka mbetur. Mban yll partizani në kapele, më thotë shok, kur... Duhet ta dënoncojmë këtë vrasës...»

Ecën nëpër borë. Vasoja u ndie edhe më i këputur nga këmbët. Zarfit që i dha pukovnik Stepani për t'u furnizuar në një fshat përtëj malit filloi të mos i besonte.

## XXIV

Toka e vadir me gjak atyre u ka ruajtur eshtrat... Ne shokët e tyre ruajmë për ta kujtime të pashlyera. Ndodhemi në malin «Ariu i bardhë», në këtë mal ku janë bërë luftime të ashpra dhe na janë vrarë shokë. Gjejmë një pushkë, një tytë mitralozi, gjashtë granata rrëth mesit të një skeleti... Një bori e goditur nga plumbi e hedhur edhe ajo në varr. Një fletë çadre, disa ballë fishekë, një bilbil sulmi... Ja dhe një fletore tjetër me disa fragmente shkrimi ende të lexueshme:

«Ta ndjekim këmba-këmbës bishën hitleriane gjer në Berlin!» Dhe vargun e këngës:

*Ngrihuni ju o të munduar...*

— Ideali ynë, — tha Skifteri. Internacionalja këndo-hej në qdo pozicion. Heshtja nderi krahët, kujtimet na pushtuan të gjithëve. Fytyra zeshkane e Skifterit dukej si një

copë e prerë nga shkëmbi. Ai u ul mbi një trug dhe filloj të shkruante. Në fletoren e tij lexoj:

«Zbresim nëpër gërxhet e malit «Ariu i bardhë» me ju në supe. Mbajmë mbi supe bashkë me arkivolet tuaja të kuqe me yje të ndezura krismat e armëve, biografitë tuaja, ëndrrat tuaja, zërat dhe këngën tuaj:

### *Internacionale do të jetë bota e re...*

Maja e malit «Ariu i bardhë» të dukej se takonte kùpën e qiellit. Skifteri vështronte vendin ku qenë zhvilluar betejat. Kazmat godisnin llogoret e mbuluara, nxirrin nga toka kockat e shokëve tanë duke i lënë asaj gjurmë të ndezura e të pashlyeshme. Shoqëruesi e ndiente që diçka ndizej në sytë e njerëzve të thjeshtë kur kalonin arkivolet me yje të kuqe dhe diç donin të thoshin, diçka donin të bënin. Edhe Skifteri shkruan: «Shoqëruesi deshi... Shoqëruesi?... Ngec stilografi, siç ngel plori i parmendës papritur në një cung apo gur. Mbi malin «Ariu i bardhë» (kështu e quanin ato ditë me luftime këtë mal) kaloi një re e zezë e ngarkuar me shi. Në fletore Skifteri shkruan vargje për dëshmorët:

*Kockat tuaja i mblodhëm  
një nga një porsi flori.*

\* \* \*

«Ariu i Bardhë duhet të mbetet i pakapshëm, këndeji do të tërhiqi me urdhrin tim», — u tha kolonel Vilenbergu oficerëve të repartit që ishte vendosur në malin «Ariu i bardhë». Fjalën e tha me një zë gërvishës, me ton kërcënues. Këtë nuk e bëri rastësisht. Ai e kishte pruvuar egërsinë e pushtetit të pakufizuar mbi ushtarin dhe s'dinte tjetërsoj të sillej, sidomos kur kishte vënë re se lajmi i hapjes së rrugës, e vetmja shpresë e shpëtimit për

kolonën e rrëthuar në Mal të Zi, u kishte dhënë zemër ushtarëve të rrëthuar, por i kishte bërë më të pavendosur të qëndronin në pozicione të tjerët.

Divizioni «Brandenburg» në tre muaj luftimi të parerë me brigadat shqiptare nuk ishte më ai divizioni që mburrej në urdhrat e ditës të Gruparmatës E. Nuk përmendej më në asnjë komunikatë emri i kolonel Vilenbergut. Divizioni ngjante me një njeri që ka humbur gjak në atë sasi që ftyra i mbetet e zbehtë e sytë të venitur. Ardhja e kolonel Vilenbergut nuk mundi të kthente tek esësët e vendosur në atë mal energjinë e mëparshme, por qëndresa e tyre u bë më këmbëngulëse, mali u mbush me mitraloza, mortaja e topa.

Një dritë shprese flakëroi në sytë e kolonelit. Ai besoi se qëndresa në këtë mal mund të mbahej për të siguruar tërheqjen pa humbje.

\* \* \*

Në natyrë ndesh në gjëra të papritura që të habisin. Dy këmbët e Ariut të Bardhë ku janë vendosur hitlerianët ulen në drejtimin tonë. Në fund aty ku mbarojnë këmbët e këtij mali janë disa kodra të vogla si kthethra, të ngjashme me putrat e ariut, kurse sipër maja e malit si koka e egërsirës. Në vështrim të parë syri të gënjen. Thua asgjë e gjallë nuk jeton në këtë mal, por ne e kemi provuar dhe e dimë se çfarë fsheh bardhësia e ftohtë e këtij mali.

Komandanti i brigadës, Sopot Golemi, e ka më lehtë të vëzhojë malin «Ariu i bardhë» nga lartësia ku qëndron në pozicione kompania jonë. Ai erdhi këtu dhe qëndroi gjatë duke vështruar. Atë ditë moti ishte pa re, ma-

li mund të vëzhgohej edhe pa dylbi. Sopot Golemi mbeti si diçka e ngulur në vend me vështrimin të mali. E kaloi dylbinë herë në njérën dorë e herë në tjetrën. I ngriu dylbia në dorë, iu mpinë sytë duke vështruar malin përballë, vëzhgoi paprerë. Prania e komandantit të brigadës, e sidomos vrojtimi që bëri mbi malin «Ariu i bardhë», bëri që në skuadër të ndizej biseda.

— Nesër mbrëma jemi aty, — tha Lulo Driza dhe vështroi nga mali.

— Ke filluar të merresh me plane të mëdha, kur kështu? — e ngacmoi një tjeter.

— Jo, nesër do flemë ngrohtë në qytet, — tha Ago Ymeri, që ikën përpara në mendime si një sulmues që çan e ecën përpara pa menduar e ka apo jo shokun në krah.

Fluturimet e Agos i jepnin fund luftës brenda ditës, si në përrallë. Më pëlqente që Agoja entuziazmohej. Në brigadë jetonte mendimi se Viti i Ri do të ishte viti i fitores mbi bishën hitleriane. Që të vinte sa më parë ajo ditë, buçiste e gjëmonte Ballkani e Evropa, për atë ditë bëheshin përlleshjet, betejat e ashpra.

Planet e komandantit të brigadës sonë përllesheshin me ato të kolonel Vilenbergut. I dyti kërkonte ta mbannte me thonj e dhëmbë malin «Ariu i bardhë», kurse i pari luftonte ta merrte me çdo kusht dhe ta dérrmonte kundërshtarë. Komandanti i kompanisë, Dardani, iu afroa, nderoi me grusht dhe përshëndeti me zë: «Vdekje fashizmit, shoku Sopot.»

— A erdhët, Dardan? — Takuan duart, vështruan njëri-tjetrin sy në sy. Trimëria e njërit shkoni dhe tek tjetri. Dardani, ishte erë që kalonte nëpër plumbat. Në zemrën e tij vlonte një zjarr i papërmabjatur zemërimi, ndiqte pas flakën e dhjetëshes me dylbi. Ata biseduan. Ishte në natyrën e Sopot Golemit të rrëmbente zemrën e trimave. Ai i hodhi dorën në sup dhe u endën nëpër borë. Topi që nga larg dërgoi predhën. Ata vazduan bisedën si të mos ndodhët asgjë. Kjo bisedë e përzëmërt erdhi mbas një thumbi të fortë që ai i dha Dardanit që

herë-herë rrëmbehej në luftë. U endën disa herë me vështrim te maja e malit, duke biseduar për luftën.

— Ta kam frikën, Dardan. I trembem guximit tënd të papërbajtur, — e kujtoi përsëri komandanti i brigadës. — Nëse nuk do t'i trembesha pikërisht kësaj, do të të besoja një detyrë tepër të rëndësishme.

Dardan Velishta heshti si një fëmijë që s'di si mund të shfajësohet për ato që kryen padashur nga vrulli i moshës. Ai e njinte dobësinë e tij dhe luftonte ta ndreqte. Edhe kësaj here nuk i bëri dot ballë vështrimit qortues të syve të Sopot Golemit. Një kohë qëndroi i heshtur me nofulla të shtrënguara nga zemërimi. U mundua t'i vidente vështrimit zhbirues të komandantit të brigadës. Ai e mbajti frymën që të mos fliste. Foli vetëm në heshtje.

— Edhe kësaj here kam gabuar, — tha Dardani. Kështu tha edhe në mbledhjen e celulës.

— Këto gabime duhet t'i ndreqësh, — i tha komandanati i brigadës dhe heshti. Priste përgjigjen e Dardanit. Dardani u bë gjak i kuq në fytyrë, i dolën djersë. Nuk foli. E mbajti atë ngarkesë shqetësuese pa e derdhur. Mendohej, ishte tepër i habitur me veten e tij. Mbas gjashtë javësh ai i kishte harruar ato qortime të rënda që iu bënnë në mbledhjen e batalionit në fshatin Batin. Sopot Golemi e vuri re se Dardani herë skuqeji, herë zbehej e fjalë nuk nxirrte. Ziente përbrenda.

— Të zbrazësh pushkën në vijën e sulmit mbi esesin që ke përpara, s'do të thotë që të harrosh se je komandant, — tha Sopot Golemi. — Kërkohet medoemos gjykim mbi veprimet dhe drejtimin e luftimit, ndryshe e papritura dhe përplasja e kompanisë në shkëmb në qdo çast është më e mundshme. Kërkohet që të bësh kujdes. Është lehtë për një komandant të vendosur të dalë në ballin e sulmit dhe të vdesë trimërisht, por është zor të dijë të komandojë. Këtë mos e harro. Dardanit i mori fytyra një çehre tjetër. Ai u mundua ta qetësonte, i hodhi dorën në sup dhe ata të dy u endën disa herë nga njëri skaj i kompanisë në tjetrin. Ecën, biseduan e vështrimi i tyre mbeni në malin e lartë e të bardhë.

— Mësojmë në luftë e sipër, por s'ke si mëson kur pësimi nuk të bëhet mësim. Është kështu? — e pyeti.

Dardani heshtte, fliste balli i tij i mbuluar me djersë.

Komandanti i brigadës e largoi vështrimin dhe e ndërpren fjälën që t'i jepte mundësi Dardanit të mendonte e të gjykonte. Foli për pikën e zezë që dukej sipër putrave të «Ariut të Bardhë». Aty vështroi me dylbi.

— I gjithë vendi aty qenka shkëmb, — tha Sopoti.

— Aty qëndron forca e tyre, — tha Dardan Velishta. Ai për shkëmbin dhe për malin mund të fliste dhe foli gjatë, ndërsa vëtveten nuk arrinte ta frenonte në sulm. Përse ndodhе kjo me Dardanin?

Mendimet që tha për malin «Ariu i bardhë» u miratuan nga komandanti i brigadës. Ato ditë dylbia e Dardan Velishtës si rrezet rontgen që depërtojnë në thellësi të mushkërive për të zbuluar njollën, kishin depërtuar e zbuluar një për një armët e vendosura te shkëmbi, një mal tjetër mbi malin. Dardani ia tregoi Sopotit të gjitha ato q'kishite parë në pozicionet e armikut. Sopoti e dëgjoi me vëmendje. Me vështrimin herë te maja e malit e herë te komandanti i kompanisë, Sopoti tha:

— Po, shoku Dardan, ju keni të drejtë. Është më lehtë kur gjarprin e godet në kokë. — Sopoti heshti. Përse heshti komandanti i brigadës?

Dardan Velishta u gjallërua për të kapur gjithë mendimin e komandantit të brigadës, por nuk arriti...

— Ka ndonjë shteg që ngjitet gjer aty? — e pyeti komandanti i brigadës.

— Ka, — tha Dardani. — Është një shteg, ka një njeri që e njeh atë sheg.

— Vendës?

— ...

Në kompani mori rrugë mendimi: «Do të sulmojmë esesët në malin «Ariu i bardhë». Dhe si përherë, kur mësohej për sulmin, secili hodhi dorën tek arma, numëroi fishekët e shtrëngoi rrëth mesit granatat...

\* \* \*

Dardan Velishta bisedonte me Goxho Bërdëllimën. Mundohej t'ia ulte zemërimin. Po ai kishte marrë flakë si zjarr kashte. Në fjalë e sipër edhe Dardani u nxeh. Ishte një keqkuptim që ndodhi, një keqkuptim që i zemëroi të dy.

— Dre, dre! — bëri xha Goxhoja. — Djalo, Dardan, po munde zbritma zemërimin me fjalë të urta, ndryshe guri në rrokullimë ka për t'i shkuar kësaj pune, s'kemi për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin, dëgjon? Mos ma hidh fjalën degë më degë, ma thuaj shqip atë që të tha komandanti i brigadës, ose shkon vetë Goxhoja të bise-dojë me Sopotin, ende ai s'ka hequr dorë nga ai mendim. Gjer këtu Goxhon nuk e prunë këmbët, por e pruri koka, or babam!

Në kompani u hap fjala se Sopot Golemi kishte thënë: «Të pyetet edhe një herë Goxho Bërdëllima, në qoftë se e ndien veten të lodhur nga mundimet e luftës, të kthehet». Se si u përhapën këto fjalë, nuk e morëm vesh asnjë, po këto u bënë shkak që xha Goxhoja u bë tallaz, s'këmbeje dot një fjalë me të. Grindej me të gjithë, pinte duhan, e thoshte: «Edhe gungaç të isha, nuk kthehesha, i çalë jo se jo, djemtë mbas esesëve duke bërë luftë në dhë të huaj e Goxhoja të kthehet të luajë cingla me më çokun në vatë! Bukur besa, mirë i ka shkuar mendja Sopotit. Nuk e di që Goxhoja e ka parë diellin ca ditë më përparrë nga ai!»

— Nuk më ka folur komandanti i brigadës për këtë çështje, — i tha Dardani qetë-qetë, po xha Goxhoja nuk e besonte. Kjo e zemëroi edhe Dardan Velishtën.

— S'të ka folur, ë? Shikomë këtu, në sy. Përse tjetër do të të fliste Sopoti, një sahat të mbajti. E përsë të mbajti? E di që s'ma tregon, por, ç'ke në zemër, ta shoh në sy. E besoj, Dardan, që të vjen keq, ama gagaç s'je, ta kundërshtoje komandantin e brigadës.

— S'mund ta kundërshtoja, — tha Dardani, — unë...

— Gjërat që s'duhet të bëhen, lypset t'i kundërshtojmë, oj, ky Sopot, harron që nga vend guri është ai dhe nga vend stralli jam vetë. E harron këtë, ndaj s'ka ç'bën e një e dy e mendja tek unë i mbeti.

— Ai është komandant dhe mendon për të gjithë, — ndërhyra unë.

— Ti pusho, — m'u hakërrye, — shiko punët e tua, dëgjon? — Fjalët e mia e ndezën edhe më tepër. Dardani më dha shenjë që të mos e ngisja më tej.

Komandanti i brigadës me radio mori urdhrin nga shtabi i divizionit tonë që të bënte takim me një brigadë partizane vendëse. Ajo sulmonte në vargmalet në krahun e djathtë të brigadës sonë. Ata u takuan me komandantin e brigadës fqinje në fshatin ku ndodhej kompania jonë. Në krahun e majtë ishin brigadat e tjera të divizionit tonë. Një sulm i përbashkët përgatitej.

— Të sera i keni malet, — i tha Sopot Golemi dhe hodhi vështrimin përpara mbi malin «Ariu i bardhë».

— Si dhe tuajat, — tha vendësi.

Biseduan gjatë përvargmalet ku ishin vendosur esesët, për terrorin që bënte armiku në qytetin Stari-Varosh dhe për sulmin që do të bëhej.

— Ju shtrihuni tutje, nga e djathta, kësaj ane jemi ne..., — I tha Sopot Golemi. — Me një goditje të koordinuar mirë do t'i zhbjjmë nga këto male esesët e kolonel Vilenbergut. E shoh se i kanë rënë pendët, s'është më ai që turfullonte si hamshor nëpër fushat e Kosovës. Radiot i kemi, të merremi vesh për çdo gjë... Edhe korrierët i kemi. Erë i kemi djemtë, t'i çojmë lajme njëri-tjetrit. Mirupafshim!

U ndanë...

\* \* \*

Maja e malit «Ariu i bardhë» ngrihet lart në drejtim të qillit. Lartohet e bardhë, e thepisur, pa rrugë. Një mal i frikshëm, me maja të mprehta e me humnera.

Syri ynë filloj të studionte malin një për një, me ato

hollësi matëse të topografëve që e hedhin çdo gjë në hartë, ashtu edhe ne e regjistruam në mendjen tonë. Si mali ajo dukej diçka e paarritshme. Sikur t'i kishte pikasur mendimet tonë, komandanti i brigadës, para se të largohej, tha:

— Qëndresa e tyre në qytet është e lidhur me qëndresën në këtë mal.

— Do të ngjitemi edhe aty, shoku Sopot, do të ngjitemi! — tha Dardan Velishta. Komisarit të brigadës, Argjir Progrit, i pëlqeu që Dardani edhe mbas kritikës që iu bë nuk e ndiente veten të ndrydhur. Një çast u bë heshtje. Që kompania jonë të sulmonte majën e malit, kërkohej miratimi i komandantit të brigadës. Më tepër nga të gjithë e ndjeu rëndë në shpirt heshtjen Dardani. Pak më parë Sopoti kishte thënë: «I trembem rrëmbimit tënd në luftim, shoku Dardan.» E tani, si të thoshte Sopoti? Do t'ia besonte kompanisë sonë këtë detyrë të rëndësishme që kishte të bënte me fatin e gjithë veprimeve luftarake të brigadës? Dardanit i vërshoi përsëri në fytyrë gjaku e iu bë prush balli me djersë. Ai ishte shkaku që komandanti i brigadës hezitoi. Në të vërtetë nuk ishte fajtor vetëm Dardani, ne shokët e tij më tepër duhej ta kishim ndihmuar. Prisnim me padurim fjalën e komandantit të brigadës.

— Mjaft qëndruam duke ngjeshur borën me këmbë, s'kemi ardhur këtu, në malet e Bosnjës, të shtypim vezë, për luftë kemi ardhur, — tha Goxho Bërdëllima i inatosur e tërë duf.

— E bërë qoftë, ama vendi i fortë më duket, — pshëritiu Sopoti dhe sytë e tij vështruan edhe kësaj radhe Dardanin. Trim i ka një symatës të përpiktë, ndaj Sopot Golemi na vështroi secilin në bebëza të syve. Na vështroi dhe e vështruan.

— Nuk është zmbrapsur para asnjë mali brigada jo-në, — tha një partizane.

Sopot Golemi hodhi vështrimin andej nga erdhi zëri. Pa një vajzë shtatlartë me flokët të derdhur mbi supe. E njuhu. Ishte Bukurie Çabiri.

\* \* \*

— Oj, oj! — thirri në mbrëmje Goxho Bërdëllima i habitur kur hyri në strehim dhe pa stufën e zjarrit që përcëllonte, — do të shkrijmë sonte nga të nxehjtët.

Afër mbrëmjes nisi furtuna, bora që ngrihej nga era kthehej në një duman mbytës, strehimi ynë lartohej e dukej si një gungë e bardhë në faqen e malit. Një pishë e lartë shumëshekullore nuk i qëndroi dot furtunës, me rrënje përjashta u përplas në hyrje të strehimit tonë.

— Mend na zuri si dërrasa zogun, — tha Ago Ymeri me fytyrën të shqetësuar

Një orë më vonë, kur malin e pushtoi errësira e natës, u dha te dera e strehimit komisari i brigadës.

— Nxehësia e tepërt na debolon, — tha Argjir Progrë dhe vështroi sobën e ndezur.

— I lanë në vend kur ikën, — thashë unë. Enkas fola që ta zbusja përshtypjen jo të mirë që u krijua.

Komisari i brigadës i zgjati duart nga soba e vështrimin e hodhi rrëth në fytyrat e shokëve të skuadrës. Afshi i të nxehtit shkru i pluhurin e hollë të borës që i kishët mbetur rrëth qafës së këpucëve, rrëthit të gjerdanit të fishekëve të kryqëzuar në gjoks. Edhe rripat, edhe teshat nxorën avull.

— Kujdes nga ndonjë e papritur, kujdes?! Po u mësuam kështu, do ta kemi keq, — tha komisari i brigadës.

— Kam thënë unë, shoku Argjir, s'bën të rrimë nën tokë si urithët, — u ankua Goxho Bërdëllima. — Ata esësët e shpojnë tokën si urithët, po në jemi partizanë dhe i nxjerrim edhe nga briri i buallit... — Argjir Progriti shndritën sytë, balli, fytyra e hequr e simpatike.

— Do ta vazhdoni shkrimin në numrat e tjerë të revistës? — më pyeti komisari i brigadës.

Ishë e papritur përmua pyetja që më bëri. Rrudha supet e nuk fola. Në numrin e fundit revista e brigadës filloj një shkrim timin përluftëtarët e skuadrës.

— Të vazhdosh, — më tha. Mënyra si e tha fjalën ishte nxitje dhe detyrë.

— Kam ndër mend, — thashë me gjysmë zëri.

— Është mirëpritur, duhet ta vazhdosh. E kuptoj që në këto kushte e ke të vështirë të shkruash, por mos harrro, sa më afér t'u qëndrosh njerëzve e ngjarjeve, aq më luftarake bëhen shkrimet, sepse janë copëza ngajeta e pëlqehen nga të gjithë. Komiteti i Partisë i divisionit në mbledhjen e fundit dha porosi që revistat e brigadave dhe gazetat e xhepit të batalioneve të dalin më dendur dhe faqet e tyre të mbushen me heroizmat e luftëtarëve, të shkruhet çdo gjë. Ajo që keni bërë është një gjë e mirë. Në revistat e gazetat e xhepit duhet të jehojë zëri i llogores, fjalë e vepra e luftëtarëve në vijën e parë.

Përjashta era frynte si lubi, drurët e pyllit përkulëshin, bora në strehim ngrihej duman. Furtuna në strehim ndihej si një shushurimë e émbël. Ajo që rojat kur kthehezin e quanin kuçedër, aty në strehim ndihej si një nanuritje që të vë në gjumë. Nxehësia e zjarrit dhe frymëmarrja jonë bëri që ngrohtësia të lëpinte me afshin e saj tavanin e strehimit dhe në disa vende zuri të pikojë. Goxhoja ndjeu një pikë të verbër uji t'i binte në shpatull.

Rreth zjarrit ishin të gjithë shokët e skuadrës. Argjir Progri bisedonte, një pjesë të skuadrës i njihëte, ishin partizanë të vjetër të ardhur në brigadë nga batalioni i Gurshtatarit, disa të tjerëve mundohej t'u afrohej nga përshkrimi i portreteve që u ishin bërë në shkrimin e botuar në bulletinin e brigadës.

— Ku është Vasoja? — pyeti. Ai nuk e njihet Vason, por në shkrimet e mia kisha dhënë portretin e tij, veshjen, trupin e tij të zhdërvjellët.

— Ka shkuar për të na sjellë bukë, po edhe sot do të na thotë: «Fishekë ju gjej, edhe florinj ju gjen Vasoja, ama bukë mos më kérkon!» — tha Dardani. — Bën përpjekje i ziu Vaso, po ku ta gjejë bukën, shoku Argjir, në këto male? Mundohet i ziu Vaso, endet me thasë në krahë, por...

— Fare pa gjë nuk na lë, shoku Argjir. Kur s'gjen bukë e patate, na bie nuska të shkruara nga pukovniku i nozullimeve, — lëshoi thumbin therës Goxho Bërdëllima.

\* \* \*

Komisari i brigadës lexoi një komunikatë të Shtabit të Përgjithshëm:

«Në Mal të Zi brigadat e ushtrisë sonë zhvillojnë luf-time të ashpra me nazistët gjermanë. Më 19 dhjetor brigadat tona dhe partizanët e Malit të Zi çiruan qytetin e Podgoricës... Më 21 dhjetor në Brskut, Ljevo-Reka dhe Verusha u sulmuani nga brigadat tona kolonat e armikut në tërheqje. Më...»

— U bëka luftë e madhe andej, komisar, — tha Goxho Bërdëllima. Ai enkas ndërhyri që të fliste komisari i brigadës. Dëgjojmë me vëmendje fjalët e komisarit të brigadës. — Vërtet Duçen e varën nga këmbët, o komisar? — pyeti ai.

— Po, — tha komisari i brigadës.

— Hajt pra, shoku komisar, dhe në kokë të Hitlerit, gëzuar! — dhe ngriti gaveten që kishte vënë në zjarr për të shkrirë borën të pinte pak ujë të nxëhtë që të shuante urinë. Argjir Progri e njihte mirë Goxho Bërdëllimën, ishte mësuar me shakatë e tij.

— Mbaroi lufta, — tha Ago Ymeri, i gëzuar, — mbaroi lufta. Vdekja e Benito Musoliniit e entuziazmoi.

— Nuk ka mbaruar ende, Ago? Ç'është kështu me ty, Ago, një e dy sa dëgjon një lajm, e bramb fjalën: «Mbaroi lufta!» Jo, jo! Aq lehtë mos e quaj këtë punë. Sa kohë kemi që hahemi dhëmb për dhëmb me esesët e këtij damillasë, — tha xha Goxhoja dhe zuri jakën e xhaketës së kolonel Vilenbergut. — Gjysma e tyre hanë dhé, po hë de, edhe këta që kanë mbetur, qençë luftojnë!...

— Të mos harrojmë, shokë, se në vijat e frontit ka qindra divizione si ky i kolonel Vilenbergut — tha komisari i brigadës.

— Ka punë bota nga galat e Hitlerit, dale-dale, vajis mitralozin, Ago, atë bëj.

U ndez biseda, flitej gjer ku kanë arritur vijat e frontit. Prapë kaloi fjala te varja e Musoliniit nga partizanët italianë.

— Atë që u ka bërë të tjerëve e pagoi me kokë, — tha Luloja.

— I vrari Duçe, qe betuar se tetë milionë bajonetat e ushtrisë së tij do ta ndalonin diellin të hidhte dritë mbi dhë. Tërë njerëzit varen nga koka, atë e varën nga këmbët.

Lulo Driza që ishte mbështetur mbi mitraloz u ngrit dhe ngacmoi zjarrin, flaka e shporetit i ndriçoi fytyrën dhe iu duk shenja e plagës së plumbit në anë të nofullës.

— Një shenjë e vogël do t'i mbetet, — tha me vete Goxho Bërdëllima. Ani, s'ka gjë, djalë është Luloja, mirë që shpëtoi. — Lulos kishte filluar t'i vinte fjala e kënga që i patën ikur ditën që u plagos në nofull. Ishte bërë Luloja siç ishte: gaztor e këngëtar. Ai ia mori këngës. Nuk belbëzonte më nga plaga e plumbit, i kishte ardhur në fytyrë gëzimi i parë dhe në buzë kënga. I mbështetur te mitralozi vazhdoi të këndonte: Me Lulon të gjithë. Kënga jehoi:

*Pararoja, pararoja,  
ju borgjezët e fëlliqur, ja ku vjen,  
ku po vjen  
pararoja  
dhe varrin po ju rrëfen...*

Kënga shprehte idealet tonë, këndonin të gjithë veç Ago Ymerit që dremiste në gjumë dhe xha Goxhos që përpinqej të këndonte, po s'mundte.

— Ago, mos i mylli sytë si pulë, apo i dhe fund luf-tës. Hë de, mbushe këngën, mbushe, djalë, këngën? — e ngacmoi xha Goxhoja dhe, sapo mbaroi këngën, iu drejtua komisarit të brigadës me pyetjen:

— Sa brigada u bënë që kemi kaluar kufirin, shoku komisar? — Xha Goxhoja s'lexonte dot, po kureshtja e shtynte të mësonte qdo gjë.

— Shtatë brigada jemi në vijën e parë të luftës, prapa ka të tjera.

— Këto më thuaj, dua të di, shoku Argjir, cilat janë? U përmendën: Brigada e Tretë, Brigada e Pestë, Bri-

gada e Gjashtë, Brigada e Shtatë, Brigda e Tetë, Brigada e Njézetedy, Brigada e Njézetepestë...

— Kështu duhet, më shumë e më mirë. As që ia priste mendja kolonelit të esesëve që do t'i ndiqnin këmba-këmbës, tytë në kurriz i mbetëm.

— Me armët tonë i përzumë nga trojet tonë stërgjyshore, do t'i përzëmë edhe nga këto male, — tha komisari i brigadës.

Biseduam për frontet e luftës, për hallet e popujve, për ditën e fitores, edhe për bukën...

— Një këngë tjetër, djem, — tha xha Goxhoja.

— Ka dhe vajza në skuadër, xha Goxho, jo vetëm djem, — ia ktheu në çast komandantja e skuadrës, Bukuria.

— Mos më thumbo me thumb hosteni, dëgjon? E di Goxhoja, e di. Hë, mo Ago, fillo këngën, — e ngacmoi me bërryl. — Hë de, c'pret, ke kohë për gjumë, mbaron nata e dhjetorit?

Zjarri na largonte të ftohtët, po na afronte urinë. Mundoheshim me fjalë ta lagonim mendjen tonë nga thesi jetëdhënës i Vasos, por uria na gjerryente zorrët. Prisnim Vason të vinte. Ai s'po dukej. Në këto raste Agoja bëhej objekt nga të gjithë dhe kjo ngaqë mbante emrin e mbiemrin e personazhit të një balade popullore që sofra i qëndronte shtruar me bukë e me mish dhe vera derdhej lumë. Mirë thuhet: Pula e uritur sheh në ëndërr sikur ha grurë. Edhe ne s'kishim bukë, po «hanim mish e pinim verë» si në baladë. Në çaste si këto Agos nuk i rrithet, e ruante humorin e tij pikërisht për këto çaste. I thashë:

— Nisja këngës, Ago? Një këngë që...

— U, si thua kështu, mo Agim ziu, nuk më dëgjon që këndoja?

— Këndon? Si këndon? — e pyeta.

— Më këndoja zorrët, vëllai im, nuk i dëgjon?

Fjalët e Agos na bënë të gajaseshim. Ai doli përjashta. U kthyte me një plis bore. Sipër shporetit vuri gavetën e tij alpine dhe mbi të plisin e madh të borës.

— C'bën, Ago? — i tha Bukuria,

— Thek bukën, ngroh mishin, shoqja komandante e skuadrës.

— Ashtu?

— Ashtu. — Agos i ndritën bebëzat e syve. Pastaj shpërtheu kënga.

— Hë de, kështu de, — tha xha Goxhoja dhe ia mori nga goja këngën marrësit. Me zë të lartë këndon e flet: — Iso, djem, iso për këngën e plumb për armikun. — Kënga buçiti:

*Pse s'ha bukë, pse s'pi verë?  
Ago, Ago, Ymer Ago!*

Nën plisin e bardhë të borës gaveta alpine e Agos mbushej me ujë.

Më erdhi papritur në kokë një mendim, në fillim turbull, m'u ngacmua nga shakaja që bëri Agoja për bukën dhe për këngën që këndoi apo sepse erdhi papritur në strehim porcion i me patate. Vaso Lundra endej me thesin në krah për ushqime, kërkonte e s'gjente gjë. E këto patate nga erdhën? Më kujtohet ajo që ndodhi mbas-dite me xha Goxhon. Ngjarja m'u kujtua një për një. Fill mbas asaj grindjeje të papritur me Dardanin, Goxho Bërdëllima, në vend të bënte autokritikë që ishte nxehur kot së koti, endej i vetëm rrëth lartësisë, murmuriste autokritikën e tij me vete, kështu bënte shpeshherë. Kur e shikonte që kishte bërë gabim, hiqej në një anë e belbë-zonte me vete. Ai u bë shkak që atë natë të mos mbeteshim pa kaluar diçka tej dhëmbit. Kujtoj çastin kur nga larg xha Goxhoja më thirri:

— Agim, eja këtu, dëgjo, dëgjo! Është sëpatë kjo që dëgjohet apo m'u trullo së veshët nga gjylja që pardje më mbuloi me dhë. Hë, e dëgjon goditjen e sëpatës apo mos më bëjnë veshët?

Kush priste në pyll? Mbas nesh një gjurmë tjetër shihej. Xha Goxhoja e nuhati që një njeri vinte mbas dhe ndaloi.

— Ku shkon? — iu ngulmua xha Goxhoja Ago Ymerit.

— Më dërgoi komandanti i kompanisë, — tha Agoja që vinte prapa e larg.

— Dardani? — Goxho Bërdëllima tundi kokën për të shkundur zemërimin, bëri disa lëvizje që më erdhi për të qeshur. Ka raste që gjërat i merr tjetër për tjetër. Gjersa i zbriti zemërimi, qëndroi në vend; me shpinën të mbështetur në trungun e një pishe. Ndezi llullën dhe pinte duhan i menduar.

— Ngadalë, se e mbulove malin me mjegull, — e thumboi Agoja. — Ç'pate që u bëre xhind, edhe tre veta të jemi, kujdes duhet të bëjmë, në pyll vërtiten zbuluesit armiq me ski e pelerina të bardha!

— Mjaft e lëvize atë «zagare në kamare», — i tha për gjuhën. — Bën mirë të heshtësh, dëgjo atë, e dëgjon dot! Hapi veshët! Ajo që thoni ju s'ka për t'i ndodhur kurre Goxhos, pse, ore, në prapanicë i kam sytë? Ik tutje, mbaj vesh aty ku të thonë, atë bëj. E dëgjon sëpatën?

Sëpata pushoi. Ndoshita ai na kishte parë... Disa hapa më tej pamë një ka të larmë që e kishin lidhur nga brirët me litarë te trungu i një ahu. Ago Ymerit iu ndezën sytë kur pa kafshën dhe tha:

— S'bëhet kiameti sikur t'i themi Vasos që t'i vëré thikën këtij kau e t'ua ndajë shokëve të kompanisë, u verbuam për bukë, u verbuam për mish. Si dreqin nuk e kemi parë, e kemi pasur afër të lidhur për brirësh dhe na plasën sytë.

— Pastaj? — e pyeta unë. Doja të dija a ishte e vërtetë fjala që tha Agoja.

Ago Ymeri ma priti copë:

— Ja, o, i vëmë këtij kau thikën te veshi. Çfarë tjetër? Kushedi ku është i zoti rron a s'rron.

Goxho Bërdëllima e kundërshtoi, nuk u bë në një mendje me Agon.

— A di ç'do të thotë një ka në këtë vend, djalo! — ia

priti. Fjalën e tha i zemëruar dhe shtoi: — Kau në këto male është shtylla e shtëpisë, numërohet si një pjesëtar i familjes. Kemi ardhur t'u ndihmojmë që të çlironen një orë e më parë nga kuçedra, jo të trohisim biçakun, të mos ta dëgjojë më Goxhoja atë llaf. — Vështrimi i syve fliste më tepër se fjalët.

Agoja nuk foli. Ai vetëm dëgjonte. Kau dha një të pëllitur të zgjatur: Muuu! Pëllitja e kaut na u duk si ulërimë egërsire.

— Me siguri u ka mbetur në vend gjermanëve, kanë dashur ta hanë mish të freskët, — tha Agoja. — Po s'vumë ne dorë në të, do të vënë esesët.

— S'është gjë që bëhet ajo që thotë mendja jote, dëgjon?

— Nuk e thotë mendja, por stomaku, — tha Agoja.

Befas na u shfaq para syve tej kaut një njeri veshur me rroba bosnjaku. Ai nuk na shikonte. U menduam t'i vidheshim syrit të tij, u fshehëm pas trungjeve të pishave. Ai as pa dhe as dëgjoi, ama e hodhi vështrimin rrëth e, kur u bind që s'kishte njeri, filloi me ngut të këpuste maya nga degët e pishës, bëri një vandak të mirë dhe ia hodhi kaut. Pastaj mënjanoi litarin me të cilin ishte lidhur dhe e fërkoi kafshën në zverk, sikur t'i thoshte me zë të ëmbël: «Kthehu pak prapa, biro!» Kau e kuptoi të zotin dhe lëvizti këmbët.

— Shët! — Goxho Bërdëllima vuri gishtin te buza dhe i habitur shikonte nga afër njeriun. Fytyra e burrit me veshje të vendësve iu duk si e parë. Ishte një burrë i moshuar, por i mbajtur mirë, sado që flokët, mustaqet e vetullat kishin filluar t'i thinjeshin. Në kokë mbante festë të zezë, rroba shajaku, mesin e kishte shtrënguar me brez leshi.

— Këtë njeri e njoh, — më tha xha Goxhoja. — Më erdhi pér të qeshur. Si mund ta njihet? Ku Bosnja dhe ku malet e Gurshpatit, hane Hind e hane Jemen, me zor e përbajta të qeshurën, më tepër se mos më zemërohej xha Goxhoja.

— Tungjatjeta, shok! — foli shqip i zoti i kaut. Go-

xho Bërdëllimës i qeshi mustaqja e bardhë për ato që kishte thënë më parë.

— Mos je çetnik, zotrote, që trembesh prej nesh? — i tha Ago Ymeri. — Mos e fshih kaun, ne s'prekim mallin e popullit. — Ai ktheu vështrimin në drejtim të Agos.

— E di, e di që ju partizanët e Shqipërisë nuk merrni asgjë, — tha bosnjaku.

— Na e ditke mirë gjuhën, zotrote, — i tha Goxho Bërdëllima.

— Kam ngrënë një barrë kripë në stanic tuaj, ku mbive këtu, o Goxho Bërdëllima, — iu përgjigj bosnjaku.

— Ai është, ai? — murmuriti me vete Goxho Bërdëllima.

Kau u harrua...

\* \* \*

I vumë përpëra një kokërr patate të zier komisarit të brigadës. Vetëm një kokërr.

— Ka për të gjithë? — pyeti.

— Për të gjithë, shoku komisar.

— Atëherë mirë se ju gjetëm, — tha komisari. — Nga kush e keni këtë dhuratë?

— Rroftë miku, — tha Ago Ymeri tek po hante kokrrën e patates me bërrylin të mbështetur në tytën e mitralozit.

Unë i tregova historinë e pëllitjes së kaut dhe për Ibron, të zotin e kaut.

— Mali me mal nuk takohet, njeriu me njerinë takohet, — tha Goxho Bërdëllima.

— Si? Si është e mundur? — pyetën kureshtarë sytë e të gjithëve.

— Mos më pyesni, e kyça dhe mbaroi, dëgjuat. Fati na e pruri në shteg, miq e kam Ibron. C'ju duhet tjetër?

— Unë nuk i besoj fatit, — tha Bukuria.

— Kurse unë i besoj, — tha Luloja. — Thuhet që nga qelli mos prit, andej mund të bien gurë, po ja që bien

nga qelli edhe patate. Kush priste të gjendej këtu në anë të botës Ibroja?

Pyeti komisari i brigadës për Ibron.

— Mik e kam, shoku Argjir, mik për kokë...  
Në vitet e Luftës së Parë Botërore Ibroja ishte ushtar me Austrinë. Më erdhi në stan, e kisha stanicin buzë Vjosës. Përse erdhën nga ana e italianëve ata tetë ushtarë të Austrisë, nuk e di, as Ibroja s'dinte të vërtetët, e dinte vetëm një graduat i tyre. Tani e marr vesh se përse kaluan vijën e frontit ushtarët e Austrisë, zbulonin pozicionet e italianëve. Ishin vënë të dy palët përballë njëra-tjetrës dhe bamb me topa. Ç'i hiqte kurrizi të ziut ushtar, kot derdhej gjaku i botës, fare kot! Ishin vënë në llogoret buzë Vjosës nga të dy anët mijëra ushtarë. Afër kisha ata të Italisë. Në fund të këmbëve u kishin rënë brekët. Di si ndodhi njëherë? Topi i Austrisë më goditi ahurin e stanit. U ndodh aty një ushtar italian, ra plasur në vijë. I hyri frika në bark. Edhe kur pushoi krisma e topit, ai s'lëvizi nga vendi. M'u desh ta ngrijë nga palltua. Ç'bën, çohu, ore bandill, i thashë. Medet si ishte bërë, fytyrë të vdekuri kishte marrë. Binte erë dreqi. Hë, djall, largohu, se më qelbe stanin, i thashë dhe ia mballosa një shqelm në prapanicë. Iku dreqi! Iku... Ky Ibroja që thoni ju, shoku komisar, erdhi vetë i tetë, u plagos dhe shokët e lanë në vend. E mora, e mjekova. M'u duk njeri i mirë dhe, kur mbaroi lufta e Parë Botërore, i thashë: Ik tani, Ibro, ik në shtëpinë tënde. Kështu është puna... Ndaj bëhet copë i shkreti. Edhe trajtë ma ka mbushur me duhan, e di Ibroja që unë e pi duhanin të rëndë.

\* \* \*

Edhe dita tjetër erdhi e ftohtë. Goxho Bërdëllima shkoi në skuadrën tjetër, e gjeti komisarin e brigadës, i tha ç'mendonte.

— Mirë, djalë, të dëgjon Goxhoja, të dëgjon, si s'të

dëgjon, je komisar brigade, kur s'dëgjon komisarët Goxho Bërdëllima, kë tjetër të dëgjojë? Ali Këlcyren? Kështu, biri im, të dëgjon, si s'të dëgjon Goxhoja, ama dhe ti diç duhet të bësh, kjo puna e Dardanit me Bukurien ka rënë erë te partizanët dhe s'bën ta pësojë djali, s'na e ka kush komandantin dhe s'dua t'i hyjë gjemb në këmbë Dardanit, dëgjon? Ndaj s'e zë gjumi rehat të ziun Goxho, dëgjon? Këtë kërkesë të Goxhos ndreqe dhe të vejë Bukturia në një kompani tjetër.

— Dardani e Bukturia janë të fejuar, e përse shqetësoheni, o xha Goxho?

— Të gjitha i di Goxhoja, rrofshin e u trashëgofshin, për sevdanë e për jetën s'ndalet asnjëherë pushka, e di mirë, por... — Fjala i mbeti në gojë, kaloi aty afër Bukturia. — T'i marrësh kokënështë, truphedhur si llastonjë pishe, e bukur sa s'ka, zemërmirë si ajo, trime që lum fëmijët që do ta kenë nënë, rrofshin e u trashëgofshin, dëgjon? Po i trembem plumbit, o komisar. Ka parë e ka dëgjuar Goxhoja. Në luftë të vret sevdaja, dëgjon?



Në mëngjes Argjir Progri erdhi në mbledhjen e celulës. Biseduam për sulmin mbi malin «Ariu i bardhë».

— Kërkohet që çdo plumb i armëve tona të bjerë në trup të armikut, — tha komisari i brigadës, — kërkohet që secili partizan të mësohet me kursimin e fishekëve dhe të mos hedhë asnjë pushkë më tepër sesa duhet; kërkohet që zjarri i armëve tona të hapet në pikën më delikate dhe në kohën më kritike për armikun; kërkohet që shpirti i sakrificës dhe i guximit të rritet më tej. Në kushtet e luftës frontale kërkohet që me veprimet tona luftarake tu përshtatemi kushteve të luftës frontale. Na duhet të bëjmë një punë të gjithanshme me partizanët. Komanda e brigadës i ka caktuar kompanisë tuaj një detyrë të rendësishme. Nga veprimi juaj do të varet shumë suksesi

i sulmit të dy batalioneve që sulmojnë ballas malin «Ariu i bardhë». Goditja juaj është goditje në kokë dhe do të ndihet tronditja e saj në gjithë pozicionet e armikut, prandaj përgatituni mirë, u sqaroni partizanëve mirë detyrën dhe veproni me mençuri e guxim. — Kur tha fjalët e fundit, komisari i brigadës e hodhi vështrimin te Dardani. Ai u skuq në fytyrë. Në mbledhje të celulës folëm të gjithë.

**Dardani:** Ta ngulisim mirë në mendjen tonë dhe të partizanëve që detyrën si kompani do ta plotësojmë atëherë kur të sigurojmë befasinë në goditje, ndryshe...

**Bukuria:** Shpirti sulmues dhe guximi, këto janë armët tona pér të fituar edhe në këtë luftim.

**Luloja:** Vend i ynë si komunist ka qenë dhe duhet të jetë: «Të parët në sulm, të fundit në tërheqje».

Argjir Progri dëgjoi me vëmendje diskutimet e shokëve, dukej i ngadaltë në fjalë, por i fortë në logjikë. Ai foli në mbledhjen e celulës se ç'duhet të kemi parasysh. Tha:

— Të sulmosh malin «Ariu i bardhë», nuk është e lehtë, por duhet t'i kapim medoemos majat e këtyre maleve. Pér këtë jemi të vendosur.

Mbas mbledhjes së celulës komandanti i kompanisë, Dardani, mblođhi kompaninë dhe na tha:

— Mali «Ariu i bardhë» pér gjermanët është pika më e rëndësishme. Pér t'i shkulur nga ky mal, nuk do ta kemi të lehtë, por edhe të pamundme jo. E dimë se mbas malit anës së lumit gjarpëron xhadeja. Kjo e bën të domosdoshme qëndresën e tyre, ashtu si e bën edhe pér anën tonë të domosdoshme marrjen e malit. Lufta do të bëhet dhëmb pér dhëmb e të dy palët me një synim të vetëm.

Goditja e armikut në lartësi te shkëmbi çorodit qëndresën e esesëve në malin «Ariu i bardhë», zbulon krahët e kolonës armike që tërhiqet, krijon panik, u heq mundësinë të largojnë forcat, armët e rënda dhe automjetet. Hë, më thoni, do ta marrim lartësinë? — pyeti Dardani dhe e ngriti dorën, e mbajti lart të mbledhur grusht. Ra heshtja. — Maja e malit «Ariu i bardhë» është gjithë

gurë e shkrepa. Ajo lëshon një hije të zezë në drejtim të maleve të bardha, ku është rrreshtruar në vijën e frontit krahas të tjerëve edhe brigada jonë.

— Hijen duhet ta gremisim! — tha Lulo Driza.

— Nuk është aq e lehtë të gremiset hija, nuk mjaf-tojnë vetëm fjalët për ta rrëzuar atë.

Mendimi i kompanisë u shpreh i prerë:

— Do ta gremisim hijen! Do ta marrim malin!



Vështruam ku do të sulmonim, shtigjet nga do të ngjiteshim në drejtim të lartësisë së malit «Ariu i bardhë», pastaj u kthyem përsëri te strehimi. Në orën dy të natës do të sulmonim. Mali ishte i ngarkuar me borë e akuj. Vasoja pruri një radiomarrëse me bateri. U mendua ta vinte në përdorim.

— Ku e gjete, Vaso? — e pyetëm.

— Aty ku u bë prita, kishte mbetur në vend, — tha ai. Radioja filloi të punojë. U mblohdhëm rrëth saj.

Biseda jonë u mek sapo Vasoja hapi radion.

Në emisionet e radiove jepeshin lajme e komunikata të luftës. Lufta kishte shtrirë përtokë shtete të vogla e të mëdha.

Lufta vazhdonte... Radiot buçisnin. Nga lajmet kuptuan që via e frontit e priste Evropën përmes si një uragan i zjarritë nga Polonia në gadishullin e Ballkanit dhe të Apeneve.

— Radion na e kërkojnë në batalion, — tha Vasoja i pikëlluar. — Thonë s'kemi kushte pér ta transportuar. E rëndë është, por ia vlen të mundohesh.

Dëgjuam spikerët e radiove: Londër... Moskë... Bari... pastaj marshe ushtarake. Të tjera kryeqytete: Athinë... Beograd... Sofie... Dhe prapë marshe ushtarake. Të gjithë flisnin pér frontet dhe pér luftën, jepnin komunikata, lajme, pastaj marshe ushtarake.

— Eshtë ndezur bota flakë, — tha Goxho Bërdëllima.

— Kërko Tiranën, atë duam, Tiranën, Vaso — tha Bukuria.

Vaso Lundra u vu në kërkim. Ai e gjeti stacionin e Tiranës.

Në ato male me borë e akull dëgjuam zërin e Radio Tiranës. Ngazëllimi ynë ishte i pa provuar. Donim të dëgjonim sa më gjatë, por...

— Bukë mos na jep, këtë bëj si të bësh dhe të mos na heqësh nga kompania, o Vaso, — i tha Goxho Bërdëllima. — Kjo qenka ç'qenka, na duhet, Vaso, na duhet dëgjon!

## XXV

— Ai këtu u vra. U godit papritur nga një predhë mortaje kur grupi diletant i brigadës jepte një shfaqje përfshatarët dhe partizanët e plagosur.

— Ishte duke i rënë violinës kur u vra, — plotësoi një tjetër. — Lozte «Internacionalen», në mos gabohem, — tha Skifteri.

Në pozicionet tona këndohej nga të gjithë «Internacionalja». Ai i binte bukur violinës. Violinën e tij e kam parë në muze. Për çfarë s'flet ajo violinë. Så ëndrra, sa dëshira, sa shqetësimë e tallaze të vijave të para të luftës njoju ajo? Tani qëndron në muze. Ajo lidh kohët...

Ai erdhi partizan nga bankat e normales dhe ra këtu me këngën e madhe në gojë: «Internationale do të jetë bota e re». Në qdo hap që hedhim sytë tanë ndeshen vetëm në pamje lufte. ....

Na kujtohet shoku ynë, violina e goditur nga dopat

e predhës, tingujt që lëshoi ajo kur kënga iu ndërprenë mes...

— Ishte luftëtar trim dhe i talentuar, — tha Skifter Velça. — Ju kujtohet ajo kënga e bukur që kompozoi?

Vendosëm piketën, vumë shenjë bri emrit të normalistit dhe ndoqëm rrugën që të nxjerr sipër në vargmalin te lartësitë e bardha.

Shenjat e llogoreve në malin «Ariu i bardhë» ende nuk janë fshirë. Ato më rikthyen në kujtesë veprimet tonë në këtë mal.

\* \* \*

Natën iu afroam malit «Ariu i bardhë». Te qafa ku bën ballë rruga që zbret nga njëri mal dhe ngjitet në tjetrin kishte ndaluar një njeri. Dukej një pikë e zezë në bardhësinë e borës. Ai qëndronte me vështrim te kolona jonë që ekte përpara.

— Ju lumtë, shokë, — tha komandanti i brigadës, Sopot Golemi. — Keni arritur në kohë. Marshimin e kryem në kushte të vështira, po ja ku dolëm te qafa e ngushtë, arritëm te putrat e Ariut të Bardhë.

Dolëm nga pylli dhe u vargëzuam në bardhësinë e borës. Moti ishte pa re, mot i ftohtë. Përballë, në drejtim të qiellit, lartohej mali dhe dukej si i paarrishëm. Sipër, në majë të malit, dukej shkëmbi në formën e një helmete gjigante.

— U lodhët? — na pyeti komandanti i brigadës.

— Bukur rrugë e zorshme ishte, — tha Dardani.

— Në ngjitje do të jetë dhe më vështirë, po o burra, shpejtoni!

Lëvizëm në drejtim të majës së malit. Dardani qëndroi me komandantin e brigadës.

— Ka mbetur prapa topi, — u ankua Dardani. Sopoti shkoi në drejtim të vendit ku mbeti topi, ndërsa Dardani erdhi në drejtimin tonë. Topi ishte i rëndë, rrotat iu fundosën në borë. Ishte një top i kalibrit të vogël, po tërhi-

qej me makinë. E kishin sjellë nga Kosova gjer aty në malet e Sanxhakut krahët e supet e partizanëve. Aty topi na ngeci në borë. Kërkohej që topi të vendosej te qafa e ngushtë përballë malit nga ku mund të godiste mbi armikun. Azemi, më i forti luftëtar nga të topit, mundohej, nxiste shokët, e shtynin, por rrotat e topit ngecni në vend. Sopot Golemi u afroa aty, i vuri supin, partizanët morën kurajë, e çuan dhe disa metra më tutje, por arma me gjithë shtratin përsëri humbi në borë.

Partizanët e nxorën edhe një herë andej topin e rëndë, por disa çape më tej ai u zhyt më thellë në borë.

— Ah, e hëngshin shtatëqind dreqën! — u ankua Azem Bajguri. — Një sliti na bën punë. Një sliti!

— Mundohu, Azem, mundohu! — i foli me emër partizanit komandanti i brigadës dhe iku, që të dilte në krye të batalioneve që ngjiteshin për t'u hedhur në sulm.

Topi ishte arma e parë që e mori në shenjë majën e malit «Ariu i bardhë».

Azemi e gradoi topin...

\* \* \*

Sopot Golemi kishte dy ditë e net pa vënë gjumë në sy. E ndjeu peshën e lodhjes, por nuk e bënte veten. Telashet pa fund të veprimeve luftarake, të ftohtët, bora, të gjitha këto vërshonin mbi të. Ashtu si lisi në stuhi, ai qëndronte, ecte në vijën e parë dhe afër pozicioneve, te një kodër e vogël midis drurëve, u ndal.

— Më duket se erdhëm, — u tha korrierëve.

Errësira e natës nuk na lejonte të dallonim asgjë, vëç siluetave të zeza si hije, përvijëzimeve të paqarta të vargmalit që shkon tutje gjer mbi qytetin Stari-Varosh, me një mbarim në formë piramide që lartohet mbi qytet.

Në orën gjashtë të mëngjesit, ende pa çelur dita, Sopot Golemi hoqi nga këllëfi pistoletën shenjëdhënëse, i vuri fishekun dhe priste kohën që të jepte shenjën e sulmit.

\* \* \*

E ngjitëm të përpjetën duke mbërthyer duart e këmbët në borë. Nga afër mundoheshim të kapnim ndonjë zhurmë. «Ariu i bardhë» na dukej sikur flinte... Po ne e dinim se esesët e kolonel Vilenbergut ishin në përgjim. Një çast malin e mbështolli mjegulla e dendur dhe nata u bë edhe më e errët. U ngritëm nga vendet, ecëm përpara me hapa më të shpejtë. Dhe ja, hovi i të ecurit u ndërpri. U përplasëm me shkëmbin. Kërkonim shtegun, po nuk po e gjenim. Shkëmb, kudo shkëmb. Shqetësimet nă rrëmbyen të gjithë.

— A do ta gjejmë shtegun? — pyeti Dardani.

— Në shteg jemi, — tha Ibroja. Gjurma e shtegut ishte fshirë, ishte bërë rrafsh. Çelëm me sëpata e bajoneta gropë në akull që të vinim këmbën. Shtrimë një litar të gjatë, formonim në ngjitje një zinxhir krahësh. Kokrizzat e borës nga forca e erës na godisnin si teh thike në fytyrë. U ngjitëm duke u mbajtur për litari.

Në horizont te shtegu endej diçka e zezë në madhësinë e një korbi plak. Dy shokë, dy nga më të shkathëtit në kompani, njéri prej të cilëve Ago Ymeri dhe Ibroja rrëshqitën përpara. Agoja nuk e besoi që ajo që lëvizte aty të ishte koka e esesit që bënte rojë. Agoja me përtim e hoqi armën dhe u bë gati. U pendua për atë që bëri, e hoqi nga shenja pushkën. Mbeti me vështrimin te korbi që ruante shtegun. Agoja ishte nxehur gjatë ngjitjes, por, duke qëndruar gjatë aty në vend, ajri i ftohtë ia blokoi mushkëritë. Atij i erdhi për t'u kollur. Një e kollitur do të bënte që çdo gjë të shkonte së prapthi. Megjithatë ai e ndiente që po i zinte grykën dhe s'dinte si ta largonte. Më në fund, duke lëvizur trupin, i dha mundësi kraharonit të tij të gjëra ta mposhtte kollën, ta shuanë në fytashtu siç shuhet energjia e rrufesë në aparatin e vogël rrufepritës. E shtrëngoi veten aq sa s'i plasën mushkëritë. Kur u qetësua, u dha shenjë shokut dhe Ibros të afroheshin. Agoja u bë gati ta godiste «korbin» me thikë. Ib-

roja nuk e la, e zuri nga dora, i afroi sëpatën dhe në heshtje i tha:

— Eshtë më mirë me këtë. — Hija e zezë u shafit në borë. Shtegu mbeti i lirë.

Bardhësia e borës të merrte sytë. Dardan Velishta shikoi vendin ku ishte vargëzuar kompania në borë, nga ana tjetër përpiquej të shquante gungat e bardha të malit.

— Të ecim më përpara, — tha Dardani. Vargëzimi i kompanisë lëvizi më përpara, zuri vend më të volitshëm, aty u ndal.

Luftëtarët e kompanisë ishin shtrirë në borë e bënin frysëmarrje të ngadaltë. Ruhej me kujdes fshehtësia e veprimit.

Dardani e dinte se, te shkëmbinjtë që shënonin mbirimin e malit, aty ku ishin në radhë fortinat, do të arrinim mbasi të kalonim pllajën e bardhë ku rrëshqet këmba në borë. Ata njëqind hapa kërkoheshin të bëheshin me shpejtësi. E përpjeta thikë nëpër borë mund të ngjitei vetëm këmbadorazi dhe t'i afroheshim gërxhit duke fituar sa më tepër kohë, ndryshe esesët me krismat e para do të hidheshin në pozicione dhe do të na vinin në shënjestër të mitralozave.

Befasia në sulm ishte kërkesë themelore e taktkës sonë. Ajo na siguronte epërsi mbi armikun. Lëvizja e kujdesshme që bënte çdo luftëtar i kompanisë tregonte se secili e kishte kuptuar detyrën e shtruar nga celula e Partisë dhë nga komanda. Ndjenja e detyrës së veçantë që i ishte besuar kompanisë sonë na i kishte shumëfishuar forcat. Po befasia duhej ruajtur gjer në çastin që do të jepnim goditjen. Mjaftonte vetëm një kollitje e njërit prej nesh, ose një rrëshqitje këmbe në borë që të na digjët në dorë gjithë plani i sulmit të befasishëm dhe shkulja e urithëve nga fortinat në majën e malit «Ariu i bardhë».

Qëndruam në pritë. Prisnim shenjën e sulmit. Agos nuk iu durua, rrëshqiti te vendi ku qëndronte Bukurie Çabiri.

— Atë gungën aty duhet ta kemi kujdes, shoqja Bukturie, — i tha.

— Shëéët, Ago, mos lëviz, mos fol! — Ago Ymeri s'mundi të qëndronte dot pa lëvizur e pa folur. Sytë e tij shpuzë dalluan te gungat e malit një frëngji dhe tytën e një mitralozi.

Në fshehtësi skuadra jonë rrëshqiti afër pozicionit të mitralozit, që, si një gjarpër, shtrinte vështrimin në përgjim përpara. Çerdhja e mitralozit ngjante me kasollët e staneve në mal. Ishte një kube e bardhë sferike e mbuluar. Brenda ishin ushtarët esesë të mitralozit. Ditën erdhën nga qyteti dengje me rroba, shlivë e mbyllur në shishe. Ata futën në atë çerdhe ngrohtësinë, shamatën. Nuk ishte vështirë të mësohej që esesët e asaj qendre zjarri ishin bërë thumb. Atë që e kishin për gjithë javën e kishin derdhur në fyt.

— Kujdes, janë të dehur, — na tha Bukturia.

— T'u hedhim një granatë brenda dhe të ngordhin, — propozoi xha Goxhoja.

— Jo, — kundërshtoi komandantja e skuadrës.

— Hëm, me demek gjer këtu arriti filli i Goxhos, ta marrë nëpër këmbë edhe Bukturia. Ç'më di kjo mua, atë qyqin tetëdhjetëvjeçar që i ka vënë thembrat zjarrit në vatër buzë Shushicës? — Deshi t'i fliste Bukturia dhe s'i foli. Në ato çaste kërkohej heshtje. Edhe xha Goxhoja nuk foli.

— E djallosa, — më tha xha Goxhoja. — S'më pushon kjo zagare gjuhë, them nga një fjalë që më bën xhind e bëhem pishman që e thashë.

— Mos harro, o xha Goxho, se bota bëhet dy herë më e lirë kur merr liri të plotë gruaja.

— E qepa, të gjitha i di Goxhoja, po ja, o Agim, s'më shkunden lehtë mua gjashtëdhjetëvjeçarit ato që më rëndojnë mbi supe.

— Mos harro që një e dhjeta e efektivit të reparteve

tona janë shoqe. Asnjë ushtri nuk ka nxjerrë në vijën e luftës kaq shumë vajza e gra.

— Njëri të vijë me mua, — tha Bukuria dhe foli: — Agim! Mbas meje! — Ika në atë drejtim. Kudo bardhësi e ftohtë. Rrëshqitëm këmbadorazi në drejtim të pozicionit. Iu afroam hyrjes së pozicionit. Ushtarët seç bisedonin. Zërat e tyre dëgjoheshin të mbetur.

— Këtyre u është helmuar ndjenja njerëzore, — i thashë Bukuries. Bukuria hyri me armën gati për zjarr. Ishin disa esesë. Ishin të pirë. Thirrja e Bukuries «Dorëzoni armët» i bëri esëll, por ishte vonë. Nuk mund të bënin asgjë. Kishin rënë rob...

Një çast Dardani u shqetësua se mos hodhëm një hap të pamatur në drejtim të «kokës së egërsirës». Qëndruam me bebëzat e syve të ngulitura mbi shkëmbinjtë. Agu i ditës dalngadalë e largoi errësirën e natës dhe mali shihej më i bardhë. Dardani hodhi vështrimin prapa, atje ku qëndronte komandanti i brigadës.

Mbas shenjëzës së sulmit që hodhi drejt majës së malit komandanti i brigadës, gjithë forcat u hodhën në sulm. Gjëmimi ishte i njëhershëm, i afërt dhe i largët. Njëherësh u hodhën edhe brigadat e tjera të divizionit në sulm.

Nga diku prej maleve të Bosnjës e ndriçuan malin «Ariu i bardhë» rrezet flakëruese të një projektori, pastaj sytë verbues të tij u mbërthyen aty ku doli kompania jonë, te pjesa e gurtë e malit. Drita na erdhi ballas dhe vendi shndriti.

Përlleshja u bë me granata dore. Ende nuk dihej kush do ta zotëronte malin «Ariu i bardhë», ne sulmuesit apo urithët esesë që rezistonin me thonj e me dhëmbë për të mbajtur atë nyje qëndrore.

Secili prej nesh kishte hallet e tij që kushtëzoheshin nga veprimet e kundërshtarit që kishte përpëra, por ne ishim të lidhur njëri me tjetrin si purtekat që zënë vend në gardh të ngjeshura fort me njëra-tjetrën.

Vijën e frontit e lidhën një të vetme flakët e pushkëve, fushqetat dhe plumbat ndriçues.

Shenjëzat që hidhte komandant Sopoti si ushta të zjarrta shkonin në drejtim të qiellit. Mbi syprinën e akullt

të malit shkelnin këmbët tonë, shpërthenin predhat. Brigada vërsulej mbi vargmalin e bardhë... Topi i Azem Bajgurit gjuante mbi një frëngji mitralozi. Sulmi i brigadës lidhej ngushtë me kompaninë tonë që u hodh drejt shkëmbinjve dhe me granata i vuri në heshtje mitralozat e esesëve. Dardani mbeti një çast majë shkëmbit. E përfytyroi veten duke e vrojtuar malin nga larg, andej e shikonte figurën e plotë të malit «ari». Iu kujtua porosia e komandantit të brigadës: «Kujdes, veprimi juaj është goditja që i jepet armikut në kokë. Ajo ka të bëjë me gjithë veprimet e brigadës». Detyra ishte plotësuar. Granatat e partizanëve ia dërrmuani dhëmbët egërsirës, i vu-më në heshtje mitralozat, ua hoqëm mundësinë të villnin helmin e tyre vdekjeprurës mbi shokët. Një shenjëz që hodhi Dardani sipër mbi majën e malit eci përpjetë, në drejtim të kaltërsisë së qiellit. Atë shenjë e priste me pardurim komandanti i brigadës.

— I thyem edhe kësaj radhe, — tha Sopot Golemi dhe vrapi më sulm. Përmendi edhe emrin e Dardanit. Korrierët që ecnin më krah të tij s'mundën të mësonin përse e përmendi komandanti i brigadës emrin e Dardanit, përmirë apo për keq?

Lartësia më shpinë të esesëve ndodhej plotësisht më duart tonë...

## XXVI

Sulmet kanë rregullat e tyre, ato shfryjnë në rrebesch njëherësh si rrebesch e furtunë e rrëmbyer dhe mbarojnë siç mbaron edhe furtuna. Kështu ndodhi edhe me sulmin tonë për t'u marrë esesëve të kolonel Vilenbergut malin «Ariu i bardhë».

Në përfundim të luftimeve që u bënë për malin «Ariu i bardhë» komandanti i brigadës, Sopot Golemi, njoftoi:

«... Batalionet e brigadës sonë sot vepruan mbi malin «Ariu i bardhë». Terreni ku vepruan forcat tona ishte mjaft i zhveshur, i gjithi i pjerrët, i mbuluar me borë e akull: Nga artileria dhe mortajat e armikut patëm dëme. Luftime deri trup me trup i zhvilluan në majën sogjatore, ku mbeten të partizanë të vrarë dhe dymbëdhjetë të plagosur. Armiku pësoi humbje të konsiderueshme në njerëz dhe në material luftarak. Atë e shkulëm nga pozicionet. Luftimet vazhdojnë...»

\*

\*

\*

Mbas luftimit, kur çdo gjë ra në heshtje, Dardani qëndroi në majën e malit me vështrim te lugina e xhadeja që gjarpëronte përposh amës së lumit. Ai tha:

— Afrohuni, Lulo, Ago! — Kérkoi me emra disa nga shokët e tij të vjetër të batalionit të Gurshpatit. Zemra i kérkoi edhe Bukurien, por fjalën nuk e foli.

— Një këngë, Ago... Një këngë që të na ngrohë.

— Pse, o Dardan, zjarr éshtë kënga që të na nxehë?

— Éshtë zjarr i pashuar, flakë e kuqe, éshtë èndrra jonë e kuqe, vepra jonë që kryejmë në ndihmë të popujve që lëngojnë në robëri, e kuqe edhe kënga jonë. — I gëzuar pa masë që kompania e plotësoi detyrën me sukses, u ul mbi shkëmbin e përhimë si të ulej mbi kokën e Ariut të Bardhë dhe ia filloj vetë këngës. Ne së bashku pasuam këngën. Kënga jehoi në majë të malit «Ariu i bardhë». Në këtë majë të lartë, të veshur me borë e akull valëvitej krenar flamuri i brigadës.

\*

\*

Në mbarim të luftimeve më thirri komisari i kompanisë, Andrea, e më tha të nisem me shokët, do të bëhet mbledhja e aktivit të Rinisë të brigadës. Kérkova nëpër transhetë ku ishin hapur në formacion luftimi partizanët. U bëra zë shokëve dhe vetë i pestë u nisém. Mbledhja bëhej në një fshat mbas malit «Ariu i bardhë». Rruga kalonte me dredha nga kreua në fund nëpër një shkëmb të thepisur që binte drejt nga fshati. Ecnim ngadalë e me vëmendje të madhe, se nga pakujdesia më e vogël mund të rrokulliseshim në humnerë. U befasuam nga e papritura. Në faqen shkëmbore të malit dëgjuam një batare pushkësh. E kjo na bëri të ecnim me kujdes,

me pushkët gati. Kur u nisëm pér në mbledhje, shokët na thanë: «Do tē flisni në aktivin e Rinisë tē brigadës».

Menduam tē fliste Luloja dhe ai u përgatit. Bëmat e Lulo Drizës në luftimet në këto vargmale tē ftohta janë frymëzuese. I flasin plagët dhe veprimet Lulo Drizës. Hapin e hidhnik në shkëmb dhe në akull. Ishim tē shqetësuar. Ato breshëri armësh aq afër çfarë ishin? E papritura qëdronte pezull, ajo nga çasti në çast do tē shfaqeji. Duhej kujdes!

Shtegu i verbër më në fund na pruri te një shesh i vogël. Dëbora në atë vend tē sheshtë midis shkëmbit ishte shkelur. Kishin mbetur gjurmë... Kjo na bëri që tē tregonim edhe më shumë vëmendje.

E papritura u qartësua kur pamë në anë tē shkëmbit tetë varre... Tetë kapele partizane... Tetë yje vezullo-nin dhe mbi një trung ishin gdhendur fjalët: «Partizanë tē barigadave shqiptare».

I njohim ata... Nderuam me grusht. Janë dëshmorët që ranë në sulmin pér tē shpartalluar esesët në malin «Ariu i bardhë». Njëri prej tyre është Arjani, i kompanisë sonë. Humbja e djaloshit tē vogël na pikëllon shumë. Mundohem tē rikujtoj jetën e luftëtarit në moshë më tē vogël tē kompanisë. Jetoi ditë, javë, muaj e vite në llogoret e luftës, një me tē rriturit në marshime... Një me tē parët në sulm. Qëndronte e luftonte si një hero. Ia ngrohte kraharorin e vogël kënga e lirisë, kënga e fitores! Erdhi Arjani ynë gjer këtu te këto vargmale tē bardha. Dhe mbeti gjer këtu një gjurmë e ndezur, yll që përherë do tē vezullojë.

Qëndruam me vështrim te germat e gdhendura në drurin përballë dhe te kapelja e partizanit mbi varrin e vogëlushit Arjan. Na kujtohen grimca tē jetës së tij si partizan, heroizmat e tij, tē bëra në emër tē fitores mbi bishën hitleriane. Ecëm me mendje në ato gjurmë.

Ecën dot mbas shqiponjës? Erë në ecje brigada partizane, erë dhe pionieri ynë, Arjani. Më është ngulitur në përfytyrim çasti i fundit kur e pashë Arjanin e vogël në pllajën e bardhë tē malit, ende më kumbon në vesh krisma e asaj pushke, zëri i vogëlushit Arjan. «Përpara, shokë!

Përpara!» Dhe ecte ai në radhët e para. Në castet e fundit, kur esesët ua mbathën këmbëve, një plumb... Ah, ai plumb! Të goditi ty, Arjani ynë i vogël. Ai plumb i shkaktoi dhimbje gjithë brigadës partizane. Po ti mbete një dritë e ndezur, o trimi ynë!

Derdhin dritë mbi këto varg male sytë e pionierit Arjan. Derdhë dritë mbi errësirën flaka e pushkës e partizanit të vogël Arjan.

Heroizmi dhe gjaku e afrojnë ditën e fitores...

Më vonë re të zeza të ngarkuara me borë u mbësh-tollën në majë të malit. Ato shkarkuan me rrëbesh gjithë ngarkesën e tyre. Furtuna e fortë dhe e ftohtë erdhi papritur. Një ah i madh mundohej t'i qëdronte furtunës. Fishekëllima rrëqethëse u dëgjuan gjersa i dolën rrënjet mbi tokë dhe ahu u përbys, ra me gjëmim e trungun ia mbuloi bora. Furtuna me rrëmbim erdhi e me rrëmbim iku. Mbas furtunës breshri kokërrmadh që kishte rrahur vendin dhe njerëzit kishte arritur gati me një pëllëmbë trashësi. Gjatë kohës që furtuna shfrynte dufin e egër, në dy krahët e malit ishin afruar esesët. Ujku mjegullën kërkon. Sapo prajti moti, gjëmoi mali nga krismat e armëve. Sopot Golemi me një plagë të lehtë plumbi te supi i djathtë qelloi me automatik në vijën e parë.

Granatierët armiq nuk u qëndruan dot goditjeve të armëve tona, filluan të tërhiqeshin.

Mbasdite qëndronim në një pozicion me xha Gothon.

— Ke ftohtë? — e pyeta.

— Më mban ngrohtë kjo virania! — dhe tregoi xhaketën me lëkurë. Mu kujtua luftimi në afërsi të Prizrenit dhe çasti kur nxori xhaketën e kolonelit nga flaka, e veshi e tha:

«Hëm, u bëra kolonel, dëgjon? Është e atij qafërrje-purit, kolonelit Vili... Vilibreka».

«Vilenberg», — plotësova unë.

«E de, e, Vilibreka, ai që, për të shpëtuar lëkurën, la xhaketën e iku në brek...»

Ishte xhaketë koloneli, po xha Goxhoja ia hoqi gratat.

— Është e ngrohtë, — thotë, — avull ma mban trupin, për zotim është xhaketë që të mbron shpirtin, jo si ato carbat e murme të ushtarëve, me të cilat mërdhin edhe në gusht.

\* \* \*

Era e ftohtë që frynte gumëzhitja e copave të predhave që vazhduan mbas dështimit të sulmit të granatierëve e bën malin ku zumë pozicionë mbas sulmit më të egër, më një thëllim më therës.

— C'budallenj që janë këta topçinjtë e kolonelit jerman! — tha xha Goxhoja. — Ende nuk e dinë se ne shqipot nëpër predha e flakë baruti kemi mbërritur gjekëtu!... Pastaj i goditi pozicionet tona një top me predha të rënda si të aeroplanit.

— Nga e prunë këtë top? — pyeti Bukuria. Kur zbrazej tovi, dridhej mali.

Erdhi në vijën e parë Vasoja. Arriti edhe në strehimin e skuadrës sonë. Na pruri bukë thekre dhe një kuti konserve të madhe. E pa vendin ku u strukëm dhe rrudhi buzët.

— Këtu s'jeni gjë, — tha Vasoja. — Për darkë mblidhemi nga unë, dëgjuat? Atë strehim nuk e sheh gryka e topit, ju pres, dëgjuat?

— Në na lëntë topçiu i nemces të dalim nga llogorja, ta gjejmë konakun, o Vaso, — tha Ago Ymeri.

Vasoja iku me vrapi nëpër hendeklidhje.

— Ky vend do të jetë i pari që do të goditet nga predha e topit, ata e dinë që ne mund të hyjmë këtu, dhe bamp predha e do të mbetemi si zogu nën dërrasë; jo,

djem, jo. — S'bën tē futemi aty, dëgjuat?! — tha xha Goxhoja nē hyrje tē strehimit. — Dreeee! — lëshoi thirrje habie. — Agim, ai Vili éshtë bërë bishë e kérkon tē na varrosë nē dhé njéherésh tē gjithë, dreee, dreee! — Qëndroi te dera e strehimit, nguli këmbë: — Nuk hyn njeriu vetë me këmbët e tij nē varr, dëgjoni ç'po thotë Goxhoja!...

Filloi tē qëllonte më dendur topi i madh.

— Dreee, dreee, ky i dalldisur do tē përmbyssë malin! — tha Goxhoja dhe hyri nē strehim.

Në mbrëmje nē pozicion qëndruan rojat, shkëmbit i dhanë krahët, vështrimet e rojave tona hetuan çdo gjë që kishte aty nē anën tjetër tē shkëmbit. Në «pallatin» e vogël tē Vasos, aty u mblodhëm kokë më kokë.

— Ku e gjete këtë pallat, o Vaso, pallat majë mali! Ku i ke sazet, o Vaso... Dasmë kemi sonte, o Vaso... Këngë kemi sonte, o Vaso! — ligjëroi Ago Ymeri.

Haziri kurdisi telat e çiftelisë.

— Zjarr mos ndizni, kemi municion brenda, e shikoni! — tha Vasoja dhe hodhi ndricimin e dritës së elektrikut. Rreth arkave me fishekë, granata e barut për top kishte edhe hasë me bukë thekre. U shtruam këmbëkryq nē «shtëpinë» e Vasos. Intendanti ishte gjithë qejf. Erdhën edhe nga skuadra tē tjera, morën bukë, fishekë e granata. Vaso Lundra çoi për partizanët dhe nga një palë rroba tē brendshme, ishin tē paketuara, sa kishin arritur nē pozicione dhe aty kishin mbetur, stivë mbi njëra-tjetren.

— Nga këto dua dy palë, dëgjon, shoku Vaso, dy palë më ruaj, se s'kam ku gjej tē tjera, më duhen, ore, plak jam unë, pleqëria e ka zor nē tē ftohtët me acar si ky këndej nga Sanxhaku e Bosnja, ndryshe djemtë, apo jo? Dëgjon? Takort, Vaso?

— Ka për tē gjithë, ka mjaft, — tha Vasoja dhe numëroi plaçkën e zënë. Në vendstrehim dëgjuam zërin e Radio Tiranës.

Mbas nesh qëndronte atdheu i lirë. Zëri i Radio Tiranës na afronte shtëpitë, familjet. Bukurie Çabiri e mbështetur te një arkë me granata dore nxori nga çanta një bllok shënimesh e shkroi:

*I dashur vëlla,*

*Motra jote, Bukuria, të shkruan. Jam shumë mirë dhe dëshiroj edhe për ju të jeni mirë. Më ke dërguar disa letra nga Kosova dhe unë nuk të kam kthyer përgjigje, se nuk e dija drejtimin e spitalit ku ndodheshe. U gëzova kur mësova që plagën e ke më mirë.*

*Është e kotë të shkruaj për luftërat e brigadës, për heroizmat e shoqeve e shokëve tanë. Ti je partizan i kësaj brigade dhe i njeh mirë ata... pavarësisht nga sakrificat e mundimet, do t'i ndjekim hitlerianët gjer në strofëkën e tyre të fundit, gjer në Berlin.*

*Të presim të kthehet në brigadë...*

*Të përshëndet dhe të puth me mall*

*Motra jote, Bukuria.*



Në strehim ngroheshim me fryshtë tonë. U mblo-dhëm shuk, pranë njëri-tjetrit. Goxhon e kisha pranë, ishte mbështetur tek unë. Më bëri një pyetje:

— Si do të jetë bota në fund të luftës? — Pjetja më futi në siklet. Kureshtja e Goxho Bërdëllimës nuk shuhej lehtë. Me kujdes vizatova në një faqe të bllokut të shëni-meve një yll dhe stemën e punëtorëve, draprin e çekanin.

— E shikon këtë? — e pyeta.

— Ehëëë, — më tha xha Goxhoja dhe m'i nguli sytë si turjelë.

— Ky do të fitojë kudo, — i thashë dhe i fola mbi luf-timet që bënин popujt për të varrosur kuçedrën nazifa-shiste dhe reaksionin. Në fund Goxhoja qeshi nën hundë me mendimet e mia. M'u kthyte:

— Dale, dale! Si shpejt i fute në një gropë të gjithë kapitalistët e botës. Që do të ngordhin, do të ngordhin se s'bën, por me një plumb, more Agim, jo! Një Hitler është dhe po i pëlqet buzën njerëzimit gjer ta vërë nën këmbë... Takort, ashtu është, fitorja është e popujve, por...

\* \* \*

Atë natë ishte mot pa re, nata ishte e bardhë, por e ftohtë dhe më e idhët se ditët e tjera. Agoja ishte rojë, përgjonte fërkonte veshët nga të ftohtët e ngrica. Nganjëherë ndalej te mitralozi dhe e kapte me duar. Hekuri i armës ishte i ftohtë aq sa i dukej se i ngjitej dora në armë. «Ftohtë! Ftohtë!» — murmuriti me vete.

Vuvurima e erës nuk pushon.

— Të dalë një shok të shikojë Agon, — tha Bukuria.

Ishte kufiri midis natës së gjatë të dimrit e agut të ditës. Në kokë Agoja kishte vënë një kokore me push leshi, e vetmja që u gjend në «depon» e Vaso Lundrës. Ai herë e mbante e herë e hiqte, se nuk ishte mësuar dhe i dukej sikur i mbyllte veshët me dyllë. Ago Ymeri qëndronte në pozicion te mitralozi, vrojtonte. Gjithnjë syrin e mbante në përgjim. Ishte i qetë syri i tij shikonte larg. Në horizontin e bardhë nuk shihej asnjë pikë e zezë. Befas një kafshë e fuqishme iu hodh në grykë. Agoja nuk arriti të hapte gojën. Ai e kupto që u përpi nga egërsira. Dëgjoi afër zë. Në atë çast i dha forcë vetes të lëvizte gishtin dhe arma na lajmëroi. Vrapuam në drejtim të Agos. Në hapat e parë që hodhëm ramë në luftim. U ndeshëm flakë më flakë me esesët.

Ata ikën edhe kësaj here. Ikën duke rrëshqitur në borë në drejtim të luginës si fantazma të bardha...

\* \* \*

Adilja e mjekoi me kujdes, qeni ujk i esesëve zbulues e kishte plagosur Agon afër qafës. Plaga ishte pa rrëzik jete, po e rëndë. Agoja nuk rënkonte nga plaga që i kishte shkaktuar qeni ujk me dhëmbët e mprehtë.

— Desh të mbyti, ditëzi, — i tha Adilja.

— Mjerë kujt i bie një fat si ky, — u ankua Agoja. — Ç'të thonë shokët e si të të qajë shtëpia, është turp!... Shpëton nga plumbat dhe më në fund të mbyt qeni. S'qe i zoti t'i bënte ballë një qeni, do të thonë...

— Është qen ujk ai, Ago, qen i stërvitur.

— Qeni qen mbetet. — Ishte i pikëlluar.

U kthyem përsëri në strehim. Në vend të Agos qëndroi në rojë Haziri. Ai vështroi përpara shpatin e bardhë të malit. Një pikë e bardhë u pa të lëvizte. Haziri e nguliaty vështrimin. Lëvizte vërtet ajo pikë e bardhë apo i bë-në sytë? Dalloi esesët e veshur me rroba të bardha. Pushka dhjetëshe nuk e mundoi të zotin e saj ta ushqejë një e nga një me fishekë duke hapur e mbyllur shulin. Haziri nga vendi i tij te shkëmbi qëlloi shtatë herë, e prapë pushkën e mbante në sy dhe e kishte të mbushur. Zbuluesit armiq u tërhoqën, vetëm njëri që u godit anoi në krah, çaloi dhe u mundua të qëndronte mbi stekat.

— Na ikën, — tha Bukuria e dëshpëruar.

— Dolëm me vonesë në pozicione, — thashë unë.

Skiatorët kaluan me rrëmbim para syve tanë dhe ikën. Ai që u godit nga pushka e Hazir Përdinit u vëçua nga të tjerët, theri përposh në drejtim të pyllit me pisha, si të shkonte drejt humnerës. Ai rrëshqiti si plumb dhe pushka e Hazirit s'arriti dot ta gjunjëzonte.


— E hëngshin shtatëqind dreqën, më iku, — u ankua Haziri dhe u ngrit nga pizicioni, zbriti në drejtim të pyllit. Bukuria e ndoqi pas, ata zbritën të dy gjer në afërsi të pyllit. Kërkuan rrëth e rrotull, nuk diktuan gjë.

— Ka fluturue, — tha Haziri duke vështruar humnerën. Gjer aty i çuan gjurmët e skive. Bukuria u dëshpërua më shumë. Armiku e gjeti skuadrën në befasi. Haziri si gjuetari që është i sigurt se e ka goditur egërsirën kërkonte. U çudit kur pa esesin, edhe pse i plagosur, pranonte më mirë të kalbej aty sesa të dorëzohej.

— Kujdes, të vrau, kujdes, Hazir! — foli e trembur Bukuria. Haziri fshehu trupin prapa trungut të një ahu të madh. Plumbat e automatikut të esesit mbetën në trupin e ahut. Haziri e vuri në shenjë.

— Mos e vra, na duhet i gjallë, — i thirri komandan-tja e skuadrës.

Fytyra e skiatorit gjerman kishte marrë një pamje egërsire.



Lëvizjet e papritura të zbuluesve gjermanë ngjanë pikërisht në kohën kur retë u trazuan dhe pritej furtuna. Mbetëm në pritje në pozicionë. Lartësia u godit paprërë nga artileria dhe përsëri në formacion luftimi u shfaqën para nesh ushtarë të tjerë esesë.

Dardani dha urdhër që t'i godisnim nga afër, atëherë kur të jetë i mundur përdorimi i granatës së dorës.

Edhe në çastet më kritike Dardan Velishtës asnjëherë nuk i kishte munguar guximi, por jo gjithnjë veprimet e tij në luftime ishin quajtur të drejta. Urdhri që na dha na u duk me vend, por shumë i rrezikshëm.


Nga afër do ta kemi më lehtë për t'i asgjësuar, — na tha Dardani. Esesët, të veshur me të bardha, u afroan aq, sa ne dallonim mirë armët, pullat e palltove, sytë e egër-suar. Dardani qëndroi i qetë aq, sa ne habiteshim c'po priste.

— Zjarr! — thirri Dardani, kur ata u turrën mbi pozicionin tonë.

Esesët sulmuan me tërbim. Dardan Velishta me dhjetëshen e tij në dorë u vërsul përpara duke thirrur:

— Para! Përpara, partizanë!

Ata u zmbrapën dhe ikën si era. Mbi borë ngelën shumë njolla të murme. Të vrarët u mbetën në vend...



Në kohën kur esesët sulmuan pozicionet tona Bukurie Çabiri dhe Hazir Përdrini u ndodhën afër njëri-tjetrit në një pozicion. Ata, si gjithë të tjerët, duke pritur t'u

afroheshin esesët, e ndien rrëqethjen e erës së ftohtë që u mpiu duart gjer te supet. Më tregonte Bukuria:

— Kur armiku po afrohej, mbi degën e ahut, para pozicionit tim ra duke përplasur krahët një zog i bukur. Atë kohë pritej sinjali për të hapur zjarr. Deri atë çast doja të hapej zjarri mbi esesët, por ndërrova mendje. Kisha pranë zogun e bukur. Më brofi zemra, kur zogu rrahu krahët dhe u ul afër. Haziri e vuri re që unë u gjëzova dhe më buzëqeshi. Mbeta me sytë të mbërthyer te zogu i bukur. Më rrëmbyen èndrrat... Zog i bukur, thashë me zë të ulët. «Kështu janë zogjtë e bjeshkëve, të bukur», më tha Haziri. Sa i bukur! thashë. Harrova që isha në luftë, harrova që kisha pranë rrezikun. «Në èndërr je, Bukurie?» më qortoi Haziri. Nuk i fola. — Bukuria nuk më tha që ajo atë kohë vërtet èndërronte. Zogu bënte fole, kërkonte të mbrohej nga furtuna e krismat.

Po Bukurie Çabiri q'mendonte për çerdhen e saj mbas lufte? Asaj asnjëherë nuk i largohej nga mendja Dardan Velishta. I pëlgente Dardani, se ishte një nga ata që sfidonit forcën e armëve të kundërshtarit. Iu kujtuan malet e Gurshpatit kur endej me Dardanin në shpinë. Bukuria donte të shihte zogjtë e bukur duke bërë foletë dhe duke flutuar degë më degë. Ja që ata nuk po i linin të qetë dhe po ua prishnin foletë edhe në ato maja të larta predhat e mitralozave, të mortajave e të topave. Prëdhat e zeza të esesëve asaj i kujtonin vdekjen, kurse zogu i bukur që ndërtonte folenë i kujtonte jetën. Bukuria më tregoi:

— Ushtarët erdhën edhe më afër... Hodhëm grana-tat e dorës dhe esesët u zmbropsën nga granatat tona, nga zjärrti i automatikëve e mitralozave. U gjëzovë kur pasqë armikun të tèrhiqej, por u habita kur vështrova se në degën e ahut ende qëndronte zogu i bukur. Nderë dorën ta përkëdhelja. Zogu nuk lëvizi. «Ka ngrirë, ka ngrirë!» i thashë Hazirit e shqetësuar. E mora zogun me kujdes, e futa në gjë ta ngrohja, e përkëdhela. Zogu mori jetë... Ëi ngrohë dhe e lëshova të ikte, zogu fluturoi drejt lugineš duke rrahar krahët, — tha Bukuria dhe vështroi në drejtum të luginës. Andej buçiti topi i madh. Ai goditi përsëri pozicionet tona.

## **XXVII**

Kolonel Vilenbergu ngjante me kalin e hazdisur e të egër që i shpëton laket të hedhur në qafë dhe turfullon me hundë, bredh sa andej-këndej, më shumë nga frika se nga gëzimi, që i shpëtoi laket. Ai harbonte, ishte i gjëzuar, sepse mbas pritave në xhade u çel përsëri shtegu. Kolona me ushtarë ecte në drejtim të Bosnjës. Lartësitë buzë xhadesë i mbante grupimi i tij që tashmë nuk quhej divizioni «Brandenburg», por grupimi «Vilenberg». Kolonelit i dukej se kolona po lëvizte tepër ngadalë. Ai kallonte rrugës dhe kërkonte të rritej tempi i marshimit. Një mendim i trishtuar e goditi si një çekan midis ballit. I shtroi vetes pyetjen: A do të mbahet nga ushtarët i lirë shtegkalimi?

Njëren nga kolonat që mundi të dilte nga pritat e brigadave partizane, po e godiste paprerë nga lartësitë në afërsi të qytetit brigada jonë. Kudo gjatë tërheqjes kolonat armike goditeshin ashpër nga brigadat partizane.

Automjetet e motorizuara, pjesët e artilerisë në pamundësi të shkonin më tej mbeteshin rrugëve, strukeshin në vende të padukshme, u bënë si diçka e shurdhët, e vdekur. Vija e luftimeve zbriti nga malet e larta në malet më të ulëta, nga vendet e mbuluara me borë në vende më pak të mbuluara nga bora, nga zona me pyje në zona të zhveshura, afër fshatrave dhe qytetit.

Kolonel Vilenbergu i mbyllur në një autoblindë të vogël me zinxhir tanku përpinqej me çdo kusht të mbante të lirë rrugëtërheqjen.

Gjenerali i korparmatës, duke përforcuar repartet e grupimit të Vilenbergut, mendoi se koloneli që kishte rënë njëherë nga fiku në luftimet në Kosovë nuk do ta linte më veten të binte përsëri në grackë. Ai kerkoi forca e armë dhe gjenerali ia dërgoi... Kjo i dha të kuptojë kolonel Vilenbergut se do të ishte reparti i fundit i ushtrisë që do të largohej nga lugina dhe qyteti Stari-Varosh, ndaj kërkonte të mbaheshin me çdo kusht lartësitetë buzë xhadesë.

Kolonel Vilenbergu me luftime ia hapi disa herë shtegkalimin kolonës që tërhiqej. E si do t'u shkonte fillinguarjeve më vonë? Për këtë ai nuk e ndiente veten as në tokë, as në qiell...

Në afërsi të qytetit, aty ku malet afrohen aq shumë saqë lumi kalon në një ngushticë që lehtë nga njëra anë në tjetrën në ditët me luftime hidhej granata e dorës, dolli në pritë Skifter Velça me një kompani. Ishte një aksion i befasishëm dhe i pari që bëhej aq afér qytetit. Në atë luftim Skifteri u plagos në të dy këmbët.

— Ja, këtu, — tha Skifteri kur vajtëm te vendi i pritës dhe vuri dorën te këmba e djathtë, afër çapokut. — E kuptova që u godita rëndë dhe rashë në tokë... Më tej nuk di ç'ndodhi me mua. Mbështetja aty në borë disa orë pa

ndjenja. Kur u përmenda, nuk ishte më natë. Gjënë e pârre që dëgjova ishte frymëmarrja e një ushtari dhe krisma e një mitralozi.

Ushtari nazist më dinte të vdekur. Mbi mua kishte vënë mitralozin. Më mirë që më dinte të vdekur. Isha përmendur plotësisht dhe mendova që të mos i jepja esesit të kuptonte asnjë shenjë jete. Plagët më dhimbnin, po zemra më mbajti. I imposhta dhimbjet. Gëk s'bëra... Dëgjoha plumbat e partizanëve si thërrmonin borën rrëth ushtarit. Esesi ulte kokën, fshihej pas trupit tim. Të gjallit i duhej afër i vdekuri... Diçka kërkohej të bëja. Çfarë? M'u kujtua që mbaja në mes një «Beretë» të vogël, — tha Skifteri dhe hodhi dorën te mesi. Tundi kokën, u kujtua që aty kishte vajtur me pasaportë... — Përgjaja ndonjë pakujdesi të esesit. Hodha dorën me rrëmbim tek arma. Ushtari i trembur lëshoi një klithmë drithëruese, diçka deshi të bënte, diçka deshi të thoshte. Qëllova mbi të. Ia zbraza radhazi katër plumbët në gjoks.

Mënyra si na tregoi dukej sikur ai sapo ia kishte zbrazur kundërshtarit në gjoks plumbat.

— «Skifter! Shoku Skifter!» — më folën. E dëgjova pranë zërin e shokëve. Ishte zëri i jetës dhe guximi m'u shumëfishua. Rrëshqita në anën e kompanisë dhe rashë plumb poshtë aty ku kishin zënë pozicion tanët.



Shkelëm një për një vendet ku luftoi brigada në malin «Ariu i bardhë». Herë mbas here shfletoj ditarin e komisarit të kompanisë sësme, Andrea Sotirit. Fletët e ditarit më fusin në ngjarje të jetuara. Çdo faqe e ditarit hedh dritë mbi veprimet tonë dhe të armikut. Ja disa nga ato:

«Kanë kaluar tri ditë nga koha që i zumë pritë armikut në khade. Tri ditë armiku s'mundi të lëvizte prej vendit. Mbas tri ditëve ura që hodhën në erë xhenierët e brigadës u rregullua dhe përsëri kolonat që vijnë nga Mali i Zi filluan të lëvizin». (Shënim i datës 26 dhjetor.)

«Natën në sulmin që bëmë njëri nga shokët e kompanisë rrëshqiti dhe ra plumb poshtë në drejtim të pozicioneve të armikut. Aty ku ra, aty mbeti, nuk lëvizi nga vendi. Qëndroi gjithë natën me këmbët në ujë. Në mëngjes kur sulmuam e gjetëm me këmbët të mbërthyera në akull. E hoqëm në thellësi. Shpëtoi nga vdekja, po këmbët do t'i priten...» (Shënim i datës 27 dhjetor.)

«Një erë e rrëmbyer shkakton një vorbull pluhuri të bardhë e të ftohtë që të rrëmbejn e të rrëzon përdhë. Xha Goxhoja ndezi Hullën dhe mbushi bulçinjtë me tym aq sa ndjeu ngrohje. Në pozicion duhet të rrimë gjithë ditën. «Lëvizni të mos ngrijmë, lëvizni!» — tha xha Goxhoja. I folëm: «Ulu, xha Goxho, ulu!» «S'kam ndër mend të vdes», — tha. Nuk u ul. Kjo u bë shkak të goditet pozicioni nga artileria». (Shënim i së njëjtës datë.)

«Sot u paraqit në pozicionin tonë një njeri... Ka mbetur kockë e lëkurë. Tregon një vrasje barbare të bërë nga esesët në kampin e përqendrimit që kanë ngritur në afërsi të qytetit. Bëjnë film duke vrarë njerëz... Esesët janë shfityruar, ata s'kanë asgjë të përbashkët me njeriun». (Shënim i datës 28 dhjetor.)

«Çfarë shpirti kanë këto bisha që filmojnë duke vrarë njerëz? Njeriu që i shpëtoi vdekjes thonë se trupat e atyre që pushikatojnë esesët i vënë në stivë anës xadesë që të mos rrëshqasin makinat me topat. Edhe këto i filmojnë...» (Shënim i së njëjtës datë.)

«Sot me Vason qëndruam në fshat. Zhvillova me fshatarët një konferencë politike. E përkthente fjalën time në serbisht Azem Bajguri. Fshatarët u treguan të gatshëm të na ndihmojnë me ç'të mundin.» (Shënim i së njëjtës datë.)

«Dje në fshatin që ndodhet në shpinë të batalionit zbritën natën një bandë çetnikësh; vranë disa aktivistë të luftës dhe një grua. Në gjoks të vrarëve u lanë të shkruar: Këdo që furnizon me ushqime partizanët e pret i njëjtë fat» (Shënim i datës 29 dhjetor.)

«Lulo Driza zuri pozicionin e krahun tim dhe bëri zjarr mbi pozicionin e esesëve. Të tjerët sulmojnë. Luloja nga vendi i mbështet me zjarr. Në disa sekonda mitralozi

e kaloi shiritin në gojëz dhe e hodhi tej si një mbeturinë të panevojshme. Luloja është qitës i shkëlqyer. Ai më plumbat gjurmëlënës kontrollon saktësinë e qitjes.» (Shënim i datës 29 dhjetor.)

«Sot Goxho Bërdëllima u bë çakërqejf. E gjeta në pozicion me numrin e ri të revistës së brigadës, nëpër dhëmbë murmuriste, mundohej të përsëriste fjalët që lexi. «Mirë ka shkruar dreqi», më tha për një shkrim që bëri Agim Noka për skuadrën e tyre. Kushedi ç'thotë më tutje, prapë ia ngul sytë fajes së revistës e lexon, s'ka forcë të ecë. Janë një pyll i madh e i lodhshëm radhët e shkronejave për xha Goxhon». (Shënim i datës 29 dhjetor).

«E ardhmja e popujve nuk është më një humbëtirë e pafund. E ardhmja u përket popujve që derdhin gjakun nëpër llogoret e luftës, e ardhmja do të ndriçohet nga vezullimi i ngjyrës së kuqe.» (Shënim i së njëjtës datë.)

\* \* \*

Kolonel Vilenbergu ndërmori një kundërsulm tjetër kundër pozicioneve tona.

— Kokëngjeshur këta derra derri, — i tha Dardanit Goxho Bërdëllima që nga pozicioni kur pa egërsinë e ushtarëve esesë në sulm.

Gérxhet që zumë dhe mbanim ngjanin si dhëmbët e një sharre gjigante. Plumbat e armëve tona i bluanin ushtarët esesë që afroheshin. Dalja e brigadës sonë në vargmalin mbi xhade i ndezi sytë e kolonelit si ujk, natën i godiste pozitat tona «syri» verbues i projektorit, ditën grykat e zjarrit buzë xhadesë në luginë dukeshin sikur grideshin me njëra-tjetrën se kush do ta zgjaste grykën më përpara e të hidhte predha më të rënda mbi formacionin tonë.

Edhe ato çaste të rënda Sopot Golemit s'i trihite qerpiku. Erdhi në vijën e parë me ballin tërë djersë. Mundohesha të gjeja të veçantën te komandanti ynë. Kishte një shtat të bukur, një pamje në fytyrë që të jepte guxim, flokë të zez e shpatulla të gjera. E ndiqte nga afër përleshjen.

— Duhet ta thyejmë medoemos kundërsulmin e tyre, — dha urdhër Sopot Golemi.

Diçka e papritur. U shfaq befas në vijën e sulmit dora e hekurt e kolonel Vilenbergut. Mbi pesëqind ushtarë me uniforma të murme na u afruan duke qëlluar e duke gërrthitur si egërsira. Në lartësitë përleshjet u bënë dhëmb pér dhëmb.

Brigada e zmbrapsi sulmin e esesëve dhe, duke i ndjekur ata, arriți përballë qytetit. Aty ndeshëm në një qëndresë tjetër të esesëve. Hodhëm granatat e dorës dhe vrapuam në sulm.

— Vdekje esesëve! — thirri komandanti i kompanisë, Dardani. Të shtyrë nga një hov i përbashkët, vazhduam sulmin. Azem Bajguri bashkë me shokët e afroi topin më afër vijës së parë.

Dardanit iu duk se pozicionet e armikut në lartësi u asgjësuan. Ai vrapoi. . . Nga afër e morën në shenjë disa armë, shtinë drejt tij. Plumbat ranë tufë, kafshuan borën e ngrirë dhe në atë vend ku zuri pozicion Dardani, guri ku ai u mbështet pér të fshehur trupin nxori tym. Ai nuk u hutua, i vuri fishekë të tjerë dhjetëshes dhe hodhi vështrimin nga të dy krabët. Donte të sigurohej, e cte përpara me të gjithë, apo. . . Ky vështrim i hoqi mundësinë të shikonte disa esesë që i kishte aq pranë dhe i drejtuan tytat e belgjikëve. U habit kur afër ndjeu një shpërthim granate. Pér pak e rrëmbyen copat, aq afër tij shpërtheu granata. U bë gati të qëllonte me dhjetëshen, por u zmbraps i trembur kur në vorbullën e tymit të granatës u duk Bukurie Çabiri. Ata që e morën në shenjë Dardanin u gjendën nën goditjet e granatës së saj. Ushtarët u munduan të largoheshin, njëri mbeti në vend e s'guxoi të ikte, u shtri në fundin e llogores e thirri:

— Austriak! Austriak!

— Austriaku i sat ème, — hungëroi Goxho Bërdëllima dhe i drejtoi grykën e malipherit.

Duke ecur në sulm në krah të Zefit, partizanit të një skuadre tjetër, dëgjuam anash krismat e armëve dhe një breshëri plumbash, që na erdhën pas krahëve. U hondhëm në pozicionet e armikut.

Katër esesë të armatosur, dy me automatikë dhe njëri me mitraloz erdhën drejt nesh. Pandehën që ishim shokët e tyre. I qëlluam. Tre prej tyre ua mbathën këmbëve, njëri ra përmbyss në borë.

Zefi këmbëshpejtë e shalëgjatë me malipher në dorë i ndoqi këmba-këmbës. Kishte dëshirë të madhe të kapte mitralozin. Shpesh Zefi pyeste komandantin e kompanisë: «Shoku Dardan, kur do të më jepni edhe mua një mitraloz?» Dhe Dardani i përgjigjej se mitralozin ai duhet t'ia merrte armikut. Kësaj here Zefi kishte vendosur që t'ia arrinte qëllimit. E ndoqi këmba-këmbës. Zefi e rrëmbeu mitralozin. Ai, si të mos ishte në vijën e parë të luftës, vrapi e kërkoi komandantin.

— Tash, shoku Dardan, besoj se do të ma lini ta mbaj unë këtë mitraloz, — tha Zefi me ata sy të zinx flakërues.

Në fillim e rrëmbyen sytë e gëzuar të Dardanit, pastaj duart e tij të fuqishme e shtrënguan fort luftëtarin.

— Esesi më shpëtoi, bre, — u ankua Zefi me sinqeritetin e një fëmije që tregon cdo gjë që i ndodh.

Gjurmë dhe yje të kuqe, dhimbje dhe këngë... Jetojmë me madhështinë e heroizmit. Ai na përpin në gjirin e vet. Gjurmët e heroizmit të luftëtarëve tanë i ndeshëm

ngado që shkelëm nëpër fusha të gjera, gryka të thella qafa të ngushta, buzë lumenjve të rrëmbyer, majë kresh-tave të larta, kudo... Ato nuk i shuajnë dekadat, as she-kujt. Toka i ruan në gjirin e vet, popujt ua transmetojrë brezave... Në çdo hap që hedhim ndalemi dhe përcaktojmë të njëjtat gjëra: pozicionet e armikut e mandej vepri-met tonë, nga nisma gjer në hedhjen e granatës. Lexojmë përsëri në faqet e ditarit të Andrea Sotirit, i cili në çdo hap që kemi hedhur përparrë ka shkruar:

«Vargëzimi i maleve shkon tutje pa mbarim me thyerje të shpeshta e pamje të ashpër dhe s'të besohet që mbas këtij mali është një qytet. Aty ku qëndronte në vëzhgim kolonel Vilenbergu arriti komandanti i brigadës sonë, Sopot Golemi». (Shënim i datës 30 dhjetor.)

Dhe më poshtë:

«Pozicionet e esesëve përparrë qytetit dalngadalë e një e nga një i morëm dhe balli i sulmit arriti te lartësia mbi qytet, aty ku kolonel Vilenbergu një orë më parë drejtonte kundërsulmin. Lartësia është prerë me llogore. Sulmit tonë nuk mundën t'i bënин ballë, nga të dy kra-hët esesët ikën të thyer, ikën e kthenin prapa grykën e pushkës. E para herë që i shikuam të shtinin duke vra-puar pa vështruar drejtimin e plumbave. Ishte një ikje e trembur që ndodhi mbas përlleshjes me granata.» (Shë-nim i së njëjtës datë.)

«Zhytemi në borë, vetëm gjokset tona mbesin jashtë dhe armët. Gjoksi për të marrë frymë, arma për të luf-tuar. Ngajmë me gogozhela të bardhë, mundohemi të shkundim borën siç mundohen edhe pishat e larta. Po as ne dhe as pishat s'mundin. Dimri rëndon mbi njerëzit, mbi drurët dhe mbi malin.» (Shënim i datës 30 dhjetor.)

«Ndodhemi larg zhurmës së erës dhe afër gjëmimit të topave. Komandanti i brigadës, Sopot Golemi, na po-rosit të ruhami nga të papriturat. Syri ynë nga mëngjesi në mbrëmje ngoset me bardhësi bore, me shkëlqim akulli dhe me ushtarë esesë të egërsuar. Luginës rrjedhin paralel lumi me ujë të bardhë dhe kolona e gjatë pa mba-rim, sa edhe vetë lumi që tërhiqet me ngut përmes kris-mash». (Shënim i së njëjtës datë.)

## XXVIII

— Unë e njoha, ai është, e njoha! — tha papritur njëri nga shokët tanë, pjesëmarrës në luftimin për shpëtimin e njerëzve të mbyllur në kampin shfarosës te xhamia në anë të qytetit. Shënoi në listë numrin 507 dhe emrin e partizanit. — Ndonjë luftëtar tjetër nga tanët nuk është vrarë. Në këtë vend e varrosëm. Ju kujtohet? Ai mbante pushkë malipher, këta a janë plumba malipheri.

Skifter Velça nuk foli, se ai qe plagosur e nuk ishte në këtë luftim. U afrua një burrë i moshuar. Ishte i zoti i shtëpisë.

— Atë natë shtëpia ime u mbush me gjermanë, — tha burri i moshuar. — Mua më lidhën dhe më zbritën tek ura. Ja, aty, te xhamia ishte bërë kampi i vdekjes, aty na kishin mbyllur me tri radhë tela dhe të rrethuar me rojë. Kur dolëm nga kampi dhe u ktheva në shtë-

pi, gjeta mbi tridhjetë kufoma gjermanësh të vrarë. I hoqa nga shtëpia, i hodha aty, midis pérroit.

— Kurse ne, atë tonin e varrosëm këtu, te lisi, — tha Isaaja.

Përsëri fjala erdhi te partizani që mbante pushkë maliheri.

— Ai edhe vetë ishte i sertë, edhe plumbat i donte si vetja, të sertë, — plotësoi Skifteri. Atij iu kujtua ankesa e partizanit pér pushkën maliheri. Njëherë në luftë e sipër ai ndeshi në një ballist që kishte vënë në drurin e pushkës disa shenja. Me ato shenja ballisti qe mburrur se pér çdo partizan të vrarë kishte vënë një shenjë në kondakun e armës që mbante. Kur mësoi si qëndronte çështja, nuk e çoi në shtab ballistik e kapur rob, por e qëlloi me pushkë midis gjoksit. Më vonë u bë xhind kur mësoi që ballisti nuk kishte vdekur. «Ka plumb të lehtë maliheri», — u ankuva si pérherë dhe pér pak sa s'ndërroi pushkën. Nga ajo ditë ai i çante në majë plumbat e maliherit. «Ja, i shikoni si janë këta plumba? Gjetëm disa ballë me fishekë.» Kështu plumbi bënte më shumë dëim, vriste njësoj si belgjiku, armikut ia bënte trupin shoshë.

Përsëri biseda u vërtit rreth ngjarjeve të ditës së fundit të vitit, tek përleshjet që u bënë në xhade dhe brenda në qytetin e Stari-Varoshit me ushtarët e kolonel Vilenbergut dhe te tridhjetë esesët që kompania jonë i asgjësoi duke ua hedhur nga dritaret granatat brenda.

Një ditë më vonë, natën e fundit të dhjetorit, i kishim shkuar më afër xhadesë e qytetit në luginë, via shndritëse e vetëtimës që lëshuan armët e brigadës u shtri në një vijë, ajo kalonte afër qytetit me zigzagjet e rrufesë, nga njëri skaj i malit mbi qytet në tjetrin. Ar-

mët e brigadës e ushqyen në vazhdimësi vetëtimën dhe ndriçimi i saj në errësirën e natës jepte shenjën që brigada vazhdonte sulmet në drejtëm të xhadesë e të qytetit. Te një pozicion dëgjohej këngë. S'e dinim cili ishte.

Kush ishte ai që këndonte? Goxho Bërdëllima, Ago Ymeri, Lulo Driza, Bukurie Çabiri, apo Azem Bajguri që qëllonte me top? Jo, ata ishin dy: Adilja, sanitarja e kompanisë, dhe djaloshi nga Kosova, Hazir Përdrini, që të merrete gjak në vetull. Adilja ishte duke i mjekuar plagën Hazirit. Por, papritur, sapo zbardhi dita, Adilja u godit nga larg prej plumbit të një pushkë «Shnajper».

Adilja mënjanoi kokën dhe ishte zbehur në ftyrë, kënga i mbeti në buzë, vështroi shokun që kishte pranë. U përpinq të fliste, bëri të lëvizte dorën, po s'e lëvizi dot, i ishin rënduar gjymtyrët dhe iu duk sikur ato i kishin lëshuar rrënje në tokë. Hazir Përdrini e hodhi në krah trupin e saj.

— Vëlla! Vëllaaa! — belbzoi me zërin e mekur Adilja.

— Mos, Adile... Mos fol! — i tha Haziri. Ai e harroi dhimbjen e plagës në pulpën e këmbës.

Eci shpatit të bardhë duke lënë një vijë të kuqe në atë bardhësi. U mundua t'i ndalte rrjedhën e gjakut. I ndjeu gjymtyrët të këputura. I dridheshin këmbët, duart. Edhe zëri i dridhej. I tha:

— Jo, motër, jo! Nuk të lëmë të vdesësh!... Ja edhe pak, arritëm, motër! — dhe me Adilenë në kurriz, me automatikun e saj varur në supin e majtë dhe gjermankën e vet në dorë, ecte, rrëzohej, ngrihej përsëri, ecte, rrëzohej e ngrihej e ngjitej lart bardhësisë së atij mali përtat çuar sa më parë në infermerinë e brigadës.

Frynte erë. Në ftyrën e tyre prisnin brisk kokrizzat e borës. Hazirit i dillnin avuj nga goja. Adilja kishte varur kokën mbi supin e tij. Nuk nxirrite zë.

— Ma jep mua, — i tha një shok që e ndeshi në shpatin e malit.

— Jo, jo! — kundërshtoi Haziri dhe eci. Këmbët i shkitën në borën kallkan. Përsëri u ngrit.

— Ka mbaruar... Kjo ka mbaruar..., — i tha shoku,

Haziri ngriti kokën si një dre i trembur, iu drodh zemra. Ndaloj.

I mbeti vështrimi te fytyra e zbehur e Adiles, mandej te shoku që kishte pranë. Tjetri kurrë nuk kishte parë një fytyrë aq të pikelluar. I dridheshin nofullat. Thirri:

— Adile! Motër! — Zëri i doli drithërues, si të mos ishte zëri i tij.

— Vajza vari kokën, krahët, trupin në krahët e tij të gjatë. Ai mbështeti ballin e vet tërë djersë të ftohta mbi ballin e saj akull, u mundua t'i kapte pulsin. Në buzët e dridhura i mbeti fjala:

— Motër! Motër...!

Mbasdite ata u kthyen në skuadër. Prunë lajmin pikellues dhe automatikun e Adiles.

— Vdiq? — pyetën sytë tanë, sapo u kthyen.

— Jo, motra Adile ra si bien trimat, — tha Haziri me bebëza të zmadhuara e me fytyrën meit, — po ajo ka lënë vëllaznit e motrat, që do t'ia marrin hakun qindfish!

\* \* \*

Goxho Bërdëllima ulur mbi trungun e një abu të rrëzuar pinte duhan dhe qëndronte si i ngurosur. Ndihej te të gjithë humbja e Adiles. Bora si një purpur i bardhë vazhdonte të binte. Ai ndjeu një shtypje në gjoks plumb të rëndë si atë ditë që iu vra i biri. Vuri re që pikellimi i humbjes së motrës Adile na kishte impirë mendjen, kurse acari gjymtyrët. Ndjeu rezikun dhe lëvizi nga vendi.

— Delet i dorëzohen ujkut, pse nrimë kështu? Për kokën time mbaruam, hajde të gallisim. Këtu ose e fitojmë këtë punë, ose shtrigë furtuna që shfryn si lubi! — Tha fjalën dhe shkoi në drejtësim të një pishe të tharë me rrënje e degë, por që ende qëndron në

këmbë. I erdhiri reth trungut, futi duart në zgavër dhe çori një copë astar nga palltoja e vjetër. Eshkën e mbante të thatë, çak, masati e ndezi eshkën. E tundi leckën në ajër gjersa ajo mori flakë. E shtyu me rrëmbim në zgavër dhe pa flakën që rrëmbeu gjithandej.

— I vure zjarrin pyllit, xha Goxho! — i folém ne.

Pishën e rrëmbeu flaka dhe vendi feksi përreth. Afshi i zjarrit e largoi afshin e ftohtë të borës që binte. Ngroheshim të heshtur. Ishte nata e parë që nuk ishte midis nesh Adilja. Dardan Velishta donte ta largonte pikëllimin nga shokët, ia mori këngës për Adilen:

*Motra jonë partizane  
sorkadhe përmbi sorkadhe.*

Zëri në fillim i doli i dridhur. E përsëriti dhe një herë fjalën, e pasoi shoku që ia kthente dhe bëmë iso ne të tjerët.

— Iso për këngën e plumb për armikun, — tha Goxho Bërdëllima. Dardani i dha më forcë zërit dhe kënga vazhdoi.

Vuvurima pa mbarim e erës që frynte në pyll i dha më hov flakës, por i mbante iso edhe kënga labe. Se këngët jehonin në këto male bashkë me ne, ato ishin më të ndezura se zjarret ku kalonim natën e ftohtë.

Vasoja po binte ushqim në vijën e parë të përleshjes duke murmuritur këngën e tij të preferuar:

*Asgjë nuk duam, nukë,  
veç ca plumbba dhe pak bukë.*

Dinte që ishte midis shokëve, por befas ndeshi ballë për ballë me dy esesë. Njëri iku i trembur nga plumbat që i ranë afër, kurse tjetri s'mundi të ikte, e kishin kapur si darë duart e Vasos. Ishin kapur fytafytas. Gjermani e mbante automatikun drejt kraharorit të Vasos, ndërsa Vasoja me flokët të çakërdisur e godiste me thikë duke hungëruar:

— Na, qen! Naaa!

Esesi sybardhë u përplas përdhé, me thikën të ngulur gjer në dorezë. Vasoja qëndronte në këmbë, me flokët ngritur drejt, si drizë, me sytë flakë, duke shikuar armikun e shtrirë. Kur nisi të hidhte hapin drejt nesh, iu morën këmbët.

— Diçka i ndodhi Vasos, — u tha shokëve Dardan Velishta dhe iku për t'i vajtur në ndihmë.

Vasoja nguli të dy këmbët, deshi të qëndronte, pos'mundi, ra në borë. I zbërthyem xhaketën dhe i gjetëm plagë plumbi në kraharor...

E patëm vështirë ta tërhiqnim Vason. Ishte trup i gjatë, i rëndë.

Në infermierinë e brigadës ia dogjën edhe një herë plagët me alkool dhe ia lidhën me fasha të bardha. Aty, pranë zjarrit, i hodhëm sipër pallton e tij dhe, kur dremiti, ikëm. Në heshtje pyetëm njëri-tjetrin:

— Do të shpëtojë?

As ai vetë nuk e dinte sa kohë kishte qëndruar në kllapi të plotë, por, kur u përmend, ndjeu ison e këngës. Isoja e këngës i kujtoi Adilen, sanitaren e shkathët e simpatike që u kishte lidhur e mjekuar plagët gjithë atyre shokëve e shoqeve në vijë të parë. E dinte Vasja se, edhe kur të shërohej e të ktuhehej në kompani, nuk do ta dëgjonte më zërin ligjërues të saj.

Brigada vazhdonte luftën, kurse aty pranë ziente isoja e këngës. Ishte grupi diletant i brigadës. U jepte shfaqje të plagosurve dhe fshatarëve.

Vasoja provoi të afrohej te dritaria, dhimbja e mbajti në vend. Murmuriti: «Eh, të ishte gjallë ajo. Bënte

këngë të bukura Adilja. Ajo ligjëronte si thëllëza e malit». Ai dëgjoi të thoshin:

— Grupi do të këndojoë këngën e sanitares partizane, këngë për motrën Adile.

Gjoksi i Vasos thithi ajrin dhe trupi i tij arriti me mundim gjer te dritarja. Donte ta dëgjonte. Isoja ziente dhe këngëtari me zë të lartë tregonte për luftimet që bëri brigada ditën e fundit të vitit dyzet e katër dhe për trimëritë e vajzës partizane. Murmuritën edhe buzët e të plagosurit vargjet e këngës:

*Adile, cikë stëralli,  
xixa syri, flakë balli!...*

## XXIX

Nga copëza jete të kohës më vijnë të afërtë ashpërsia e luftimeve që u zhvilluan ditën e fundit të vitit dyzet e katër dhe shokët: Dardan Velishta si zgalem në furtunë, Azem Bajguri me top..., minatori Lulo Driza, gurthyesi Ago Ymeri, duke bërë qitje me mitraloz, Goxho Bërdëllima me malipherin në dorë, Vaso Lundra me thesin e intendentit në krah, Bukurie Çabiri me fjalën e saj të ëmbël, Hazir Përdrini duke kenduar këngën maje krahut, gjurmët e ndezura të gjakut të derdhur:

Ecëm mbas gjurmëve të brigadave në Mal të Zi e më tej në Bosnjë. Përmendim brigadat: Brigada e Pestë... Brigada e Gjashtë... Brigada e Tretë... Zgjaten pa fund njëshkolonat e brigadave. Përsëri të tjera Brigada: Brigada e Shtatë... Brigada e Tetë... Brigada e Njëzetëdytë... Brigada e Njëzetepestë... Njëzet e ca mijë partizanë e partizane të Shqipërisë që luftonin në këto male, fshatra e qytete.

— Mbi gjashtëqind dëshmorë, — tha Skifter Velça i menduar. Zbritëm drejt këmbës së urës së qytetit në bregun e lumit. Aty janë varrosur dy shokët tanë. Vajtëm aty mbas shirave. Toka ishte e lagur. Zbritëm me mundim. Ecëm njëri pas tjetrit, i pari si gjithnjë e cte Skifter Velça. Asnjëherë nuk e pashë të lodhur, ashtu si atëherë në ditët me luftime, i gjallë në ecje dhe fjallëmbël. Monopati nga premë që të binim tek ura e gurtë në dalje të qytetit ishte me tokë shtufi. Duke ecur, bisedonim për ditën e parë të viti dyzet e pesë, për sokëllimën e Sopot Golemit, komandantit të brigadës sonë, që zbriste plumb mbas plumbave të automatikut të tij duke thirrur:

— Përpara, brigadë partizane! Përparaaaa!

Për këto çaste bisedonim, rijetonim ato luftime. Ndeshja me esesët e divizonit «Brandenburg» ishte e ashpër, ajo zgjati tre muaj. Brigadat tonë atë e shporrën nga Kosova, edhe nga malet e Sanxhakut. Mbeturinat e këtij divizioni të përforcuar nga forca të tjera i vumë në ikje.

Kërkohej medoemos të kapej ura, për t'ua mbyllur shtekëkalimin.



Në çastin kur prisnim që ndeshja të përfundonte, esesëve të kolonel Vilenbergut u erdhën përforcime nga Vishegradi. Krahu i djathtë i brigadës u rrezikua së tepërmë.

— Hë ti, partizani i radios, kërkoje brigadën e vendësve, kërkoje de! — i thirri Sopot Golemi.

Radisti mblodhi supet.

Sopoti kaloi në një batalion tjeter. Kur u kthyen andej, nga meraku shkoi te radisti.

— E, bre shok, ende s'po bie në gjurmë të brigadës vendëse që thuhet se e kemi në krah! — Sopoti bisedoi

me Argjir Progrin. I tha: — Përse nuk dëgjohet radioja e tyre? Si do të jetë puna? Ku shkuan ata?

Brigada hyri në luftim me zbardhëllimin e ditës dhe vazhdoi sulmin.

Sopot Golemi kërkoi përsëri radistin: «E de, më thuaj si është puna. Flas me korparmatën tonë në Shkodër sikur e kam këtu, më arrin zëri gjer në Tiranë, dhe s'po flas dot me brigadën vendëse që kam në krah.»

Komisarit të brigadës i lëvizi si purtekë midis ballit një damar, shtrëngoi grushtet dhe mendohej...

\* \* \*

Ish te dita e parë e Vtitit të Ri. Ajo na gjeti në luftë e në përleshje.

— Edhe ky vit do të jetë me re të zeza, më rrymë të ftohtë e mot të rënduar, — tha devolliu Argjir Progrini.

— Po, po, edhe këtë dimër të egër, me erë e furtunë, me të ftohtë që mpin edhe drurët do ta kalojmë në përleshje..., — tha Sopoti.

Në vijat e luftës ditën e parë të Vtitit të Ri 1945 na u shfaqën ushtarët esesë, që po kundërsulmonin pozitat e humbura.

Ushtarëve me uniformë të murme që erdhën nga Vishegradi u kërkuam me plumb zemrën. Ne kishim besim të plotë se nën goditjen e gjithë popujve gjatë vitit 1945 kuçedra hitleriane do të gjunjëzohej. Komandanti i brigadës dha shenjën e sulmit. Komisarët dhe komandantët e çdo kompanie sokëllinë me të madhe:

— Përpara, partizanë, përparaaa!

Sulmi ynë në orët e para të mëngjesit u bë i pa-

përbajturi. Me granata u hodhëm mbi ta. Nëpër shpërthimet e granatave pashë Dardanin të vraponte mbas granatës së tij duke ndjekur një kapiten hitlerian që vraponte me të katra. E ndiqte mbas dhe i thërriste:

— Qëndro aty ta shohësh, qëndro! — Kapiteni ishte bërë erë, por plumbat e dhjetëshes së Dardanit ia prenë hovin.

Kufoma mbeti aty disa hapa para Dardanit.

Kolonel Vilenbergu nuk mundi të bashkonte forcat e tij në anën tjetër të lumit me ato që erdhën nga Bosnja.

\* \* \*

Komisari i Brigadës, Argjir Progri, në emër të komitetit të partisë të brigadës shkroi dhe sot u shpërndau në brigadë një tjetër thirrje. Një kopje e saj kaloi dorë më dorë në gjithë kompaninë. Ajo erdhi edhe në pozicionin tonë. Bukurie Çabiri na mblodhi rrëzë një shkëmbi dhe na lexoi thirrjen.

*Komandantë e komisarë!  
Partizanë dhe partizane!*

*Viti i ri 1945 na gjeti larg atdheut, në vəzhdimin e luftës që e nisëm pesë vjet më parë.*

*Edhe këtë Vit të Ri e përshëndesim me krismat e forta të armëve tona, drejtuar armikut më gjakatari të popujve. E përshëndesim me përpjekjet tona për të ngritur gjithnjë më lart emrin e popullit tonë, të Atdheut tonë, të Partisë sonë, të Ushtrisë sonë heroike, e përshëndesim me shpirtin tonë internacionalist, me këngën tonë të pavdekshme:*

*Internationale do të jetë bota e Re.  
Sot, ditën e parë të vitit, edhe ne si gjithë luf-*

*tëtarët e brigadave tona që vazhdojnë luftën kundër hitlerianëve në tokat e Jugosllavisë, përshtendesim dhe ngjatjetojmë popullin shqiptar, Ushtrinë Nacionallçirimitare, Komandantin tonë të Përgjithshëm, shokun Enver Hoxha, dhe ju premtojmë me bindje dhe vetëmohim se do ta vazhdojmë luftën deri në arritjen e objektivit të fundit: shkatërrimin e plotë të nazifashizmit.*

\* \* \*

Hovi i sulmit tonë ishte në rritje. Dardani, sapo doli në lartësi, shtrëngoi fort pushkën dhjetëshe, aq fort, saqë iu tendosën muskujt, donte kështu të shuanë rrëmbimin që të mos ngutej. Aty kafshoi fort buzën e tij, e kjo e shëmtoi pak në fytyrë. U kuptua që gjelltiste atë që s'donte ta gjelltiste Dardani partizan, por i duhej Dardanit komandant. Ishte përpjekja e dhimbshme për të frenuar vetveten. Ai e bëri këtë.

— Asnjë hap më tej, ndalon! — thirri më zë të lartë mbas sulmit që bëmë. Njëherësh të gjithë ramë në tokë me vështrim përpara e të zemëruar me Dardanin që në çastin kur ishim vënë në ndjekje të esesëve dha urdhër të mos shkonim më tutje. — Këtu qëndroni, asnjë hap më tej; — thirri Dardani, i trembur se mos papërmabjtja në sulm bëhej shkak që të mos zbatohej urdhri që i dha komandanti i brigadës. Ai kishte marrë urdhër që, sapo të merrej lartësia mbi urë, kompania të qëndronte në vend. Në aso rastesh ishte domosdoshmëri qëndresa, ajo u shërbente më tepër veprimeve të brigadës se sulmi.

— Asnjë hap më tej, — urdhëroi. — Jemi larguar shumë nga shokët. Këtu qëndroni, këtu!

Mbas pak arriti komandati i brigadës, Sopot Golemi.

Erdhi me një frymë. Marrja e lartësisë i duhet brigadës. Ai e shikoi për herë të parë aq afër qytetin. Rruga anës së lumit ishte e mbushur me ushtarë. Kolona tentoi të tèrhiqej. Ai dha urdhër:

— Topi të sillet këtu!

Azem Bajguri me shokët e tij duke e shtyrë e prunë topin në vijën e parë. Pa u vendosur topi në pozicion, lugina u mbush me mjegull.

— Ka shtëpinë e saj mjegulla në këtë luginë, mos u mërzit, Azem, — i tha Dardani.

— Mos, breeee! — u ankua Azemi duke vështruar grykën e topit.

Azemi qëndronte pranë topit, drodhi një cigare e i mërzitur, tha:

— S'po pran kjo mjegull e mallkueme. Si me ba, bre?

Hapi kasetën, vështroi predhat, mbushi topin dhe priste që të ngrihej mjegulla dhe të jehonte topi i tij për çlirimin e atij qyteti.

— Paj, — tha i shqetësuar Azem Bajguri, apo shikoi në tejkëqyrësen e topit makinat që shkonin në drejtim të urës.

Dardan Velishta iu afrua Azemit.

— Këqyri, bre, këqyri, breeee, shoku Dardan, — tha Azemi, — qe ku kanë dalë esesët e kolonel Vilenbergut. I shikon? — Fliste e lëvizte instrumentet. Gryka e topit kërkonte shenjën.

— Zjarr! — komandoi Azemi.

Dylbia e topit ia pruri afër shpërthimet dhe i gëzuar mbas çdo shpërthimi që godiste te makinat në zhade ai thërriste:

— Bukur, vëllazën, zjarr!

Goditja e topit fuqizoi sulmin e brigadës.

U dëgjua një zë i thekshëm malësori që sokëllinte në vijën e parë të luftës:

— O, priti, gjerman, partizanët e Shqipnisë, breeee! Ishë sokëllima e Hazir Përdrinit.

\* \* \*

Kolona u hodh dhe një herë drejt prites sonë tek ura që të hapte shtegun. U hodh me fuqinë që i sulet rröbës ngacmuese demi i arenës së cirkut. Zemërimi u ndez në shpirtin e ushtarëve dhe ata erdhën në drejtim të urës për dyluftim. Kësisoj u hapën shtegun për të vrapuar, po brinjët u mbeteshin zbuluar. Plumbat tanë i godisnin në brinjë. Pak më lart sokëllinte Sopot Golemi:

— Zjarr! Zjarr!

Kompania jonë u hodh në drejtim të këmbës së urës.

Kolonel Vilenbergu përpërlej si grifsha kur i thyen njërin krah. Plumbat tanë s'e linin të bënte një hap përpara, as kolonën të térhiqejet.

Në breshërinë e plumbave të mitralozit, kompania jonë përparoi drejt urës. Hazir Përdrini nuk ishte larg nga arma që villte zjarr, mori në shenjë mitralozin që ishte mbi këmbën e urës, ktheu vështrimin prapa dhe thirri me sa zë kishte:

— Mbi ta, breee! — dhe u sul në drejtim të mitralozit. U dëgjua zëri i Hazirit: — Para, part..., — po thirrja e tij afër urës së madhe u këput në buzën e tij të njomë nga plumbat e esesit, ashtu siç e këpusin fletën e gjelbër nga dega dhe bie në tokë, për të mos shijuar më kurrë njomësinë e natyrës.

U vra...

\* \* \*

Edhe aty, ku mbaronin vargmalet e një krahine e fillonin ato të Bosnjës, Goxhos iu rikujtua jeta e tij në malet e Labërisë, jeta me halle e me drama. Në thoshte: «Kam ç't'i tregoj dheut! Jetova e luftova, pashë kohën

e Partisë që ngriti në këmbë vegjelinë. Vegjelia e bëri forra! Partia e bëri Shqipërinë Shqipëri dhe frerët ia dha popullit, e bëri ushtrinë çelik e syshqiponjë që të rrëzojë përtokë italianë e jermanë. Afër varrit isha, më zuri vrulli i këngës së kuqe dhe drodhi valle dhe buzë-plasuri Goxho Bërdëllima. Po, po, drodha vallen e vendit, valle derti me gjurmë gjaku brenda. U bë qorri mesy. Ej, c'po bën kjo Parti, ferrat e Goxhës i krasiti një e nga një. Lima e komisarëve më lëmoi, më bëri dhe mua tjetër Goxho, më dha dritë në sy të shoh Shqipëri e botë, të shoh larg e të mendoj thellë, se, kur sheh drita e syrit larg, mendja e njeriut rrahka botën...»

Aty ku ishte në pozicion Goxho Bërdëllima filloi të murmuriste këngën e tij të preferuar:

*Mos pandehni se u plaka,  
mos pandehni se u lodha,  
trima djemt e mi!*

Nuk thirri si herët e tjera: «Iso, djem, iso për këngën e plumb për pushkën.» Shokët e skuadrës bënin zjarr mbi esesët, të cilët si të verbuar suleshin të dilnin nga rrethimi. Ashtu, papritur, i shkrepi që të hidhej sipër mitralozit armik tek ura. Dhe për atë i shkrepte në mend, Goxhos nuk i mungonte guximi.

— Atij gjarprit që më vranë djalin duhet t'ia shtyp kokën, — tha Goxho Bërdëllima për esesin me mitraloz të mbyllur në bunker. Disa hapa para grykës së mitralozit ishte shtrirë pa jetë trupi i Hazirit. Ai hoqi kapelen dhe mbeti kokëjashtë me flokët e thinjur e të rritur pak si tepër. E kishte rrëmbyer zemërimi i vrasjes së Hazirit që e donte aq shumë.

— Gjarpër duhet mbytur, — tha dhe eci përpara. E mbështetën me zjarr të gjithë shokët e skuadrës.  
— Atij që na vranë Hazirin do t'ia bëj gropën se s'bën,  
— tha dhe rrëshqiti përpara.

Esesi në bunkerin e madh tek ura e ndjeu rrëzikun, e vuri në shenjë atë që guxoi t'i afrohej. Esesi shtinte, xha Goxhos i duhej ende guximi të arrinte

gjer afër që të përdorte granatat. Kjo bëri që vështrimi ynë të qepej te këmba e urës ku sulmonte Goxho Bërdëllima.

Dardani e hodhi vështrimin andej nga shkonte këmbadorazi në drejtësim të mitralozit xha Goxhoja e, i trembur, tha:

— Do të vritet!

Buzë lumit bora ishte shkrirë, koka me flokë të bardhë borë e xha Goxhos shihej që larg. Mbas pak pozicionin ku ishte struktur esesi e mbuloi tymi. Nga tymi i granatave nuk pamë se ç'ndodhi... Goxho Bërdëllima ia hapi shtegun kompanisë duke ia lëshuar esësit granatën në bunker.

— O, priti partizanët e Shqipërisë, breee! — sokëllinë me të madhe. Kompania u hodh drejt urës. Xhadënë e vumë nën zjarrin e armëve tona.

\* \* \*

Kolona e kolonel Vilenbergut që mbushte luginën me ushtarë e topa nuk kishte më forcë rrëshqitëse, ajo i ngjante gjarprit të goditur në kokë. Kolonel Vilenbergu u përpoq të ndërmerrte një kundërsulm sa të hapte dhe një herë shtegkalimin, po sulmi i brigadës nuk e la të merrte frymë. Ai me sy të zgurdulluar u dha urdhër esesëve të hapnin shtegkalimin. Kur nuk ia doli në krye, hungëroi si ari i plagosur, vështronë syngrirë sulmin tonë, dëgjoi zërin e Sopot Golemit dhe s'diti q'të bënte tjetër. E kuptoi se nuk i kishte mbetur tjetër rrugë shpëtimi veç të vravonte nëpër plumbat në drejtësim të Vishegradit. Ju duk vetja si njeriu më i braktisur në botë. Vrapoi nëpër plumbë që t'i shpëtonte darsë së rrethimit.

— Ai ishte me grupin që doli nga qyteti dhe arripi gjer tek ura e lumit, — pohoi për kolonel Vilenbergun një ushtar që u kap. U tha gjithashtu se një partizan

kishte parë midis të vrarëve një trup të gjatë me shenja koloneli. Trupi i rënë përmbyss ishte mbërthyer e bërë një i vetëm me ujët. Partizani e kishte tundur, donte të sigurohej. Fjala arriti gjer në veshin e komandantit të brigadës.

— Ku, ku? — pyeti Sopot Golemi.

Trupi i gjatë i kolonelit kishte rënë përmbyss midis kufomave të tjera të ushtarëve te këmba e urës, buzë lumit. Kishte rënë me fytyrë në ujë dhe aty kishte ngrirë.

Popujt do të hakmerren gjer në fund, — tha Sopot Golemi.

■ ■ ■

Nga Vishegradi të tjera reparte u erdhën esesëve në ndihmë. U vumë përsëri ballë pér ballë, ne me tytat nga malet e Bosnjës, ata nga ne.

Edhe ditën e parë të vitit dyzet e pesë predhat këmbohen nga afër. Krismat e të dyja palëve u shkrinë në një të vetme. Luftimet zhvilloheshin me grana dore. Njëri nga tanët guxoi të ngrihej në këmbë. E njohëm. Ishte komandanti i brigadës.

— Në sulm, partizanë — kumboi zëri i tij. Ai çau përpara përmes plumbave.

Sokëllima dhe guximi i tij na hodhi të gjithë në sulm. Trimëria hapi udhë përmes krismave, hapi shtigje të tjera midis ushtarëve me helmeta dhe kryqe. Radhët tonë shkuan më përpara.

Thirrja «Në sulm, partizanë», si maja e bajonetës, i ndoqi esesët këmba-këmbës...

## NE VEND TË EPILOGUT

Në qytetin e Vishegradit në Bosnjë kaloi një tren, mbi harkun e urës së gurtë shëtisnin njerëz, poshtë harkut të urës lundronte një barkë e madhe me motor, në ndërtesën afër hotelit ishin vendosur arkivolet e kuqe me yje të ndezura dhe me emra. Ishin arkivolet e të rënëve në luftimet e viti dyzet e pesë për çlirimin e atij qyteti, ata që s'e ndaluan pushkën gjer në 9 maj të viti dyzet e pesë kur kuçedra hitleriane u gjunjëzua nga lufta e popujve. Ne ish-luftëtarët e brigadave të Shqipërisë shkelëm në Drinsko, në Rudo, në Suhagorë, në Drobrun, në Priopole, në..., në Vishegrad. Dëgjuam nga banorët të përmenden në gjuhën e tyre emrat e brigadave tonë.

Në një mëngjes të brustë u nisëm. Mbi qytet kishte mijegull... Malet dukeshin të zymta. Rrugës kaluam me arkivole të kuqe.

Arritëm në Stari-Varosh. Përsëri arkivole të tjera

të kuqe me yje që flakërojnë dhe njerëz që hedhin lule.

...Rruga ishte e mbushur me turistë. Një turist me mjekër ishte te këmba e urës së qytetit. Ai fiksonte veten në fotografi në vendin e rrethuar me tela ku kishte qenë atëherë kampi. Ndoshta ishte ndonjëri nga ata që i shpëtoi rrethimit. Ndoshta ishte nga ata të skuadrës që i çonin në litarë njerëzit e këtij qyteti. Çfarë mund të jetë ky turist, që, kur pa kolonën tonë, u zembraps i trembur?!... Njëri nga turistët në anë të lumit, aty te këmba e urës, u aksidentua. Bëra një fotografi të kolonës me arkivole të kuqe.

Hodha vështrimin te turisti, mjekroshi i moshuar po fiksonte veten në fotografi te vendi ku kishte qenë kampi i shfarosjes. Ndoshta ai... I zemëruar e kyça aparatin në valixhe dhe m'u kujtuan ato radhë të nën-vizuara nga komisari i kompanisë sonë, Andrea Sotiri, në ditarin e tij. Ai shkruante: «Mbas lufte kapitalistët e reaksionarët do të mundohen të fshijnë gjakun që po derdhet nga popujt në këtë luftë që nesër të dalin me shenja kryqi dhe sépatat e nazifashistëve në helmeta. Kurrë nuk duhet të lejojmë të avullohet lumi i gjakut që derdhim!»

Kolona me yje të pashuara gjithnjë rritej... Kaluan kolonat nëpër luginat anës lumenjve Drin e Lim, çau Moraçë, përshkoi nëpër rrugët e malet e Bosnjës, San-kolonë. Kolonë me arkivole të kuq, me yje të ndezura kuq... Kombi i mblodhi ata.

Në kufi u hapën portat. Yjet e pashuara u kthyen në Atdhe...

Ushtarët e postës kufitare i përshëndesin me krisma armësh. Kolona eci... Në Shkodër nëna me të zeza. Në Kukës qyteti i ri hodhi mbi ta lule... Tirana, kryeqyteti, i priti nën diillin që shndriste. Ishte mbledhur në mi-thërues. Në radhë të parë të rreshtave familje dëshmo-

rësh dhe të afërmit e tyre, ish-luftëtarë të brigadave. Në mes tyre pashë Dardanin dhe Bukurien me tufa lulesh në duar. Pyetën:

— Erdhën eshtrat e xha Goxhos?

Të gjithë pyesin. Të gjithë duan të dinë.

Gazetat shkruan për kolonën e kuqe... Ardhjen e saj e ndjeu gjithë Atdheu. Kombi i mblođhi nga të gjitha anët eshtrat e luftëtarëve të rënë. I solli në kryeqytet. Janë mbi gjashtëqind. Një batalion me ushtarë përhëndetë me krisma. Veteranët, shokët e tyre, rrudhën ballin, pionierët shallkuq mbuluan arkivolet me lulet që mbanin nëpër duar. Radioja dha muzikë dhe këngë.

*Nëna ju kish rritur  
Për një botë të re...*

Ata u radhitën nën Statujën e Nënës Shqipëri, zunë vend me rreshta. U mbulua kodra e Varrezave të Kombit me yje të ndezura, me yje të kuqe...

Nënët e tyre vunë tufa me lule... Dora e nënave kaloi sipër emrave, ledhatoi germat dhe mermerin e bardhë. Dhimbja e nënave, gjithë kryeqytetasve u rrudhi ballin. Eshtë dhimbja e kombit për të rënët. Nënët nderojnë me grusht ashtu siç nderonin bijtë e bijat e tyre. Thonë:

*Djem, si na bëhet kështu,  
vitet tutje ju tëhu.*

Grykat e pushkëve të ushtarëve përsëri flakëruan si lulëkuqe.

Përhëndetën me armë të pavdekshmit.

Fund